

Bordi Editorial

PROF. DR. FERIT DUKA, *Universiteti European i Tiranës (UET)* – Drejtor

PROF. DR. ROMEO GURAKUQI, *Universiteti European i Tiranës (UET)* – Anëtar

DR. BLENDI KAJSIU, *University of Antioquia, Colombia* – Anëtar

PROFESSOR JOHN PARRISH SPRAWL, *Indiana University School of Liberal Arts* – Anëtar

PROF. ASOC. DR. BASHKIM GJERGJI, *Universiteti i Tiranës* – Anëtar

DR. NATHANIEL COPSEY, *Aston University, Britani e Madhe* – Anëtar

Kryeredaktore

PROF. ASOC. DR. BELINA BUDINI

Redaktorë shkencorë

PROF. DR. TONIN GJURAJ, *Universiteti European i Tiranës (UET)* – Anëtar

PROF. DR. ALEKSANDËR DHIMA, *Universiteti European i Tiranës (UET)*

DR. VALBONA NATHANAILI, *drejtore UET Press*

DR. IRENA MYZEQARI

Redaktore gjuhësore

MARSILDA NDINI

Arti grafik

BESNIK FRASHNI

BOTIM I FAKULTETIT TË SHKENCAVE SOCIALE
UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS / TIRANË
Bulevardi “Gjergj Fishta”, Nd. 70, H1, Tiranë, Albania
www.uet.edu.al / info@uet.edu.al



UETPRESS

Botime të kolanës “REVISTA SHKENCORE”.

© 2016 UET Press. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Asnjë pjesë e këtij botimi, mbrojtur nga ligji nr. 9380, dt. 28.04.2005 i Shtetit Shqiptar “Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera lidhur me të”, nuk mund të riprodhohet, ruhet, transmetohet a përdoret me asnjë formë a mjet grafik, elektronik apo mekanik, përfshirë por jo kufizuar fotokopje, skanime, digjitalizim, rrjet web apo sisteme të tjerë, pa lejen me shkrim të botuesit.

Punimet e paraqitura shprehin mendimet dhe qëndrimin personal të autorëve.
Redaksia nuk mban përgjegjësi për sa autorët kanë shprehur në shkrimet e tyre.

Universiteti Europian i Tiranës

Shtëpia Botuese Universitare “UET Press”

Adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Nd.70, H.1, Kodi Postar 1023, Tiranë, Shqipëri.

odeta.barbullushi@uet.edu.al

www.uet.edu.al/uetpress

Revista është kataloguar në datën e publikimit pranë Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë dhe Bibliotekës së Universitetit Europian të Tiranës.



Shtëpia Botuese Universitare
“UET Press” është pjesë e
Universitetit Europian të Tiranës.

Tiranë, 2016.

përmbajtja

Editorial

Media të reja; Komunikime të reja.....5
Belina **BUDINI**

Eufemizmat në ligjërimin publik shqiptar dhe raporti i tyre me të vërtetën9
Gilman **BAKALLI**

“Ringjallja e autorit” përmes vetë-stilizimit; rasti i kryeministrit Rama26
Belina **BUDINI**

Përdorimi i Facebook në zgjedhjet lokale.....36
Roland **LAMI**

Lindja e Berishës politik48
Alfred **LELA**

Femërorja në revistat e modës shqiptare56
Irena **MYZEQARI** & Teuta **ZYBERLI**

*Efikasiteti i teknikave të hipnoterapisë dhe të relaksimit
në reduktimin e ankthit të përgjithësuar: studim sasior*72
Klodiana **RAFTI** & Fleura **SHKËMBI**

*Modernizimi dhe Demokracia: Një vlerësim kritik ndaj teorisë së
modernizimit në studimin e demokratizimit*101
Gerti **SQAPI**

<i>Roli i muslimanëve në ndërtimin e ndërgjegjes kombëtare shqiptare</i>	<i>112</i>
Lulzim HOXHA	

Ese	
<i>Ndikimet e filozofisë antike greke dhe filozofëve bashkëkohës me të, në veprën e Gregorit të Nisës</i>	<i>122</i>
Arjan CURI	

Policy Paper	
<i>Adaptim arkitektonik pranë zonës “Harry Fultz”</i>	<i>136</i>
Otjela LUBONJA	

<i>Të rinjtë, rrjetet sociale dhe shoqëria e networkut.....</i>	<i>149</i>
Elisabeta BAJRAMI	

Recensë	
<i>Identiteti i Partive Politike në Shqipëri gjatë periudhës 1990–2013. Roland Lami & Aleksandër Kocani. Shtëpia botuese: Lambert Academic Publishing.....</i>	<i>165</i>
Anjeza XHAFERRAJ	

Recensë	
<i>Mbi librin “Vështrim i parë mbi Teorinë e Komunikimit” dhe dy pikëvështrime të lidhura me Shqipërinë.....</i>	<i>169</i>
Bashkim GJERGJI & Belina BUDINI	

<i>Lindja e politikës vetëshprehëse përmes teknologjive të reja.....</i>	<i>174</i>
James STANYER	
<i>Përktheu për POLIS: Alfred Lela</i>	

Abstracts.....	189
----------------	-----

EDITORIAL

MEDIA TË REJA; KOMUNIKIME TË REJA

Mjetet, praktikat dhe ligjërimet e publike në Shqipëri

———— **Prof. Asoc. Dr. Belina Budini** —————
KRYEREDAKTORE

Mediat e reja janë shndërruar në instrumente të rëndësishme, që kanë shënjuar më parë, për njerëzit në përditshmërinë e tyre, por edhe për hapësirën publike. Mundësia për të krijuar, publikuar dhe shpërndarë tekste, video dhe mesazhe, me anë të websiteve popullore si Youtube, Facebook, Wikipedia, Twitter, etj, i ka shndërruar të gjithë në “autorë” potencialë. Diskutimet dhe analizat në lidhje me praktikat e reja që vijnë bashkë me këto forma të reja komunikimi, janë të larmishme ndërsa zhvillohen gjerësisht në të gjitha mjediset dhe jo vetëm ato akademike dhe profesionale. Ky numër i revistës shkencore Polis të Fakultetit të Shkencave Sociale në Universitetin Europian të Tiranës nuk mund t’u shpëtonte këtyre diskutimeve, që kanë nisur të zhvillohen edhe në mjediset universitare shqiptare si reflektim i zhvillimeve bashkëkohore kudo.

Disa nga mundësitë dhe risitë, si edhe problematikat e shqetësimit që ngrenë këto zhvillime, janë paraqitur në këtë numër të revistës, brenda kontekstit të Shqipërisë, kryesisht për sa i përket ligjërimin publik, me më tepër theks tek politika, por edhe tek socialja, kulturorja, etj. Për vetë rëndësinë e kulturores, me një diskutim të tillë hapet edhe ky numër i revistës. Artikulli me titull “*Eufemizmat në ligjërimin publik shqiptar dhe raporti i tyre me të vërtetën*” përbën një nga kontributet më të vyera të këtij numri, ndërsa autori është pedagogu dhe kolegu ynë Gilman Bakalli, që u nda nga jeta vetëm përpara disa javësh. Në shenjë nderimi për punën e

tij kërkimore shkencore pranë Departamentit të Komunikimit dhe Marrëdhënieve Publike, revista përzgjodhi për publikim një artikull që ngërthen edhe tematikën me të cilën ai mbrojti së fundmi titullin Profesor i Asociuar. Artikulli përbën një trajtim të sofistikuar të eufemave në ligjërimin publik, duke nisur nga zanafilla e tyre dhe deri në kontekstin e ligjërimeve të sotme publike.

Duke u përqendruar tek ligjërimi i politikës në veçanti, por përmes rrjeteve sociale si edhe i mediave të reja, për këtë numër të revistës kam marrë në analizë komunikimet e reja të Kryeministrit të Shqipërisë në artikullin me titull “Ringjallja e autorit” përmes vetë-stilizimit; rasti i Kryeministrit Rama” (B. Budini).

Po kështu, artikulli me autor, Prof. Asoc. Dr. Roland Lami merr në shqyrtim mirëfillazi rrjetet sociale, duke analizuar përdorimet e tyre nga ana e aktorëve politikë shqiptarë, duke u ndalur konkretisht tek gara për bashkinë e Tiranës në zgjedhjet e 2015, dhe nga ana e kandidatëve Veliaj dhe Kosova në Tiranë.

Në një artikull që trajton “gjuhën e re” ose “newspeak” autori Alfred Lela e ka “të renë” kryefjalë të punës së tij kërkimore, edhe pse e reja në këtë rast është qëmtuar në një media të vjetër sikurse është gazeta “Bashkimi” e shtatorit të vitit 1990. Artikulli me titullin “Lindja e Berishës në politik” merr një analizë të hollësishme në artikullin e parë politik të Berishës dhe dekonstrukton “gjuhën e re” të përdorur prej tij, duke e vënë përballë “gjuhës së vjetër” të elitave të deriatëhershme komuniste në Shqipëri.

Më tej, artikulli me titull “Femërorja në revistat e modës shqiptare” me autore Dr. Irena Myzeqari dhe Teuta Zyberli analizon revistat e modës në Shqipëri, për të parë se si ato e ndërtojnë imazhin e gruas dhe femëroren në faqet e tyre.

Në një artikull me titull “Efikasiteti i teknikave të hipnoterapisë dhe relaksimit në reduktimin e ankthit” autoret Klodiana Rafti dhe Fleura Shkëmbi trajtojnë efektet e përdorimit të teknikave të hipnoterapisë klinike, në reduktimin e ankthit të përgjithësuar dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës.

Artikulli me titull “Modernizimi dhe Demokracia: Një Vlerësim Kritik ndaj Teorisë së Modernizimit në Studimin e Demokratizimit” me autor Dr. Gerti Sqapi sjell argumentet kryesore teorike brenda teorisë së modernizimit për studimin e demokratizimit, si dhe një vlerësim kritik ndaj këtyre shpjegimeve moderniste nën dritën e evidencës empirike dhe të eksperiencës së demokratizimeve bashkëkohore të vendeve të ndryshme.

Në punimin me titull “Roli i myslimanëve në ndërtimin e ndërgjegjes kombëtare shqiptare” autori Lulzim Hoxha është përqendruar në analizën e ligjëritimit të politikanëve shqiptarë të perandorisë Osmane, për të evidentuar rolin e intelektualëve të Rilindjes në fabrikimin dhe përfytyrimin e idesë së kombit dhe ndërgjegjes kombëtare, gjithashtu edhe tiparet e veçanta të modernitetit shqiptar në kontekstin e periudhës së Tanzimatit.

Në një punim në formë eseje filozofike autori Arjan Curi sjell një reflektim rreth ndikimeve të filozofisë antike greke dhe filozofëve bashkëkohës në veprën e Gregorit të Nisës

Në një punim në formë “policy paper” me titull “Adaptim arkitektonik pranë zonës “Harry Fultz”, autorja, Dr. Otjela Lubonja synon të nxjerrë në pah një zonë e cila ka nevojë për riadaptim, për ta bërë atë sa më të gjallë dhe me nevoja plotësuese.

Në artikullin me titull “Të rinjtë, rrjetet sociale dhe shoqëria e networkut” autorja Elisabeta Bajrami ka kërkuar rreth raportit të të rinjve me përdorimin e teknologjive të komunikimit duke veçuar këtu rrjetet sociale më të përdorura në Shqipëri (Facebook, Instagram, Twitter, Youtube, Hi5).

Dy recentët e këtij numri janë njëra e shkruar nga Dr. Anjeza Xhaferri mbi librin “Identiteti i Partive Politike në Shqipëri gjatë periudhës 1990-2013” me autorë Roland Lami & Aleksandër Kocani dhe tjetra mbi librin “Vështrim i parë mbi Teorinë e Komunikimit” me autorë Em Griffin, Andrew Ledbetter, Glen Sparks, Belina Budini dhe Bashkim Gjergji.

Eufemizmat në ligjërimin publik shqiptar dhe raporti i tyre me të vërtetën

Prof. Asoc. Dr. Gilman Bakalli

Rregulli nr. 1 i ligjëritimit politik: politikani thotë gjithmonë të vërtetën.
Rregulli nr. 2: nëse politikani nuk thotë të vërtetën, apliko rregullin nr. 1.
Një prej instrumenteve më të preferuara për t'i përmbushur njëkohësisht dhe
në të njëjtën masë rregullin 1 dhe 2 është eufemizmi.
(Manual për politikanë, botimi i 30-të, 1957, vëllimi IX, fq. 325.)

Abstrakt

Në këtë ese studimore fokusohem tek mënyrat e funksionimit të eufemizmeve dhe raportit të tyre me pasqyrimin e realitetit dhe të vërtetës. Duke qenë se eufemizmi shfaqet në forma të ndryshme linguistike dhe i shërben qëllimeve të ndryshme linguistike, fillimisht duhet të dallojmë disa nënkategori të tij. Në seksionin e mëposhtëm (1) shqyrtoj disa nënfunksi të ndryshme të eufemizmeve, më pas diferencoj disa nëntipe linguistike (2), diskutoj rolin e tyre në ndryshimin semantik (3), i krahasoj ato me aktet ligjërimore (4) dhe përpiqem pastaj t'i jap përgjigje pyetjes në lidhje me të vërtetën apo falsitetin e mundshëm të eufemizmit (5).

Hyrje

Që në kohë të lashta gjuha nuk është përdorur thjesht si mjet komunikimi dhe informimi, por edhe si një instrument keqinformimi të qëllimshëm. Një nga mjetet më të preferuara për t'i deformuar mendimet e njerëzve përmes elementeve gjuhësore është eufemizmi. Tradita e lashtë greke e lidhte eufemizmin me mendimin magjik, d.m.th. me besimin se pasojat fatale mund të shmangeshin duke e zëvendësuar një fjalë tabu me një fjalë perifrazuese, e cila mendohej se nuk e kishte një forcë të tillë magjike. “Eufema ka qenë, në zanafillë, një fjalë apo frazë që përdorej në vend të një fjale apo

fraze fetare, e cila nuk duhej artikuluar me zë të lartë; etimologjikisht, eufema është e kundërta e blasfemës”(http://en.wikipedia.org/wiki/Euphemism). Por përdorimi i eufemizmeve nuk kufizohet tek sfera fetare. Ndryshimi i konceptimit të të adresuarit nga një entitet me pushtet të mbinatyrshëm në një target njerëzor të persuazionit, e shndërroi eufemizmin në mjet të propagandës politike. Shkolla retorike e Antikitetit dhe e Mesjetës i konsideronte eufemizmat si fenomene linguistike, por i kategorizonte ato ndryshe. Aristoteli i konsideron ato si nën tipe të metaforës¹, Ciceroni përdor termat *verecundia* (rezervuar, diskret) dhe *verba tecta* (fjalë të mbuluara)², Kuintiliani i referohet atyre si forma të veçanta të alegorisë³. Gjatë epokës së Rilindjes eufemizmi u përdor në kuptimin e “prognozës së të mirës”⁴. Megjithatë retoricienët e epokës së Barokut e përdornin eufemizmin ashtu siç përdoret në ditët e sotme: Vosius e përkufizon atë si *figura res odiosas ingratasque designans nominibus non ingratibus*⁵ (figurë letrare që përshkruan me fjalë të këndshme gjëra të urryera, të thëna me ngurrim apo pa dashje.) Fabricius i rikthehet këndvështrimit antik të eufemizmit duke e quajtur atë një metaforë e cila përçon “një koncept më të butë”⁶ se sa vetë objekti. Këto janë disa nga kuptimet kryesore, në të cilat përdoret sot gjerësisht eufemizmi. Dubois et., al. (1974) e përkufizon atë si një shprehje “e cila fshin nga një pohim të konsideruar si objektiv se me që vlerësohen si të tepërta ose bezdisëse”⁷. Në këtë ese studimore, do të fokusohem tek mënyrat e funksionimit të eufemizmeve dhe raportit të tyre me pasqyrimin e realitetit dhe të vërtetën. Duke qenë se eufemizmi shfaqet në forma të ndryshme linguistike dhe i shërben qëllimeve të ndryshme linguistike, fillimisht duhet të dallojmë disa nënkategori të tij. Në seksionin e mëposhtëm (1) do të shqyrtoj disa nën funksione të ndryshme të eufemizmeve, më pas do të diferencoj disa nëntipe linguistike (2), të diskutoj rolin e tyre në ndryshimin semantik (3), t’i krahasoj ato me aktet ligjërimore (4) dhe të përpiqem pastaj t’i jap përgjigje pyetjes në lidhje me të vërtetën apo falsitetin e mundshëm të eufemizmit (5).

Nënfunksi

Eufemizmi është një mënyrë e këndshme prezantimi gjuhësor e një realiteti të papëlqyeshëm dhe të kontestuar. Ekzistojnë mjete gjuhësore për të paraqitur gjëra negative në terma pozitive, të cilat duhen dalluar nga fjalë me konotacione

ofenduese, të quajtura disfemizma dhe nga shprehje neutrale apo standarde të quajtura ortofemizma⁸. Në lidhje me funksionin që eufemizmat luajnë në diskurs, mund të bëjmë dallim midis dy nënlojesh të eufemizmit: funksion “**mbështjellës**” dhe funksion “**fshehës**”⁹. Eufemizmat me funksion mbështjellës shërbejnë për të shprehur indirekt diçka që nuk duhet shprehur *expressis verbis*. Ato përdoren zakonisht në fushën e fesë dhe tabuve sociale, d.m.th. në kontekstin e hyjnore apo pushtetit të djallit nga njëra anë dhe në atë të vdekjes, sëmundjeve, ekskrementeve dhe të seksualitetit nga ana tjetër. Në këtë kuptim duhet bërë dallim midis eufemizmeve “mbështjellës” të natyrës fetare dhe atyre të natyrës sociale. Ideja e përdorimit të eufemizmeve në sferën fetare i shërben shmangies së përdorimit të drejtpërdrejtë të një emri të shenjtë e të tabuizuar siç është Zoti, duke e quajtur “Ai i Madhi”, apo për të shmangur përmendjen e emrit të një pushteti të lig siç është djalli, demoni apo ndonjë kafshë e rrezikshme duke gjetur emra të tjerë për ta për të shmangur frikën nga zgjimi apo shfaqja e tyre. Kurse eufemizmat sociale përdoren për të treguar respekt dhe empati për ndjenjat apo imagjinatën e të tjerëve duke i “mbështjellë” cilësitë e pakëndshme apo të pahijshme të objekteve të referuara me tipare pozitive. Kjo është arsyeja pse priremi të flasim për atë që “u shua” në praninë e të afërmeve të të vdekurit apo për atë që “u largua nga kjo jetë”. Për të njëjtën arsye njerëzit e shmangin përdorimin e fjalës “sakat” dhe përdorin “handikap, i dizavantazhuar etj.” apo në vend të “kancerit” flasin për “sëmundjen e keqe”. Një motivim i ngjashëm për përdorimin e eufemizmeve “mbështjellës” të sferës sociale mund të konstatohet në situata sociale ku kërkohet mirësjellje siç janë rastet kur preferojmë të themi “po përdor tualetin”, “pjesët intime”, “ato fjetën bashkë”, për të shmangur terma të pahijshëm apo vulgarë. Pra, ndërsa përdorimi i eufemizmeve fetarë motivohet nga frika ose supersticioni, eufemizmat sociale mund të konsiderohen si shprehje të turpër, taktit, empatisë dhe si rrjedhim si një formë e mirësjelljes sociale. Në të dyja rastet sidoqoftë eufemizmat “mbështjellës” nuk përmbajnë idenë e gënjeshtëtrës apo mashtrimit.

Në ndryshim nga eufemizmat “mbështjellës”, eufemizmat “fshehës” janë mjete shprehëse me maskim të qëllimshëm. Përdoren qëllimisht në fushën e politikës, ushtrisë dhe reklamave për të manipuluar qëndrimet dhe sjelljet e të tjerëve. Shembuj të eufemizmeve fshehës mund të jenë “prezencë uji” në vend të përmbytjes, “ka pasur edhe gabime” për skandalet korruptive qeveritare, “misioni ynë në Afganistan” ose “misioni paqeruajtës” për mbështetjen e sulmeve ushtarake, “pedagogët seniorë” për pedagogët pleq. Të gjitha këto mënyra të shprehuri kanë një qëllim: të pengojnë lindjen e mendimeve të pakëndshme në kokën e lexuesit

¹ Cit. Fritz, Gerd: Einführung in die semantische Semantik. Tuebingen: Niemeyer, 2005. Fq. 25.

² Po aty, fq. 25.

³ Po aty, fq. 26.

⁴ Cit. Leinfellner, Elisabeth: Der Euphemismus in der politischen Sprache. Berlin: Duncker&Humblot, 1971. Fq. 35.

⁵ Po aty, fq. 40.

⁶ Po aty, fq. 41.

⁷ Dubois, Jacques, Francis Adeline, Jean- Marie Klinkenberg, Philippe Minguet, Francois Pire, hadelin Triron: Allgemeine Rhetorik, përkthyer dhe botuar nga Armin Schütz. München: W. Fink, 1974. Fq. 13.

⁸ Allan, Keith, Kate Burridge: Forbidden Words. Taboo and Censoring of Language. Cambridge-New York-Melbourne-Madrid-Cape Town-Singapore- São Paulo: Cambridge University Press 2006. Fq. 31-40

⁹ Luchtenberg, Sigrid: Euphemismen im heutigen Deutsch. Mit einem Beitrag zu Duetsch als Fremdsprache. Frankfurt/Main: Lang 1985. Fq. 24

apo dëgjuesit dhe të nxisin krijimin e një realiteti që i përshtatet folësit. Shpesh këto eufemizma shërbejnë edhe për të qetësuar ndërgjegjen e dëgjuesëve përmes zbutjes së anëve negative të realitetit, si p.sh. eufemizmi i mësipërm “prezencë uji”, i cili synon të fshehë përmasat reale të përmbajtjes dhe të shmangë krijimin e mundshëm të panikut tek dëgjuesit.

Kjo nuk nënkupton që eufemizmat fshehës të jenë domosdoshmërisht të suksesshëm në qëllimin e tyre. Sidomos kur eufemizmi fiton përdorim të gjerë apo bëhet objekt i diskutimit publik, impakti i tij eufemistik zbehet. Efekti manipulues të eufemizmeve bazohet teorikisht tek hipoteza e njohur e Sapir-Whorf. Para se të kalojmë tek analiza e nëntipeve të eufemizmeve ia vlen të ndalemi pak tek kjo hipotezë, sipas së cilës gjuha ndikon mënyrën tonë të menduarit.

Në esenë e tij me titull “Statusi i linguitikës si shkencë” Edward Sapir shkruan:

“Gjuha është një guidë drejt realitetit social. [...] ajo kushtëzon fuqishëm mënyrën tonë të menduarit rreth problemeve dhe proceseve sociale. Qeniet njerëzore nuk jetojnë vetëm në një botë objektive, nuk jetojnë vetëm në realitetin e aktiviteteve sociale, por janë edhe nën varësinë e asaj gjuhe specifike, e cila është bërë mjeti shprehës i asaj shoqërie. Është iluzion të mendosh se njeriu i përshtatet një realiteti pa përdorimin e një gjuhe dhe se gjuha është një mjet i rastësishëm që shërben për të zgjidhur problemin e komunikimit. [...] Ne shohim, dëgjojmë apo përjetojmë ashtu siç përjetojmë për shkak se zakonet gjuhësore të komunitetit tonë përcaktojnë disa zgjedhje interpretative.”¹⁰

Benjamin Lee Whorf e zgjeroi më vonë tezën e Sapir duke konstatuar se:

“Gjuha nuk është thjesht një mjet për të riprodhuar idetë tona, por edhe formësues i këtyre ideve, program dhe guidë për aktivitetin mendor të njeriut, për analizën e impresioneve të tij...Bota është një rrjedhë kaleidoskopike ndijimesh, të cilat mendja jonë i organizon - dhe kjo ndodh kryesisht nëpërmjet sistemit linguitik në mendjen tonë.”¹¹

Në këtë mënyrë pra, gjuha reflekton perceptimin tonë të realitetit, i cili nga ana e tij influencon reagimet tona ndaj njerëzve, fenomeneve, ideve. Gjuha pra, është një mjet përmes të cilit ne formësojmë realitetin dhe mjeti përmes të cilit ne i komunikojmë të tjerëve perceptimin tonë të realitetit. Gjuha mund të shërbejë fare mirë si mjet për ta shtrembëruar realitetin dhe për të influencuar sjelljen e të tjerëve duke u kthyer në një armë për të arritur si të mirën ashtu edhe të keqen më të madhe. Por si arrin Whorf në këtë pozicion radikal? Ai vetë shkruan, se kjo ide i erdhi kur pa se si gjuha i çoi punëtorët e agjencisë së sigurimit kundër zjarrit, ku ai punonte si nëpunës, në një situatë të rrezikshme. Benjamin Lee Whorf e fillon

esenë e tij me tre shembuj për të përshkruar ndikimin e gjuhës, siç e ka përjetuar herë pas here gjatë punës së tij:

Punëtorët po merren me sistemimin e “fuçive boshe të gazit” në magazinë. Njëri prej tyre ndez një cigare dhe papritmas e gjithë magazina përfshihet nga një shpërthim i fuqishëm dhe merr flakë. Mbiemri “bosh” ka bërë që punëtorët të jenë të shkuajdesur me zjarrin. Mirëpo fuçitë “boshe” të gazit janë më të rrezikshme se ato “plot”, sepse përmbajnë avuj lehtësisht të ndezshëm!

Enët destiluese prej metali duhen izoluar me “gurë gëlqeror”. Guri gëlqeror është gur dhe, si i tillë, nuk digjet, mendojnë të pranishmit...dhe gabojnë! Sërish merr flakë diçka si pasojë e një emërtimi të gabuar.

Mbetjet prej plumbi duhen pastruar. Plumbi nuk është lëndë e djegshme, kështu që nuk përmban problem të zhvendoset në një vend ku në atë moment po saldohet. Çfarë ndodh? Mbetjet e plumbit marrin flakë, sepse përmbajnë elemente parafine. Shkaktohet si pasojë një zjarr i madh me dëme të mëdha. Sërish fjala “plumb” ka shkaktuar një keqkuptim me pasojë të rënda.¹²

Emërtimet gjuhësore shpiten në disa mënyra veprimi që mund të kenë pasojë katastrofike. Në rastin konkret janë disa fjalë të veçanta si “bosh”, “gëlqere” dhe “mbetje plumbi” që krijojnë disa përfytyrime, të cilat çojnë në disa veprime. Sipas Whorf, fara e fatkeqësisë fshihet tek semantika e atributit “bosh”, e cila nënkupton si “pa përmbajtjen e zakonshme” ashtu edhe “bosh, nul, i zbrazët”. Punëtori fatkeq, i mburrur në konceptimin e realitetit nga kategoritë e tij linguitike, nuk arriti të kuptonte se avujt e gazolinës janë të padukshëm dhe se një fuçi plot me gaz të ndezshëm duket njëloj si një fuçi bosh, e zbrazur nga gazi. Kështu që, katastrofa buron nga paafërsia për të parë dhe jo si pasojë e gjuhës angleze. Prandaj mendoj se hipoteza Sapir-Whorf, sipas së cilës gjuha përcakton mendimin, është e gabuar. Të gjithë e kemi përjetuar atë momentin kur kemi dashur të artikulojmë apo të shkruajmë një fjalë dhe jemi ndalur pasi kemi kuptuar se “kjo nuk është ajo që mendojmë, apo kishim ndërmend”. Të gjithë e pra e kemi provuar se ekziston një “çfarë kishim ndërmend” që është ndryshe nga ajo që kemi thënë apo shkruar.

Diskutimi që mbron idenë se gjuha përcakton mendimin vazhdon të mbahet gjallë vetëm në sajë të pezullimit të dyshimit si akt intelektual. Bertrand Russell thoshte se një qen nuk është në gjendje t’ju tregojë se prindërit e tij, megjithëse të varfër, ishin të ndershëm, por a mund të dalim në konkluzion se, për këtë arsye, qenit i mungon ndërgjegjja? Kur debaton me studentët në lidhje me këtë pikë, përgjithësisht ato logikojnë së prapthi: gjuha e influencon mendimin, sepse po të mos e influenconte, nuk do kishim arsye për ta kritikuar mendimin seksist. Kurse sa i takon eufemizmeve të qeverisë, ato janë të përbuzshme jo aq shumë si forma të kontrollit të mendjes, se sa si forma të gënjeshtërisë. P.sh eufemizmi “rritja e të ardhurave doganore” synon të japë

¹⁰ Cit. Fill, Alwin Frank: Linguistische Promenade. Eine vergnügliche Wanderung durch die Sprachwissenschaft von Platon zu Chomsky. Bot. 2. Wien: Lit Verlag 2012. Fq. 72.

¹¹ Po aty, fq. 73.

¹² Cit. në: Gipper, Helmut: Gibt es ein sprachliches Relativitätsprinzip? Untersuchungen zur Sapir-Whorf Hypothese. Frankfurt/Main: S. Fischer 1972. Fq. 35.

një kuptim më të gjerë se sa “rritja e taksave” dhe dëgjuesi e kupton se, nëse politikani do kishte nënkuptuar “taksa”, ai do të kishte thënë “taksa”. Sapo një eufemizëm pikaset, njerëzit nuk janë aq trushpëlarë sa ta kenë problem të dallojnë mashtrimin.

Nëntipe

Nga pikëpamja semantike, eufemizmat mund t'i ndajmë në eufemizma sintaksorë, tek të cilat, thuhet e gjithë fjalia është e “infektuar” nga eufemizmi dhe eufemizma leksikore, tek të cilat, efekti qetësues apo zbukurues mbartet nga një fjalë apo frazë e vetme.

Eufemizmat sintaksorë janë fjali të plota, të ndërtuara me fjalë a fraza pa konotacione negative në mënyrë të atillë që të garantojnë fshehjen apo zbehjen e të vërtetave të pakëndshme:

1. Në komunën Ana e Malit, ku ndodhet edhe fshati Obot i izoluar prej një muaji, raportohet se ka prezencë uji në afro 250 shtëpi. (Raportim standard i të gjitha mediave të shkruara dhe vizive në periudhën e përmblyetjeve në Shkodër në vitin 2012).

E gjithë fjalia dekoron ose neutralizon një realitet të pakëndshëm: përmblyetje masive e tokave dhe banesave. Në vend që të pranohet qartësisht situata e rënduar prej përmblyetjeve, gazetarët përdorin terma neutralë për ta paraqitur situatën nën një dritë krejtësisht normale. Asgjë për t'u shqetësuar, thjesht prezencë uji!

2. Ndeshja nuk përfundoi siç pritej. Ky rezultat të çon në një situatë të re tashmë. (Trajneri i skuadrës së Vllaznisë pas humbjes me ekipin e Kukësit)

Edhe në këtë rast, si në fjalinë e mësipërme 1, ka përpjekje për ta stolitur një realitet negativ, realitetin negativ të humbjes së një ndeshjeje futbolli. Në vend që ta pranojë qartazi humbjen, trajneri në fjalë përdor trajtën e pacaktuar “siç pritej” dhe jo, p.sh. “siç e prisnim”. Edhe në pjesën e dytë të fjalisë, ndodh e njëjta përpjekje për ta anonimizuar rastin duke shmangur përdorimin e “neve na çon” (duke e zëvendësuar me “të çon”). Gjithashtu edhe përdorimi i një “situatë e re” shmang sqarimin direkt për tifozët se humbja e ndeshjes mund të rezultojë në dalje nga kategoria. Politika gjithashtu është e famshme për përdorimin e eufemizmeve sintaksorë. Disa prej tyre kanë fituar status thuhet proverbial, siç mund të shihet nga shembujt e mëposhtëm:

3. Për çdo rast, çështja e investimeve në fushën e energjitikës lë vend të hapur për diskutime
4. Momenti historik që po kalojmë na vë para sfidash të mëdha
5. ...përmes adresimit të drejtë të problemeve dhe sfidave

Në të tre rastet, forca eufemistike është e shpërndarë brenda strukturës së fjalisë dhe ka fituar karakter proverbial duke u kthyer në një frazë klishe, përmbajtja e së cilës nuk i intereson më askujt dhe që e përgjum vëmendjen e dëgjuesit. Në të trija fjalitë nuk përcaktohet aspak se cili është konkretisht “momenti historik”, cilat janë “sfidat e mëdha”, dhe pse u zgjidhkan problemet duke “i adresuar drejt” ato?

Brenda eufemizmeve sintaksore mund të gjejmë forma të ngjashme, të cilat përdoren kryesisht në diplomaci për shkak të asaj që mund ta quajmë “mjegullsi referenciale”. Fjali të tilla përdoren në raste kur synohet shmangia e përmendjes së emrit të autorit të një veprimi apo fakti, me kushtin që fakti të jetë i njohur nga të gjithë pjesëmarrësit në një kontekst të caktuar.

6. Disa njerëz nuk do të mësojnë kurrë si të sillen
7. Shqipëria duhet ta çojë përpara sfidën e integritetit. Në krye të qeverisë duhet një njeri që ta kuptojë këtë...
8. Ngjarja në bulevard (Bamir Topi)
9. Grupe me axhendë paralele (Alexander Arvizu)

Fjalinë 6 e dëgjojmë të artikullohet nga një person i edukuar, i cili është ofenduar nga një bashkëbisedues dhe dëshiron të tregojë superioritet intelektual duke e shmangur konfliktin e drejtpërdrejt verbal. Fjalina 7 artikullohet shpesh nëpër fushata elektorale nga një kryetar opozite, i cili aspirohet për postin e kreut të qeverisë, të cilit ia adreson paafësinë e këtij të fundit për ta kuptuar sfidën në fjalë. Fjalitë 8 dhe 9 janë artikuluar respektivisht nga ish-presidenti i Republikës Bamir Topi dhe ambasadori amerikan në Tiranë Alexander Arvizu në vitin 2011 në deklaratat e tyre me rastin e ngjarjes së 21 janarit, në të cilat ato, me sa duket për ta shtensionuar situatën tragjike, përdorin togfjalëshja neutral, me vagullsi të theksuar referenciale.

Një mënyrë tjetër e zakonshme për të fshehur autorin e një veprimi të pakëndshëm është përdorimi i formës pasive në vend të asaj aktive:

10. “Ka pasur edhe gabime”, “sigurisht që janë bërë edhe gabime gjatë qeverisjes sonë...

Të mos përmendësh as gabimet e as autorin/autorët e gabimeve të bëra gjatë qeverisjes do të thotë të përpiqesh të kalosh në heshtje çështjen e fajit dhe të marrjes së përgjegjësisë. Përdorimi i diatezës pësore nga politikanët para kamerave televizive, nuk ndryshon në strukturë nga “ai djali i vogël i cili shfaqësohet para prindit për dritaren që u thyë”¹³.

Ndryshe nga eufemizmat sintaksorë, eufemizmat leksikore konsistojnë në krijimin e fjalëve modifikuese që mund të jenë abstraguese ose pozitive.

¹³ Ayto, John: Over 3000 Ways to Avoid Being Rude or Giving Offense. London: Bloomsbury 1994. Fq 2.

Eufemizmat abstragues zëvendësojnë strukturën normale ose të duhur të një objekti të pakëndshëm me një perifrazim abstrakt ku mungojnë cilësitë negative të objektit në fjalë. Kështu për shembull, mbështetja e qeverisë shqiptare ndaj sulmeve ushtarake amerikane në Afganistan konsiderohet si “misioni ynë paqeruajtës në Afganistan”, ulja e pagave transformohet në “ndërrhyrje në sistemin e pagave”, po ashtu edhe rritja e taksave kthehet në “ndërrhyrje në sistemin e taksave”, WC transformohet në “banjo”, ndërsa të varfrit nuk janë më të varfër por “të dizavantazhuar ekonomikisht”.

Eufemizmat pozitive janë ato eufemizma, të cilat zëvendësojnë cilësitë semantike negative të fjalëve me attribute pozitive. Sipas këtij parimi, kolegët e mi të moshuar profesorë quhen “pedagogë senior”, grabitja mund të marrë emrin e këndshëm “rishpërndarje e pasurisë”, një katastrofë si ajo e Gërdecit u tentua të emërtohej si “aksident teknik”, kurse prishja e një zone të gjelbëruar periferike dhe ndërtimi në të i disa uzinave ka marrë emrin ekologjik “park industrial”, i cili evokon tek dëgjuesi gjelbërimin dhe qetësinë e parqeve natyrore.

Çështje të pakëndshme mund të eufemizohen duke përdorur të kundërtat e tyre, siç është rasti tek lufta, e cila zëvendësohet me “paqe” apo tortura me “dashurinë”. Ky dhunim i semantikës qëndron në themel të asaj që George Orwell tek libri i tij “1984” e quan “doublepeak” dhe që karakterizon gjuhën e re “Newspeak”:

Doublepeak nënkupton aftësinë për të mbajtur në mendje njëkohësisht dy besime kontradiktore dhe për t’i pranuar ato po njëkohësisht. Të dish dhe të mos dish, të jesh plotësisht i vetëdijshëm për të vërtetën e plotë teksa thua gënjeshtër të strukturuar, të kesh dy mendime të kundërta dhe ti besosh të dyja, të përdorësh logjikën kundër logjikës, ta refuzosh moralin duke pretenduar se je moral, të besosh se demokracia është e pamundur dhe se Partia është gardian i demokracisë, të harrosh gjithçka mundesh të harrosh dhe ta risjellësh në kujtesë në momentin e nevojshëm duke e harruar sakaq sërish, dhe, mbi të gjitha: t’ia aplikosh të njëjtin proces vetë procesit. Por rafinesa më e madhe mbetet: me vetëdije të shkaktosh pavetëdijen dhe, sërish, të bëhesh i pavetëdijshëm për aktin e sapo kryer të hipnozës. Bile edhe për ta kuptuar fjalën *doublethink* kërkohet përdorimi i *doublethink*-ut.¹⁴

Doublepeak përbën një strategji për të fshehur cilësitë semantike të papërshtatshme në mënyrë që ato të zhyten në harresë, duke e ngushtuar kësisoj rrezën e të menduarit. Këto janë raste ekstreme të eufemizimit pozitiv, por nuk janë larg këtij ekstremi ato shoqëri, të cilat ushtarët e tyre me mision ushtarak në një vend fqinj apo të largët i quan “paqeruajtës” apo atë institucion, i cili dikur quhej “ministri e luftës”, e quan “Ministria e Mbrojtjes”.

Sipas Allan & Burridge, eufemizmi shpesh lidhet me “perspektivën e folësit, kurse disfemizmi me perspektivën e të tjerëve”¹⁵ dhe përshkruajnë këtë si situatë

“ne kundrejt atyre”. Veçanërisht në gjuhën politike, shpeshherë eufemizmi i korrespondon një disfemizmi, i cili përdoret për t’iu referuar krejtësisht të njëjtit objekt apo grupi personash në anën e armikut.

Eufemizmat dhe ndryshimet semantike

Në librin e tij “Parimet dhe historia e gjuhës”, botuar fillimisht në vitin 1880, Hermann Paul trajton eufemizmin në kapitullin e ndryshimeve semantike. Ai e trajton atë shkurtimisht bashkë me hiperbolen, disfemizmin, litotën, pezhoracionin, ironinë nën titullin “modifikimet e kuptimit”. Paul shkruan:

Përballë vrazhdësisë banale të gjuhës popullore qëndron eufemizmi për aq kohë sa ky e mënjanon shprehjen tabu për shkak të ndjenjës së turpër dhe duke e zëvendësuar atë me një tjetër. Me shumë gjasë kjo e fundit do të marrë karakter të neveritshëm më pas. Krahajo shprehje si të pasmet, turpi, të derdhësh ujë e hollë, banjo apo fjala latine coitus. Ashtu si tek shprehjet që lidhen me ndjenjën e turpër, edhe ndjesia religjioze apo supersticioze e nxit krijimin e shprehjeve përshkruese.¹⁶

Në mënyrë të drejtë, Paul përmend shmangien e ndjesisë së turpër dhe të asaj fetare apo supersticioze si motiv standard për përdorimin e eufemizmeve, por nuk ka ndonjë referencë të përdorimit të qëllimshëm të eufemizmeve në politikë dhe diskurs publik. Këtë aspekt e trajtojmë më sipër. Arsyeja pse e citoj Hermann Paul në këtë punim lidhet me faktin se Paul e përshkruan eufemizmin si burim të ndryshimeve semantike dhe, duke thënë se shprehja eufemistike mund të kthehet me kalimin e kohës në një shprehje fyese apo të turpshme ai bëhet pararendës i asaj dukurie linguistike, e cila 100 vjet më vonë do merrte emrin “euphemism treadmill” nga Stiven Pinker.

Siç e tregojnë shembujt e dhënë nga Paul dhe shembujt e tjerë të eufemizmeve leksikore, shprehjet eufemistike, d.m.th. fjalët dhe idiomat mund të konvencionalizohen duke u kthyer në shprehje standarde që e kanë humbur nuancën eufemistike të fillimit. Siç shkruan dhe Shopenhaueri: “...kur një emërtim, në vetvete i padëmshëm, diskreditohet, fajin nuk e ka emërtimi por i/e emërtuara, kështu që emërtimi i ri do ketë shumë shpejt fatin e të vjetrit. Është njëloj si me kategoritë edhe me individët: nëse dikush e ndryshon emrin, kjo vjen ngaqë nuk është i aftë ta mbajë me nder emrin e mëparshëm; ai mbetet po ai që ishte dhe nuk do mund ta mbajë me nder as emrin e ri.” Për ta aktualizuar Shopenhauerin: të gjitha këtyre mbivlerësimeve linguistike që përmendëm më sipër u paraprin një zhvlerësim. Jeta e tyre zgjat për aq kohë sa këto lartësime të bëhen aq të zakonshme sa edhe vetë fjalët që ato kanë zëvendësuar.

Pra, procesi është vërtetë interesant. Çështje të konsideruara si tabu mbeten të tilla për kohë të gjatë edhe pse emrat e përdorur për emërtimin e tyre kanë ndryshuar

¹⁴ Orwell, George: Nineteen-eighty-four. A. Novel. Harmondsworth, Middlesex: Penguin Books 1973, fq. 171

¹⁵ Allan, Keith, Kate Burridge: Forbidden Words. Taboo and Censoring of Language. Cambridge-New York-Melbourne-Madrid-Cape Town-Singapore- São Paulo: Cambridge University Press 2006. Fq. 49-53

¹⁶ Paul, Hermann: Prinzipien der Sprachgeschichte. Tübingen: Niemeyer: 1975. Botimi i 9-të. Fq. 15.

disa herë. Pra, roli i eufemizmit për t'i çliruar disa çështje nga stigmatizimi i tyre është i diskutueshëm.

Leinfellner citon (nga artikulli i W. Safire "The new language of politics", 1968) konstatimin sarkastik të një gruaje të varfër:

Mendoja se isha e varfër. Pastaj më thanë se nuk isha e varfër, por grua në nevojë. Pastaj më thanë se ishte poshtëruese ta vendosja veten si njeri në nevojë. Më thanë se isha e privuar. Pastaj më thanë se isha paprivilegjuar, pastaj më thanë se isha e dizavantazhuar. Aktualisht jam pa asnjë kacidhe. Por kam një repertor të pasur me fjalë.¹⁷

Emërtimi i koncepteve me eufemizma përshkruhet nga linguisti Stiven Pinker si "euphemism treadmill". Në artikullin e tij me titull "Loja e emërtimit", ai shpjegon se çfarë ndodh gjatë këtij procesi:

"njerëzit shpikën, krijojnë fjalë të sjellshme duke iu referuar gjërave të pakëndshme apo me ngarkesë emocionale, po eufemizmi ndodhet sakaq nga asociacioni dhe emri i ri që duhet gjetur fiton konotacionet e veta negative. "Nevojtoje" u bë "W.C.", e cila u bë "banjë". Transportieri eufemistik tregon se konceptet dhe jo fjalët janë përgjegjëse: jepi një koncepti një emër të ri dhe emri ngjyroset nga koncepti; mos mendoni se konceptet rifreskohen nga emra të rinj".¹⁸

Sipas Steven Pinker, konotacionet, më shumë se fenomene semantike, janë fenomene konjitive.

Me fjalë të tjera: strategjia e zëvendësimit të fjalëve me karakter tabuistik ka natyrë ciklike. Një term, fillimisht neutral (ortofemizëm) merr gradualisht konotacione negative duke u përdorur si fyerje, p.sh. dhe kthehet në një term malinj (disfemizëm). Kështu që lind nevoja për ta zëvendësuar me një fjalë të re "politikisht korrekte" (eufemizëm), i cili përmes përdorimit të përditshëm kthehet në term neutral, në ortofemizëm, pra.

Eufemizmat dhe aktet e ligjërimit

Në kapitullin e shumë cituar "Logjika dhe biseda"¹⁹, Grice përdor fjalinë e mëposhtme:

11. Ai ishte paksa i intoksikuar (në lidhje me një burrë i cili ka thyer të gjitha mobilet),

¹⁷ Cit. Leinfellner, Elisabeth: Der Euphemismus in der politischen Sprache. Berlin: Duncker&Humblot, 1971. Fq. 130

¹⁸ Pinker, Stiven: "The Game of the Name". In: New York Times, April 3, 1994. (http://pinker.wjh.harvard.edu/articles/media/1994_04_03_newyorktimes.pdf).

¹⁹ Grice, H. Paul: Logic and Conversation, in: Cole, Peter, Jerry, L. Morgan (eds.): Speech Acts. (Syntax and Semantics, Vol. 3). New York-San Francisco-London 1975, fq. 41 - 58.

bashkë me ironinë, hiperbolen dhe metaforën si shembull për të treguar se si nuk respektohet Parimi i Parë e Cilësisë: "Mos thuaj diçka që beson se është e gabuar". Shembulli në fjalë, sipas Grice, është rast ilustrues i *meiosis*, që është një hiperbolë negative, e cila në traditën e retorikës së lashtë quhej *minutio*. Fjalja 11, në kontekstin e dhënë, tregon se personi, të cilit i referohet, ishte paksa i pirë, kështu dukshëm në kontradiktë me kontekstin në të cilin është artikuluar. Folësi mund të kishte thënë:

12. Ai ishte tapë

Të dyja fjalitë janë dhunime të dukshme të Parimit të Cilësisë. Kështu pra, duke konsideruar se folësi i përmbahet Parimit të Bashkëpunimit, fjalitë mund të ri-interpretohen në kuptimin e tyre të kundërt si "personi në fjalë ishte xurxull dhe nuk dinte ç'bënte". Fjalitë 11 dhe 12 janë shembuj pohimesh indirekte dhe mund të zbulohen vetëm nëpërmjet një interpretimi racional.

Ku dallojnë nga njëra tjetra *meiosis* dhe *eufemizmi*? Mendoj se të dyja ndahen nga një fill shumë i hollë. Të dyja janë strategji që përdoren për të shmangur përshkrimin adekuat të fakteve, por, ndërsa tek *meiosis* kjo ndodh haptazi dhe me vetëdijen e fortë se e pavërteta e pjesshme do perceptohet nga dëgjuesi, tek eufemizmi kjo ndodh fshehurazi dhe me shpresën se pjesa e papërshtatshme do kalojë pa u vënë re. *Meiosis* është formë e aktit ligjërimor indirekt, gjë që s'mund të thuhet për eufemizmin. Eufemizmi nuk operon në nivel ilokucionar por perlokucionar: nuk mund të thuhet *me anë të kësaj, unë eufemizoj se...* ashtu siç nuk mund të thuhet *me anë të kësaj, unë po gënjej se...* Në praktikën e përditshme linguistike artikulimet eufemistike nuk kërkojnë ri-interpretim të pohimeve të tyre. Nëse ato do të kërkonin interpretim, do konsideroheshin si akte të ligjërimit indirekt dhe, si të tilla, do ta humbnin karakterin e tyre perlokutiv dhe do ishin kundër produktive. Por duke qenë se eufemizmat përdoren pikërisht për të shmangur këto ri-interpretime, ato mund të merren edhe si forma të dobëta gënjeshtre, pra si pohime direkte, të cilat janë pjesërisht të pavërteta.

Përfundimisht nga ky rregull bëjnë disa eufemizma abstragues që nuk e prekin Parimin e Cilësisë, por atë të Sasisë ("bëje kontributin tënd bisedimor aq informativ sa e kërkojnë qëllimet e shkëmbimit")! dhe të Sjelljes ("shmang paqartësinë e të shprehurit"). Një shprehje e tillë si ajo e Ministrit Saimir Tahiri:

13. Do ndërhyjmë në Lazarat

Mund të konsiderohet si eufemizëm, sepse Ministri i Brendshëm përdor hiperonimin "ndërrhyje" në vend të hiponimit "aksion policor", i cili do kishte qenë më i përshtatshëm për të përshkruar atë që ndodhi realisht në Lazarat në verën e

vitit 2014. Duke përdorur një hiperonim, thënia e Tahirit është më pak informative se duhej të ishte dhe, në këtë mënyrë, shkel Parimin e Sasisë. Kur mediat flasin për “ngacmim seksual” ndërkohë që realiteti flet për një tentativë për përdhunim, kemi të bëjmë sërish me cenim të Parimit të Sasisë. Mund të thuhet se të jesh i paqartë, mund të konsiderohet edhe si thyerje e Parimit të Sjelljes. E njëjta gjë mund të aplikohet edhe për shembujt e mësipërm eufemistikë nga 1 tek 9.

Duke përmbledhur mund të themi se eufemizmat pozitivë përbëjnë shkelje të Parimit të Cilësisë, kurse eufemizmat sintaksorë dhe abstragues shkelin Parimet e Sasisë dhe të Sjelljes.

Eufemizmi dhe raporti i tij me të vërtetën

Në një kuptim radikal, asnjë fjali apo pohim nuk mund të jetë e vërtetë ose e gabuar. Duke qenë se nuk mund të pasqyrojë një realitet plotësisht, por thjesht një seksion të caktuar të tij, çdo pohim kufizohet përmes zgjedhjes së fjalëve, vetëm në ato aspekte që folësi/shkruesi i konsideron të rëndësishme. Kjo gjë na lejon të themi se çdo pohim nuk merr në konsideratë pjesë të qenësishme të realitetit të cilit ai i referohet. Në këtë kuptim të gjitha fjalitë mund të merren si të gënjeshtër të pjesshme, megjithëse mund të merren edhe si pjesërisht të vërteta. Le ta sqarojmë këtë me shembujt e mëposhtëm:

14. Duke qenë se babai i Loretës, një punëtor papërvojë, u pushua nga puna pa njoftim paraprak prej shefit, të premten në orën 12.00, familjes Bushati i duhet të jetojnë tani e tutje me 50 mijë lekë në muaj asistencë.
15. Duke qenë se babai i Loretës u pushua nga puna pa njoftim paraprak prej shefit të premten familjes Bushati i duhet të jetojë tani e tutje me asistencë të ulët.
16. Duke qenë se babai i Loretës u pushua, familjes Bushati i duhet të jetojë me të ardhura të pakta.
17. Duke qenë se babai i Loretës humbi punën, familja Bushati do jetë e varfër.
18. Duke qenë se babain e Loretës e kapi reforma, familja Bushati do jetë e dizavantazhuar ekonomikisht.

Fjalitë 14 -18 mund të jenë të gjitha të vërteta (ose të rreme), por ato dallojnë njëra nga tjetra për shkak të detajimit të informacioneve që përmbajnë. Fjalitë nga 14 deri tek 17, megjithë reduktimin e informacionit, mbeten fjali deskriptive, kurse fjalia 18 mund të konsiderohet eufemistike për shkak të shprehjeve që përmban: “*e kapi reforma dhe ekonomikisht e dizavantazhuar*, të cilat e paraqesin në një dritë neutrale një situatë aspak të këndshme siç është të qenit i papunë. “E kapi reforma”

në vend të “u pushua” e zhvendos fokusin e vëmendjes nga vendimi autoritarist i shefit tek një forcë madhore dhe me konotacion pozitiv siç është reforma dhe e paraqet humbjen e vendit të punës si një pasojë të domosdoshme që sjell me vete nevoja për ristrukturimin e reformim të institucionit. Duke e larguar përgjegjësinë nga shefi. Po ashtu edhe “ekonomikisht e dizavantazhuar” e zëvendëson mizerjen sociale që sjell me vete varfëria me një indikator krejtësisht të vagullt e abstrakt të varfërisë siç janë “dizavantazhet”. Duke e shmangur vëmendjen nga vendimi autoritarist tek domosdoshmëria administrative institucionale dhe nga mizerja tek dizavantazhet fjalia 18 nuk e përshkruan situatën në formë të drejtpërdrejtë, por imponon një lexim dashamirës dhe pozitiv. Për shkak të elementeve subjektive dhe devijuese, një fjali si 18 nuk mund të jetë e vërtetë, megjithëse nuk mund të konsiderohen kurrsesi krejtësisht të rreme.

Në artikullin e tij “Politika dhe gjuha angleze”, George Orwell shkruan:

Në epokën tonë, ligjërimi dhe shkrimi politik konsistojnë kryesisht në mbrojtjen e së pambrojtshmes. Gjëra të tilla si vazhdimi i sundimit anglez në Indi, spastrimet dhe internimet politike në Rusi, lëshimi i bombave atomike në Japoni edhe mund të mbrohen, por ama vetëm përmes argumentesh tejet brutale për t’u gëlltitur nga njerëzit dhe që nuk përputhen kurrsesi me qëllimet e shpallura të partive politike. Kështu që detyrimisht gjuha politike duhet të përdorë masivisht eufemizma dhe shprehje të vagullta e pyetje retorike. Fshatra të tërë bombardohen nga ajri, kasollet hidhen në erë nga plumbat shpërthyes, dhe e gjitha kjo quhet *proces paqeje*. Miliona fshatarëve u grabiten feramat dhe detyrohen të marrin rrugët vetëm me një trastë në shpine, dhe kjo quhet *transferim i popullsisë* ose *ndreqje kufijsh*. Njerëzit burgose për vite të tëra pa gjyq, qëllohen nga pas në zverk ose çohen të vdesin nga skorbuti nëpër kampet e Arktikut, dhe kjo quhet *eliminim i elementeve të dyshimtë*. Një frazeologji e tillë nevojitet kur dikush dëshiron të emërtojë gjëra pa dashur të krijojë imazhe mendore rreth tyre. Imagjinoni për një çast një profesor të gjuhës angleze, i cili përpiket të mbrojë totalitarizmin rus. Ai nuk mund të shprehet drejtpërdrejt duke thënë: “jam i bindur se mund t’i heqësh qafe kundërshtarët politikë, nëse kjo sjell rezultate të mira”. Me shumë gjasë ai do ta formulojë kështu idenë e tij: “duke e pranuar që regjimi sovjetik shfaq disa tipare, të cilat humanitaristët priren t’i kundërshtojnë, mendoj se duhet të biem dakord për faktin se një farë kufizimi i të drejtës për opozitë politike është një proces shoqëruar i pashmangshëm i periudhave tranzitore dhe se masat e rrepta ndaj popullit rus janë justifikuar gjerësisht përballë arritjeve konkrete.” Ky stil i fryrë përbën në vetvete njëlojë eufemizmi. Një masë e madhe fjalësh me rrënjë latine bie si dëborë e bardhë butësisht mbi faktet duke i mbuluar të gjitha detajet. Armiku më i madh i gjuhës së qartë është pa sinqeriteti. Kur ka një hendek midis qëllimeve reale dhe atyre të deklaruara, personi i drejtohet instinktivisht fjalëve të gjata dhe idiomave të stërpërdorura, si të ishte një sepje prej së cilës kullon bojë curril. (Orwell 1967:153-4)

Për Orwellin, siç e tregon edhe konceptimi i tij cinik i “Newspeak”, eufemizmi është një formë e pasinqeritetit dhe, si i tillë, fsheh mendimet e personit që i përdor. Si manifestim i gjuhës së paqartë, eufemizmi është i papranueshëm, së paku në fushën e politikës dhe të komunikimit mediatic. Nëse eufemizmat janë të pasinqertë ato duhen konsideruar si gënjeshtër.

Duke qenë se tipari përkufizues i eufemizmit është fshehja e të paktës një pjese të informacionit relevant, shprehjet eufemistike nuk mund të konsiderohen asnjëherë plotësisht të vërteta, në kuptimin e ngushtë të fjalës. E megjithatë, ato nuk mund të konsiderohen as si gënjeshtër të qëllimta, sepse pjesë e informacionit të përcjellë prej tyre mund të jetë korrekte. Ato janë si koka mitologjike e Janusit, një kryqëzim midis të vërtetës dhe gënjeshtres. Kjo është arsyeja pse Leinfellner i përkufizon shprehjet eufemistike si “gënjeshtër të pjesshme”. Fjalitë e mëposhtme eufemistike:

1. Në komunën Ana e Malit, ku ndodhet edhe fshati Obot i izoluar prej një muaji, raportohet se ka prezencë uji në afro 250 shtëpi.
2. Ndeshja nuk përfundoi siç pritej. Ky rezultat të çon në një situatë të re tashmë.
3. Për çdo rast çështja e investimeve në fushën e energjetikës lë vend të hapur për diskutime

mund të jenë të vërteta, por (si shkelje të Parimit të parë të Sasisë) ato nuk japin informacionin e plotë që kërkohet apo pasqyrimin real të situatës pak a shumë si më poshtë:

- 1'. Gjendja në komunën Ana e Malit është kritike, pasi afro 250 shtëpi janë përmbytur dhe nuk kanë komunikim me zonat përreth...
- 2'. Skuadra jonë e humbi ndeshjen dhe ky rezultat na çon në kategorinë e dytë.
- 3'. E vërteta është se investimet në fushën e energjitikës kanë qenë të pakta.

Në këtë rast, të gjitha fjalitë (1 - 3) i plotësojnë kushtet për t'u cilësuar si pohime të vërteta, por mbeten të mangëta kur krahasohen me fjalitë (1' - 3'), për të cilat mund të themi se janë “më të vërteta” se (1 - 3), sepse përshkruajnë fakte relevante dhe japin informacion të plotë, që folësi e njeh dhe dëgjuesi e pret.

E njëjta logjikë mund të aplikohet edhe për fjalitë që përmbajnë eufemizma leksikalë:

4. Momenti historik që po kalojmë na vë para sfidash të mëdha.

Kjo shprehje mund të jetë e vërtetë, por vetëm në nivel abstrakt. Duke folur për “moment historik” dhe për “sfidë”, folësi e mban dëgjuesin në errësirë në lidhje

me momentin dhe sfidën duke mos i dhënë asnjë referencë se për cilin moment historik bëhet fjalë konkretisht dhe cilat janë këto sfida. Në këtë rast mund të themi se fjalja është epistemologjikisht e vërtetë, por pragmatikisht e rreme.

Shprehjet eufemistike, qofshin ato sintaksore apo leksikore, në pjesën më të madhe të tyre janë semantikisht të paplota më lidhje me realitetin që përfaqësojnë. Në këtë formë të përgjithshme, kjo mund të aplikohet për të gjitha fjalitë, pasi, siç e pamë më lart, plotësia radikale nuk mund të arrihet asnjëherë. Prandaj mund të shtojmë një kriter tjetër: shprehjet eufemistike janë të paplota sa i takon pritshmërive. Kjo do të thotë që, në dallim prej pohimeve shkencore, e vërteta apo falsiteti i një shprehjeje eufemistike, mund të gjykohet vetëm nga këndvështrimi i dijes konsensuale sa i takon edhe plotësisë së informacionit relevant. Pra, eufemizmi mund të jetë i vërtetë (apo i rremë) vetëm në sfondin e disa normave të pritshmërisë.

Sidoqoftë duhet bërë dallim midis së vërtetës apo gënjeshtres që lidhen me eufemizmat abstragues dhe pozitivë. Të parat janë po aq të vërteta sa edhe ekuivalentet e tyre jo eufemistike, por thjesht më pak konkrete apo informative në lidhje me vërtetësinë e pretenduar. Kurse të dytat, eufemizmat pozitivë pra, janë gjithmonë pjesërisht të rreme, sepse u shtojnë një tipar pozitiv pohimeve me përmbajtje negative (të zymtë, të mjerueshme, të trishtueshme etj.)

Si pohime pjesërisht të vërteta a pjesërisht të rreme apo të vagullta dhe mashtruese, eufemizmat nuk duhen parë vetëm nga këndvështrimi epistemologjik, por duhen analizuar edhe nga një pozicion moral, i cili, sigurisht, nuk është asnjëherë i lirë nga implikimet ideologjike. Kjo është arsyeja pse ato janë vazhdimisht objekt i debateve publike dhe zgjidhen si shembuj për fjalën më të keqe të vitit. P.sh. gjatë viteve '90 fjala më e keqe e vitit në Europë (1992) konsiderohej fjala “spastrim etnik”. Kjo përzgjedhje u bë mbi argumentin moral ngaqë metafora “spastrim” duhej konsideruar si imorale, sepse i krahason qeniet humane me rroba të papastra që duhen larë duke fshehur këssoj referentin kryesor të shprehjes: eliminimin masiv të njerëzve për arsye raciste.

Konkluzione

Eufemizmat janë shprehje që përdoren për të fshehur shoqërizime të pakëndshme. Duhet bërë dallim midis nënfunksioneve “maskuese” dhe “fshehëse” të tyre. Të parat përdoren në zonën e tabuve sociale e fetare dhe kanë bazë morale, kurse të dytat duhen konsideruar si mënyrë e mashtrimit të qëllimshëm në diskursin publik. Eufemizmat manifestohen në forma të ndryshme: si sintaksore dhe leksikore. Format leksikore janë ose abstraguese ose pozitive. Përmes konvencionalizimit, përdorimi i të dyjave mund të çojë në ndryshime semantike, të cilat mund të sjellin

nevojën për eufemizma të rinj. Një proces i tillë mund të shkaktojë një zinxhir historik eufemizmesh, të cilat, Stiven Pinker, i quan “euphemism treadmill”. Megjithatë eufemizmat janë shkelje të Parimeve të Cilësisë nga njëra anë dhe të Sasisë dhe Sjelljes, nga ana tjetër, ato nuk mund të konsiderohen si akte indirekte të ligjërit, sepse qëllimi i tyre është të bllokojnë dhe jo të evokojnë reagime interpretuese tek dëgjuesit. Në dallim me aktet indirekte të ligjërit, të gjitha eufemizmat mund të konsiderohen si gënjeshtër të pjesshme, sepse nuk përputhen me standardet e qartësisë së pritshme. Sidomos eufemizmat pozitivë janë më të rrezikshme sepse u japin tipare pozitive akteve dhe ngjarjeve negative.

Në diskursin publik, sidomos në politikë, eufemizmat janë një mënyrë strategjike e persuzionit dhe, në të njëjtën kohë një mur mbrojtës psikologjik me të cilin rrethohet një rrëfimtari lajmesh të këqija. Ekziston vazhdimisht rreziku që eufemizmat të bëhen tinëzisht pengesë e të menduarit. Nëse fjalët apo shprehjet eufemistike zënë vend me sukses në përdorimin e përditshëm të gjuhës, duke konkurruar me shenjat ekzistuese linguistike, nëse zbukurimet leksikore bëhen me sukses pjesë e leksikut si emërtime të zakonshme, atëherë eufemizmi ia ka dalë ta mbështjellë perceptimin tonë me një vello të mjegullt duke e bërë të vështirë, edhe për shpikësit e këtyre eufemizmeve, t'i dallojnë objektet e referuara nën një dritë më pak pozitive. Prandaj, eufemizmat nuk duhen kuptuar thjesht si instrumente gjuhësore për “mashttrimin e qëllimshëm”²⁰, por gjithashtu edhe si elemente “të vetëmashtrimit të paqëllimshëm”²¹.

Bibliografi

- Allan, Keith, Kate Burridge: Forbidden Words. Taboo and Censoring of Language. Cambridge-New York-Melbourne-Madrid-Cape Town-Singapore- São Paulo: Cambridge University Press 2006.
- Ayto, John: Over 3000 Ways to Avoid Being Rude or Giving Offense. London: Bloomsbury 1994.
- Dieckmann, Walther: Information oder Überredung. Zum Wortgebrauch der politischen Werbung in Deutschland seit der Französischen Revolution. Marburg: Elwert 1964.
- Dubois, Jacques, Francis Adeline, Jean- Marie Klinkenberg, Philippe Minguet, Francois Pire, hadelin Triron: Allgemeine Rhetorik, përkthyer dhe botuar nga Armin Schütz. München: W. Fink, 1974.
- Fill, Alwin Frank: Linguistische Promenade. Eine vergnügliche Wanderung durch die Sprachwissenschaft von Platon zu Chomsky. Bot. 2. Wien: Lit Verlag 2012.
- Fritz, Gerd: Einführung in die semantische Semantik. Tuebingen: Niemeyer, 2005.

²⁰ Heringer, Hans Jürgen: “Ich gebe Ihnen mein Ehrenwort”. Politik-Sprache-Moral. München: Beck, 1990, fq. 56.

²¹ Dieckmann, Walther: Information oder Überredung. Zum Wortgebrauch der politischen Werbung in Deutschland seit der Französischen Revolution. Marburg: Elwert 1964, fq. 108.

- Gipper, Helmut: Gibt es ein sprachliches Relativitätsprinzip? Untersuchungen zur Sapir-Whorf Hypothese. Frankfurt/Main: S. Fischer 1972.
- Grice, H. Paul: Logic and Conversation, in: Cole, Peter, Jerry, L. Morgan (eds.): Speech Acts. (Syntax and Semantics, Vol. 3). New York-San Francisco-London 1975.
- Heringer, Hans Jürgen: “Ich gebe Ihnen mein Ehrenwort”. Politik-Sprache-Moral. München: Beck, 1990.
- Leinfellner, Elisabeth: Der Euphemismus in der politischen Sprache. Berlin: Duncker & Humblot, 1971.
- Luchtenberg, Sigrid: Euphemismen im heutigen Deutsch. Mit einem Beitrag zu Duetsch als Fremdsprache. Frankfurt/Main: Lang 1985.
- Orwell, George: Nineteen-eighty-four. A Novel. Harmondsworth, Middlesex: Penguin Books 1973.
- Paul, Hermann: Prinzipien der Sprachgeschichte. Tübingen: Niemeyer: 1975. Botimi i 9-të.
- Pinker, Stiven: “The Game of the Name”. In: New York Times, April 3, 1994. (http://pinker.wjh.harvard.edu/articles/media/1994_04_03_newyorktimes.pdf).

“Ringjallja e autorit” përmes vetë-stilizimit; rasti i kryeministrit Rama

Prof. Asoc. Dr. Belina Budini

Abstrakt

Edi Rama e ka pohuar vetë për të përditshmen britanike “The Guardian” në vitin 2003 që ai është një pop-star mes kryetarësh dhe kryetar mes pop-starësh. E ka stilizuar veten si të tillë jo vetëm në rolin e tij si ministër kulture e kryetar bashkie, por edhe në krye të partisë dhe në krye të qeverisë. Në periudhën e tij si kryeministër shfaqjet e tij prej pop-stari vetëm sa janë zgjeruar dhe po kështu edhe repertori i tij i komunikimit dhe PR-it. Në një studim për dukurinë e politikanit mediatik, të botuar në vitin 2009 me titull “Edi Rama, politikani pop(ulist)-star”, kam analizuar më tepër strategjitë e tij komunikative dhe të imazhit lidhur me daljen në skenë dhe ngjitjen e tij në pushtet, kur komunikimin e ka pasur përgjithësisht avantazh politik. Me pak përjashtime. Për këtë artikull që ndalet tek periudha si kryeministër, kam analizuar gjithashtu performancat e tij simbolike, kësaj radhe përmes fotografive, selfie-ve, komunikimeve në rrjete sociale, duke përdorur instrumentet e analizës semiotike të Roland Barthes dhe paradigmën e re të performatizmit propozuar vitet e fundit nga Raoul Eshelman (2008). “Ringjallja” e autorit ose rikthimi tek pushteti performues i autorit është perspektiva që i lidh të dyja qasjet teorike në fjalë. Pra në vijim të pesimizmit metafizik që sugjeron “vdekjen e autorit”, performatizmi i lexon aktet nga një kënd i rikthyer kah autori, sepse periudha aktuale vetë është e shënjuar nga vetë-autorësia. Artikulli argumenton, duke ndjekur linjën e mësipërme teorike, se me anë të performancave simbolike dhe vetë-stilizimit, rasti i Kryeministrit Rama ilustron “rilindjen e autorit” në komunikimin politik në Shqipëri. Ky artikull sugjeron më tej se intensiteti dhe larmia e akteve simbolike në rendin e punës së përditshme të kryetarit të qeverisë, meriton të analizohet si rast dhe si model për sa kohë që dukuria e politikës së shout po përhapet dhe priret të bëhet mbizotëruese edhe në vendin tonë. Me pasojën që lë pak ose aspak vend për performancë përmbajtësore si financiare, juridike dhe reformatore në vend. Rama ka vendosur tanimë një model të politikës së shout në Shqipëri me implikime për arenën politike, mediat dhe opinionin publik.

Hyrje

Edi Rama është shprehur se “Jam një pop-star mes kryebashkiakësh dhe kryebashkiak mes pop-starësh” në kohën kur ishte kryetar i Bashkisë së Tiranës (The Guardian, 2003). Më vonë si Kryetar i Partisë Socialiste dhe në periudhën si Kryeministër i Shqipërisë, profili i tij prej pop-stari është përforcuar edhe më tej. Me të marrë drejtimin e qeverisë, repertori i tij i komunikimeve u zgjerua duke përfshirë pothuajse të gjitha aspektet e jetës publike nga arti tek feja, nga librat dhe kritika tek sporti dhe muzika, nga shfaqjet televizive tek mediat sociale. Ai jo vetëm që merr vëmendjen e një pop-stari, por vetë-serviret si i tillë rregullisht dhe qëllimisht, duke u përpjekur të dalë edhe në skenën ndërkombëtare si i tillë. Vetëm pak ditë më parë, sërish britanikja The Guardian e referonte Ramën në një artikull të gjatë të dedikuar si “kryeministrin artist” që ka zyrën më të pangjashme të një udhëheqësi në botë dhe si kreun e parë të një shteti që hap ekspozitë arti në detyrë në një prej galerive më të famshme në botë në SHBA (The Guardian, 2016).

Megjithëse mund të ketë një farë autorialiteti në procesin e vetë-paraqitjes së çdo politikani, sidomos atyre që u atribuohet statusi “celebrity”, kryeministri i Shqipërisë veçohet si politikan i vetë-ndërtuar si i tillë me anë të një axhende të personalizuar shou dhe spektakli publik. Atëherë kur shfaqet, në studimet e komunikimit dhe të Marrëdhënieve Publike, kjo dukuri ka marrë emrin “celebrity politics” ose “celebrity diplomacy”. Sikurse shprehen studiuesit, politikantë simbolike priren të zëvendësojnë thelbin e përmbajtjes me formën e spektaklin në një epokë që mbizotërohet prej tyre (Kellner, 2010). Ata pranojnë se vetë mjedisi i ri i komunikimeve politike mund ta vërë politikanin përpara një lloj presioni për t’u angazhuar në politikë-shou, mirëpo shpesh performancat simbolike përqafohen për kënaqësinë dhe lehtësinë e vënies në skenë në krahasim me punën e mundimshme pa praninë e kamerave që kërkojnë proceset e vendim-marrjes dhe të qeverisjes, diplomacisë, politikë-bërjes, vendosjes së dialogut dhe të kompromisit si edhe proceset zbatuese të tyre. (Po aty).

Spektakli dhe performancat teatrale që ngërthehen në veprimtaritë rutimore të kryeministrit të Shqipërisë dëshmojnë qartazi aftësitë e tij si komunikues dhe performues. Mirëpo, intensiteti dhe larmia e këtyre akteve në rendin e punës së përditshme të kryetarit të qeverisë, meriton të analizohet si rast dhe si model për sa kohë që dukuria e politikës së shout po përhapet dhe priret të bëhet mbizotëruese në Shqipëri. Me pasojën që lë pak ose aspak vend për performancë financiare, juridike dhe reformatore në vend. Rama ka vendosur tanimë një model të politikës së shout në Shqipëri me implikime për arenën politike, mediat dhe opinionin publik.

Qasja metodologjike

Duke shqyrtuar rastin e Ramës si një “mediakrat” i mirëfilltë që e performon politikën e tij të stilit përmes mediave klasike dhe atyre të reja, ky artikull ka për qëllim të analizojë dukurinë e politikës së shout përmes qasjes së performatizmit, duke u mbështetur në teorinë e “performatizmit” të propozuar nga Raoul Eshelman si edhe në leximet semiotike të shkollës së Roland Barthes¹ (Eshelman 2008; Griffin et. al., 2016).

Në vend që të adresoj të gjithë aspektet e analizës së performatizmit, do të përqendrohem në dy aspekte të ndërthurura që janë më të rëndësishme për të kontekstualizuar aktet e komunikimeve publike si edhe performancat e një politikani si Rama: Kornizimin autorial dhe përdorimin e shenjës si akt kuptim dhënës. Në të njëjtën kohë, duke qenë se një nga qëllimet e semiotikës është të interpretojë shenjat jo verbale (përveç gjuhës ose pjesës verbale të saj si disiplinë), do të qëmtohet për to në “galerinë” e shfaqjeve pamore dhe në “kinemanë” e daljeve publike të kryeministrit.

Barthes-i ishte i interesuar në shenjat që janë në dukje të drejtpërdrejta por që komunikojnë në mënyrë të fshehtë kuptime ideologjike dhe konotative, duke riqarkulluar vlerat mbizotëruese të shoqërisë (Griffin et. al, 2016). Si të tilla, shenjat sipas tij janë mashtruese. Në këtë artikull kam operuar me konceptet bazë analitike të teorisë origjinale të Barthes-it, si modeli më i mirë për analizimin e shenjave, sidomos të atyre që përcillen me anë të masmediave.

Këto elementë ose aspekte pamore dhe performuese që synoj të analizoj janë nxjerrë nga galeria e fotografive që zyra e kryeministrit si edhe ai vetë kanë shpërndarë dhe postuar për mediat dhe publikun përmes website-eve, e-mail-ave dhe rrjeteve sociale. Kësisoj është përdor metoda e kërimit cilësor për mbledhjen e të dhënave. Ato konsistojnë në evidenca të mbledhura përmes monitorimit të shfaqjeve të kryeministrit ashtu sikurse ai i ndërton ato dhe ashtu sikurse ato paraqiten në media gjatë kohës së tij si kryeministër, që nga viti 2013 dhe në periudhën aktuale.

Janë përzgjedhur për këtë artikull jo më shumë se 20 fotografi të cilat kanë prodhuar edhe më tepër komente dhe kanë tërhequr më tepër vëmendjen e publikut e të mediave në vend si edhe atyre ndërkombëtare në lidhje me vetë kryeministrin. Këto fotografi do të bëhen objekt i imtësishëm analize, ndërsa do të merren përgjithësisht në konsideratë për analizim edhe videot, intervistat si edhe shfaqjet televizive e filmat e shkurtër apo video-selfiet që kryeministri dhe mediat kanë publikuar.

¹ Raoul Eshelman është një sllavist gjermano-amerikan që jep mësim aktualisht në Departamentin e Letërsisë së Krahësuar në Ludëig Maximilians University në Munich. Eshelman bën pjesë tek ai grup i mendimtarëve bashkëkohorë post-postmodern që konstatojnë rënien e postmodernizmit.

Qasja teorike

Duke huazuar nga Roland Barthes-i, janë përdorur konceptet e shënjesit, të shënjuarës dhe të shenjës. Shënjesi dallohet si forma fizike e shenjës, ashtu sikurse ajo perceptohet nga shqisat tona. E shënjuara ka të bëjë me kuptimin që shoqëron shenjën dhe vetë shenja është kombinimi i pandashëm i shënjesit dhe të shënjuarës. Sidoqoftë, në këtë punim nuk do të thellohem në analizën strukturore apo në klasifikimet e taksonominë e shfrenuar që ndërton Barthes. Do të operacionalizojmë vetëm konceptet e sipërmendura gjatë analizës së fotografive. Qasja teorike do të plotësohet me performatizimin si mënyrë për të interpretuar njëherësh autorin dhe shenjën nën dritën e zhvillimeve aktuale në media dhe në politikë.

Raoul Eshelman ka përdorur termin “performatizëm” si alternativë ndaj paradigmes postmoderne. Ai sugjeron se bëhet fjalë për një zhvillim epokal si të përkundërt me postmodernizmin që ka nisur të shfaqet në letërsi, film, art, media dhe fusha të tjera të jetës publike që nga fundi i viteve 1990 e këtej, si edhe vijon të zëvendësojë gradualisht postmodernizmin (Eshelman, 2008). Ndërsa postmodernizmi ngërthen pesimizmin metafizik, vdekjen e autorit dhe një shumësi interpretimesh, aktet performatiste janë më të orientuara kah autori, lejojnë më tepër optimizëm, dhe skalisin transhëndencën drejt një perceptimi më të unifikuar të realiteteve (Eshelman, 2001).

Performatizmi përbën një zhvendosje të paradigmes për sa u përket akteve semiotike dhe interpretimeve të tyre. Në pikëpamjen e Eshelman-it, për sa i përket fuqisë autoriale dhe epërsinë e saj për domethënie, të besuarit është rezultati i pashmangshëm i çdo akti semiotik. Akti i performimit ka autoritetin për të krijuar besueshmëri dhe është e pamundur që të bëhet objekt i një kritike metafizike ose dekonstruksioni (Eshelman, 2001). Performanca nuk i lë marrësit tjetër opsion përveçse të kapërcejë mosbesimin e tij/saj dhe të pranojë atë që i shfaqet.

Rilindja e autorit

Si fillim “në performatizëm rolin qendror për sa i përket kuptim dhënies e ka autori”. Megjithatë Eshelman jep më së shumti shembuj të veprave fikson, artistike si edhe arkitekture, të cilat shpalosin një kornizim autorial, në këtë punim do të përpiqem që të bëj lidhjen ndërmjet akteve të komunikimit politik dhe fuqisë autoriale në mënyrë të ngjashme, aq më tepër që arti dhe politika mbivendosen në rastin e profilit të kryeministrit shqiptar, i cili krijon ose ndërton influencën e vet autoriale njëherësh si artist (duke qenë piktor) dhe si politikan. Pikturat e tij të

shndërruara në dekorin mural të zyrës së tij të pritjeve në kryeministri janë vetëm një prej ilustrimeve të kësaj ndërthurje performative.

Duke iu rikthyer Eshelman-it, kornizmi autorial i dikton audiencës njohjen e unitetit të punës apo aktit, duke e pranuar mbresën që ajo lë në formën e vet holistike (tërësore), edhe atëherë kur audienca ose publiku është i ndërgjegjshëm për artificialitetin dhe kompleksitetin dhe do të mund ta dekonstruktonte tërësinë e shfaqjes. Argumenti është se “artefact”-i ndërtohet nga autori-artist në mënyrë të atillë që e thjeshtëzon çështjen. Nëse e aplikojmë këtë qasje në komunikimin politik, autori do të ishte “aktori” që ndërton rolin dhe performancat për audiencën publike. Sipërfaqja e atij roli që i shfaqet publikut është një version i thjeshtëzuar i realiteteve paradoksale të politikës.

Më poshtë, janë paraqitur tabelat e analizuara të fotografive të përzgjedhura që përcjellin njëherësh idenë e kornizimit autorial si edhe përdorimin strategjik të shenjave ose simboleve nga ana e kryeministrit shqiptar në aktet e tij publike brenda dhe jashtë vendit.



Shënjuesi

Figura drejtuese (klerikë) të spektrit fetar në Shqipëri me kryeministrin e Shqipërisë në Paris gjatë paradës së paqes, pas ngjarjes tragjike të sulmit terrorist në redaksinë e revistës humoristike “Charlie Hebdo”.

E shënjjuara

Harmonia fetare; Uniteti; Toleranca fetare; Solidariteti fetar shqiptar

Shenja (korniza aitoriale)

Kryeministri i Shqipërisë si figurë përbashkuese dhe promovues i harmonisë fetare shqiptare në Paris gjatë paradës së paqes.



Shënjuesi

Lapsat me ngjyrat e flamurit francez në xhepin e xhakës së kryeministrit të Shqipërisë gjatë paradës së paqes pas sulmeve terroriste në Paris.

E shënjjuara

Solidariteti me Francën, Je suis Charlie, Shqipëria mbështet dhe nderon Francën në një moment dramatik; Një dedikim autentik dhe artistik për Francën.

Shenja (korniza aitoriale)

Kryeministri i Shqipërisë si politikan-artist, mbështetës i stilizuar i Francës dhe protagonist kreativ i paradës së paqes në Paris



Shënjuesi

Kryeministri përqafton një qengji të vogël gjatë një vizite në një prej zonave rurale shqiptare, të prekura nga përmbajtjet.

E shënjjuara

Mirësi; Ngrohtësi; Përkujdesje; Jezus.

Shenja

Një lider i përlulur dhe i përkujdesur, me stil biblik si Jezusi.



Shënjuesi

Kryeministri bën një selfie ndërsa mban në duar një papagall blu, ngjyra që simbolizon Partinë Demokratike.

E shënjjuara

Lojë, shaka, Ironi me Partinë Demokratike dhe rivalin politik, Basha.

Shenja

Një kryeministër lojcar, ironik, i vetë-pëlqyer.



Shënjuesi

Një kërpudhë si vepër arti në kopshtin përpara Kryeministrit.

E shënjjuara

Kreativitet, abstraksionizëm, koshiençë artistike, provokim, vanitet.

Shenja (korniza aitoriale)

Qeverisje me art, leadership provokues, shija e personalizuar e kryeministrit prevalon mbi formalizmin institucional



Shënjuesi

Njerëz që shohin një ndeshje të Kombëtares shqiptare të futbollit në kopshtin pas kryeministrit të shndërruar në kinema të hapur verore.

E shënjjuara

mbështetje për skuadrën kombëtare dhe kombin; nacionalizëm, përbashkim kombëtar, futbollit si ngjarje politike.

Shenja (korniza aitoriale)

Rama si lider përbashkues përmes shikimit të organizuar të një ndeshje futbolli, e ndërtuar si ngjarje publike qeveritare.

**Përshkrimi mediatik**

Foto e ditës: Rama shënon në Vlorë pas përballjes me Blushin.

Shënjuesi

Kryeministri gjuan dhe shënon gjatë një vizite zyrtare në Vlorë, pas përballjes në parlament me Blushin dhe kritikën e tij brenda Partisë Socialiste.

E shënuara

Arritje, produktivitet, lidhshmëri efektive, sportivitet, kompetitivitet.

Shenja (korniza autoriale)

Kryeministri në formë për të luajtur dhe shënuar, si një lider efektiv dhe sfidues i Blushit.

**Shënjuesi**

Kryeministri përfaqëson dhe puth një të moshuar gjatë një takimi politik të moderuar nga kryeministri. I moshuari në një moment, i entuziazmuar, i uron Jetë të Gjatë Shokut Rama.

E shënuara

Popullaritet, populizëm, lidhshmëri spirituale, stil i Enver Hoxhës.

Shenja

Shfaqje e stilit populist të Enver Hoxhës e tipit “Gju me gju me popullin”.

**Shënjuesi**

Kryeministri Rama duke shoqëruar gjatë një pritje në zyrat e qeverisë shqiptare Kancelaren Gjermane Angela Merkel, aty ky portreti i themeluesit të shtetit shqiptar Ismail Qemali rrethohet nga piktura të realizuara nga vetë kryeministri.

E shënuara

Ekstravagancë, Personalizim, Krenari kombëtare dhe personale, Egocentrizëm.

Shenja (korniza autoriale)

Rama si një kryeministër egocentric, politikisht jo korrekt, ekstravagant dhe lojçak.

**Shënjuesi**

Kryeministri Rama dhe gazetari i njohur televiziv, Blendi Fevziu në studion e emisionit Opinion pas një interviste, duke aluduar në lidhje me një incident diplomatik në Vjenë ku kryeministri ishte përfshirë në këtë kohë dhe që konsistonte në një gjest të shkëlqes së veshit.

E shënuara

Parodi: ribërje e gjestit të ashtuquajtur të gabuar në formën e një parodie mediatike, orientalizëm

Shenja (korniza autoriale)

Kryeministri që parodizon kritikën e tij duke përsëritur gjestin e shumëpërfolur që shkaktoi një incident diplomatik, “tërheqje prej veshi” e medias, në stilin e një babai autoritar oriental.

Përvijime të krahasuara

Fidel Castro është një nga figurat politike që ka gëzuar për një kohë të gjatë statusin e një politikani superstar në Amerikën Latine, por edhe ndërkombëtarisht. Pas tij, modelin e Kastros e përfaqëson Hugo Chavez i cili është shndërruar në një mjeshtër të spektaklit politik. Pavarësisht gjyimeve në lidhje me politikën dhe taktikën e Chavez-it, mjeshtëria e tij për sa i përket spektaklit mediatik dhe politikës në stilin “celebrity”, nuk vihet në dyshim jo vetëm nga publiku por as nga studiuesit (Kellner, 2010). Një nga shprehjet e tij gjatë një dalje publike në Shtetet e Bashkuara para disa vitesh u shndërrua në hit ndërsa u shpreh se kishte ndërë erë të rëndë sulfuri që tregonte se ndoshta përpara tij në skenë do të kishte kaluar djalli duke iu referuar presidentit George W. Bush që kishte marrë fjalën pak përpara Chavez-it në podium. Batutat janë edhe vëniet e tij tipike në skenë.

Po kështu, edhe fitorja e Obamës lidhet shpesh me efikasitetin e tij për të mobilizuar spektaklin mediatik, si kur është fjala për fushatën, ashtu edhe për publicitetin e fituar nga mediat tradicionale, apo përmes internetit duke qarkulluar një mori videosh në You Tube si “Obama Girl” dhe “Yes we can”, përfshi edhe fjalimet e tij, plotësuar këto me një mori videosh të qarkulluara edhe nga vetë mbështetësit e tij të rinj. U pa qartë sipas Kellner, se në fund të fushatës së tij të gjatë si kandidat për president, Obama doli në pah si një super-star i rangut më të lartë.

Si gjatë fushatës ashtu edhe në rolin e tij si president, Obama e ka përdorur statusin e tij prej super-stari në funksion të axhendës së tij të diplomacisë publike. Popullariteti i tij i jashtëzakonshëm shërbeu sipas studiuesve si një frenim për anti-amerikanizmin e rrezikshëm në rritje gjatë në të gjithë botën gjatë periudhës Bush-Cheney. Pas udhëtimeve të Obamës në Europë, në Mbretërinë e bashkuar, deri në Trinidad dhe Ghana si edhe plot vende të tjera, vetëm gjatë muajve të para si president Obama u shndërrua në super-star global. Ajo që ndodhi ndoshta mund të shpjegojë edhe marrjen prej tij të Çmimit Nobel për Paqen në tetor të vitit 2009, edhe pse u prit me mjaft kundërshtime.

Në një regjistër të ngjashëm ka operuar në arenën ndërkombëtare edhe Edi Rama. Edhe pse në përmasat e një figure, duke qenë se është kryeministri i një vendi të vogël si Shqipëria dhe për të fituar pakëz vëmendje iu desh që të dalë në stil alla Donald Trump kundër vetë Donald Trump gjatë një vizite dhe dalje për mediat në SHBA! Shfaqjet e tij si politikan-artist janë komentuar edhe mediat ndërkombëtare dhe kanë tërhequr vëmendjen, ndërsa nuk ka hezituuar të hapë ekspozita personale pikturash ndërsa mban postin e kryeministrit si në Gjermani

dhe në vende të tjera, të fitojë mbulim mediatik për to si edhe për akte të tjera simbolike sikurse gjatë Paradës së Paqes në Paris me foto-opportunitetin e servirur në krah të klerikëve të të gjithë spektrit fetar në Shqipëri, etj. Në Europë, ashtu si Obama apo Hugo Chavez përtej oqeanit, kanë shkëlqyer me mjete të ngjashme figura të tilla si Boris Johnson apo Matteo Renzi.

Përfundime: Prirjet dhe rreziqet

Në një kohë kur kultura mediatike është bërë epiqendër e politikës, si për sa u përket zgjedhjeve ashtu edhe qeverisjes, nuk është e papritur që diplomacia dhe politika e spektaklit po marrin më tepër shtrirje dhe rëndësi. Megjithatë dukuria paraqitet mjaft ambigue dhe është e vështirë të përgjithësohet rreth saj apo të dalësh në përfundime të sigurta për ecurinë e saj.

Për shembull në një përpjekje për të shqyrtuar dukurinë e politikës së super-spektaklit, në librin e tij “Celebrity Diplomacy” të publikuar në vitin 2009, Andrew Cooper paraqet një qasje përgjithësisht pozitive në lidhje me ndërhyrjen e super-starëve në diplomaci dhe në kauzat politike, duke nisur nga Audrey Hepburn dhe deri tek Princesha Dajana apo shembuj më bashkëkohorë si Bono dhe Bob Geldof. Ndërsa përgjithësisht e intrigon diplomacia e stilit super-star, ai gjithsesi tërheq vëmendjen ndaj ushtrimit të saj si rrugë për t’i rënë shkurt, ndërsa ajo bëhet shkak për të hequr vëmendjen nga çështje më serioze politike dhe diplomatike si edhe lëniën në hije të profesionistëve të informuar për t’i dhënë zë këtyre çështjeve.

Cooper gjithashtu evidenton rreziqet e amatorizmit në drejtim të diplomacisë spektakolare duke u bërë shkak për bjerrjen ose diskretitimin e kauzave të mira. Sidoqoftë, një pjesë e politikanëve duke u shndërruar në super-starë globalë arrijnë të promovojnë interesat kombëtare ose të përfshihen në trajtimin e çështjeve globale. Cooper vëren se Bill Clinton dhe Nelson Mandela e kanë përdorur statusin e tyre prej super-starësh për të promovuar kauza të rëndësishme globale dhe janë angazhuar në “celebrity diplomacy” edhe pas përfundimit të mandatit të tyre. Po kështu, edhe rasti i Obamës si një model i epokës së spektaklit mediatik, flet për mundësinë që të jep statusi i superstarit për të avancuar çështje dhe axhenda të rëndësishme.

Sidoqoftë, kjo lloj politike apo diplomacie shihet me shqetësim kur llogariten efektet e saj afatgjata për sa i përket krijimit të kultit të super-starit dhe kur idhujt, modelët dhe idealet e sotme krijohen kryesisht përmes imazheve mediatike dhe spektaklit.

Megjithatë si një dukuri relativisht e re ende mund të jetë herët për të vlerësuar efektet dhe pasojat e saj për politikën bashkëkohore.

Referencat

- Barthes, Roland, Semiotika, Kapitulli 26 në “Vështrim i parë mbi Teorinë e Komunikimit”, Em Griffin et. al., 2015: Mc Graw Hill Education.
- Cooper, A.F., 2009. Celebrity diplomacy. Boulder: Paradigm Publishers.
- Eshelman, Raoul, (2001), Performatism, or the End of Postmodernism. *Anthropoetics* - The Electronic Journal of Generative Anthropology, Volume VI, number 2. <http://www.anthropoetics.ucla.edu/ap0602/perform.htm>
- Eshelman, Raoul, (2008), Performatism, or the End of Postmodernism, The Davies Group Publishers
- Jason Farago, 2016, “Meet Edi Rama, Albania’s artist prime minister”, 15 November 2016 <https://www.theguardian.com/artanddesign/2016/nov/15/meet-edi-rama-albanias-artist-prime-minister-exhibition>.
- Kellner, Douglas, 2010. Celebrity diplomacy, spectacle and Barack Obama in *Celebrity Studies* Vol. 1, No. 1, March 2010, Taylor & Francis.
- Kellner, Douglas, 2005. Media spectacle and the crisis of democracy. Boulder, CO: Paradigm Press.
- Kellner, Douglas, 2009. Barack Obama and celebrity spectacle. *International Journal of Communication*, 3 (1), 1-20.
- Sophie Arie, 2003, “Regeneration man; Tirana’s pop-star mayor has cheered up Albanians by giving their capital a facelift” by The Guardian, 22 October 2003. <http://www.guardian.co.uk/world/2003/oct/22/worlddispatch.sophiearie>

Përdorimi i Facebook në zgjedhjet lokale

Prof. Asoc. Dr. Roland Lami

UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS

e-mail: roland.lami@uet.edu.al

Abstrakt

Sot rrjetet sociale ofrojnë një infrastrukturë të re për medien publike dhe politikën publike. Falë rrjeteve sociale po krijohen premisat e zbatimit të një forme të re të demokracisë së drejtpërdrejtë, si realizimi në kohë reale i sondazheve të opinionit, votimeve elektorale, referendumeve popullore, etj. Zgjedhjet e fundit në Shqipëri, kanë dëshmuar për një tendencë në rritje të përdorimit të internetit në funksion të zgjerimit të përdorimit të rrjeteve social. Mirëpo, ndryshe nga ajo çfarë bëhet në vende me traditë në këtë fushë, kandidatët apo partitë politike më shumë ekspozonin veprimtarinë e përditshme sesa tentojnë të ndërveprojnë me publikun. Publiku më shumë përdoret sesa e përdor informacionin. Format e komunikimit zhvillohen vertikalisht dhe jo horizontalisht. Si të thuash aktorët politik përdornin rrjetet sociale me të njëjtën mendësi që përdoren mediet tradicionale. Një prirje e tillë u vu re edhe në garën për kreun e bashkisë së Tiranës në zgjedhjet e 2015, nga ana e kandidatëve Veliaj dhe Kosova në Tiranë.

Fjalë kyç: rrjetet sociale, partitë politike, fushatë elektorale, komunikim, imazh etj.

Hyrje

Interneti fal potencialit të saj është shndërruar në dekadat e fundit në një utopi për të gjithë ata që besojnë në ashtëquajturën Cyberie, “fshati planetar” i themeluar mbi lirinë, inteligjencën, njëkohshmërinë dhe shkëmbimet pa kufi (McLuhan, 1989). Bazuar në pretendimet e ngritur nga një kategori studiuesish, interneti sot mundëson kontaktin mes njerëzve me ose pa anonimat, I jep fund hierarkisë

shoqërore, rrit ndjeshëm zhvillimin e një inteligjence kolektive, si dhe mundëson çlirimin nga një kulturë masash e simbolizuar kryesisht nga televizioni.

Ky evolucion teknologjik është parë nën optikën e impaktit politik në shoqëri. Kjo për faktin e thjeshtë se pas çdo vale të teknologjive të reja lindin shpresa për një përsosje të demokracisë nëpërmjet zbatimit të mjeteve të fuqishme që mundësojnë kapërcimin e bllokimeve institucionale, ndërhyrjet e pretenduar të masmediave në informimin dhe largimin e qytetarëve nga jeta e qytetit. Sot, individët kanë më shumë akses në informacionet që më parë filtroheshin më pare nga gazetarët. Me pak fjalë, po ndodh ajo që Gianni Vattimo (1989) e ka quajtur “martja e fjalës nga sub-kulturat”. Njerëzit po intensifikojnë kontaktet duke injoruar hierarkitë shoqërore dhe largësitë fizike. Sipas tij, e gjitha kjo, mund të konsiderohet si një formë çlirimi dhe shenjë e demokracisë nga poshtë. Jo vetëm kaq, por platformat e rrjetëzimit social mundësojnë një ikonografi të re të politikës popullore shprehet Couldry (2014) si dhe një bazë të re në shpalosjen e historisë së implikimit të teknologjisë në politikë, duke zgjeruar kështu vizionin e Walter Benjamin-it të kulturës politike siç e quan ai në kohët moderne.

Sot rrjetet sociale ofrojnë një infrastrukturë të re për medien publike dhe politikën publike, të cilin, Penney Lewis (2011) e quan infrastrukturë e medias demokratike. Mundësia për të vepruar në mënyrë anonime në distancë i ka reduktuar disa nga barrierat e veprimit si: frika, ndrojtja, frustacioni etj. (Cavanagh, 2007). Interneti mundëson aktorët e lidhur lehtësisht në rrjet me njëri - tjetrin për të formuar rrjete më të mëdha. Atmosfera e çliruar e internetit, lehtësia me të cilën mund të krijohen lidhjet informale pa ndonjë referencë për dallimet të cilat ballë për ballë mund të krijojnë kufizime, renditen si më të rëndësishmet në zgjerimin e rrjeti social (Cavanagh, 2007).

Lauren Langman (2005) pohon se internet kërkon nga ne ta ridimensionojmë tërësisht natyrën e mobilizimit politik, pavarësisht se ne nuk e dimë se çfarë forme duhet të marrë një aktor politik pasi mundësitë në rrjet janë të ndryshme. Mund të ndodh që një aktor politik pa asnjë bagazh fillestar autoriteti politik duke vepruar online befasisht mund të fitoj statusin si aktor politik me peshë ose një me peshë ta zbeh autoritetin e tij fal ndikimit të rrjeteve sociale mbi të.

Qarkullimi i fotove dhe i videove online është bërë diçka e rëndomtë sot, po kështu edhe komentet në blogjet e njerëzve të tjerë. Disponueshmëria me rritje e telefonave celular me akses në internet të shpejtë ka rritur në mënyrë eksponenciale aftësinë e njerëzve për të qenë marrës dhe qarkullues të medias. Sot ne jemi në gjendje të takohemi dhe të organizohemi politikisht me njerëz që nuk i njohim dhe nuk i shohim, duke vepruar kështu me shpejtësi marramendëse përtej kufijve lokal, rajonal madje dhe kombëtarë (Bennett & Entman, 2001)¹. Disa shohin tek

¹ Bennett, L. W., & Entman, M. R. (2001) *Mediatic Politics: Communication in the future of democracy*, Cambridge University Press

kjo gjë fillimin e një mënyre të re për të bërë politikë, më shumë interaktive, më pak formale.

Edhe në Shqipëri, po krijohen hapësirat e reja të komunikimit, të cilat nëse do ti referohemi Frosini-t (1992) përmirësojnë ndjeshëm komunikimin: deputet – elektorat. Fal rrjeteve sociale po krijohen premisat e zbatimit të një forme të re të demokracisë së drejtpërdrejtë, si realizimi në kohë reale i sondazheve të opinionit, votimeve elektorale, referendumeve popullore, etj. Zgjedhjet e fundit në Shqipëri, kanë dëshmuar për një tendencë në rritje të përdorimit të internetit në funksion të zgjerimit të përdorimit të rrjeteve social. Shumë politikanë kanë intensifikuar përdorimin e rrjeteve sociale si: Facebook, Twitter, MySpace, Instagram etj në funksion të komunikimit me publikun.

Facebook-mania është shndërruar në një fenomen mjaft të përhapur në periudhën e fushatave zgjedhore. Fushatat elektorale për zgjedhjet vendore të 2011 dhe 2013 shënojnë një hop cilësor dhe sasior për sa i përket numrit të kandidatëve që shfrytëzuan rrjetin social facebook dhe twitter për të komunikuar me elektoratin dhe simpatizantët e tyre. Hapja e faqeve në rrjetin social facebook u kthye në modë në zgjedhjet e fundit lokale të 2015. Një numër i konsiderueshëm kandidatësh hapën llogari të paguara në rrjetin social, facebook. Në të njëjtën kohë, me qindra e mijëra ndjekës u përfshinë në këto faqe. Mirëpo, ndryshe nga ajo çfarë bëhet në vende me traditë në këtë fushë, kandidatët apo partitë politike më shumë ekspozonin veprimtarinë e përditshme sesa tentonin të ndërvepronin me publikun. Në faqet e tyre përgjithësisht publikoheshin foto nga takimet elektorale, të dhëna personale për veten ose partinë ku bënë pjesë kandidati, deri diku publikime të programeve elektorale dhe mungonin propozimet e temave për debate, organizim sondazhesh për për tema specifike, madje asnjëri nuk caktoi një datë apo kohë bisedimi virtual me mbështetësit e tij/saj. Informacioni që qarkullonte në këto rrjete ishte kryesisht linear me një kah, i ngjashëm me atë të medias tradicionale. Publiku më shumë përdorej sesa e përdorte informacionin. Format e komunikimit zhvilloheshin vertikalisht dhe jo horizontalisht. Si të thuash aktorët politik përdornin rrjetet sociale me të njëjtën mendësi që përdoren mediet tradicionale. Më shumë informohej sesa ndërveprohej me qytetarët. Informacioni më shumë ishte linera me një kah dhe vertikal sesa horizontal me shumë drejtime.

Një prirje e tillë u vu re edhe në garën për kreun e bashkisë së Tiranës në zgjedhjet e 2015. Pavaresisht se Partia Socialiste në fushatë u këshillua nga eksperti i komunikimit në qeverinë Bler, Alastair Campbell, ndërsa Partisë Demokratike, u këshillua nga kompania amerikane Mellman, facebook u përdor nga kandidatët kryesisht për informacion dhe jo matje për çështje të veçanta apo ndërveprim me mbështetësit. Pikërisht për të monitoruar në mënyrë objektive përdorimin e facebook dhe mënyrën e përdorimit të tij nga ana e kandidatëve, u ndalëm tek fushata e zhvilluar ngady kandidatët: Veliaj dhe Kosova në Tiranë


Metodologjia

Për të realizuar në mënyrë objektive mënyrën e përdorimit të facebook-ut nga ana e kandidatëve Veliaj dhe Kosova u përzgjedh metoda e vëzhgimit. Fillimit, u përcaktuan elementët që do të vëzhgohen si: numri i fotove, komenteve, like, share dhe video. Më pas, u hollën të dhënat në programin Excel dhe u ndërtuan grafikët përkatës. Vëzhgimi u fokusua tek faqet zyrtare të kandidatëve në facebook. U përzgjedh facebook i këtyre kandidatëve si njësi studimore nisur nga numri i lartë i ndjekësve dhe frekuentimi më i madh krahasuar me forma të tjera të komunikimit online.

Natyra e të dhënave të përftuar ishte e natyrës sasiore dhe cilësore. Periudha e vëzhgimit u shtri nga 7 Maj - 19 qershor të 2015. Kriteri përzgjedhës tëdy kandidatëve nuk ishte thjeshtë i bazuar në rezultatin e zgjedhjeve të 2015 por edhe në faktin që të dy kandidatët kishin numrin më të madh të klikimeve në facebook.

Rezultatet e vëzhgimit

Përsa i përket ndjekësve në facebook shihet një diferencë e dukshme ndërmjet kandidatëve, konkretisht nr i ndjekësve të kandidatit Veliaj në fillim të fushatës është 213.000, ndërsa ato të Kosovës janë 67.000, pra, rreth tre herë më pak se rivali i tij. Në fund të fushatës, Veliaj e mbyll me 230.693 ndërsa Kosova me 96.000. Këto të dhëna flasin për një interes në rritje në përdorimin e facebook nga ana e kandidatit Veliaj në raport me Kosovën shumë përpara në kohë se të fillonte fushata elektorale. Grafiku i mëposhtëm e ilustron këtë diferencë.



Arsyet e përdorimit të facebook para fillimit të fushatës nga ana e kandidatit Veliaj mund të jenë të shumta por tre mund të veçojmë si më të rëndësishëm. E para, Veliaj ndryshe nga Kosova përpara kandidimit drejtonte Ministrinë e Mirëqenies

dhe Shanseve të Barabarta kështu që ka qenë i detyruar si çdo ministër tjetër në qeveri të mbajë një faqe zyrtare për të informuar publikun për punën e bërë në këtë ministri, kështu që e ka ngritur rrjetin social para garë për kreun e baskisë. Së dyti, Veliaj për shkak të moshës së re është më shumë i përfshirë në rrjete sociale sesa Kosova dhe në një farë mënyre njeh më mirë rëndësinë e përdorimit të tij si kanal komunikimi. Të shumtë janë studimet që evindentojnë lidhjen moshë – intensitet përdorimi të facebook. Së treti, Veliaj njihet në publik si njeri i afërt i kryetarit të PS, kështu që zyrtarizimi i tij si kandidat për kreun e bashkisë së Tiranës ndryshe nga Kosova është bërë shumë kohë se të fillonte zyrtarisht fushata, duke i krijuar mundësinë që të shfrytëzojë më shumë kanalet alternative të komunikimit për ti paraprirë fushatës krahasuar me kandidatin Kosova.

Nr. i fansave në fillim dhe në fund të garës


Kandidatet	7 Maj	19 Qershor
Veliaj	213.000	67.000
Kosova	230.000	96.000

Këto të dhëna, vënë në dukje diferencën e ndjekësve ndërmjet kandidatëve po ashtu evidentojnë faktin që pavarësisht se Veliaj hyn zyrtarisht në fushatë me një numër ndjekësish gati dyfish krahasuar me kandidatin Kosova, numri i rritjes së ndjekësve gjatë fushatës është më i vogël krahasuar me atë të Kosovës. Kjo e dhënë lë të kuptohet se strategjia e ndjekur në facebook nga ana e Veliaj ka qenë më pak produktive krahasuar me rivalin e tij politik ose interesi për përdorimin e facebook si instrument komunikimi gjatë fushatës është zbehur duke i dhënë rëndësi formave alternative të komunikimit.

Për sa i përket publikimit të fotove në faqen e tyre duket qartë tendenca e vendosjes së fotove të personalizuar tek të dy kandidatët. Siç e shpjegon dukurinë në fjalë, studiuesi Miller (2011), “ideja se ajo çka bëjmë së bashku ka për tu konvertuar, aty për aty, jo thjeshtë në imazhe për tu përfshirë në një album fotosh, por në një valë imazhes online, është sot diçka integrale në menaxhimin e jetës sonë publike dhe private. Akti rutinor i të postuarit të fotove të një veprimtarie të përbashkët në facebook lidh ‘të treguarit’ me të ‘komentuarit’.” (Miller, 2011:95). Kjo gjë, tregon për një prirje gjithnjë e më të madhe të individit për të hedhur informacion rreth vetes me synimin për të siguruar një prezencë publike. Ose e shprehur ndryshe “individit priret të sigurojë një objektivizim të vetvetes” (Miller:179). Ky personalizim i përqendruar kryesisht tek imazhi apo e thënë ndryshe tek forma, e shpëput politikanin nga përmbajtja doktrinare dhe konceptet abstrakte. Publikut gjithnjë e më shumë i kërkohet të gjykojë për formën dhe jo përmbajtjen. Për atë ç’ka duket dhe jo çfarë thotë (Maigret, 2010).

Referuar të dhënave, vlen të thuhet se Kosova ndryshe nga Veliaj ka postuar fotot sipas aktiviteteve të zhvilluara gjatë ditës me statuse të ndryshëm, ndërsa Veliaj i poston në një status në formën e një albumi aktiviteteve të ndryshme të ditës.

Nr. i fotove të publikuar në facebook




Nga pikëpamja e përmbajtjes, konstatohet që imazhi i kandidatëve është tërësisht i kuruar, deri në detajin më të vogël. Nisur që nga mënyra e të veshurit, qëndrimit, dekorit, ngjyrave janë pjesë e bagazhit të imazhit që kërkohet të përcillet tek votuesi në mënyrë që t’i ‘rrembejë’ simpatinë dhe besimin që në ditën e zgjedhjeve të votojë për kandidatët respektiv. Rëndomtë konstatohet ajo që Jean Baudrillard, në librin e tij të famshëm “Amerika”, ku citon ish-presidentin Ronald Reagan thotë se filozofia amerikane e fushatave, paraqet një model kandidati të sigurtë në vetvete, i cili buzëqesh duke treguar kështu që çdo problem është i zgjidhshëm, lëviz bindshëm dhe çdo gjest me anë të trupit të tij, nuk është e rastësishme, por mbart një mesazh. Mirëpo, kjo formë stilizimi i pamjes është shndërruar në standart për tu imituar nga të gjithë aktorët politik, pavarësisht kontekstit ku zhvillojnë aktivitetin politikë. Siç shprehet me të drejtë Meunier & Peraya (2009) larmia e simbolikës së komunikimit jo verbal si: shikimi, qëndrimi, gjestikulacioni, shprehjet në fytyrë, përdorimi i hapësirës, dekorit po i nënshtrohen gjithnjë e më shumë simbolikës “tip” të fabrikuar nga kompanitë e marketingut. Ky i fundit e fabrikon dhe e shpërndan atë për konsum tek audienca. Të keqen në këtë rast e pëson publiku, i cili e ka të vështirë të dallojë ngjyresat politike dhe personalitet njerëzore të ndryshme përball një numri të kufizuar simbolesh virtuale të standardizuar që i ofrohen për deshifrim (Gaglio, 2005).

Me këtë logjik, disa poza “tip” që transmetojnë një mesazh të caktuar synohet të përfshihen në pjesën dominante të fotografive të postuara në rrjetet sociale, me justifikimin që gjithkush të mund t’i receptojë në mënyrë të atypëratyshme. Kjo kërkesë nxitet si nga kompanitë konsulente dhe nga aktorët politik, të cilët iu referohen disa pozave tip të përdorura nga politikanë të suksesshëm në arenën

ndërkombëtare, duke pretenduar të kenë të njëjtin efekt pavarësisht kontekstit social të publikut. Kjo prirje ka bërë të mundur që modelet gjeneralizuese t'i mbivendosen modeleve specifike që ata kanë trashëguar nga e kaluara në një proces të gjatë socializimi. Mirëpo, duke qenë se të gjithë përpiqen të imitojnë modele të suksesshëm imazhi nga fushatat e politikanëve të njohur, imazhi i tyre pavarësisht, diferencave profesionale, akademike, ideologjike që ata përfaqësojnë, reduktohet në një numër të kufizuar imazhesh.

Një prirje e tillë është më e dukshme tek kandidati Veliaj, i cili në një numër jo të pakët fotosh tenton të imitoj pozimet e Presidentit Barack Obama.



Mirëpo ajo që vihet re të paktën nisur nga nr. i *like*, komenteve dhe share të bërë në faqet zyrtare të kandidatëve është fakti që pavarësisht nr. më të madh të fotove të postuar nga kandidati Veliaj dhe pozimeve, në shumë raste të ngjashme me ato të Presidentit Barack Obama, përsëri nr. like, komenteve dhe *share* janë më pak, krahasuar me rivalin Kosova.

Nr	Erion Veliaj	Halim Kosova
Like	85072	129654
Komente	676	1019
Share	1077	1636

Një shpjegim për këtë diferencë mund të jetë thjeshtë e natyrës logjistike, në kuptimin që Kosova ka angazhuar më shumë shtabin e tij elektoral për të administruar faqen e facebook në raport Veliaj, por nuk mund të injorohet një shpjegim më substancial që **lidhet** me fushën e semiotikës. Prirja imituese në disa poza të Veliaj në raport me shumicën e fotove gati origjinal të Kosovës mund të jenë perceptuar si falsitete ose të pa kuptueshme në kontekstin shqiptar. Nëse do t'i referohemi perspektivës të autorëve Morley (1986) dhe Hall (1996), shpjegimi në këtë rast mund të lidhet me mënyrën e gabuar të të konceptuarit të tjetrit, gjatë fazës së komunikimit. Sipas autorëve në fjalë, vështirësia krijohet me vetë kuptimin e mesazhit të përcjell me anë të fotove, të cilat nuk varen vetëm nga përmbajtja në vetvete e mesazhit, por më shumë nga shkalla e interpretimit dhe kjo e fundit kushtëzohet nga tradita që qëndron pas personave që përpriqet ta bëjë këtë gjë. Komunikim nuk do të thotë vetëm të prodhosh informacion dhe ta shpërndash

atë, por nënkupton mbi të gjitha të jesh i vëmendshëm ndaj kushteve në të cilat mesazh-marrësi e merr, e pranon, e kundërshton, e rimodelon në funksion të horizontit të vet kulturor, politik, filozofik mesazhin dhe njëkohësisht, i përgjigjet nga ana e tij. Jo rastësisht, urat e komunikimit konsolidohen brenda anëtarëve që ndajnë të njëjtat kode komunikimi dhe përjashtohen të tjerët e ndryshëm nga ata. E gjitha kjo shpjegohet me faktin se njerëzit “janë të pajisur me një seri skemash të brendësuar me anë të të cilave ata perceptojnë, kuptojnë çmojnë dhe i vlerësojnë mesazhet.” (Bourdieu, 1989). Përmes *habitat*-it nëse do të përdorim konceptin e Bourdieu (1989), njerëzit prodhojnë praktikën e tyre dhe i përcaktojnë e i vlerësojnë ato. *Habitati* i manifestuar te secili individ është përfutur gjatë kursit të historisë individuale dhe është një funksion i një pike të veçantë në historinë shoqërore ku ai ndodhet. Kështu që një mesazh komunikimi që përthithet pozitivisht nga audienca në SHBA jo detyrimisht ka të njëjtin efekt në audiencën shqiptare dhe anasjelltas.

Një aspekt tjetër i përmbajtjes së fotove të postuar në facebook nga ana e kandidatëve Veliaj dhe Kosova është përpjekje maksimale për të tërhequr emocionet e publikut. Për këtë arsye Axford dhe Huggins (2001:65) e vënë theksin te rëndësia e përlllogaritjes së emocioneve që frymëzojnë jetën politike. Puthja e dorës e një nëne të thyer në moshë, mbajtja në krah i një fëmije me ngjyrë, hedhja e dorës në supin e një pensionisti, përqaftimi i ngrohtë i bashkëshortes në ambiente publike, shetitja me familjen apo të bërit pazar në fundjavë etj., janë disa nga emocionet që duan të përcjellin aktorët politikë në fotot e tyre. Përmes projekteve emocionale, politikanët organizojnë emocionet që duan të përfaqësojnë dhe të transmetojnë te publiku. “Strategjia e akumulimit të irracionales përkthehet në shumë raste në kapital politik.” (David & Paolo, 1996:272). Një gjë e tillë, për Curran (2002) konsiderohet si shpërndarje e përmbajtjes individuale te konsumatori.



E gjithë kjo, e përqendron vëmendjen e publikut te karakteri i politikanit dhe shumë pak te dimensionin politik i tij. Në krahun tjetër, specialistët e kompanive marketuese përqendrohen më shumë në evidentimin e cilësive të figurave politike dhe shumë pak në aspekte programore ose doktrinare. Në një farë mënyre jeta politike, duke u kuruar nga kompanitë marketuese dhe i bërë i ditur nëpërmjet

rrjeteve sociale shndërrohet në objekt komentesh për publikun. Gjithnjë e më shumë rrjetet sociale ekspozojnë espektet personale të aktorit politik. Për shumë politologë, ky evolucion i imazhit është shndërruar në një parodi, sepse shmanget vëmendjen nga çështjet që kanë të bëjnë me publikun (Balkin, 1998; Sartori, 2005). Fokusi tek jeta private e politikanit ndryshon kufijtë midis publikës dhe private, ajo ndryshon natyrën e asaj që është mbajtur në mënyrë të përshtatshme nga shqyrtimit publik. Jo vetëm kaq, por “përhapja e informacionit (ose thashethemeve) nëpërmjet fotove apo komenteve në status në lidhje me jetën private të aktorëve politikë përforcon idenë se sjellje të tilla private nuk janë tërësisht private, por janë edhe çështje publike për të cilat ky i fundit duhet të jete i interesuar” (Meyer, 2002: 56). Edhe pse disa informacione nuk kanë të bëjnë me çështjet politike, kompanitë konsulente gjykojnë se publikut duhet t’i serviren të gjitha të dhënat që ai/ajo të zgjedhë çfarë është relevante për marrjen e vendimeve me natyrë politike (Bohman, 2004:48).

Me këtë mendësi, shumë figura publike tentojnë të projektojnë aq sa është e mundur një imazh tërheqës për publikun duke zbuluar aspekte të ndryshme të fëmijërisë apo të familjes së tyre. Mirëpo, për Balkin (1998) sa më shumë politikanë shtojnë përpjekjet për të përdorur imazhin si një mënyrë për krijimin e afërsisë me zgjedhësit e tyre, aq më shumë ata fshijë kufijtë mes publikes dhe asaj që ata e promovojnë si private. Paraqitja e një aspekti privat për konsum publik, fton publikun të japë mendim në lidhje me të, duke e larguar nga substanca dhe ajo që vertetë duhet të shqetësojë atë. Shanto (2013) argumenton se politikanët, vazhdojnë të jenë bashkëpunëtorë të gatshëm në krijimin e një kulture të re politike, e cila i sheh aspektet private të jetës së një personi po aq të rëndësishme sa ato publike. Jeta private bëhet publike dhe jeta publike bëhet private pa pasur patologji, sepse të dy bashkësitë (private/ publike) janë para së gjithash konfigurime historike të “ndryshme dhe fluide” dhe jo sfera komunikuese, dhe se konfigurimet nuk vijnë njëri pas tjetrit, por mbivendosen (një politikan pjesërisht është në rolin e tij të përfaqësimit jopersonal, pjesërisht në ekspozimin e unit të tij, kur jep pëlqimin e tij: rrjetet sociale informojnë në mënyrë pedagogjike, argëtojnë, i bëjnë të dyja etj).

Ky ndryshim, shpie në kalimin nga vullneti për të transmetuar dije në atë për të vendosur lidhje me publikun dhe me jetën e tij të përditshme (Bennett & Entman, 2001). Mirëpo, çështja që shtrohet në këtë rast është se nga cilat parime do të niset publiku të gjykojë? Siç e shpjeguam edhe më sipër “imazhi” sipas Couldry (2013) shndërrohet në një nga rrugët më të shkurtra drejt kërkimit të informacionit. Kështu që, njerëzit falë rrjeteve sociale vendosin bazuar tek argumentet “joshëse” duke anashkaluar shpesh argumentet thelbësore. Kjo prirje konstatohet rëndomtë edhe tek fotot e kandidatëve që janë përzgjedhur për tu analizuar në studimin tonë.

Një gjetje tjetër në studim është mungesa e realizimit të sondazheve online për çështje të ndryshme. Shtabet elektorale edhe në këto zgjedhje preferuan më

shumë të kryejnë matje në terren sesa ti kushtojnë rëndësi anketimeve online. Një praktike e munguar në Shqipëri, pavarësisht eksperiencave që kanë kompanitë e huaja konsulente pranë shtabeve elektorale në vendet respektive. Nënvlësuar faktin që sondazhet online nuk janë thjeshtë instrumente për veljen e mendimeve të qytetarëve, por dhe mundësi më shumë për të “instaluar demokracinë e drejtpërdrejtë në kohë reale, e cila mundëson tek secilit trajtimin e problemeve të përbashkëta (Levy, 1996:24). Aq më shumë që, - siç bëhet e ditur nga shumë matje në terren, - një nga arsytet që njerëzit janë të ç’interesuar për politikën është pretendimi i ngritur që ata nuk kanë mundësi të shprehin hapur atë që mendojnë për çështje të ndryshme, kështu që sondazhi është një nga instrumentet që e mundëson një gjë të tillë.

Po ashtu, vërehet një mungesë e bisedimeve virtuale me ndjekësit në facebook. Asnjë nga kandidatët ndryshe nga kandidatet e zgjedhjeve të kaluar Rama dhe Basha nuk organizojnë takime për të bashkëbiseduar virtualisht me ndjekësit e tyre. Në një farë mënyre i gjithë strategjia e komunikimi në facebook bazohet tek informimi në lidhje me aktivitetet e kandidatit dhe jetën personale dhe partiake të tij dhe aspak tek ndërveprimi me ta. Një dimension i munguar dhe i pashfrytëzuar. Kjo për vet faktin se nëse do ti referohemi bashkëbisedimeve gjatë takimeve elektorale me kategori të ndryshme sociale konstatohet lehtësisht që të tilla takime nën efektin e kamerave më së shumti janë të inskenuara dhe të mirëmenduara për efekt show nga ana e kompanive marketuese sesa janë takime reale ku qytetari shpreh lirshëm mendimin e tij. Sigurisht, ka probabilitet të lartë që i njëjti inskenim të ndodh dhe në bashkëbisedimin virtual me ndjekësit në rrjetet sociale, mirëpo, ndryshe nga ajo që ndodh në terren ku kasetat e montuara nga kompanitë konsulente iu dërgohen televizioneve për transmetim, apo përcaktimi i një radhe të bashkëbiseduesve me kandidatin, në rrjetet sociale mundësia e censurës të bashkëbiseduesve është gati e pamundur. Kështu që rritet mundësia për të bashkëbiseduar me kandidatit dhe për tu mos censuruar fjala apo hequr e drejta për tu shprehur. E gjitha kjo, krijon një hapësirë lirie që për një pjesë të publikut vlerësohet si shumë e rëndësishme për procesin e komunikimit.

Për sa i përket publikimit të aktiviteteve në formë video, vetëm Kosova ka hedhur dy të tilla, ndërsa Veliaj asnjë. Numri është i papërfillshëm për tu shprehur në formë tabele apo grafiku por të paktën mjafton për të evidentuar se kandidatët i kanë shfrytëzuar shumë pak materialet filmike në këtë fushatë. Qoftë edhe për të postuar spotet publicitare apo aktivitetet e përditshme të fushatës. Një mundësi e pashfrytëzuar nga ana e kandidatëve nisur nga interesi i lartë që manifestojnë përdoruesit e rrjeteve sociale. Matje e ndryshme tregojnë që pas fotos video është më e klikuara në rrjetet sociale. Aq më shumë që kostot e kripura të transmetimit të reklamave në mediet elektronike e bën shumë rentabël shfrytëzimin e facebook për të publikuar materialet e ndryshme filmike të fushatës.

Konkluzioni

Të dhënat e mësipërm krijojnë idenë se nevojitet një kohë e gjatë për të pretenduar veljen e frutave të duhura elektorale në një njërën krah dhe diversifikimin e rrjeteve sociale në krahun tjetër. Aq më shumë të pretendosh rritjen e shkallës së interesit për atë pjesë të elektoratit që ndjehet i papërfaqësuar apo i injoruar nga ana e aktorëve politik. Mirëpo, duke parë rritjen e shpejtë të numrit të përdoruesve të rrjeteve sociale brenda një periudhe të shkurtër kohe, nevojat në rritje nga ana e aktorëve politik për të intensifikuar format e komunikimit me elektoratin si dhe faturat e kripura të kompanive marketuese këto vështirësi të para nuk duken të pakapërcyeshme. Aq më shumë që një situatë të ngjashme është kaluar edhe në vende të tjera që sot kanë shumë të zhvilluar këtë teknikë komunikimi. Ekzistojnë të gjitha gjasat që brenda një periudhe të shkurtër kohe, falë teknologjisë së komunikimit virtual të rritet interesi i ndërsjellë për të realizuar atë që Rodota e shikon si “një përputhje më të madhe ndërmjet vendimeve dhe interesave reale.”(1993:594) Ka mjaftueshëm arsytet për të besuar se qytetari shqiptar, falë mundësive që ofron teknologjia mund të ketë në të ardhmen një vizion më të qartë sesa sot për t’u lehtësuar ndjeshëm nga pesha e administratës dhe burokracisë. Aq më shumë, nëse qytetari ndërgjegjësohet me kalimin e kohës se nëpërmjet hapësirave që i ofron teknologjia jo vetëm mund të njohë më shumë e më mirë por edhe të vendos mbi disa aspekte që paraqesin interes për të, ka shumë gjasa që rrjetet sociale të gjejnë një përdorim masiv. Sigurisht, kjo ndodh nëse edhe në krahun tjetër aktorët politikë intensifikojnë komunikimin me ndjekësit e tyre. Ndryshojnë mendësinë e përdorimit të rrjeteve sociale e cila në shumë raste është e ngjashme me atë të medie tradicionale. Aktualisht, mediet sociale tek ne më shumë përdoret për të shpërndarë informacion sesa për të ndërvepruar me elektoratin. Ndërkohë, që praktika e vendeve më të zhvilluar sesa ne, gjithnjë e më tepër i përdorin këto instrumente komunikimi për të ndërvepruar me elektoratin e qëndrueshëm dhe atë potencial sesa thjeshtë për të shpërndarë informacion.

Bibliografia

- Becker, T., Slaton, D.Ch. (2000) *The Future of Teledemocracy*, London:PRAEGER.
 Budini, B. (2009) *Edi Rama Politikani Pop(ulist)-Star*, Tirana:UET Press.
 Bourdieu, P. (2009) *Mbi televizionin*, (Perk. Belina Budina) Polis.Tirane: UET PRESS.
 Dahl, R. (1989) *Democracy and its critics*, New Haven: Yale University Press,
 Castells, M. (2002) *The internet Galaxy: Reflections on the Internet, Business, and Society*. Oxford, Oxford University Press.

- Couldry, N. (2013) *Media, Shoqëria, Bota: Teoria sociale dhe praktika e medias digjitale*, Tirane: ISHM.
 Holden, B. (1974) *The Nature of Democracy*. United Kingdom: Thomas Nelson & Sons Ltd.
 International Telecommunication Union, (2009) <http://w.w.itu.int/ITU-D/ict/index.html>.
 Instituti EUNACAL (2011) *Raport për rezultate Sondazhi Zhvilluar Dhjetor-Janar*.
 Fondacioni për Shoqëri të Hapur. Ilda Londo, Reportere, Raporti për Shqipërinë. Zhvillimi i medias Dixhitale: Shqipëria. 2012
 Levy, P. (1996) *L'intelligenza collettiva*, Feltrinelli, Milano.
 Global Information Technology Report 2012, <http://reports.weforum.org/global-information-technology-2012/>
 Giddens, A. (2002) *Runaway World*, London: Boolmarque Ltd.
 Kajsia, B. (2009) *Media dhe politika, “Amerikanizimi i fushatës”*, Polis Nr. 8, Tirane: UET PRESS
 Raporti i Institutit Shqiptar të Medias, “Fëmijët dhe media”, dhjetor 2011.
 Maignet, E. (2010) *Sociologjia e Komunikimit dhe e Mediave*, Tirane.
 Marshall, M. (2008) *Instrumentet e komunikimit: Media si një zgjatim i njeriut*. Tiranë: I.D.K
 Masuda, Y. (1981) *The Information society as post – industrial society*, Washington: World Future.
 Miniwatts Marketing Group, Qershor 2010.
 Mill, S. (1861) *Consideration on representative Gouvernment*, The liberal Arts Press
 Shame, P. (2004) *Democracy Online: The Prespects for Political Renewal Through the Internet*, New York: Routledge
 Becker , T. Slaton, Ch. (2000) *The Future of Teledemocracy*, Praeger Publishers, 88 Post Road West, Westport, CT 06881.
 Progni, L. (2012) “Vleresimi dhe ndikimi i internetit e rrjeteve sociale ne politiken shqiptare”, <http://monitorimediash.wordpress.com/2012/11/12/vleresimi-dhe-ndikimi-i-internetit-e-rrjeteve-sociale-ne-politiken-shqiptare>.
 Rodota, S. (1973) *Elaboratori elettronici e controllo sociale*, il Mulino, Bologna.
 Toffler, A. (1981) *The Third Wave*, London: Pan Books
 Zanchini, G. (2005) *Teledemoracia: nënshetetas kokulur apo qytetar*, Tiranë: ISHM.
 Zguri, R. (2009) *Komunikimi bashkohor midis shqiptareve, “Komunikimi online ne realitetin shqiptarë”*, Tiranë.

Lindja e Berishës politik

Analizë teksti e artikullit të parë politik të Berishës në gazetën ‘Bashkimi’ të shtatorit 1990

Dokt. Alfred Lela

Abstrakt

Ky punim ka si qëllim gjetjen dhe analizimin e atyre që, për qëllim të këtij studimi, do të quhen “gjuhët” e të njëjtit tekst ose një artikulli të vetëm, publikuar në gazetën “Bashkimi” të shtatorit 1990. Nga analiza janë vërejtur katër gjuhë të tilla në tekstin e shqyrtuar më poshtë. Bëhet fjalë për atë që do të quajmë 1- “gjuhë të vjetër” (ligjërime i përdorur nga elitat komuniste në Shqipëri në periudhën 1945–1991) e cila përafrohet deri diku me atë që njihet botërisht si newspeak (Orwell, 1947) apo siç një tjetër autor e quan ‘shqipja totalitare’ (Vehbiu, 2007); 2- ‘gjuhën e re’ (ligjërimin me terma “perëndimorë” ose fjalë të papërdorura deri atëherë në ligjërimin publik në Shqipëri (si për shembull pluralizëm, demokraci, të drejtat e njeriut, pronë private etj.); 3- “gjuhën teknike” ose “shkencore” (fjalë që kanë të bëjnë me profesionin e ligjëruesit në këtë rast, mjekësinë); dhe, së fundmi ‘gjuhën ideologjike/politike’ (pra terma që mund të jenë të majtë ose të djathtë). Teksti i analizuar këtu është një artikull i shtatorit 1990–kohë kur regjimi komunist në Shqipëri ishte ende në fuqi (do të rrëzohet rreth dy vjet më vonë) i Sali Berishës, asokohe kardiolog e më vonë Presidenti i parë postkomunist. Synimi i këtij artikulli është hartimi i një fjalori dhe më pas me anë të një analize sasiore e katër llojeve të gjuhës për të kuptuar se cila peshon më shumë në diskursin e Doktor Berishës.

Hyrje

Ky artikull (Berisha, 1990) është edhe debutimi politik i njeriut që pas një viti e gjysmë do të bëhet presidenti i parë postkomunist i Shqipërisë. Bëhet fjalë për një shkrim të gjatë në një prej periodikëve të kohës (Bashkimi, 1990).

Së pari, do të hulumtohen fjalë dhe shprehje të *gjuhës së re*, domethënë koncepte apo terma të panjohur për publikun e asokohe, fjalor i cili jo vetëm lajmëron një retorikë të re, por edhe një guxim intelektual. (Për këtë të fundit duhet të mbani mend kohën dhe kontekstin shoqëror e një Shqipërie që përballet me ndryshimet e ndrojtura, por të pashmangshme pas 45 vitesh komunizmi Stalinian).

Së dyti, do të kërkojen gjurmë të *gjuhës së vjetër* asaj që George Orwell e quante *newspeak*, pra një diskurs që edhe nëse nuk është totalitar është socialist apo komunist në kufizimin e vet.

Së treti, do të hetohet për shenja të *fjalorit teknik* që lidhet me profesionit e autorit, mjekësinë, atë që quhet diskurs shkencor.

Së katërti, dhe e fundit, do të zhvendosemi te piketa që na çojnë te gjurmët e *retorikës ideologjike*. Këtu do të kërkojmë të identifikojmë shenja të së djathtë apo të së majtës në ligjërimin e autorit të tekstit.

Teksti nuk do të jepet i plotë, por prej tij do të shpëputen terma që përkojnë me një nga katër gjuhët që kërkojnë të identifikohen këtu. Këta terma do të formojnë secili një mini fjalor dhe krahasimi i tyre do të na mundësojë një analizë sasiore nga e cila do të nxjerrim dominancën e një gjuhë dhe renditjen e të tjerave.

Kërkimi i gjurmëve ligjërimore të tekstit të shqyrtuar këtu do të bëhet përmes retorikës duke pasur parasysh faktin se gjuha është njëfarë gjurmë gishti ideologjik, të cilën nëse dimë ta interpretojmë-e zbulon autorin, edhe kur ai ose ajo përpiket të fshihet. Prandaj, na duhet të shohim brenda retorikës dhe jo përtej saj (Toye, 2013). Një tjetër argument për t’u marrë parasysh është se kuptimi i çdo fjale apo grupi fjalësh mund të nxirret vetëm nga analiza e tekstit: rrethana, të njohura gjithashtu si konteksti në të cilën u shkrua ky tekst, janë po aq thelbësore. Kjo është quajtur si “dimensioni simbolik ritual i politikës” (Finlayson, 2016). Kur flasim për rrethanat (sociale, politike, kulturore) apo kontekstin, ne duhet të marrim parasysh posaçërisht profilin shqiptar të tyre apo *fazat e ndryshme të zhvillimit dhe procesit të leksikut politik e shoqëror të gjuhës shqipe* (Samara, 2008).

Metodologjia: Një analizë sasiore për të arritur te cilësia (profili) i autorit të tekstit

Metodologjia e përdorur për qëllimet e këtij artikulli është qasja sasiore e gërshetuar në fund me atë cilësore. Numerikisht, fjalët apo termat e përdorur nga Sali Berisha do të grupohen në katër grupe të veçanta për të kuptuar fillimisht se cila prej gjuhëve rëndon më shumë në komunikimin politik të intelektualit shqiptar të fillim viteve ’90 të shekullit të shkuar. Pasi të vendoset kjo balancë (ose të vërehet mungesa e saj) do të bëhet një krahasim i shkurtër me anë të qasjes metodologjike cilësore.

Në total teksti i shkruar nga Sali Berisha përmban 2838 fjalë. Prej këtij totali 166 fjalë janë evidentuar dhe klasifikuar si terma që përkojnë me një prej katër kategorive të gjuhës të specifikuar për qëllimet e këtij artikulli. Disa prej tyre nuk janë fjalë unike, pra nuk janë njësi më vete, por pjesë të fjalisë: këto do të evidentohen si (1) një njësi për llogari të një matjeje apo krahasimi shkencor. Në të njëjtën kohë edhe përsëritjet, pra përdorimi i një termi më shumë se njëherë do të përlllogaritet si pjesë e fjalorit. Kjo sepse edhe përsëritja e një termi flet, jo vetëm për bindje të folësit, por edhe për atë se me anë të termit vetë dhe të përsëritjes së tij ai ka dashur të arrijë një qëllim retorik apo politik.

Gjuha e re

Fjalët apo termat e klasifikuara si gjuhë e re në një tekst prej 2838 fjalësh janë 66. Ato janë kryesisht terma që në kushte të tjera nuk mund të klasifikoheshin si më shumë se fjalë të zhargonit politik në një demokraci normale, por këtu na duhet të mbajmë parasysh kontekstin: një Shqipëri ende nën komunizëm. Fjalë të tilla janë demokratizim, integrim, zhvillimet europaine, frymë qytetare, pluralizëm të mendimit etj. Veç tyre do të gjeni fjalë që janë më shumë se zhargon dhe fusin në komunikimin politik koncepte të reja duke u bërë pararendëse në njëfarë mënyrë të një ere që pritet të mbërrijë në diskursin e përgjithshëm politik e social të Shqipërisë. Të tilla mund të veçojmë: diaspora shqiptare, ne intelektualët, demokratët pa demokratë e të tjera.

Fjalori i gjuhës së re

- | | |
|--|--|
| 1- Demokratizimi | pranon demokracinë me vlerë unifikuese |
| 2- imperativë historike e kohës | edhe për çështjen kombëtare shqiptare |
| 3- marrëdhëniet dhe lidhjet e popullit tonë me popujt e tjerë—popullit, jo të partisë e cila në diskursin komunist të kohës ishte e vetmja që vendoste lidhjet | 7- frymën (e tyre) qytetare-një frymë e re që vendos në qendër polislin përkundër frymës komuniste të arave, fabrikave, kantierëve |
| 4- integritet- e kundërta e asaj që ishte shoqëri shqiptare e asaj kohe, e mbyllur, paranojake e pa integruar | 8- diaspora shqiptare-mërgata shqiptare që në termat komuniste ishte reaksionare dhe antishqiptare |
| 5- zhvillimet evropiane-ajo që ndodh në Europë përfshin edhe shqiptarët, shqiptarët si pjesë e Europës. | 9- demokratizimi |
| 6- proceset demokratike në vendin tonë janë njëkohësisht një ndihmë e çmuar për luftën e vëllezërve tanë në Kosovë- | 10- çështjen shqiptare-flet dhe pranon ekzistencën e një çështjeje shqiptare duke pasur parasysh shqiptarët jashtë kufijve të Shqipërisë |
| | 11- e unitetit moral dhe shpirtëror të kombit- |

- | | |
|--|---|
| 12- rezultanteje kombëtare të qëndrueshme | 42- heterogjene |
| 13- ne, intelektualët | 43- mendimi në to shprehej lirisht |
| 14- kombit | 44- kulturë të lartë komunikimi |
| 15- ndryshimin e njerëzve dhe të realitetit në një raport proporcional | 45- liria e mendimit dhe e shprehjes |
| 16- demokratizimin | 46- individët |
| 17- elementët antidemokratë | 47- pluralizmi |
| 18- brezin që bëri luftën | 48- të barabartë para ligjit |
| 19- pluralizmit të mendimit | 49- nuk ia mbylli gojën dhe s'ia topiti kurrë mendjen burrit shqiptar |
| 20- monizmin | 50- Në asnjërin prej këtyre neneve mendimin e shprehur lirisht nuk e konsideron krim social |
| 21- demokraci pa demokratë | 51- dinjitet njerëzor |
| 21- uniforma e mendimit | 52- pluralizëm |
| 23- karakterin e përjetshëm pluralist të mendimit njerëzor | 53- marrjen e vendimeve të ekuilibruara politike |
| 24- moniste | 54- hartimin e një strategjie e taktike të drejtë të lëvizjes kombëtare |
| 25- Dogmatikët | 55- kuvendet e mëdha kombëtare |
| 26- mendimin e tjetrit | 56- pluraliste edhe në rrafshin politik |
| 27- Proceset demokratike | 57- pluralist |
| 28- demokracia si pushtet i popullit i ka trojet në popull e buron nga shpirti i tij | 58- pluralizëm |
| 29- demokratizimi | 59- Demokracia |
| 30- agoni e vërtetë sociale | 60- humanizmi |
| 31- verbëri politike | 61- njeriun si qenie supreme, |
| 32- studimet sociologjike dhe psikologjike | 62- humanizmi |
| 33- politike sociologjike | 63- të drejtave të tij |
| 34- autocensurës | 64- popullit tonë edhe në rast se i ka munguar ndonjë strukturë legjislative e demokracisë, nuk i ka munguar ndonjëherë shpirti i saj |
| 35- mikrorreferendumi | 65- drejtës njerëzore |
| 36- votimit të fshehtë | 66- demokratizimit |
| 37- votimit të hapur | |
| 38- mbledhjet, letrat e forma të tjera | |
| 39- manipulohen | |
| 40- mbledhjet tona | |
| 41- presidiume imponuese | |

Gjuha e vjetër

Fjalët e koleksionuara në këtë seksion nga teksti i analizuar këtu janë kryesisht të idiomës komuniste të kohës. Burimi i tyre janë sa dokumentet zyrtare, sa zhargoni i nomenklaturës aq edhe ligjërimi i elitave kulturore të cilat për 45 vjet ushtruan ndikimin e tyre nëpërmjet asaj që u quajt letërsia apo arti socrealist. 50 fjalë i përkasin kësaj idiome, 16 më pak se sa gjuha e re e identifikuar më lart.

Fjalori i gjuhës së vjetër

1- shënojnë hapa të rëndësishme në thellimin	asgjë, njerëzit bëjnë gjithçka”
2- zhvillimin e pandërprerë e të pakthyesëm	28- masat e gjëra
3- vendimtar për ardhmërinë tonë	29- shumica dërrmuese e punonjësve
4- ecjen dhe zhvillimin e shoqërisë sonë në rrugën e përparimit të gjithanshëm	30- proces vendimtar
5- forcojnë akoma më shumë	31- forcat konservatore
6- gjithnjë më të madh	32- elementët ¹
7- pushtuesit serbomëdhenj	33- kuadro
8- e pashembullt	34- privilegje
9- jetik	35- intolerantët
10- detyrat e mëdha	36- rigorozitet
11- hapësirat e reja	37- vjelja e mendimeve
12- çelin para nesh	38- stadin aktual
13- mobilizojmë forcat	39- lapsit të “mprehtë” të aparatçikëve
14- t’ua përkushtojmë luftës për zbatimin, thellimin dhe përsosjen e pandërprerë	40- thellësisht demokratike
15- bibël	41- shqiptari në shekuj
16- zot	42- E dogjën, e vranë, e prenë dhe e shkretuan gjatë historisë së tij të përpjekjeve, betejave dhe durimeve të mëdha
17- linja e prerë e demarkacionit	43- vetvetiu mund të shtrohet pyetja
18- qëndrimeve të reja	44- fat të kobshëm
19- shfrytëzimin	45- pushtetuesit dhe bashkëpunëtorët e tyre
20- fuqizimin	46- armën me të cilën ai u mbijetoi terreve të zgjatura që historia s’ia kurseu
21- bazë të fuqishme	47- mbështetje e fuqishme
22- anakronike	48- shkalla e lartë
23- konsekuent	49- binom i pandarë
24- misionin e tij fisnik	50- thesar të çmuar
25- paraardhësve të tij të ndritur	
26- zotit	
27- tezën e Marksit se “historia nuk bën	

¹ Përdorimi i termit “element” për të thënë “njerëzit” është një mënyrë e newspeak-ut për të fshehur termin “individ”.

Gjuhë shkencore

Identifikimi i shkencore në diskursin e Sali Berishës, arsimimi dhe profesioni i të cilit në kohën kur është paraqitur ky artikull, është mjekësia, synon një raport të kësaj idiome në raport me politiken.

Fjalori i gjuhës shkencore

1-të vërtetën	14-pozitivizëm
2-kërkimin	15-metodave
3-zbulimin	16-teknikave
4-ekspozimin	17-eksperimentimeve
5-të vërtetën	18-të vërtetës
6-afirmimin	19-Studimet social-psikologjike të bazuara në teknikat sasiore e cilësore të analizës së mendimeve dhe opinionëve
7-riafirmimin	20-mostra
8-verifikimin	21-kritereve rigorozisht shkencore
9-riverifikimin	22-analizën në thellësi
10-e të vërtetave	23-mekanizmat sociale dhe psikologjike
11-gjysmë të vërtetat	24-analizën shkencore
12-artefaktet	
13-të pavërtetat	

Gjuha ideologjike/politike 15

Fjalët, interpretimi i të cilave mund të konfigurojë një tabelë gjuhësore apo komunikative që këtu e emërtojmë ideologjike/politike janë më të paktat, e njëkohësisht më ilustrueset. Për të mos e lënë shkencoren të zhvlerësojë kontekstin, ne këtu, më shumë se në gjuhët e tjera na duhet ta marrim parasysh atë. Termat politikë të përdorur nga Berisha më shumë se ideologji si e tillë, janë ravgime antropologjike. Këtu ai i referohet Kanunit, një kodi ligjor të maleve shqiptare, odës së burrave, besëlidhjes, Zotit etj. Pra, i kthehet traditës. Si e tillë, si kthim te tradita mund të emërtohet kjo idiomë politike e Berishës.

Fjalori i gjuhës ideologjike

1- odat e burrave	7- kombin
2- ligja e lashtë	8- edhe kuvendet lokale të besëlidhjes
3- garant i vërtet dhe i gjithëfuqishëm s’mund të ishte një njeri	9- traditë
4- u përkiste të gjithëve dhe e mbronin të gjithë.	10- forcë morale
5- kanuni, një, nga sistemet më të lashtë, më të prerë e më madhorë juridike	11- vëllazërimit e unitetit kombëtar
6- shpallte shtëpinë e shqiptarit, shtëpi të mikut dhe të zotit	12- filozofinë dhe kulturën e tij kombëtare
	13- djep
	14- truall
	15- qytetar

Përfundime

Retorika është përdorimi i simbolizmit dhe gjuhës për të siguruar se një mesazh është koduar në mënyrën e dëshiruar nga komunikuesi. Komunikimi retorik është qëllimisht joshës, është kyç për propagandën dhe përdoret për të inkurajuar një ndryshim në sjelljen e audiencës (Lilleker, 2006). Retorika është një mjet i përdorur në komunikimin e të gjitha rrafshëve politike që nga koha e qytet-shteteve greke. Në pikëpamjen e Aristotelit ‘retorika është një mjet për të përkulur vullnetin e njerëzve’.

Përfundimet cilësore që arrihen në përmbyllje të një analize sasiore të artikullit të Sali Berishës lidhen, në një masë të madhe, me atë që është quajtur ‘sukses i retorikës’ dhe sipas Lilleker (2003) ka të bëjë me të kuptuarit kompleks të audiencës, normave sociale, vlerave dhe frikës. Kur flasim për audiencë në rastin e shkrimit të analizuar këtu dhe të autorit të saj duhet të kemi parasysh të paktën tri të tilla.

E para është klasa politike në pushtet, e cila i përket një shteti autoritarist apo diktatorial komunist. Çfarë leximi do t’i bëjë ajo ‘gjuhëve’ të artikullshkruesit? Këtu mund të flitet edhe për ‘frikë nga audienca’ dhe jo për njohje të frikërave ta audiencës. Audienca e dytë, është publiku apo ai që, sipas rastit, mund të quhet ‘popull’ apo opinion publik. Çfarë do të gjejnë ata te artikulli i një intelektualisti si Dr. Berisha? Shpresë për të ardhmen? Qëndresë? Konformizëm? Rebelim? Kjo audiencë është e mbivendosur dhe “suksesi” për të cilin flet Lilleker është i diskutueshëm. Audienca e tretë është ajo që mund të quhet inteligentsia, pra klasa e intelektualëve, elita e mendimit. Gjykimi i tyre do të ishte i një llojit tjetër dhe ata do të konsideronin “sukses” retorik disa parametra të tjerë të artikullit.

Për këtë edhe ‘gjuhët’ e ligjërimit të artikullshkruesit janë disa: ai, me vetëdije ose jo, ka kërkuar që shtresat retorike të bashkohen në një, duke unifikuar kështu edhe audiencat. Gjuha e vjetër është një dedikim për klasën në pushtet; gjuha e re është të kërkuarit e partneritetit me inteligentsian; gjuha ideologjike është përpjekja për të ndërtuar vetes një profil politik; dhe, më e fundit, gjuha shkencore vjen në shkrim si “rudiment” profesional i cili luan megjithatë rol duke e veshur me autoritet retorikën.

Duke ndjekur arsyetimin e Aristotelit, sipas të cilit mjetet e disponueshme të bindjes janë të bazuara në tri lloj provash: logos, ethos dhe patos mund të thuhet se Berisha i ka përdorur të tria për të arritur te ‘suksesi’ retorik i artikullit.

Bibliografia

- Orwell, G.(1950) *1984*: Penguin Publishing Group. London.
 Vehbiu, A.(2007) *Shqipja totalitare-Tipare të ligjërimit publik në Shqipërinë e viteve 1945-1990*: Çabej. Tiranë.

- Berisha, S.(1990) *Intelektuali dhe koha, binom i pandarë*: Gazeta Bashkimi. Tiranë
 Toye, R.(2013) *Rhetoric, a very short introduction*: Oxford University Press. Oxford
 Finlayson, R& Atkins, J.(2016) *Political Studies “As Shakespeare so Memorably Said...”: Quotation, Rhetoric, and the Performance of Politics*: Political Studies, March 2016 vol. 64 no. 1 164-181
 Samara, M.(2008) *Rreth leksikut politik e shoqëror në gjuhën shqipe*: Akademia e Shkencave të Shqipërisë. Tiranë
 Lilleker, D.(2006) *Key Concepts of political communication*: Sage Publications. Los Angeles

Femërorja në revistat e modës shqiptare

Dr.Irena Myzeqari

Teuta Zyberli

Abstrakt

Ky studim synon të bashkojë në rrjetën e tij dy elementë të rëndësishëm, gjininë si variabël dhe Analizën e Ligjerimit si metodë, për të analizuar më nga afër revistat e modës në Shqipëri, për të parë se si ato e ndërtojnë imazhin e gruas dhe femëroren në faqet e tyre. Studimet kritike ndaj medias, gjithmonë e kanë cilësuar variablin “gjini” si një pikënisje të rëndësishme studimore dhe për Janice Radway, “analiza e teksteve nxjerr në pah përmbajtjen e përsëritshme dhe patriarkale. . .që nuk rreshtin së theksuari inferioritetin shoqëror të grave” (Maigret 2010: fq. 176). Judith Butler, e ndikuar nga politikat e identitetit të Michel Foucault, paraqet një pikëpamje më radikale për identitetin duke pohuar se “meqë” të thuash është “të bësh”, realiteti social është së pari një lojë etiketimesh që janë fortësuar janë ftohur përgjatë kohës (po aty: fq.180) dhe se gjinia është performuese në sensin që ajo është çfarë njeriu bën, jo ajo çfarë ai është” (Butler 1990: fq.18). Thënë kjo, ky studim synon që me anë të analizës së etiketimeve dhe analizës së artikujve në faqet e këtyre revistave të kuptojmë se si performohet gjinia, pra në atë çfarë gratë thuhet se bëjnë apo duhet të bëjnë dhe jo se çfarë ato bëjnë realisht.

Hyrje

Një nga pohimet më të rëndësishme të Studimeve të Kulturës dhe atyre identitare është se identitetet krijohen, zhvillohen dhe duhen kuptuar brenda një konteksti të caktuar, kushtet e të cilit shpeshherë krijohen nga faktorë të pavarur prej kontrollit tonë. Media dhe agjentë të tjerë socialë, jo vetëm ushtrojnë ndikim tek mënyra se si ne e ndërtojmë këtë vetë, por edhe ofrojnë modele të gatshme të subjekteve sociale të cilat konsiderohen si identitete të suksesshme ose jo brenda një vendi, trendi apo epoke. Një nga degëzimet më interesante të studimeve të kulturës, ka qenë

edhe interpretimi i teksteve të ndryshme duke filluar që nga shkrimet në gazetë, intervistat e për të përfunduar tek leximet e teksteve të ndryshme letrare. Struktura gjuhësore fsheh shpesh dhe legjitimon në të njëjtën kohë aparatin ideologjik të dominimit social. “Duke qenë se media luan një rol kyç në [civilizimin e sotshëm], lloji i gjuhës që ajo përdor dhe mënyra se si ajo e prezanton realitetin ka një ndikim të madh tek mënyra se si ne i perceptojmë subjektet sociale dhe pikëpamjen për botën në tërësi...” (Minna, 2009: fq.3).

Duke u nisur nga ato që u thanë më sipër, këndi kërkimor i këtij studimi synon të bashkojë në rrjetën e tij dy elementë të rëndësishëm, gjininë si variabël dhe Analizën e Ligjerimit si metodë, për të analizuar më nga afër revistat e modës në Shqipëri, për të parë se si ato e ndërtojnë imazhin e gruas dhe femëroren në faqet e tyre. Studimet kritike ndaj medias, gjithmonë e kanë cilësuar variablin “gjini” si një pikënisje të rëndësishme studimore dhe për Janice Radway, “analiza e teksteve nxjerr në pah përmbajtjen e përsëritshme dhe patriarkale. . .që nuk rreshtin së theksuari inferioritetin shoqëror të grave” (Maigret 2010: fq. 176). Judith Butler, e ndikuar nga politikat e identitetit të Michel Foucault, paraqet një pikëpamje më radikale për identitetin duke pohuar se “meqë” të thuash është “të bësh”, realiteti social është së pari një lojë etiketimesh që janë fortësuar janë ftohur përgjatë kohës (po aty: fq.180) dhe se gjinia është performuese në sensin që ajo është çfarë njeriu bën, jo ajo çfarë ai është” (Butler 1990: fq.18). Thënë kjo, ky studim synon që me anë të analizës së etiketimeve dhe analizës së artikujve në faqet e këtyre revistave të kuptojmë se si performohet gjinia, pra në atë çfarë gratë thuhet se bëjnë apo duhet të bëjnë dhe jo se çfarë ato bëjnë realisht.

Objektivat e studimit, hipoteza dhe limitet e studimit

Femërorja është kudo në media. Televizion, gazeta, revista apo edhe në rrjetet sociale si Facebook apo Instagram, hasen dendur imazhe që promovojnë standartet e bukurisë, sjelljes, formave të duhura trupore, imazhe të cilat kanë ndikim tek lexuesit përdoruesit e këtyre mediumeve. Shumë kërkime të bëra, jo vetëm në fushën e medias por edhe në psikologji e sociologji, nxjerrin të dhëna tronditëse se si këto imazhe janë bërë shkas për probleme të ndryshme të personalitetit, problemeve në ushqim dhe në socializim për një numër të konsiderueshëm njerëzish, specifikisht vajzave të reja të cilat mendohen të jenë edhe përdorueset më të mëdha të këtyre mediumeve. Ky punim, nisur nga një qasje post-strukturaliste, ku kombinohen teoritë e studimit të kulturës me ato feministe, merr në shqyrtim një numër revistash mode, ndër më të njohurat në vendin tonë dhe analizon portretizimin e gruas dhe femërores në faqet e tyre. Studime të tilla, ku kombinohen këto variabla, kanë qenë të pakta dhe të dhënat që ato mund të ofrojnë mund të shërbejnë për studimet e

mediemeve të ndryshme. “Shumë revista të famshme për vajza u tregojnë grave se si të fokusohen tek pamja e tyre, atributet e jashtme (si forma trupore, tonifikimi i muskujve, flokëve, make-up-it, rrobave etj.) dhe shumë rrallë përmendin rëndësinë e të qenit të zgjuar, të sofistikuar apo të zotërojnë attribute të tjera pozitive të cilat nuk kanë asnjë lidhje me pamjen e tyre të jashtme” (Sparhawk 2003: fq. 6).

Metodologjia

Gjuha është ajo që na mundëson ndërveprimin me tjetrin. Më anë të gjuhës “njerëzit nderojnë një botë shoqërore të diferencuar që sjell statuse, role, qëndrime dhe pozicione të caktuara. . . [dhe] në këtë këndvështrim ligjërimi duket “si një rezervuar” mjetesh dhe mënyrash bisede që u përgjigjen pozicioneve ose roleve sociale” (Dhima 2013: fq.362). Nën lentet e post-strukturalizmit mund të themi lehtësisht se nuk ka botë përtej gjuhës sonë. Për Foucault formacionet ligjërimore na tregojnë se çfarë njerëzit janë duke thënë dhe duke bërë në një periudhë historike e që janë sisteme veprimesh, jo e atyre që bëjnë si të tilla. Foucault ofron një diskutim të asaj që ai e quan “objekt-poste” të përcaktuara nga një formacion të diskursit, rolet sociale të folësve të këtyre diskurseve (Lemke 2005: fq.26). Është pikërisht kjo analizë e ligjërimin dhe e strukturave gjuhësore, ajo që na mundëson të kuptojmë se si krijohen realitetet sociale dhe identitetet tona.

Bazuar tek instrumentat analitike që na jep Analiza e Ligjërimin dhe Analiza Kritike e ligjërimin, të 5 revistat e marra për studim do t’i nënshtrohen kësaj metode analitike. Së pari janë marrë dhe analizuar revistat një nga një, për të parë se cilat ishin elementet kryesore, duke u ndalur, tek formati i faqes, nr. i rubrikave, rubrikat më shpesh të përditësuar. Së dyti, të dhënat u mblodhën dhe u grupuan brenda 5 kategorive kryesore të cilat janë:

- 1- *Rubrikat*
- 2- *Bukuria*: kush është nocioni për të bukurën;
- 3- *Instrumentalizimi i seksit*: përdorimi i joshjes si armë nga gratë;
- 4- *Trupi*: standartizimi i bukurisë;
- 5- *Brain in or out*: personaliteti dhe arritjet e gruas.

Në kategorinë e parë të dhënat janë më tepër sasiore si p.sh sa të gjatë ishin artikujt, tematikat më të shpeshta etj. ndërsa tek kategoritë e tjera të dhënat janë të një natyre më cilësore. Tek katër kategoritë e tjera do të analizohen:

- 1- Zgjedhjet e fjalëve; çfarë fjalësh përdoren për të etiketuar një femër; 2- Konotacioni ose ngjyrimet e fjalëve: epitetet, përcaktorët;

- 3- Klishet ose gjëra që merren për të mirëqëna, si përsëmbull “dihet se gratë flasin shumë” etj.
- 4- Termat seksist për të etiketuar trupin e tyre ose bukurinë e tyre;
- 5- Lloji i ideologjisë që fshihet pas artikujve.

Rishikim Literature

Në përqendrimin e postmodernizimit në kontekste të ndryshme, është vënë në dukje mënyra si ne flasim dhe shkruajmë në kufij shoqëror, historik dhe institucional. Kudo diskursi kthehet në terma të rëndësishme nëpër diskutime të ndryshme për artin, letërsinë, gazetarinë ku nuk lejohet t’u bëhet bisht praktikave shoqërore, kushteve historike të kuptimit aty ku prodhohen dhe perceptohen tekstet.

...«Ligjërimi (diskursi), nuk është thjesht ai që përkthen luftat apo sistemet e dominimit, por ai për të cilin e përmes së cilit luftohet, pushteti të cilin kërkojmë ta zotërojmë».... (Foucault, 1971)

Pra, ajo që ne dimë tashmë është se ligjërimi nuk është thjesht një mjet komunikimi, por është gdhendja e realitetit e shihet si një proces i rëndësishëm në fenomene sociale. Në kuadrin e ligjërimin si praktikë sociale i referohet jo vetëm bashkësisë së fjalëve që përbëjnë tekstin (e shkruar ose të folur), por dhe proceseve të prodhimit dhe interpretimit të atij teksti meqënëse ekziston një ndërveprim midis pronësisë së tekstit (gramatikor, semiotik, sintaksor etj.) dhe burimeve në mendjet e personave për të kuptuar, interpretuar dhe prodhuar tekste. Pra, duke qenë se analiza kritike e ligjërimin është në vetvete një qasje poststrukturaliste, duhet të mos harrojmë se gjuha nuk operon në një mjedis të izoluar, po ashtu edhe ligjërimi, i cili është gjithmonë në ndryshim.

Institucionet ashtu sikurse shoqëria, në kushte specifike, prodhojnë një bashkësi specifike konvencionesh (marrëveshjes) që përcaktojnë diskursin: çdo instancë, edhe individuale, përfshin gjithmonë marrëveshje sociale, si në nivel diskursi ashtu edhe në nivel praktikash. Kjo nënkupton që një individ është i aftë të veprojë (në nivel diskursi dhe në praktikë) vetëm nëse ekzistojnë marrëveshjet sociale në brendësi të të cilave veprohet. Ajo që vlen për t’u theksuar është analiza orientuese, ku kuptimi i saj përfshin të gjitha ato aspekte të një teksti apo diskursi me të cilën orientohet drejt të adresuarit të mundshëm, në drejtim të vet përmbajtjes prezantuese, dhe në sistemin shoqëror të zërave heteroglosik të diskursit të saj e të komunitetit në përgjithësi. Kuptimi orientues është më në thelb rreth social marrëdhënies: mënyra sesi një zë diskursi ndërton marrëdhëniet e tij me të tjerët.

Një individ definohet si një sistem material nga ana e ndërtimit për disa qëllime analitike të një prej shumë kufijve të ndryshme të mundshme që mund të mbyllin sistemin. Argumenti thotë:

“Nocionet e trupit, natyrisht, i paraprijnë formacioneve shkencore të diskursit. Pjesët e quajtura tradicionalisht të trupit, mund të na ndihmojnë të kuptojmë se “trupi kulturor

“, nuk është vetëm “etno-anatomi”, por të gjitha kuptimet simbolike dhe konventat vlerë bashkangjitur trupit, për pjesët e saj, të “llojeve” të ndryshme të organeve, etj. me një komunitet të caktuar. Ky është trupi si bartës i kuptimit social, trupit semiotik. Kur shohim një individ, tiparet dalluese që kemi mësuar të identifikojmë janë më shumë ato të këtij organi shoqëror dhe kulturor të përcaktuar semiotike (duke e parë atë në aspektin social të tij kuptimin-seksi, “i shëndoshë”, “i ngathët”, “atletik” dhe etnoanatomik: “fytyra”, “busti”, etj). Për të analizuar subjektin në konstruktin semiotik, duhet t’ia nisim nga sistemet sociale, një nga modelet kryesore të organizimit të këtyre praktikave, është ajo e akteve sociale, në të cilën ata janë të lidhur me njëri-tjetrin si elemente përbërëse të një sekuencë më të madhe të aktivitetit apo strukturës. Ne i ndëtojmë në strukturën e menjëhershme të veprimtarisë dhe çfarë i bën ato të dallueshme, të dukshme, individuale, të rëndësishme dhe të vlefshme si trupa. Përcaktimi i rolit është i rëndësishëm, një kamarierë apo një guzhiniere, mund të jetë një nënë, një bashkëshorte, studente, aktore, bijë etj. Në të gjejmë dy llojet e mëtejshëm të abstraksionit në rrugën për nocionin tonë kulturor të një personi individual. (Lemke, 1995:73)

Komuniteti në fakt prodhon lloje të caktuara sociale të individit. Shkalla e ndryshueshmërisë në trupat e tyre semiotike (të dukshme, mosha, hijeshia, lartësia, pesha, hiri, cilësia e zërit, etj), është mjaft e ngushtë në krahasim me popullsinë si një e tërë. Kështu do të jenë stilet e tyre të veshjes, e flokëve dhe lëvizjeve, dhe këto do të lidhen me një gamë të ngjashme të ngushtë të strukturave të mundshme të aktivitetit në të cilën ata do të marrin pjesë dhe një varg përkatës i roleve sociale që ne do të ndëtojmë për to. (po aty)

Mediat dhe Shoqëritë

Mediadhe në veçanti televizioni, me pushtetin që zotëron si pasojë e ndërthurjes së audios dhe videos, sjell në çdo shtëpi, në një kohë të shkurtër, një sistem koherent të mesazhit dhe imazhit, nga të gjithë cepat e vendit”. . . . Qytetarët preferojnë t’u ekspozohen informacioneve në përputhje me opinionet e tyre. Ata kërkojnë elementët që përforcojnë besimet e tyre dhe shmangin ato që i lëkundin këto besime. . . .” (Lazarsfeld 1944).

Në vazhdim të asaj çka perceptojmë si opinion, e me fjalën perceptim do të kuptojmë: “. . . pasqyrimin një tërësi e anës së jashtme të sendeve ose të dukurive në vetëdijen e njeriut me anë të shqisave dhe që përmban në vetvete edhe përvojën e njeriut. . . .” (Fjalor i shqipes së sotme, 1984, fq. 877).

Gjatë komunikimit për fusha të ndryshme në jetën e përditshme, njerëzit perceptimet mund t’i kenë të njëjta por japin zgjidhje të ndryshme duke ruajtur pavarësinë e opinionit të vet në një botë që është gjithmonë në lëvizje dhe ndryshon mendim orë e çast, duke thënë këtë më vjen ndërmend një shprehje e Emersonit ku thotë:

“... Është e lehtë të jetosh sipas opinionit të botës, kur je vetëm, është e lehtë të jetosh sipas mendimit tënd, por i mençur është ai që jeton midis të tjerëve dhe ruan pavarësinë e vet. . . .”

Ajo çka vlen gjithashtu për t’u përmendur është dhe teknika apo kurthet që ngrihen në këto lloje teknikash. Në librin “Mediat dhe Shoqëritë”, është folur se disa lloje teknikash ofrojnë ose shtrembërojnë informacionet për mirë ashtu dhe për keq, duke arritur synimet qoftë me hapa të ngadalta ose më të shpejta. Si më poshtë:

- *Të shkruarit dhe imazhi*—E para është në fushën e arsyes, e dyta në fushën e emocioneve. Abuzimi i tyre mund të jetë kurth i dezinformimit, një pengesë në rrugën e mendimit.
- *Transmetimi direkt ose shpejtësia: mendimi ka nevojë të mbajë një farë distance, gazetari duhet të mbajë të njëjtën distancë nëse dëshiron të përcjellë një informacion për të genë.*
- *Imazhet virtuale: krijohen në sajë të pajisjeve informatike mund ti shërbejnë realitetit duke i pararendur atij, duke e bërë të dukshme diçka që nuk mund të shihet me sy të lirë. Ato hedhin një urë të rëndësishme për mendimin midis botës së prekshme dhe asaj të hamendësuar.* (Mediat dhe shoqëritë, 2011:767-768)

Sociologjia e komunikimit dhe e mediave

“Mediat e komunikimit masiv përdoren për të ushqyer realitetin e përditshëm me kënaqësi ditë pas dite, dhe për të rritur harmoninë në familje. Ato flasin për një botë të mbushur me premtime të ndërtuar si mjedis, por sidomos për të rritur aktivitetin në familje. . . .” (Sociologjia e Komunikimit dhe e Mediave, 2010, fq. 168)

Në leximin e këtij libri, u vu re që Radway analizonte tekstet me përmbajtjet e ripërsëritura të tregimeve që paraqisnin atë rreth të shoqërisë që ishte inferiore ndaj grave. Ajo vinte theksin në këto tregime duke shpjeguar:

“... Të paafta për të ndryshuar jetët e tyre, lexueset ëndërrojnë për një jetë imagjinare që do t’i pengonte të vepronin në një botë reale. Edhe pse nuk janë aspak revolucionare, ato përsëri arrijnë t’i ndërgjegjësojnë disa gra [për mënyrën e tyre të jetesës, i bëjnë që të kthejnë vështrimin drejt vetes së tyre, të imagjinojnë zgjedhje të reja]. . . .” (Sociologjia e Komunikimit dhe e Mediave, 2010, fq. 177)

Analiza

Rubrikat

Që në projektimin e parë të “mendjeve gazetareske” është planifikuar që një media të përmbledhë të përditshmen, të përmbledhë ngjarjet që krijojnë jetesën dhe stilin e saj; të japë këshilla për t’u kujdesur për shëndetin, për trupin, modën, mënyrën e të ushqyerit. Qëllimi i përfshirjes së të gjitha këtyre rubrikave është që kjo revistë të shkojë në sa më shumë duar, të lexohen sa më shumë, në këtë mënyrë i përgjigjet dhe dëshirave për të patur një treg sa më të konsoliduar. E gjithë kjo që thamë, vitet e

fundit është bërë “si e modës” sepse është kuptuar që njerëzit janë shumë të interesuar që të dinë të rejat më të fundit në çdo fushë, për shëndetin, modën, bukurinë, marrëdhëniet etj. Në shumë media ka dhe rubrika si “PAPARACI ose GOSSIP”, ku interesi i njerëzve për njohjen e VIP-ave, është i pakufijshëm, ndaj dhe këto revista i lënë hapësirë “shuarjes së kuriozitetit” për jetën e tyre. Në vrojtimin e bërë në këto revista kemi parë një numër relativisht të madh të rubrikave. Në revistën “ICON-STYLE” shohim se ka **më pak** rubrika, rreth 7 të tilla, të cilat pasqyrojnë këto fusha të lartpërmendura. Shohim se përditësimi i kësaj reviste bëhet në opsionin online (kjo gjë ndodh me të gjitha revistat të cilat i kemi shqyrtuar). Shohim se në artikujt e hapur të kësaj reviste, publikohen reklama të disa firmave të rëndësishme në bashkëpunim me firmat e njohura ndërkombëtare si p.sh: “Swarovski”; “Villaroy & Boch”; “Swatch” etj. Revista numër 2 është revista “CLASS”, përveç hapësirave që u jep modës, artit, thashethemeve, bukurisë, Alketa Vejsiu ka vendosur që t’u jap këshilla edhe për organizimin e festave apo evenimenteve, marrëdhënieve shoqërore dhe jo vetëm.

“CLASS-i” ka gjithsej 9 rubrika, të vendosura e të pasqyruara bukur dhe me klas, përditësimi bëhet në mënyrë të vazhdueshme sipas lajmit dhe rëndësisë së tij. Reklamat që pasqyrojnë kjo revistë janë reklama “Diamond Dental”; “GoldenPoint”; “Vodafone”; “Ital Optika” etj. Në përgjithësi themi që reklama është shpirti i tregtisë, dhe në këto raste ato (revistat) i përdorin reklamat jo vetëm për t’ua ofruar njerëzve të tjerë por dhe duke përfutur për veten e tyre.

E treta është “Who”, përmban si titull “një pyetje, por të jep shumë përgjigje”, përgjigjet janë 12 rubrika, përveç atyre që kanë të përbashkëta më sipër, i dedikon një hapësirë dhe sondazheve; intervistave; oltbook. Reklamat janë: “Proper Pizza”; “Dimal”; “Samsung” etj. *E katërta* në radhë është revista “LADY ALBANIA”, e cila ka 10 kategori, ku një rubrikë e veçantë është Karriera, me anë të së cilës mund të orientohesh në treg. Marketingu duket se ka vendin e tij të veçantë dhe në këtë revistë ku shihen më tepër firmat si: “Mango”; “Dyqan Taxi”; “GoldenPoint”; “Philips” etj. E fundit e përzgjedhur është revista “ANABEL”, e cila ka një dyndje të madhe, ndër më të mëdhat prej të gjithave, me 8 rubrika, qofshin ato sasiore dhe cilësore. Reklamat që publikohen më shumë janë ato të “Vodafone” dhe “Telecom”, dy kompanitë më të mëdha në treg të telefonisë celulare. Në përfundim të kësaj analize mund të themi që: të gjitha synojnë t’ju vijnë në ndihmë femrave për një jetë me sa më shumë lehtësira si nga ana ekonomike dhe ajo e paraqitjes, përjashtim bën këtu revista e parë, “ICON” e cila merret paksa dhe me meshkujt.

Bukuria

Që të flasësh për bukurinë duhet të përdorësh vetë bukurinë. Duke iu përmbajtur kësaj shprehjeje, të gjitha revistat flasin për bukurinë, për mënyrën sesi ta arrish këtë. Bukurinë të dy gjinitë e përshkruajnë në mënyra të ndryshme. Përse e themi këtë?

Nëse gratë bukurinë e përdorin jo vetëm për joshje, burrat mendojnë se e përdorin vetëm për këtë, nëse gratë thonë që bukuria është një element më shumë në rekrutimin (baza materiale dhe garderoba në një vepër teatrale) e aftësive të tyre, burrat mendojnë që gratë e përdorin si armë për të çarë përpara. Nëse për një grua e ka një fytyrë, për burrat do donin që të mos ishte fytyra e tyre. 7 janar 2016, artikulli në revistën “WHO” me titull “Sa shpesh e kritikojnë veten femrat gjatë ditës”.

Në këtë artikull të bie në sy paragjykimi që i bëjnë vetvetes femrat në lidhje me bukurinë e tyre të jashtme, pra mungesa e vetvlerësimit. Fjalët që vihen re më shumë janë kritikrat e ekzagjeruara si “**ua sa e shëmtuar kjo**” “**sot jam gdhirë me një “bunker” më shumë**”; “**flokë të shëndetshëm**”; “**shkëlqim në fytyrë**” etj.

Dua të kujtoj një shprehje e cila lidhet me femrën e bukur, që e thotë një leksikografe e njohur, Erin McKean:

“Nuk je e detyruar të jesh e bukur. Nuk i detyrohesh askujt për bukurinë tënde. As të dashurit/bashkëshortit/partnerit, as kolegëve të punës, veçanërisht as meshkujve që takon në rrugë. Nuk iu detyrohesh as prindërve, as fëmijëve, nuk i detyrohesh shoqërisë në përgjithësi. Bukuria nuk është një qira që e pagan sepse ke zënë një hapësirë të quajtur “fëmër”.... Revista Class, “30 shprehje frymëzuese nga gra që guxojnë”, 25 janar 2016.

www.revistaclass.al/d/84/194/5447/30-shprehje-frymëzuese-nga-gra-qe-guxojne/

E bukura nuk ka limit, dhe femrat këtë dinë ta shfrytëzojnë shumë mirë, këtë e ka përkufizuar më së miri autori francez, François de La Rochefoucauld, që thotë: “Gratë nuk e njohin pakufishmërinë e cilësive të tyre....”(F. Rochefoucauld, 2007, fq. 25)

Në kohën e sotme, ato i njohin cilësitë dhe defektet e tyre, puna është që ato duan të perfeksionojnë bukurinë e tyre.

Instrumentalizimi i seksit

Nga vëzhgimi i revistave të përzgjedhura, u vu re që jo të gjitha e trajtonin temën e marrëdhënieve intime. Akoma duket se kemi tema tabu, të cilat nuk kanë arritur të depërtojnë tek pronarët dhe gazetarët e këtyre mediave. Përgjithsisht marrëdhëniet në çift, këto revista e përshkruajnë si diçka të bukur, jo thjesht si një akt seksual të mbushur me fjalë të cilat mund t’i lexosh por në jetën e përditshme nuk përdoren. Ai/ajo që na tregon apo rrëfen një marrëdhënie e fillon më lojrat që bëhen në fillim për të krijuar një atmosferë më intime, interesante dhe më të kënaqshme. Kështu përdoren fjalët “**gjoksi i bukur**”; “**thitha të fryra**”; “**lëkurë e butë**”; “**ndeze**”; “**shikimi sy më sy**”; “**përdorimi i gjuhës**” etj, e në fund mbas një paralaje të ndezur shkohet në aktin e fundit, në penetrim midis dy organeve gjenitale, M dhe F. Këtu na vjen ndërmend libri i Paulo Coelho, “11 minuta”. Sipas tij kaq janë minutat të cilat përcaktojnë një akt seksual të kënaqshëm. Në vazhdim të identifikimit të atyre revistave të cilat flasin më tepër për këto marrëdhënie janë revistat: “WHO” dhe “ANABEL”. Në një prej artikujve të revistës “WHO”, të datës 17 tetor 2015,

titulli artikullit ishte përdorur një klishe, **“Ngjyra e flokëve tregon sa e mirë je në krevat”**, sigurisht që ne e dimë mjaft mirë që shumica e audiencës apo e lexuesve tërhiqet më shumë nga ky titull, pasi gjëja e parë që mendojnë është :”A është e përputhshme ngjyra ime?” ose “Ok, unë jam brune, a thua do jem e mirë në krevat?” A ka menduar ndonjëra prej vajzave lidhjen midis seksit dhe ngjyrës së flokëve? Sipas atij artikulli duket se ka më tepër se ç’mund të mendojmë, pasi ka një lidhje të fshehtë midis ngjyrës dhe jetës seksuale, duke qenë se ngjyra e flokëve tregon “tërthorazi” se ç’natyrë kemi. Duket se me termat e përdorura ato që janë më të **“ndeura”** janë flokëkuqet, të cilat përshkruhen si më **“aktivet”**, më të **“zjarrrat”** dhe më të **“shkathtat”**. Në vazhdim flitet për biondet të cilat përshkruhen si më të **“besueshmet”** dhe më të **“fuqishmet”**. Sigurisht që të gjitha këto vijnë nga studime të kryera në shtete të mëdha e në universitete prestigjioze. Më tej, më 22 mars 2016, në revistën “ANABEL”, një tjetër titull shet “5 arsyt pse femrat e mbushura janë të papara në shtrat”. Duket se format më eksituese për partnerin, janë ato të mbushurat. Duke qenë se këto femra kanë më **“tepër”** në çdo pjesë të trupit, **“gjoks, vithe, kofshë”**, krijon një ndërveprim seksual më të rëndësishëm gjithashtu këto femra të **“mbushura”** janë edhe më “epshore”, kanë një nivel më të lartë të libidos. Në vazhdim që ndoshta është dhe më e rëndësishmja “më pak paragjykim”, këto “kilet e tepërta” pranojnë dhe më me lehtësi “defektet” e partnerit, duke krijuar thjeshtësi dhe liri në marrëdhënie. Rregulli që titulli shet, duket mjaft mirë në përzgjedhjen e fjalëve që gazetarët bëjnë në shkrimin e artikullit të radhës, dhe të gjitha fjalët e përdorura duket se gjejnë një titull bombastik për të tërhequr vëmendje dhe shikueshmëri. 22 shkurt 2016, në revistën “ANABEL” titulli “Shenjat e pamohueshme se jeni e mrekullueshme në shtrat” duket se shiti jo dhe aq, me 87 pëlqime. Femra sigurisht që pas aktit seksual pret reagimin e partnerit, nëse ai **“nuk rri dot pa të prekur gjatë ditës”** apo që **“shtrëngon duart apo këmbët”** apo dhe **“vazhdon të jetë flirtues”**, nëse merren këto përgjigje atëherë përgëzime femër e dashur, je e mrekullueshme në shtrat, (e gjitha kjo e shprehur në këtë artikull). Duke qenë se gazetarët dhe media e di shumë mirë se çfarë kërkon audienca të dijë e mbi çfarë të informohet, ata shkruajnë artikuj që të plotësojnë dëshirat e tyre. Siç titulli shet, ashtu ndodh dhe me seksin.... “Kjo e fundit përmbledhet në: riprodhim, kënaqësi dhe krenari...” (Jong, 1973, fq.55)

Trupi, standartizimi i bukurisë

Duket se ndër shekuj trupi i femrës ka kaluar në evoluim dhe ka ecur përpara, dhe në shikim të parë duket se në çdo 10 vite, humben me mijëra kilogramë nga të gjitha femrat në mbarë botën. Nëse në ditët e sotme dëgjojmë grupin emëror “trup femre” do të na vijnë ndërmend personalitete apo modele shumë të famshme të cilat vite më parë ishin dhe janë në qendër të vëmendjes për trupin perfekt që kishin

dhe kanë. Shumë prej nesh do të kujtonim **seks-simbolet** si Marilyn Monroe, e vitit 1950; Kate Moss 1990; Adriana Lima, 2000 ndërsa tani në vitet 2015-2016 seks-simbolet e mbarë botës janë: Kim Kardashian dhe Jennifer Lopez. Piktorë të ndryshëm të kohëve më të vryera të artit, pasqyronin femra me hiret dhe kilet më të përshtatshme, femra që nuk identifikoheshin me kilet, (kujtoj këtu Mona Lisën; Venerën etj, të cilat në artin e penës nuk flisnin me kile, por me vështrime). Femrat e asaj kohe me këmbë të gjata u ngjanin orëve me rërë, apo strukturë këndore kockash dhe gjymtyrë shumë të hollë apo femra të gjata, të dobta dhe me gjoks të madh, për të ardhur sot në trupat e shumë-kërkuara nga femrat, trupi J-Lo-s apo Kim-it, të cilat kujdesen në ekstrem për pamjet e tyre, ku i gjithë trupi i tyre që nga koka e deri te këmbët duket se ngjasojnë me kthesa të forta, që siç i thotë dhe ime më me humor “duken si kthesat e Qafë-Llogarasë”. E në fakt i gjithë ky përkujdes krijoi për disa kohë dhe kaos tek të gjitha vajzat e reja që synonin trupat e tyre deri në atë pikë sa të bëheshin dhe anoreksike, dhe në vazhdim të këtij shekulli duket se tashmë “trendit anoreksik” i është hapur luftë dhe tanimë synohen trupat e kolmë ose “0 nuk është më një masë” Revista “CLASS” i ka kushtuar rëndësi dhe pjesës së trupit duke i dhuruar lexuesve besnike këshilla për trupin, për të gjitha masat trupore, duke u treguar e kujdesshme që asnjëra prej tyre të ndihet jekomforte me atë çka lexon dhe atë çka trupi i saj shpreh. Një prej artikujve të saj me titull “7 mënyra për të mos e urryer më trupin tënd” tregon sesa do e “pashpirt” të jesh treguar me trupin tënd gjatë gjithë vitit me ushqime, me palestër etj, duket se ofron një zgjidhje tjetër që ndoshta pas shumë përpjekjeve, është më mirë ta pranosh atë që është ashtu siç është. Ajo që synohet më tepër është mos ndjekja e modeleve të famshme, “Mos ndiq Gigi Hadid për t’u frymëzuar por gra si Barbie Ferreira, që ka një vetëbesim ngjites. **“Mos u bëj sklave e modës”** është një tjetër shprehje e cila këshillon fort që të ndjekësh masën dhe jo pamjen, **“larg xhinseve të ngushta dhe bluzave pas trupit”**, gjithashtu dhe gabimi që bëjnë më shumë vajzat është se ajo ç’ka nuk pëlqehet nga trupi tyre, bëhet objekt bisede kudo, sa herë që bëhet anti-reklamë për peshën tek miqtë e përhershëm, ajo çka thuhet mbrapsht nga të tjerët janë gjithmonë fjalë të mira që ose nuk janë të sinqerta, ose nuk janë fort të mira. Po pse gjithmonë duhet të presësh nga të tjerët për të marrë një “kompliment” apo një fjalë të mirë, kur ajo që duhet të bësh është që vlerësimi të nis nga vetvetja më parë dhe më pas nga të tjerët?! Të gjitha revistat në kategorinë e tyre të trupit, identifikojnë çdo fjalë, çdo masë, çdo femër me personalitete, aktore, modele të famshme, dhe çdo shpjegim apo këshillë i atribuojnë nga një modele perfekte. Në revistën “ANABEL” u vu re që të gjitha artikujt për trupin niseshin kështu: “ERANDA LIBOHOVA: NJË **“BISHË”** NË PLAZH”; **“TRUPI «BOMBË”** I J-LO”; “RRËFEHET LORI HOXHA: ZBULON SEKRETET PËR NJË **TRUP TË HATASHËM**” etj, e vetmja pyetje që lind është nëse këto artikuj reklamojnë VIP-at apo këshillojnë femrat e thjeshta që ndonjëherë pa frikë, xhelozojnë dhe nuk ndihen aspak mirë me atë çka janë. ?!

Nga ana tjetër, revista “LADY ALBANIA” duket se bën një përzgjedhje fjalësh më me kujdes, etike dhe të tërheqëshme dhe më e rëndësishmja “fjalë reklamuese” që do të thotë se në shpjegimin e një artikulli për bukurinë trupore, në këshillat që përdoren, kjo revistë synon t’u bëjë reklamë dhe produkteve që mund t’i realizojnë këto qëllime të lexuesve dhe konsumatorëve njëkohësisht. Në përfundim të kësaj analize një shprehje e thënë prej një këngëtareje ndërkombëtare: “Ne duhet të riformojmë perceptimin tonë rreth mënyrës si e shikojmë veten....” e thënë kjo nga Beyonce !!

Brain in or out

Personaliteti dhe arritjet

Të gjithë e dimë atë shprehjen e famshme: “Pas një burri të suksesshëm, qëndron një grua e fortë”. Kjo ka të bëjë drejtpërdrejtë me personalitetin e tyre, sepse gratë janë të guximshme, kanë iniciativë, pavarësisht ndjeshmërisë së tyre arrijnë ti përballojnë dramat, apo tragjeditë e jetës më me shumë forcë dhe kurajo. Siç thotë dhe poeti rus Konstantin Balmont:

“Gruaja është muzikë. Gruaja është dritë”. (K. Balmont, 2007, fq. 6)

Karakteristikat e një gruaje të formuar janë: “**ndjeshmëria**”; “**karizma**”; “**sensi i humorit**”; “**vetbesimi**”; “**pasioni**”; “**dashuria që ka për jetën**”; “**dhuron jetë**”. Të gjitha këto formojnë imazhin e një gruaje të fortë, të zgjuar, plot dritë dhe jetë. Në një prej artikujve të revistës “LADY ALBANIA” të datës 25 prill 2016, flitet për disa karakteristika që kemi përmendur më lart, shkurtimisht, janë ato që joshin lehtësisht seksin tjetër. Titulli është “Karakteristikat e femrave pas së cilave meshkujt çmenden”. Përmenden “**besimi në vetvete dhe pavarësia**” ku femrat e forta dinë t’i bëjnë gjithnjë meshkujt për vete, ndërsa pavarësia e bën të ndihet e lirë dhe që mashkulli e çmon tej mase. “**Natyra pasionante**” ku meshkujt çmenden pas femrave që kanë natyrë **pasionante** dhe disi **lozonjare**, pasi nuk janë vetëm ata që provokojnë por do të ndihen dhe të provokuar. Ajo që të bën më shumë përshtypje është se në artikull thuhet: “nëse dëshiron të jesh ajo që do të pushtojë zemrën e tij, atëherë kij parasysh se çfarë duan meshkujt”, duke ndikuar kështu në mendime dhe në veprimet e radhës së një vajze. Ndërkohë në revistën “ANABEL”, më 2 nëntor 2015, artikulli “përse meshkujve ju pëlqejnë vajzat cool” shkon edhe më tej duke kaluar në një “sit” të djemve vajzat që preferohen më shumë. Fjalët “**hot**”; “**maniake seksi**”; “**xheloze**” duket se plotësojnë këtë artikull. Me këto fjalë shpjegohet shkurtimisht se pse meshkujt pëlqejnë ato vajza të cilat janë “hot” (ku jo detyrimisht të jesh hot, do të thotë që numri i gjoksit të jetë 3+; por të jesh hot, do të thotë se vajzat janë të afta të kenë **intelekt**); xhelozia gjithashtu

shpjegohet si një xhelozi nga një **e rritur**, që do të thotë jo të bësh **alarmante** çdo gjë e të bërtasësh kudo; apo maniake seksi (ku të gjithë partnerët dëshirojnë të kenë partnere që u pëlqejnë **eksperimentet**, megjithëse ka partnerë që nuk e duan këtë gjë.... në përfundim vajzat duhet të fitojnë besimin, të jenë të kuptueshme dhe sigurisht dhe maniake seksi. Në 14 maj 2016, një tjetër artikull “guxon” duke caktuar drejtpërdrejtë “**zgjuarsinë e një vajze**” vetëm nga disa “**flirttime**”. Në artikull vajzat e zgjuara “**nuk ia falin kujtdo besimin dhe dashurinë**” ku një pjesë e madhe e zgjuarsisë është **përvojë** dhe **intuit**, këto e drejtojnë zgjuarsinë tek ato partnere që përmbushin çdo aspekt jo thjesht me **flirte**; apo ato vajza që “**nuk kanë frikë nga vetmia**” ndihen njësoj kurdoherë, krijojnë **droje** nga ato që posedojnë, apo ku **flirti** nuk është prioritet i tyre. Në përfundim, shpesh krijohen klishe, në rastin tonë është klisheja: “**Vajzat e zgjuara janë të vështira në dashuri**”, e gjitha kjo sepse kërkojnë shumë dhe e dinë se çfarë duan konkretisht, por ato që u përmenden më sipër janë sjellje tipike të vajzave të zgjuara. Si përfundim po huazoj një shprehje të një artikulli ku personalitete të ndryshme, gra të botës, ia dedikojnë grave të tjera dhe jo vetëm seksit të njëjtë:

“...Në një ditë pa energji, e mbytur nga pesimizmi i njerëzve që të rrethojnë, që duan të të bindin që, vetëm sepse je vajzë, do e kesh gati të pamundur të arrish aty ku do doje, duhet që gratë të shembin klishe të rreme që janë ngritur për to, ato i shpallin të drejtat e tyre..!” (Revista CLASS, 30 shprehje frymëzuese nga gra që guxojnë, 25 janar 2016) <http://www.revistaaclass.al/d/84/194/5447/30-shprehje-frymëzuese-nga-gra-qe-guxojne/> (parë më 22. qershor 2016)

Përfundime

Në përmbledhje të gjithë analizës së mësipërme për sa i përket artikujve të dedikuara për vajzat dhe gratë të cilat luftojnë dita ditës për të drejtat e tyre në mbarë botën, duket sikur ajo që duhet luftuar më shumë është ajo që shkruhet për to, të jetë e shkruar qartë, brenda rregullave të etikës. Të gjitha këto media, duke qenë se shumica prej tyre drejtohet nga vajza të suksesshme ndoshta duhen fokusuar më tepër në të drejtat, qëllimet apo synimet që çdo vajzë apo grua duhet të ketë në këtë botë sa të bukur aq edhe të shëmtuar. Në përfundim rubrikat duhet të kenë larmishmëri dhe ngjyra, siç u vu re të gjitha revistat synonin të kishin ndjekësa të njëjtë, lexuese të të gjitha grup-moshave, dhe të gjitha në përgjithësi kishin të njëjtat rubrika (në përjashtim të ndonjë kategorie të veçantë). Pra, revistat e modës në vendin tonë mundohen të promovojnë një imazh të gruas së lirë moderne dhe liberale e cila në dukje është një subjekt social i gjithanshëm por në të vërtetë ato ofrojnë vetëm një model sipërfaqësor të gruas si objekt social. Bukuria e saj mbetet vetëm sipërfaqësore, tek make-up dhe tek format trupore të cilat duket të jenë

trend në këtë epokë dhe asnjë më shumë. Gjuha që përdorin është e mbushur me klishe mbi idenë e të bukurës dhe ato ofrojnë shumë pak hapësirë për promovim të personalitetit të gruas apo suksesit të saj.

Imazhe të tilla jo vetëm që çojnë në një portretizim të gabuar të gruas por nga ana tjetër fuqizojmë edhe ngarkesat ideologjike kulturore të cilat për shumë kohë kanë mbajtur gjallë status-kuonë e gruas.

Të gjitha këto kategori apo rubrika kishin për qëllim që përveçse të reklamnin ndonjë objekt estetik, synonin gjithashtu të këshillonin “të bukurën” për t’u bërë akoma dhe më e bukur, gjithashtu të nxisnin disa veprime tek to. Duke kërkuar gjithmonë e më tepër të bukurën dhe jo të zgjuarën, vajzat tashmë duan që të ushtrohen fort për trupin e tyre, t’i nënshtrohen operacioneve plastike (të cilat së fundmi janë shtuar me shumicë), të gjitha këto për të qenë të pranueshme në shoqëri, për t’u pëlqyer nga seksi tjetër, duke sjellë me vete një trishtim të madh. Për këtë fakt, do të përmendim një thënie të fuqishme të Charles Bukowsk-it:

“....Jam lodhur duke parë fytyra femrash të rrethuara nga botox. Gjijnj të tejmbushur, të copëtuara nga konkurrenca, prapanica të ekspozuara, taka dhe truke kozmetike, gjeste të vështira për gratë e lirshme, tashmë të padallueshme edhe nga ato të zanatit. . . Dëshiroj të shikoj femra me feminitetin e tyre, me fjalë të ëmbla dhe të sigurt në të njëjtën kohë. Me mendime origjinale dhe të reja. Dëshiroj të shikoj femra të pavarura, jo skllave të burrave që sakrifikojnë dinjitetin e tyre. Femra me zemra prej akulli të shkrirë, shoqe dhe mike të meshkujve, të lira dhe të singerta. . . .”

Shtojcat

1. Revista Class, “Të brendshmet më të mira për formën tënde të vitheve” 21 prill 2016, <http://www.revistaclass.al/d/5/190/7119/të-brendshmet-më-të-mira-për-formën-tënde-të-vitheve/> (parë më 2 qershor 2016)
2. Revista Class, “7 mënyra për të mos e urryer trupin tënd, 18 prill 2016 <http://www.revistaclass.al/d/5/190/7041/7-mënyra-për-të-mos-e-urrier-më-trupin-tënd/> (parë më 2 qershor 2016)
3. Revista Class, “10 mite dhe fakte rreth celulitit” 19 mars 2016, <http://www.revistaclass.al/d/5/190/1939/10-mite-dhe-fakte-rreth-celulitit/> (parë më 2 qershor 2016)
4. Revista Class, “Cila është përgjigja e zgjuar kur ai të pyet pse më dashuron”, 26 qershor 2016 <http://www.revistaclass.al/d/129/73/8576/cila-eshte-pergjigja-e-zgjuar-kur-ai-te-pyet-pse-me-dashuron/> (parë më 2 qershor 2016)
5. Revista Class, “9 shenjat që ai do të martohet me ty brenda një viti”, 17 mars 2016 <http://www.revistaclass.al/d/129/73/6285/9-shenjat-që-ai-do-të-martohet-me-ty-brenda-një-viti/> (parë më 2 qershor 2016)

6. Revista Class, “Sa kohë duhet realisht të marrim veten pas ndarjes dhe arsyeja pse kjo kohë nuk është e lehtë”, 13 prill 2016, <http://www.revistaclass.al/d/129/73/6928/sa-kohë-duhet-realisht-të-marrim-veten-pas-ndarjes-dhe-arsyeja-pse-kjo-kohë-nuk-është-e-lehtë/> (parë më 2 qershor 2016)
7. Revista Class, “Pse vajzat e zgjuara duhet të përpiqen më shumë për të gjetur dashurinë”, 9 prill 2016, <http://www.revistaclass.al/d/129/73/6823/pse-vajzat-e-zgjuara-duhet-të-përpiqen-më-shumë-për-të-gjetur-dashurinë/> (parë më 2 qershor 2016)
8. Revista Class, “10 videot më sensuale që duhet ti shohësh me partnerin”, 11 shkurt 2016, <http://www.revistaclass.al/d/129/73/5670/10-videot-me-sensuale-që-duhet-ti-shohësh-me-partnerin/> (parë më 2 qershor 2016)
9. Revista Class, “15 veprime që e bëjnë çdo marrëdhënie të zgjasë”, 28 janar 2016”, <http://www.revistaclass.al/d/129/73/5491/15-veprime-që-e-bëjnë-çdo-marrëdhënie-të-zgjasë/> (parë më 2 qershor 2016)
10. Revista Class, “Interneti i bën keq dashurisë, si të rifitosh dëshirën për të kryer marrëdhënie”, 13 nëntor 2015, <http://www.revistaclass.al/d/129/73/4466/interneti-i-bën-keq-dashurisë-si-të-rifitosh-dëshirën-për-të-bërë-më-shumë-seks/6>> (parë më 2 qershor 2016)
11. Revista Class, “ja sekretet për një lëkurë të shëndetshme gjatë verës” 28 maj 2016, <http://www.revistaclass.al/d/5/69/7943/ja-sekretet-per-nje-lekure-te-shëndetshme-gjatë-verës/> (parë më 2 qershor 2016)
12. Revista Class, “3 hapa për të pasur fytyrë të shkëlqyer gjithë mëngjesin”, 28 prill 2016, <http://www.revistaclass.al/d/5/69/7306/3-hapa-mëngjesi-për-të-pasur-fytyrë-të-shkëlqyer-gjithë-ditën/> (parë më 2 qershor 2016)
13. Revista Class, “Kjo është gjëja e vetme që ti nuk e ke ditur që ngjall xhelozin te femrat e tjera”, 27 qershor 2016, <http://www.revistaclass.al/d/5/69/8592/kjo-është-gjëja-e-vetme-që-ti-nuk-e-ke-ditur-që-ngjall-xhelozin-te-femrat-e-tjera/> (parë më 2 qershor 2016)
14. Revista Class, “Cat-eye është shumë provokues për ty, provo grimin sy-qenushi”, 15 prill 2016. <http://www.revistaclass.al/d/5/69/6975/cat-eye-është-shumë-provokues-për-ty-provo-grimin-sy-qenushi/> (parë më 2 qershor 2016)
15. Revista LadyAlbania, “3 metoda efikase për ti thënë lamtumirë celulitit pa ndërhyrje kirurgjikale” 21 qershor 2016, <http://ladyalbania.al/bukuria-dhe-estetika/3-metoda-shumë-efikase-për-ti-thënë-lamtumirë-celulitit-pa-nevojë-për-ndërhyrje-kirurgjikale>.la (parë më 2 qershor 2016)
16. Revista LadyAlbania, “Seksualiteti i femrave sipas moshës çfarë duan femrat”, 4 mars 2016 <http://ladyalbania.al/marrëdhënie/Seksualiteti-i-femrave-sipas-moshës-çfarë-duan-femrat>.la (parë më 2 qershor 2016)
17. Revista LadyAlbania, “Muskujt e dashurisë dhe ndjeshmëria seksuale e femrës”, 15 janar 2016, <http://ladyalbania.al/marrëdhënie/Muskujt-e-dashurisë-dhe-ndjeshmëria-seksuale-e-femrës>.la (parë më 2 qershor 2016)

18. Revista LadyAlbania, "Seksi i mirë i bën femrat më të shëndetshme", 4 nëntor 2016, <http://ladyalbania.al/marredhenie/Seksi-i-mirë-i-bën-femrat-më-të-shëndetshme>.la (parë më 2 qershor 2016)
19. Revista LadyAlbania, "5 gjëra që një beqare urren ti dëgjojë", 29 prill 2016, <http://ladyalbania.al/marrëdhënie/5-gjëra-që-një-beqare-urren-ti-dëgjoje>.la (parë më 2 qershor 2016)
20. Revista LadyAlbania, "10 gjëra që femrat mund t'i bëjnë më mirë sesa meshkujt", 29 prill 2016, <http://ladyalbania.al/marrëdhënie/10-gjëra-që-femrat-mund-ti-bëjnë-më-mirë-sesa-meshkujt>.la (parë më 2 qershor 2016)
21. Revista LadyAlbania, "6 rastet kur është Ok të jesh egoist", 4 nëntor, <http://ladyalbania.al/marredhenie/6-rastet-kur-është-OK-të-jesh-egoiste>.la (parë më 2 qershor 2016)
22. Revista Anabel, "Tre gjëra cdo femër duhet ti bëjë pas seksit", 15 qershor, <http://www.anabel.al/artikull/15923/tre-gjera-që-çdo-femër-duhet-ti-bëje-pas-seksit>/ (parë më 2 qershor 2016)
23. Revista Anabel, "A i pëlqeni kuptoheni nga koha që vonon tju ktheje sms", 10 prill 2016, <http://www.anabel.al/artikull/14227/a-i-pëlqeni-kuptoheni-nga-koha-që-vonon-tju-ktheje-sms>/ (parë më 2 qershor 2016)
24. Revista Anabel, "Flirti me sms çfarë s'duhet të shkruani", 7 mars 2016, <http://www.anabel.al/artikull/13385/flirti-me-sms-fare-s'duhet-të-shkruani>/ (parë më 2 qershor 2016)
25. Revista Anabel, "Ja pse jeni ende beqare", 17 shkurt 2016, <http://www.anabel.al/artikull/12883/ja-pse-jeni-ende-beqare>/ (parë më 2 qershor 2016)
26. Revista Anabel, "Sa më shumë kohë beqare aq më e vështirë një lidhje", 9 shkurt 2016, <http://www.anabel.al/artikull/12691/sa-më-shumë-kohe-beqare-aq-më-e-vështirë-një-lidhje>/ (parë më 2 qershor 2016)
27. Revista Anabel, "Një femër më e zgjuar se ai: sa tërheqëse është", 28 janar 2016, <http://www.anabel.al/artikull/12361/një-femër-më-e-zgjuar-se-ai-sa-tërheqëse-është>/ (parë më 2 qershor 2016)
28. Revista Anabel, "7 gjërat që çmendin një mashkull", 23 nëntor 2016, <http://www.anabel.al/artikull/10976/7-gjërat-që-çmendin-një-mashkull>/ (parë më 2 qershor 2016)
29. Revista Anabel, "5 detaje që tregojnë gjithcka për personalitetin tuaj", 20 nëntor 2016, <http://www.anabel.al/artikull/10914/5-detaje-që-tregojnë-gjithcka-për-personalitetin-tuaj>/ (parë më 2 qershor 2016)
30. Revista Anabel, "Si e arrijnë orgazmën femrat shqiptare.", 30 janar 2016, <http://www.anabel.al/artikull/12419/si-e-arrijnë-orgazmën-femrat-shqiptare>/ (parë më 2 qershor 2016)
31. Revista WHO, "Këtyre gjashtë tipareve femërore meshkujt nuk i rezistojnë dot", 26 janar 2016, <http://www.revistawho.com/breakingnews/këtyre->

- [gjashtë-tipareve-femërore-meshkujt-nuk-i-rezistojnë-dot/](http://www.revistawho.com/breakingnews/ky-virtyt-femëror-i-tremb-meshkujt) (parë më 30 prill 2016)
32. Revista Who, "Ky virtyt femëror i tremb meshkujt" 18 janar 2016, [http://www.revistawho.com/breakingnews/ky-virtyt-femëror-i-tremb-meshkujt/](http://www.revistawho.com/breakingnews/ky-virtyt-femëror-i-tremb-meshkujt) (parë më 30 prill 2016)
33. Revista Who, "Meshkujt preferojnë femrat e kolme", 20 tetor 2015 [http://www.revistawho.com/jetë/studimi-meshkujt-preferojnë-femrat-e-kolme/](http://www.revistawho.com/jetë/studimi-meshkujt-preferojnë-femrat-e-kolme) (parë më 30 prill 2016)
34. Revista Lady Albania, "Karakteristikat e femrave pas së cilave meshkujt çmenden", 25 prill 2016, [http://ladyalbania.al/marrëdhënie/karakteristikat-e-femrave-pas-së-cilave-meshkujt-çmenden/](http://ladyalbania.al/marrëdhënie/karakteristikat-e-femrave-pas-së-cilave-meshkujt-çmenden) (parë më 30 prill 2016)
35. Revista Anabel, "5 arsyt pse femrat e mbushura janë të papara në shtrat", 22 mars 2016, [http://www.anabel.al/artikull/13738/5-arsyet-pse-femrat-e-mbushura-janë-të-papara-në-shtrat/](http://www.anabel.al/artikull/13738/5-arsyet-pse-femrat-e-mbushura-janë-të-papara-në-shtrat) (parë më 2 qershor 2016)
36. Revista Anabel, "Shenjat e pamohueshme se jeni e mrekullueshme në shtrat", 22 shkurt 2016, <http://www.anabel.al/artikull/13027/shenjat-e-pamohueshme-se-jeni-e-mrekullueshme-në-shtrat> (parë më 2 qershor 2016)
37. Revista Anabel, "Nëse flirtoni kështu jeni padyshim një vajzë e zgjuar", 14 maj 2016, [http://www.anabel.al/artikull/15134/nëse-flirtoni-kështu-jeni-padyshim-një-vajzë-e-zgjuar/](http://www.anabel.al/artikull/15134/nëse-flirtoni-kështu-jeni-padyshim-një-vajzë-e-zgjuar) (parë më 2 qershor 2016)
38. Revista Anabel, "Përse meshkujve iu pëlqejnë kaq shumë vajzat Cool", 2 nëntor 2015, [http://www.anabel.al/artikull/10532/përse-meshkujve-iu-pëlqejnë-kaq-shumë-vajzat-cool/](http://www.anabel.al/artikull/10532/përse-meshkujve-iu-pëlqejnë-kaq-shumë-vajzat-cool) (parë më 2 qershor 2016)
39. Revista ICON, "Çfarë thotë ngjyra e buzëkuqit për ju", 22 maj 2016.

Bibliografia

1. Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, (1980), Fjalor i shqipes së sotme, Tiranë.
2. Balle, F. (2011) Mediat dhe Shoqëritë. UET Press.
3. Butler, J. (1990) Gender Trouble. New York: Routledge.
4. N.A. (2007) Fjalë të arta për gratë. Tiranë: "Harizaj", Forum.al, Charles Bukowski, 22 shkurt 2010 <http://www.forum-al.com/showthread.php?p=244060> (parë më 23 qershor 2016)
5. Grej Medlin, 1967, "Gruaja normale", no information. <http://www.telegrafi.com/kultura-masive-dhe-media/> (parë 20/qershor/2016)
6. Jong, E. (1973) Frika e Fluturimit. Tiranë: Bota Shqiptare,
7. Lemke, Jay.L. (2005) Textual Politics. Discourse and Social Dynamics. Taylor and Fransis.
8. Maigret, E. (2010) Sociologjia e Komunikimit dhe e Mediave. Tiranë: Papirus.
9. Sparhawk, J.M. (2003) Body Image And The Media: The Media's Influence On Body Image. Thesis: University of Wisconsin- Stout
10. Tiainen, Minna (2009) BEHIND THE COSMO-GIRL: Women's representation and the brand of Cosmopolitan magazine. Thesis: University of Jyväskylä, Finland
11. Telegrafi (2013) "Kultura masive dhe media".

Efikasiteti i teknikave te hipnoterapisë dhe te relaksimit në reduktimin e ankthit të përgjithësuar: studim sasior

Klodiana Rafti

PHD CANDIDATE., UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS, ALBANIA
KLODIANA.RAFTI@UET.EDU.AL

Fleura Shkëmbi

DR., EUROPEAN UNIVERSITY OF TIRANA, ALBANIA

Abstrakt

Hipnoza dhe përdorimi i saj është i shoqëruar me shumë sfida në historinë e psikologjisë dhe mjekësisë. Sot, hipnoterapia përfshihet në trajtimet standarde psikologjike, mjekësore ose dentare. Çrregullimet e ankthit janë të pranishme pothuajse në të gjitha kulturat dhe ato e reduktojnë cilësinë e jetës, ku me prevalencë mjaft të shprehur është ankthi i përgjithësuar. Ankthi ndërmjet studentëve të universitetit është krejt i zakonshëm. Qëllimi i studimit ishte njohja me efektet e përdorimit të teknikave të hipnoterapisë klinike, në reduktimin e ankthit të përgjithësuar dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës. Për nga dizenjimi, përdorëm një studim gjysmë eksperimental, në të cilin u aplikuan tre teknika terapeutike: Forcimi i Egos, Metafora dhe Relaksimi Progresiv, me qëllim reduktimin e ankthit të përgjithësuar në rastet e studentëve të grup moshës 20-30 vjeç. Kampioni përbëhej nga 214 studentë të përzgjedhur rastësisht. Si instrument vlerësues u përdor Pyetësi i ankthit të përgjithësuar GAD-7 (alfa= .843). Rezultuan me nivel të lehtë të GAD (N=81; 38 %), me nivel të moderuar të GAD (N=34; 16 %). Në fazën e dytë të studimit u përzgjedhën 20 femra dhe 20 meshkuj nga kampioni i mësipërm. Këta u ndanë në katër grupe (3 grupe morën trajtim: Metafora, Forcimi i Egos dhe Relaksimi Progresiv) dhe grupi i katërt u përdor për kontroll. Nga rezultatet sasiore, del se teknikat e hipnoterapisë janë më efikase sesa teknika e relaksimit dhe po ashtu, se teknika e sugjerimeve direkte/autoritare e Forcimit të Egos është më efikase, se teknika e

sugjerimeve indirekte/tolerante e Metaforës në reduktimin e ankthit të përgjithësuar dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës. Duhet të merren në konsideratë aplikime të teknikave të hipnoterapisë dhe të relaksimit progresiv në rastet me ankth në popullatën jo klinike.

Fjalë kyç: *Hipnoterapi, teknika, ankth i përgjithësuar, cilësia e jetesës*

Hyrje

Hipnoza është një gjendje ose rrethanë, në të cilën personi mund të hyjë nga sugjestionet e përshtatshme dhe të arrijë ndryshim të perceptimeve, memories ose humorit. Hipnoterapia është përdorimi i hipnozës në trajtimin e një çrregullimi ose shqetësimi psikologjik. Hipnoza edhe në ditët e sotme ka vështirësitë e saj për ta përcaktuar dhe po ashtu, ka shumë elemente të cilat ende sot e kësaj dite mbeten të debatueshme në aspektin e evidencave të natyrës shkencore. Hipnoza dhe disa teknika të hipnoterapisë (forcimi i egos dhe metaforat) janë huazuar nga psikoanaliza dhe janë parë si të dobishme në trajtimin e çrregullimeve të ankthit. Hipnoterapia ka potencial të konsiderueshëm për t'u përdorur në shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe është pranuar si një mjet ndihmës për shumë gjendje ose rrethana shëndetësore (Rankin-Box & Williamson, 2006). Sot, hipnoterapia përfshihet në trajtimet standarde psikologjike, mjekësore ose dentare (Jonas & Levin, 1999; Pintar & Lynn, 2008). Nga teknikat e hipnoterapisë janë zgjedhur ato të forcimit të egos dhe metaforat. Metaforat janë tregimi i një historie gjatë hipnozës klinike. Metaforat, konsiderohen si një nga mënyrat më të fuqishme dhe të qeta për të komunikuar një informacion të rëndësishëm tek pacientët, për të arritur qëllime të caktuara në jetë (Yapko, 2003). Metaforat mund t'i përdorim për arsye relaksi (induktiv të transit) ose si proces të terapisë. Metoda e forcimit të egos arrihet përmes sugjerimeve të drejtpërdrejta. Pra, në rastin e metaforave sugjerimet janë indirekte, ndërsa tek forcimi i egos, direkte. Përveç teknikave të hipnozës, teknikat bihejviorale si relaksimi progresiv i muskujve kanë treguar efikasitet të lartë në trajtimin e ankthit. Procedurat e relaksimit progresiv të muskujve, janë aplikuar në një variacion problemesh klinike, si një teknikë e vetme ose në bashkëpunim me metoda të tjera. Përdorimi më i zakonshëm, ka qenë lidhur me stresin dhe ankthin, të cilët manifestohen shpesh me simptoma psikosomatike.

Çrregullimet e ankthit janë të pranishme pothuajse në të gjitha kulturat (Demyttenaere, 2004) dhe të dhënat tregojnë, që do të përjetohet nga afër 18% e të rriturve çdo vit dhe nga afër 32% e njerëzve gjatë gjithë jetës së tyre (Kessler, 2005). Ankthi e redukton cilësinë e jetës (Cramer, 2005; Rappaport et al, 2005; Saarni, 2007) dhe kontribuon në paafësi (Bloom, 2011), duke shkaktuar dëmtim të rëndë profesional dhe humbje të produktivitetit (Greenberg et al.,

1999; Ormel, 1994). Episodet e GAD ndikojnë gjithashtu mbi cilësinë e jetës, duke e dëmtuar funksionimin (arritjet akademike ose mungesat me javë në punë) si dhe ndërveprimet sociale dhe cilësinë e jetës në përgjithësi (Mendlowicz & Stein, 2000). Tek studentët e universitetit, ankthi është krejt i zakonshëm dhe studimet tregojnë se rreth 75% e të gjithë individëve me çrregullime të ankthit do ta përjetojnë atë gjatë periudhës së studimeve (Bolden, 2008; Margarita, 2008).

Qëllimi i këtij studimi ishte njohja me efektet e përdorimit të teknikave të hipnoterapisë klinike, në reduktimin e ankthit të përgjithësuar dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës. Studimi kishte natyrë gjysmë-eksperimentale, në të cilin u aplikuan tre teknika terapeutike: Metafora, Forcimi i Egos dhe Relaksimi Progresiv me qëllim reduktimin e ankthit të përgjithësuar në rastet e studentëve të grupmoshës 20-30 vjeç.

Bazat teorike të psikoanalizës, bihejviorizmit dhe të hipnozës

Shkolla Psikoanalitike

Qasja sipas Frojdit:

Psikoanaliza është një familje me teoritë psikologjike dhe metodat e bazuara në punën e filluar nga Sigmund Frojd. Psikoanaliza ishte shkolla e fundit, e cila ndikoi fuqishëm në zhvillimin e psikologjisë, në atë kohë kur terapia e sjelljes ishte në zhvillim e sipër. Mjeku i ri austriak zbuloi nga seancat e hipnozës që aplikonte te pacientët, se ata ishin të aftë të kujtonin ndjenja dhe emocione të fshehta për të tjerët. Ajo që solli të re Frojdi ishte determinizmi psikik që do të thotë se sjellja, mendimet, ndjenjat dhe simptomat janë shteg i përbashkët final i proceseve të pavetëdijshme (Meissner, 2009). Frojd, ishte ai, i cili konceptoi për herë të parë termin e së pavetëdijshmes, seksualitetin të fëmijët (deri atëherë ishte menduar se fëmijët nuk kishin seksualitet) represionin e ndjenjave dhe të emocioneve. Ai propozoi tre instancat e strukturës psikike. Mbi të gjitha këto ishin koncepte të reja për të kuptuar dhe trajtuar qenien njerëzore në një këndvështrim të ri.

Për sa i përket konceptit të së pavetëdijshmes, ky zbulim çon në përfundimin, se mendja njerëzore ka një formë të censorit, që mendon se memoriet e caktuara, mendimet dhe ndjenjat janë të pakonceptueshme dhe se ky material është i represuar (Meissner, 2009).

Rreth vitit 1892, Frojdi braktisi hipnozën për të vazhduar me asosacionet e lira. Këtë herë, ndryshe nga praktikat e hipnozës, pacienti shtrihet në një kolltuk, flet për ato që i vijnë në mend dhe nuk i duhet të përdorë hipnozën për të rikujtuar ngjarjet, ndërsa psikoanalisti qëndron ulur prapa tij, pa u vënë re, përgjithësisht duke e dëgjuar dhe duke shtuar ndonjë fjalë (Fromm, 1980). Pacienti shpreh

gjithçka që mendon dhe fantazon lirshëm, duke qenë ai i pari, që merr iniciativën për të folur dhe e bën terapistin të jetë pasiv, ndryshe nga hipnoza që varet nga miratimi i pacientit, autoriteti dhe aftësia e terapistit.

Në psikoanalizë, pacienti nuk kërkon të marrë këshilla, por qëllimi është që të hyjë thellë nëpërmjet saj dhe të kuptojë veten (Sorr, 1989). Ideja se emocionet tona të fshehura, në mënyrë të pavetëdijshme dalin në sipërfaqe nëpërmjet ëndrrës, është një nga gjetjet më të vlefshme të psikoanalizës.

Modeli topografik i mendjes: Puna e thellë dhe këmbëngulëse e Frojdit përkufizoi mendjen në tre instanca topografike:

Vetëdija - e cila shihet si një fenomen subjektiv, përmbajtja e së cilës mund të komunikohet vetëm me anë të gjuhës dhe sjelljes. Frojdi supozon, se vetëdija përdor një formë të energjisë psikike të neutralizuar, që ai i referohet si një kateksë e vëmendjes (Meissner, 2009). Me fjalë të tjera, dikush është i vetëdijshëm për një ide ose ndjenjë të veçantë, si rezultat i investimit të një sasive diskrete të energjisë psikike, në atë ide ose ndjenjë (Meissner, 2009).

Paravetëdija - Këtu futen përmbajtjet që mund të sillen në vetëdije përmes fokusimit të vëmendjes. Konceptualisht, e paravetëdijshmeja ndërvepron me të dyjat, regjionin e vetëdijshëm dhe të pavetëdijshëm. Që të arrijë vetëdijen e vëmendshme, përmbajtja e së pavetëdijshmes duhet të lidhet me fjalët dhe kjo bëhet e paravetëdijshme (Meissner, 2009).

Pavetëdija - Sipas mësimave të psikoanalizës, kjo është një dinamikë dhe përmbajtjet mendore, po ashtu dhe proceset e vetëdijes, janë të mbajtura jashtë vetëdijes, përmes forcave të censorit ose të represionit, të cilat manifestohen si rezistenca për të kujtuar (Meissner, 2009).

Struktura e aparatit psikik: Sipas psikoanalizës aparati psikik ka një strukturë të përbërë prej tri instancash: Idi, Ego dhe Super Ego.

Idi - Konceptohet si pjesa e errët e personalitetit tonë dhe, ai nuk duhet vështuar si sinonim me pavetëdijen, sepse edhe ego dhe superego, kanë komponentë të pavetëdijshëm. (Meissner, 2009).

Ego - Është instancë tjetër, e cila e ka origjinën nga Idi dhe që ka për funksion: kontrollin dhe rregullimin e instikteve; gjykimin apo aftësinë për t'i paraprirë pasojave të një veprimi; relacionin me realitetin si kuptimi, testimi dhe adaptimi i realitetit; funksionet mbrojtëse të ego-s p.sh: represioni i cili shikohet si mbret i mbrojtjeve.

Superego - Superego vendos dhe përmban vetëdijen morale të personit, në bazë të sistemit kompleks të idealeve dhe vlerave të internalizuara prej një prindi (Meissner, 2009). Kjo kryen një shqyrtim të vazhdueshëm të sjelljeve, mendimeve dhe ndjenjave të një personi; kryen krahasimet me standardet e pritura dhe ofron miratim ose jo miratim (Meissner, 2009). Këto aktivitete në pjesën më të madhe janë të pavetëdijshme.

Bazuar në këto, konceptimi i personalitetit sipas Frojdit është si një ajlsberg, ku e pavetëdijshmja zë pjesën më të madhe e drejtuar nga forca primitive dhe të vjetra, të cilat përbëjnë Idi-n. Frojdi bëri ndarjen e dy rendeve të funksioneve mendore, duke i quajtur proces parësor dhe dytësor, ku Idi përdor proceset parësore, duke shpërfillur kohën dhe hapësirën, duke i trajtuar të kundërtat si errësirë/dritë ose lart/poshtë si të ishin të njëjta (Sorr, 1989). Idi punon që të kënaqë principet e kënaqësisë, të cilat mund të kuptohen si kërkesa për të treguar rëndësi dhe plotësim të nevojave imediate/të menjëhershme: e dua tani.

Ego-ja, është ajo pjesë e mendjes e cila përfaqëson vetëdijen dhe përdor proceset dytësore. Funksioni i parë i saj është vetëruajtja. Ego-ja, si pjesë e personalitetit, është e vetëdijshme për realitetin dhe është në kontakt me botën jashtë; duke konsideruar rrethanat, ajo vendos balancën e kërkesave të bëra nga Idi dhe Superego-ja. Meqenëse ajo është në kontakt me realitetin, në të kundërt me Idi-n, i plotëson nevojat atëherë kur gjendet objekti i përshtatshëm: duhet të bëjë plan për të marrë diçka.

Ndërsa koncepti i tretë, Superego-ja, mund të shihet si figura prindërore e formuar nga urdhrat dhe kritikant. Superego-ja përmban të vetëdijshmen tonë sociale dhe përmes ndjenjave të fajit dhe ankthit, kur bëjmë diçka gabim, ajo na drejton drejt sjelljeve të pranueshme nga shoqëria. Superego-ja nuk përfundon deri në moshën shtatëvjeçare dhe ka dy aspekte: koshiencën, e cila brendëson ndëshkimet, ego-n ideale, që formohet nga shpërblimet dhe modelet pozitive të prindërve të fëmijës. Koshiencia dhe ego-ja ideale ia komunikojnë kërkesat e tyre ego-s nëpërmjet ndjenjave të krenarisë, turpësorisë dhe fajit: ti nuk mund ta kesh, sepse nuk është e drejtë (Sorr, 1989).

Mekanizmat mbrojtës: Mekanizmat mbrojtës janë një proces i pavetëdijshëm i psikikës, që i ofrojnë Ego-s çlirim prej konfliktit ndërmjet Idi-t intruziv, Superego-s kërcënues dhe ndikimit të fuqishëm që vjen nga realiteti i jashtëm. Funksioni kryesor i këtyre mekanizmave psikologjikë është të ndalojnë përjetimin e ndjenjave/emocioneve që shkaktojnë dhimbje. Funksioni i dytë është shtrembërimi i aftësive tona për të perceptuar realitetin ashtu siç është në të vërtetë. Mbrojtjet krijohen si refleksione të përpjekjeve të Egos, për të ndërmjetësuar mes shtypjeve të Idit, në një anë dhe kërkesave të realitetit të jashtëm, në anën tjetër. Këto përbëjnë një element domethënës të karakterit të personit. Mbrojtjet mund të jenë adaptive, të shëndetshme dhe patologjike (Meissner, 2009).

Mekanizmat kryesorë mbrojtës janë: Represioni, Formimi i Reagimeve, Projektioni, Regresioni, Racionalizimi, Mohimi, Zhvendosja, Introjeksioni, Sublimimi, Shuarja, Izolimi etj.

Regresioni - Sipas psikoanalizës është një mekanizëm mbrojtës i matur, që karakterizohet me përpjekjet për kthimin në një fazë më të hershme libidinale, të të funksionuarit, me qëllim të shmangies së tensioneve dhe konflikteve të

evoluara në nivelin prezent të zhvillimit. Ky reflektim e ka tendencën bazike të fitimit të kënaqjes instinktuale në një periudhë më pak të zhvilluar. Regresioni është një fenomen normal, gjithashtu një shkallë e caktuar e tij është thelbësore për relaksim, gjumë dhe orgazmë. Po ashtu, konsiderohet edhe si një shoqërim thelbësor i procesit kreativ (Meissner, 2009).

Represioni - Sipas psikoanalizës, është një mekanizëm mbrojtës neurotik, që karakterizohet me dëbimin ose mbajtjen jashtë vetëdijes të një ndjenje ose ideje. Represioni primar i referohet frenimit të ideve ose ndjenjave para se ato të kenë arritur vetëdijen; sekondari përjashton ato që kanë arritur vetëdijen. Represioni nuk është harruar realisht, sjellja simbolike mund të jetë e pranishme. Ky dallon prej supresionit prej ndikimit të inhibimit të vetëdijshëm të impulsit deri në pikën e humbjes dhe jo vetëm deri në shtyrjen e qëllimit të mbajtur gjallë. Perceptimi i vetëdijshëm i ndjenjave dhe impulseve është bllokuar në represion (Meissner, 2009).

Stadi e zhvillimit psiko-seksual: Frojdi vuri re se, në periudha të caktuara të jetës, pjesë të ndryshme të lëkurës na japin kënaqësi të madhe, të cilat më vonë do t'i quanin zona erogjene. Atij iu shfaq imazhi i bebes së vogël që e gjen kënaqësinë nga thithja, veçanërisht nga thithja e gjoksit të nënës; por, në fakt, bebet kanë një instikt që t'i afrojnë të gjitha gjërat në kontakt me gojën. Pak më vonë gjatë jetës, ai e kalon kënaqësinë në pjesën anale. Kur arrin rreth 3-4 vjeç, ai mund të ketë zbuluar kënaqësinë nga prekja, duke fërkuar gjenitalet e veta dhe vetëm në periudhën e maturisë seksuale mund ta gjejë kënaqësinë nga interkursi seksual.

Stadi oral - fillon nga momenti i lindjes deri 18 muajsh dhe fokusi i kënaqësisë është te goja. Thithja dhe kafshimi janë aktivitetet kryesore.

Stadi anal - fillon nga 18 muajsh deri 3 vjeç. Fokusi i kënaqësisë është anusi, kur mbajtja dhe nxjerrja e fecës është kënaqësia e tij më e madhe.

Stadi falik - nga 3,4-5,6 vjeç, kur fokusi është te gjenitalet dhe masturbimi është i zakonshëm.

Stadi latent - fillon nga 5-6-deri në pubertet, rreth 12 vjeç. Gjatë këtij stadi, Frojdi besonte se impulsi seksual shtypet në shërbim të të mësuarit.

Stadi gjenital - fillon me pubertetin dhe paraqet rigjallërimin e drejtimit seksual në adoleshencë dhe fokusimi më i madh lidhet me interkursin seksual (Meissner, 2009).

Kompleksi i Edipit

Çdo stad ka disa detyra të vështira, të cilat asociohen se ku mund të shfaqen problemet e veta. Në stadin falik na shfaqet kriza e Edipit. Gjatë kësaj faze, djemtë e vegjël venë re ndryshimin ndërmjet vajzave dhe djemve, sepse ata kanë penis ndërsa vajzat jo, ndoshta sepse atyre iu është këputur dhe ndoshta kjo mund t'i ndodhë edhe atij. Këtu është edhe fillimi i ankthit të kastrimit. Vajzat e vogla, të cilat nuk kanë penis, do të dëshironin të kishin dhe gjithë fuqia lidhet me të, duke zhvilluar zilinë e penisit (Meissner, 2009).

Nga psikoanaliza kemi zbuluar se fantazia më e zakonshme e fëmijës është kompleksi i Edipit: ku fati i tij është vrasja e babait dhe martesë me nënën. Por termi kompleks i Edipit nuk përfshihet tek fëmija në formën e të rriturit, por në një formë të përshtatshme për të.

Nevoja për dashuri e fëmijës është e drejtuar, ose nga nëna, ose nga babai dhe mund të flasim për një kompleks, kur kjo nevojë për dashuri arrin atë shkallë, sa që objekti i zgjedhjes mbrohet me xheloz: burri i vogël do ta ketë nënën të gjithën për vete, duke hequr qafe babanë dhe shpesh këto dëshira janë evidente në jetën reale, sepse fëmijët janë krijesa të vogla, ende primitive, me mendime të rrezikshme (të vrasin konkurrentin), por të padëmshme në realitet, sepse kjo vlen edhe për qëllimet e tij ndaj nënës (Meissner, 2009).

Teoria e ankthit: Frojdi ka theksuar tri lloje të ankthit:

1. Ankthi realist - që ne mund ta quajmë frikë; është përvojë emocionale që formohet kur personi vë re rrezikun nga objekti; ose situata e jashtme, e cila e rrezikon ekzistencën dhe funksionimin e organizmit; ose kur në botën e jashtme s'ka afër stimulues mbrojtës dhe siguries (mungesa e nënës shkakton frikë).

2. Ankthi moral - kur kërcënimi nuk vjen nga jashtë (pra nga bota fizike), por prej brendësisë së botës së jashtme të superego-s. Në fakt, është një mënyrë tjetër përshkrimi e ndjenjave, si turpi dhe frika nga ndëshkimi; apo ndjenja e fajit është përvojë emocionale e mundimshme, që krijohet nën ndikimin e superegos e sidomos, të asaj pjese, që quhet vetëdije. Superegoja, është përfaqësuese e brendshme e autoritetit të prindërve dhe shoqërisë, e cila i kërcënohet egos, se do ta dënojë nëse bën diçka, që kundërshtohet nga ego-ideali. Këtë frikë nga ego-ideali, Frojdi e lidhi me gjendjet anksozo-depresive dhe depresionin në përgjithësi.

3. Ankthi neurotik - është frika e kërcënimit të impulsive të Idit, pra frika nga humbja e kontrollit, racionalitetit apo edhe e mendjes. Është përvojë emocionale e pakëndshme, që krijohet me aktualizimin e rreziqeve jo logjike, që vijnë nga e pavetëdijshmja dhe nga bota e instikteve të Idit, të cilat egoja me mekanizmat e vet mbrojtës s'mund t'i neutralizojë apo largojë.

Teoria psikoanalitike e sheh ankthin si një sinjal. Frojdi ka identifikuar dy tipe të situatave ankth-provokuese: stimulimin e tepruar instinktual, që prodhon një gjendje të mungesës së ndihmës dhe të traumës; si dhe kërcënimin e rrezikut, ky paralajmërim i njohur si *anxiety signal* operon si i pavetëdijshëm dhe shërben për t'i mobilizuar burimet e egos, për ta larguar rrezikun (Meissner, 2009). Megjithatë Frojdi është fajësuar shpesh për thjeshtësinë e mendimit në lidhje me hipnozën dhe për lënien në hije të saj gjatë dhjetëvjeçarëve të parë të shekullit të kaluar, shkrimet e tij shfaqin një teori të pasur mbi hipnozën dhe një pranim të sigurtë mbi borxhin që teoria psikoanalitike dhe praktikimi i saj i detyrohen hipnozës. Edhe pse ai, e braktisi përdorimin e hipnozës si një mjet klinik, Frojdi mbajti një interes teorik të këtij subjekti dhe në shumë çështje të nderuara në kërkimet

e atëhershme. Ndërkohë, që theksi i tij në aftësitë e hipnotistit ndoshta është tepruar, reflektimet në lidhje me vëmendjen, pritshmëritë sociale, dinamikën e grupit, testimin e realitetit dhe lidhjen midis hipnozës dhe gjumit kanë dalë nga investigimet empirike (Bachner-Melman & Lichtenberg, 2001).

Qasja sipas Jungut

Jung ka një qasje totalisht ndryshe për psikologjinë njerëzore, duke theksuar se të kuptosh psikikën njerëzore duhet të eksplorosh botën e ëndrrave, artin, mitologjinë, mistikën, botën fetare, spiritualitetin dhe filozofinë. Ai njihet për të rejtat që solli me të pavetëdijshmen kolektive, arketipet, konceptet introvert/ekstrovert. Jungu ka ndikuar në psikiatri, para së gjithash, me studimet e tij në aspektin fetar dhe mund të themi me bindje, që analiza jungiane ka më tepër funksion spiritual (Stevens, 2001). Mes të kuptuarit të strukturës psikike, ndërgjegjja e përcaktuar nga ai është pjesë e procesit evolucionar. Egoja është qendra e personalitetit të vetëdijshëm.

Në hirearkinë strukturore të mendjes, sipas Jung-ut fusha e së pandërgjegjshmes qëndron poshtë së ndërgjegjshmes, e pandërgjegjshmja është konsideruar si matricë, nga e cila e vetëdijshmja del në çdo brez dhe këtu është ndarja domethënëse e tij nga teoria e Frojdit, por në të njëjtën kohë edhe krijesa e tij e re për psikologjinë (Stevens, 2001).

Teoria e Jungut e ndan psikikën në tri pjesë: *E para* është Ego, të cilën ai e identifikon me mendjen e vetëdijshme. *E dyta* është e pavetëdijshmja personale, e cila përfshin çdo gjë që nuk është e vetëdijshme, por që mund të arrihet të bëhet. E pavetëdijshmja personale përfshin kujtimet, që dalin lehtë në të vetëdijshme si edhe ato, të cilat kanë qenë shtypur për arsye të ndryshme. *E treta* është e pavetëdijshmja kolektive, është rezervuari i eksperiencave tona si specie, një lloj njohurie me të cilën ne të gjithë lindim dhe nuk mund të bëhemi të vetëdijshëm për të. Eksperiencat e dashurisë me shikim të parë, déjà vu-ja dhe njohja e menjëhershme e disa simboleve dhe kuptimit të miteve, mund të jenë njohje e menjëhershme e lidhjes së realitetit jashtë me realitetin tonë të brendshëm të pavetëdijshme kolektive (Stevens, 2001).

Terapia Psikoanalitike

Teoria psikoanalitike solli zhvillimin edhe të psikoterapisë psikoanalitike e cila për një periudhë kohore ka qenë dominuese. Janë shumë të rëndësishme për punimin, të diskutohen disa fenomene, të cilat i konstruktoi psikoanaliza dhe psikoterapia psikoanalitike.

Transferenca - Është një proces psikik që ndodh gjatë terapisë, është një proces tërësisht i pandërgjegjshëm, i cili përkufizohet fillimisht si procesi gjatë të cilit, pacienti i vesh terapistit qëndrime dhe ide që vijnë nga figura të mëparshme që ka pasur gjatë fëmijërisë, apo më vonë gjatë jetës dhe që kanë qenë përfshirëse, sidomos ato prindërore. Gjatë asosacioneve të lira, pacientët do të flasin për

gjithçka që ka lidhje me frikërat, dëshirat, shqetësimet, simptomat e tyre neurotike, inatet, zemërimet, dashuritë, të cilat mund të kenë lidhje ose jo me terapistin e tyre (Meissner, 2009). Nëse terapisti dhe pacienti i përkasin gjinive të ndryshme, këtë proces mund ta përshkruajmë lehtë si i rënies në dashuri, të këtij pacienti me psikoanalistin e tij, i cili bëhet objekti i dashurisë, admirimit, varësisë dhe xhelozisë, duke u sjellë me psikanalistin ashtu si mund të sillet njeriu kur ka rënë në dashuri me dikë (Fromm, 1980). Megjithatë transferenca ndodh tek të gjithë mjekët dhe terapistët, ishte Frojdi i cili e formuloi këtë koncept të afeksionit të pacientit ndaj mjekut, duke e shpjeguar atë si dukuri të lidhjes dashurore (ose armiqësore) të figurës së terapistit, si afeksion të hershëm të fëmijërisë ndaj njërit prej prindërve, pra këto ndjenja transferohen tashmë diku tjetër.

Qasja Bihevioriste

Behaviourism është përkufizuar si studimi i sjelljes njerëzore nga analiza e stimulit dhe përgjigjes (Oxford English Dictionary, 1998). Reber & Reber (2001, f.84) konstatojnë se sjellja është një term i përgjithshëm, i përdorur për të përshkruar përgjigjet e matshme të organizmave si: veprimi, aktiviteti, reagimi, përgjigjja, lëvizjet, proceset dhe operon në përgjigje të një stimuli të caktuar. Biheviorizmi ishte bazamenti teorik i zhvillimit të terapisë së sjelljes. Terapia e sjelljes është një lloj terapie, e cila synon të ndryshojë sjelljet e keqpërshtatura dhe anormale, kurse fokusi është i drejtuar tek sjellja në vetvete, se sa tek analizat analitike dhe dinamike të konflikteve të mbuluara apo të burimeve të konfliktit (Dictionary of Psychology, 1995, f. 89).

Teoria e sjelljeve është e interesuar të studiojë sjelljet e vëzhgueshme, duke injoruar çfarë ndodh në mendje, duke e parë sjelljen të kushtëzuar nga ngjarjet që ndodhin në mjedis. Duke studiuar ngjarjet, mund të jetë efikase që të drejtojnë individin të sillet në mënyrë të parashikueshme. Në rastin e kushtëzimit klasik, sjelljet janë të rregulluara nga bashkëveprimi; për shembull qeni i Pavlov-it mësoi të sekretonte pështymë kur binte zilja e kambanës, sepse kambana ishte e lidhur me erën e ushqimit. Në rastin e kushtëzimit operant/veprues, sjelljet rregullohen nga një sistem përforsimi. Përforsimi pozitiv referohet për veprime, që rrisin mundësinë e një veprimi tjetër të caktuar, për shembull, t'i japësh një qeni një copë mish çdo herë që ai risjell një top të hedhur. Përforsimi negativ referohet në tërheqje të një veprimi të caktuar, në mënyrë që të shuajë këtë sjellje, për shembull, pa sjellje të topit nuk ka copa mishi. Këto dy koncepte së bashku, mund të përdoren për t'u dhënë formë sjelljeve. Që nga koha kur këto teori u parashtruan, teoria e sjelljeve është zhvilluar në shumë mënyra, të cilat e largojnë nga modelet origjinale reduktuese.

Sidoqoftë, parimi themelor qëndron në faktin se, sjelljet e vëzhgueshme janë më të vlefshme sesa sjelljet, të cilat mendohen se kanë shkaktuar këto sjellje.

Të gjitha funksionet e sistemit nervor edhe ato më komplekset konsistojnë në sekuencën: *Stimul – Reagim*.

Reagimi – është, ose aktivizimi i një seti të caktuar, ose sistemi neuronesh, ose pasojat e shkatuara nga këto si imazhet e perceptuara, ose kontraktimi muskular.

Stimuli - është ngjarja para reagimit, pra që shkakton këtë reagim. Qëndrueshmëria e marrëdhënies stimul - reagim është ajo që ne e quajmë zakon (habit). Zakonet janë të të gjitha niveleve, që nga lëvizjet e thjeshta, natyrale (të dëgjosh, të vështrosh, të zgjidhësh problem), deri tek ato më komplekse që kërkojnë një set aftësish (të luash basketboll, të bësh operacione kirurgjikale apo të luash në piano) (Wolpe, 1990).

Autorët kryesorë:

Pavlov (1890), njihet si personi i parë, i cili vuri re dhe ekzaminoi sjelljen. Ai njihet si psikolog rus dhe emërtohet si babai i kushtëzimit klasik. Nëpërmjet eksperimentit të vet me reagimin e sjelljes së qenëve ndaj ushqimit, (sekretimi i pështymës) u vu re se ky reagim ndodh edhe kur nuk u ofrohej më ky stimul (ushqimi), por vetëm shoqëruesi i tij (zilja). Ai na mësoi edhe procesin e shuarjes, që ndodh në rastet kur përgjigjja e kushtëzuar ulet dhe rifitimi spontan ndodh kur ai rishfaqet më vonë.

Thorndike (1898), formuloi teorinë e "*law of effect*" i cili shpjegoi se sjellja mësohet nëpërmjet provës dhe gabimit kështu që, sjellja do të kushtëzohet më lehtësisht, në qoftë se pasojat e stimulit janë të kënaqshme. Kjo metodë është përdorur me efikasitet më vonë në trajtimin e sjelljeve të varura. Ai ka dhënë kontributet e veta edhe në zgjidhjen e problemeve në industri si: testimi dhe ekzaminimi i punonjësve.

Watson (1913), ishte i pari, i cili avancoi qasjen bihevioriste dhe tregoi fuqinë e kushtëzimit klasik me rastin e Albertit të vogël, që kishte frikë nga miu i bardhë. Ai e arriti këtë nëpërmjet zhurmës sa herë që fëmija shikonte miun e bardhë dhe kushtëzimi ishte aq i fortë, sa që fëmija e gjeneralizoi frikën e tij tek të gjithë objektet e bardha të mbuluara me qime.

Skinner (1938), e ngriti kushtëzimin shumë hapa më lart, nëpërmjet procesit të cilin e quajti kushtëzimi operant. Skinner demonstroi, se si ndodh procesi i të mësuarit dhe më pas hodhi idenë se të gjithë llojet e të mësuarit duhet të shpjegohen nëpërmjet përvetësimit të kushtëzimit operant.

Wolpe (1950), është shumë i njohur për punën e tij me disensibilizimin sistematik. Ai zhvilloi metodën e tij për trajtimin e atyre që vuajnë nga ankthi ekstrem në lidhje me një ngjarje specifike apo situatë. Kjo metodë përfshinë burimin e hirearkisë së ankthit, në hirearkinë e ankthit të shkaktuar nga situata (SUD - Subjective Anxiety Scale). Wolpe investoi arritjen e tij në trajtimin e viktimave të Luftës II Botërore (PSTD).

Bandura (1977), është ai i cili krijoi teorinë e të mësuarit duke hedhur idenë se qenia njerëzore mëson nëpërmjet observimit/vëzhgimit dhe imitimit të të tjerëve.

Dhe arriti në konkluzionin, se sjellja e mësuar arrihet nëpërmjet ndërveprimit të mendimeve, vlerave, pritshmërive dhe emocioneve të individit në reagimet ndaj të tjerëve.

Konceptet kryesore:

Kushtëzimi klasik - Përshkruhet se si ne mësojmë përmes asocimit dhe lidhjes së dy gjërave: njëra e vjetër dhe tjetra e re të cilat ndodhin në të njëjtën kohë, domethënë që stimuli i ri zë vendin e stimulit të vjetër. Stimuli i vjetër si për shembull era e limonit që shkakton refleksin e pështymës, nuk mund të kontrollohet sepse ndodh në mënyrë automatike, ndërsa stimuli i ri ndodh në të njëjtën kohë me të vjetrin disa herë resht, më pas mjafton vetëm ai që të shkaktojë të njëjtin efekt, sepse formohet një asosacion ndërmjet të dyve. Kur krijohet ky asosacion, mjafton që të përmendim fjalën limon dhe sekretimi i pështymës do të ndodhë (stimuli i pakushtëzuar). Stimuli neutral tani bëhet i kushtëzuar (sekretimi i pështymës).

Kushtëzimi operant/veprues - Na tregon se si ne mësojmë përmes rforcimit, kështu që çdo sjellje e përsëritur, përfordhet ose ulet përmes eksperiencës, por përsëri ky ndryshim i sjelljes është i pakontrolluar. Një sjellje e caktuar nëse shpërblehet do të rritet dhe e kundërta. P.sh, nëse ne hamë diçka e cila është e shijshme dhe na ul urinë, atëherë jemi të prirur që ta hamë përsëri; ndërsa e kundërta ndodh me një ushqim i cili nuk na pëlqen, do të ulim mundësinë e përsëritjes. Përmes shpërblimit dhe ndëshkimit sjelljet mësohen ose çmësohen (hiqen). Skinneri e përshkruajti këtë si sjelljen ABC; Antecedent - Behaviour - Consequence.

Shpërblimi, quhet ndryshe edhe rforcimi. Përfordimi pozitiv ndodh, kur shpërblimi është i kënaqshëm dhe përfordimi negativ, kur nuk të jepet shpërblim ose kur të hiqet diçka që ti e dëshiron/të kënaq.

Shuarja, kur lartojmë diçka me qëllim që të pakësojmë një sjellje të caktuar, procesi quhet shuarje, pra ti largon diçka me qëllim që përgjigjia të ulet. Kjo teknikë bazohet në kushtëzimin veprues. Nëse një sjellje, një emocion ose mendim nuk shpërblehet do të ndalojë gradualisht dhe do të shuhet, prandaj është më efikase nëse duam të kemi sukses;

Frenimi reciprok, Wolpe parashikonte se frika dhe të ngrënit janë në raport dinamik reciprok. Nëse frika e madhe ka aftësi ta inhiboj aktin e ngrënies, ushqimi që do t'u jepej shtazëve neurotike në situatat që shkaktojnë frikëra të vogla, sigurisht që do të mund të inhibonte frikën. Nëse në prani të ngacmimeve që shkaktojnë frikë, i nxisim reaksionet që janë të papërputhshme me frikën, frika zbehet ose zhduket (Wolpe, 1990).

Desensibilizimi, është një procedurë trajtimi, e cila prish lidhjen ndërmjet stimulit neutral dhe reagimit të përshtatshëm emocional, që zëvendëson frikën ndaj situatës me një reagim më të fortë relaksimi, ndryshe mund të quhet edhe kundër kushtëzimi. Frika zëvendësohet me relaksim, sepse pacienti nuk mund të ndiejë edhe frikë edhe relaks në të njëjtën kohë. Ky proces fillon me momentin e nivelit të ulët të relaksit, në mënyrë që reagimi i relaksimit ta kalojë përgjigjen e

ankthit të dobët. Kjo metodë përdoret për arsyet: Të lartojmë frikërat dhe kujtimet e panevojshme, të tepërta dhe të paarsyeshme: Të prishet lidhja ndërmjet një situatë që përballemi dhe reagimit emocional të padëshiruar.

Të mësuarit - Mund të përshkruhet si proces që na drejton drejt ndryshimit të një sjelljeje. Pra ndërsa ne mësojmë, të jemi vigjilent në mënyrën se si perceptojmë mjedisin ku jetojmë, mënyrën se si interpretojmë stimulim me të cilin përballemi, si veprojmë e bashkëveprojmë. Baza e idesë së bihejviorizmit është se vetëm sjelljet e dukshme ja vlejné të studiohen, ndërsa gjendja emocionale dhe mendimet janë subjektive (Bandura, 1986).

Relaksimi progresiv i muskujve

Relaksimi progresiv i muskujve është një metodë, e cila u implementua nga Jacobson më 1938 dhe më pas ka vazhduar në variante nga më të ndryshmet, derisa sot mund të themi që kjo teknikë e teorisë së sjelljes është përshtatur në shumë fusha të tjera të terapisë, mjekësisë, në sport, në edukim; sepse relaksimi redukton stresin, ankthin, ul nivelin e frikërave dhe fuqizon pacientët në nivel fizik, psikologjik dhe emocional. Teknika e relaksimit progresiv të muskujve fillon me relaksim të grupeve të caktuara të muskujve të trupit. Zakonisht fillohet, ose nga koka dhe zbrësim përgjatë gjithë trupit, ose e anasjelltë, fillojmë nga këmbët dhe vazhdojmë deri te muskujt e kokës dhe të skalpit të kokës. Kjo teknikë merr mjaftueshëm kohë, por zakonisht më shumë në seancën e parë, sepse sa më shumë të ushtrohet/përdoret, aq më të lehtë e ka pacienti. Pas një periudhe ushtrimi të kësaj metode, relaksi arrihet shumë më shpejt (Yapko, 2003). Pas një periudhe praktikimi, më pas, mjafton që të përmendim vetëm atë pjesë të trupit dhe arrihet relaksi (Yapko, 2003). Kjo teknikë konsiston në realizimin e tendosjes të një grupi të caktuar muskujsh dhe më pas në shtendosjen e tyre, me qëllim që të arrihet relaksimi.

Hipnoza

Fjala hipnozë rrjedh nga greqishtja, dhe do të thotë “gjumë”. Ky nocion është marrë nga mitologjia e lashtë greke, me të cilin personifikohej zoti i gjumit, Hypnos (Pintar & Lynn, 2008). Në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe (2010), hipnoza pranohet si degë shkencore dhe përkufizohet si:

“gjendje e afërt me gjumin, në të cilën mund të vihen njerëzit ose kafshët e larta me anë të sugjestionit, për t'i mjekuar nga ndonjë sëmundje ose për t'i bërë, që të sillen sipas vullnetit të dikujt (Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe, 2010, f. 530).

Përgjithësisht mund të themi se është një gjendje ose rrethanë, në të cilën personi është në gjendje që nga sugjestionet e përshtatshme të arrijë ndryshim të perceptimeve, memories ose humorit. Përkufizimi i hipnozës nuk është diçka e

lehtë, sepse kemi po aq përkufizime të hipnozës, sa edhe persona që kanë tentuar t'i japin një përkufizim asaj (Kroger, & Fezler, 1976).

Një dekadë më vonë pas përcaktimit të APA-s, Society of Psychological Hypnosis (Green, Barabasz, Barrett, & Montgomery, 2005) e ka përcaktuar duke e përfshirë edhe teknikën klinike të vetëhipnozës të përshkruar si “veprimi i administrimit të procedurës hipnotike tek vetja”.

Gjendja e hipnozës mund të arrihet vetvetiu, mund të iniciohet nga terapeuti, pacienti ose në bashkëpunim mes të dyve. (Tamo, 1998). Librat na mësojnë se hipnoza nuk është diçka e mbinatyreshme, misterioze apo një dhunti të cilën mund ta kenë individë të veçantë, ajo është një proces të cilin mund ta mësojmë nga ekspertë dhe kërkon njohuri nga hipnoterapsisti dhe vullnet të lirë e fokusim nga pacienti. E vërteta është se hipnoza nuk ka asgjë mistike apo magjike, është thjesht një gjendje koncentrimi dhe fokusimi i vëmendjes. Është e rëndësishme të kuptojmë se mendimet, imagjinata dhe dialogu i brendshëm që njerëzit i flasin vetes në mënyrë kritike, ndikojnë në mos arritjen e qëllimeve dhe në çlirimin e potencialit njerëzor. Kërkimet mbi hipnozën, kanë kontribuar shumë në të kuptuarit e sjelljes dhe eksperiencës njerëzore, normale dhe jonormale. Autorët përmbledhin ndikimin e zhvillimit të kërkimeve mbi hipnozën gjatë shekullit të fundit; duke ilustruar vlerat investigative të hipnozës në fenomene të caktuara në fushat e të vepruarit, të ndjerit, të besuarit dhe të kujtuarit (Barnier & Mcconkey, 2003).

Metodologjia

Qëllimi dhe objektivat e studimit

Qëllimi i këtij studimi ishte njohja me efektet e përdorimit të teknikave të *hipnoterapisë klinike* në reduktimin e ankthit të përgjithësuar dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës. Njohja me efektet e përdorimit të teknikave të *hipnoterapisë klinike* në reduktimin e ankthit të përgjithësuar dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës. Duke u bazuar në faktin se *hipnoterapia klinike* është një terapi e shkurtër (maksimumi 12 seanca), është joshës aplikimi i saj në trajtimin e rasteve me ankth të përgjithësuar në popullatën e përgjithshme.

Objektivat e këtij studimi janë:

1. Matja dhe krahasimi i efikasitetit të teknikave të *hipnoterapisë*
2. Efekti i mundshëm i variablave të tjera socio-demografike në efikasitetin e këtyre metodave terapeutike si: mosha dhe gjinia.

Ky do jetë një studim *gjysmë eksperimental* në të cilin do të aplikohen tri teknika terapeutike: *Metafora*, *Forcimi i Egos* dhe *Relaksimi Progresiv*. Teknikat e mësipërme

do të përdoren për reduktimin e ankthit të përgjithësuar në rastet e studentëve të grupmohës 20-30 vjeç. Efektet terapeutike të këtyre teknikave do të maten me anë të pyetësorit GAD-7 si dhe me nivelin e vështirësive në punë, në kujdesin për shtëpinë dhe marrëdhëniet me njerëzit e tjerë. Për efekt studimi, do të ketë edhe një grup të katërt që do të jetë *Grupi i Kontrollit* i cili për gjashtë javë nuk do të marrë pjesë në asnjë trajtim me teknikat e mësipërme, por nuk do të jetë as nën trajtimin e ndonjë lloji terapie tjetër.

Pyetjet kërkimore janë:

1. A janë efikase teknikat e *hipnoterapisë* dhe *Relaksimit Progresiv* në reduktimin e ankthit të përgjithësuar dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës?
2. A janë teknikat e *hipnoterapisë* më efikase se *teknika e relaksimit* në reduktimin e ankthit të përgjithësuar dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës?
3. Cila nga teknikat e *hipnoterapisë* është më efikase (teknika e sugjerimeve direkte/autoritariane e *Forcimit të Egos* dhe teknika e sugjerimeve indirekte/ tolerante e *Metaforës*) në reduktimin e ankthit të përgjithësuar dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës?
4. A ka dallime gjinore në efikasitetin e teknikave në reduktimin e ankthit të përgjithësuar dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës?

Hipotezat e studimit janë:

- H 1. Teknikat e *hipnoterapisë klinike* dhe teknika e *Relaksimit Progresiv* janë efikase në reduktimin e ankthit të përgjithësuar dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës.
- H 2. Teknikat e *hipnoterapisë klinike* janë më efikase se teknika e *Relaksimit Progresiv* në reduktimin e ankthit të përgjithësuar dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës.
- H 3. Teknika e sugjerimeve direkte/autoritare e *Forcimit të Egos* është më efikase se teknika e sugjerimeve indirekte/tolerante e *Metaforës* në reduktimin e ankthit të përgjithësuar dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës.
- H 4. Ka dallime në efikasitetin e teknikave mes gjinive në reduktimin e ankthit të përgjithësuar dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës.

Procedura e studimit

Aspekti etik

Studentëve iu ofrua një letër miratuese, përmes së cilës do të deklarohet pjesëmarrja me vullnet të lirë në studim, si edhe do të sigurohet anonimiteti dhe ruajtja e të

dhënave personale. Duke qenë që, për nga natyra, ky studim është i thelluar, do të botohen vetëm ato fakte për të cilat do të vendoset mes terapistit dhe pacientit.

Përdorimi i informimit dhe pëlqimit paraprak të pacientit është relativisht i ri për psikoterapinë në përgjithësi dhe për hipnozën në veçanti. Disa terapistë argumentojnë se është e panevojshme të merret pëlqimi i informuar, paraprak, i posaçëm për hipnozën, duke theksuar se nuk nënshkruajnë kontrata me klientët (Gilligan, 1987; Grinder, Delozier & Bandler, 1977; Mills & Crowley, 1986).

Instrumentet e studimit

Për mbledhjen e të dhënave në studim është përdorur:

Pyetësi i ankthit të përgjithësuar (GAD-7) (Spitzer, Kroenke, Williams & Löwe, 2006) i plotësuar me disa pyetje lidhur me vështirësitë në shtëpi, punë dhe marrëdhënie me të tjerët. Ky pyetësor është përdorur si një mjet vlerësimi i ashpërsisë për pacientët me GAD (Spitzer, Kroenke, Williams & Löwe, 2006; Swinson, 2006). Ai ka një strukturë një dimensionale që përputhet me strukturën e GAD sipas kritereve të DSM-IV-TR. GAD-7 përbëhet nga 7 pyetje/tregues ku secili prej të 7 treguesëve shënohet nga 0 në 3 dhe shkalla e rezultateve të GAD-7 shkon nga 0-21. (Spitzer, Kroenke, Williams & Löwe, 2006). Nga studimi i bërë në përdorimin e GAD-7 në popullatën e gjerë (Löwe, Decker, Müller, Brähler, Schellberg, Herzog, Herzberg, 2008) dalin në konkluzionin se ky test mund të përdoret si një test i besueshëm në popullatën e gjerë. Cilësi të mira psikometrike janë treguar edhe në popullatën e përgjithshme në Holandë (Donker, Van Straten, Marks & Cuijpers, 2011) dhe në Portugali (Sousa, Viveiros, Chai, Vicente, Jesus, Carnot, Gordo & Ferreira, 2015). Konsistenca e brendshme në studim ishte e lartë: alfa= .843. Shkalla e nivelit të ankthit të përgjithësuar sipas pyetësorit GAD:

- 0-4 pikë minimale
- 5-9 pikë të ulëta
- 10-14 pikë të moderuar
- Mbi 14 pikë të lartë

Faza e parë e studimit

Gjatë fazës së parë të studimit, target-grupi ishin 240 studentë të grup moshës 20-30 të cilët u përzgjedhën në bazë të testit GAD-7 me nivel të lehtë dhe mesatar të ankthit të përgjithësuar. Kampioni që plotësoi testin ishin 240 studentë të përzgjedhur në mënyrë krejt rastësore në shkollat private dhe publike. 26 pyetësorë dolën të pavlefshëm. Kampioni, pas largimit të pjesëmarrësve me rezultatet e pavlefshme, në fillim, ka përfshirë 214 studentë. Për nga gjinia: meshkuj, 91 (42.5

%) dhe femra, 123 (57.5 %). Këta ishin studentë të universiteteve private (N=114; 53.3%) dhe shtetërore (N=100; 46.7%). Ky target-grup u përzgjedh për këto arsye: Vendosin me vullnetin e tyre të lirë për t'u përfshirë në studim; janë në një moshë ku bëjnë zgjedhje të informuara; ky është target-grupi më i përshtatshëm.

Bazuar në rezultatet që dolën nga pyetësi i GAD, prej 214 studentëve që kanë plotësuar pyetësorët, gjejmë se: nuk plotësojnë kriteret e GAD (N=84; 59.4 %), kanë nivel të lehtë të GAD (N=81; 38 %), kanë nivel të moderuar të GAD (N=34; 16 %), kanë nivel të lartë të GAD (N=14; 6.6%). Nga të dhënat doli që nuk ka dallime të studentëve mes universiteteve shtetërore dhe private prandaj ky variabël nuk u mor parasysh si kriter në përzgjedhjen e mëtejshme të target-grupit. T- testi i pavarur është përdorur për të krahasuar rezultatet sipas përkatësisë private apo shtetërore të studentëve në nivelin e ankthit të përgjithësuar. Rezultatet tregojnë se nuk kemi dallim domethënës sipas tyre, ku nga privatët (M=6.49; DS=4.52) dhe shtetërorët (M=6.06; DS=4.27), $t(213) = .720, p=.47$. Nga i gjithë target-grupi prej 214 studentësh vetëm 7 prej tyre kishin marrë pjesë në seanca të tjera terapie, të cilët u përjashtuan nga përzgjedhja e mëtejshme. Kjo për arsyen se pjesëmarrësit do të kishin marrë një informacion rreth zhvillimit të terapisë dhe do të ndikonte në rezultatet e dhëna në trajtimin me hipnoterapi. Janë pyetur studentët nëse i janë nënshtruar ndonjë lloj trajtimi terapeutik dhe ka rezultuar se: nuk kanë marrë trajtim (N=207; 96.7%) dhe kanë marrë trajtim (N=7; 3.3%). Janë pyetur studentët a janë trajtuar me hipnozë më parë dhe ka rezultuar se nuk kanë marrë trajtim me hipnoterapi (N=208; 97.2%) dhe kanë marrë trajtim (N=6; 2.8%).

Faza e dytë e studimit

Në fazën e dytë të studimit të dhënat bazë u filtruan në 81 studentë me GAD të nivelit të lehtë (5-9), (25 meshkuj dhe 56 femra), 34 studentë me GAD të nivelit të moderuar (10-14), (15 meshkuj dhe 19 femra). Po këta 81 dhe 34 pjesëmarrës u filtruan sërish në bazë të gjinisë dhe brenda kategorisë gjini mashkullore/femërore u përzgjedhën 12 meshkuj/femra me GAD të lehtë (5-9) dhe 12 meshkuj/femra me GAD të moderuar (10-14). Për të përzgjedhur meshkujt u përdorën vetëm numrat tek në renditje (dy meshkuj u përzgjedhën në mënyrë rastësore nga numrat çift meqenëse janë vetë 20 numra tek), ndërsa për femrat numrat çift derisa u arrit numri i përcaktuar.

Në studim u zhvillua një test paraprak për të parë nivelin e ankthit të 4 grupeve dhe rezultoi se nuk kishte dallime kështu që u procedua me testin T. Nga të dhënat doli se kishte dallime domethënëse të nivelit të ankthit mes gjinive. T-testi i pavarur është përdorur për të krahasuar rezultatet sipas gjinisë në nivelin e ankthit të përgjithësuar. Rezultatet tregojnë se kemi dallim domethënës sipas gjinive, ku meshkujt (M=5.01; DS=4.00) dhe femrat (M=7.24; DS=4.46), $t(213) = 3.83, p=.00$. Magnituda e dallimit në vlerën mesatare (dallimi në mesatare=-2

.2, 95% CI: -3.38 to -1.08) është shumë e vogël (eta në katror = .002); prandaj edhe në përzgjedhjen e mëtejshme u vendos që grupet të ishin të balancuara për sa i përket gjinisë, 20 femra dhe 20 meshkuj gjithsej, prej nga 5 femra dhe 5 meshkuj për secilin grup. Në këtë fazë të dytë të përzgjedhjes u morën në studim 48 studentë, gjysma prej të cilëve femra dhe gjysma tjetër meshkuj. Në studim u përfshinë 20 femra dhe 20 meshkuj, ndërsa 4 femra dhe 4 meshkuj (një femër/mashkull për çdo grup) u lanë për arsye sigurie nëse dikush largohej nga pjesëmarrja. Kjo përzgjedhje u bë për arsye praktike dhe terapeutike. Në fazën e dytë të studimit, target-grupi i përzgjedhur u nda në mënyrë rastësore në 4 grupe të cilët ishin të balancuar sipas gjinisë: 20 femra dhe 20 meshkuj (5 meshkuj dhe 5 femra për çdo grup). Për sa i përket nivelit të ankthit, testi ANOVA tregoi se nuk kishte diferenca domethënëse mes 4 grupeve. Pjesëmarrësit u trajtuan me këto teknika:

1. Teknika e *Metaforës* (sugjestionet indirekte/teknikë tolerante) 5 femra dhe 5 meshkuj prej të cilëve 5 me nivel të ulët ankthi të përgjithësuar dhe 5 me nivel të moderuar ankthi të përgjithësuar.
2. Teknika e *Forcimit të Egos* (sugjestionet direkte/teknikë autoritare) 5 femra dhe 5 meshkuj prej të cilëve 5 me nivel të ulët ankthi të përgjithësuar dhe 5 me nivel të moderuar ankthi të përgjithësuar.
3. Teknika e *Relaksimit Progresiv të Muskujve* 5 femra dhe 5 meshkuj, prej të cilëve 6 me nivel të ulët ankthi të përgjithësuar dhe 4 me nivel të moderuar ankthi të përgjithësuar.
4. Grupi i kontrollit i cili nuk do të trajtohet me asnjë lloj teknike apo terapie. 5 femra dhe 5 meshkuj, prej të cilëve 3 me nivel të ulët ankthi të përgjithësuar dhe 7 me nivel të moderuar ankthi të përgjithësuar.

Faza e tretë e studimit

Pasi u mblodhën të gjithë pyetësorët dhe u bë përzgjedhja e pjesëmarrësve, me ata u krijuan kontakte të drejtpërdrejta të një bisede informuese për qëllimin e zhvillimit të studimit dhe të plotësimit të kriterëve në pjesëmarrje. Më pas u përcaktua procedura e takimeve një herë në javë në një periudhë prej 6 javësh, me kohëzgjatjen 25-30 minuta, me përjashtim të seancës së parë e cila zgjati 60-70 minuta për efekt të mbledhjes së të dhënave personale. U vendos që ky eksperiment të vazhonte për 6 javë sepse për trajtimin e ankthit me hipnoterapi kjo është mesatarja e seancave për trajtim. Mund të ndodhë që pacienti të ketë nevojë për më shumë ose më pak seanca, në varësi të subjektit dhe kushteve të tij. Seancat u zhvilluan një herë në javë për çdo pjesëmarrës. Gjatë trajtimit të pacientëve nuk u përdor muzikë apo efekte të tjera zanore në mënyrë që të eliminonim ndikimet e variablave të tjerë të jashtëm në trajtim. Procedura për çdo teknikë, vendi ku u zhvilluan seancat, si edhe instrumentet matës ishin të njëjtë për të gjithë pjesëmarrësit. Gjithashtu, për të

kontrolluar efektet e teknikave në eksperiment u përdor i njëjti volum zëri, lartësi e tonalitetit dhe entuziazëm, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti tek pjesëmarrësit.

Në skriptet e të 3 teknikave është përdorur e njëjta gjuhë e thjeshtë dhe tonaliteti i zërit iu përshtatet secilës teknikë për të arritur efektin e duhur të relaksit në të tre teknikat. Ndryshim në paraqitjen e skripteve në të 3 teknikat është se 2 teknikat e hipnoterapisë e përmbajnë pjesën e relaksit brenda, por më pas punojnë edhe me elementin e mendimit, ndërsa teknika e *Relaksimit Progresiv* ka të përfshirë vetëm pjesën e relaksimit fizik. Gjatë gjendjes së hipnozës punohet në nivel të pavetëdijes, për këtë arsye edhe gjuha e përdorur i përshtatet asaj dhe skriptet përmbajnë fjalë të thjeshta që pacienti të mos ketë vështirësi në të kuptuarin e tyre. Gjithashtu, kemi një përpjekje të përjashtimit të fjalëve negative, përdorimin e fjalëve pozitive të cilat do të ndikojnë në nivelin e pavetëdijshëm për arsye që të përthithen edhe në rastet kur ata mund t'i zërë gjumi ose të kenë humbur përqendrimin. Terapisti ka qenë i njëjtë tek teknika e Metaforës, Forcimit të Egos dhe Relaksimit progresiv të muskujve sepse:

1. Gjatë Relaksimit Progresiv të Muskujve, edhe pse është një teknikë e Terapisë së Sjelljes, pacientët, nga relaksi, mund të hyjnë në gjendje transi dhe terapeuti duhet të jetë në gjendje të reagojë në situata të tilla.
2. Mund të ndodhë që pacientit, edhe në gjendje relaksi, t'i kujtohet diçka nga e kaluara dhe terapeuti duhet të jetë i përgatitur për këtë situatë.
3. Është përjashtuar variabli i ri që do të ishte ai i terapistit.
4. Toni i zërit, që është shumë i rëndësishëm tek të tria teknikat do të jetë i njëjtë dhe nuk do të kemi ndryshime thelbësore.

Në seancën e parë u mblodhën të dhënat personale: gjinia, mosha, historia mjekësore dhe psikiatrike, aktivitetet e kohës së lirë, simptomat.

Rezultatet

Rezultatet paraqiten sipas pyetjeve kërkimore/hipotezave përkatëse. Ky studim paraqet analizën sasiore në 2 pjesë: rezultatet për reduktimin e nivelit të ankthit dhe rezultatet për cilësinë e jetës.

Analiza sasiore

Analiza sasiore për efikasitetin e teknikave të përdorura në reduktimin e ankthit të përgjithësuar nga intervistat e marra nga pjesëmarrësit

Pyetja kërkimore 1. Sa efikase janë teknikat e hipnoterapisë klinike dhe Relaksimit Progresiv në reduktimin e ankthit të përgjithësuar dhe përmirësimin e cilësisë së jetës?

H 1. Teknikat e *hipnoterapisë klinike* dhe teknika e *Relaksimit Progresiv* janë efikase në reduktimin e ankthit të përgjithësuar dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës.

T-test (paired samples) është përdorur për të vlerësuar *ndikimin e trajtimeve* të përdorura në vlerat e GAD pas trajtimeve të aplikuara. Ka rezultuar një zvogëlim domethënës në vlerat e ankthit prej vlerave para-trajtim; ku GAD T1 (M=9.50; DS=2.71) dhe pas-trajtim GAD T2 (M=5.75; DS=2.33), $t(30) = 9.97$, $p < .000$ (dy drejtimëshe) (Tabela 8). Zvoglimi i vlerës mesatare ishte 3.75 me një interval konfidence prej 95 % (rangu nga 2.99 deri në 4.50). teknika eta në katror (.07) na tregon se ka një efekt të madh raporti.

Grupi i Metaforës: Ka rezultuar një zvogëlim domethënës në vlerat e ankthit prej vlerave para-trajtim; ku GAD T1 (M=9.50; DS=1.50) dhe pas-trajtim GAD T2 (M=5.50; DS=.52), $t(10) = 9.48$, $p < .000$ (dy drejtimëshe). Zvoglimi i vlerës mesatare ishte 4 me një interval konfidence prej 95 % që rangohet nga 3.0 deri në 4.9. Eta katrore (.90) teknika na tregon se ka një efekt të madh raporti (Tabela 10).

Grupi i Forcimit të Egos: Ka rezultuar një zvogëlim domethënës në vlerat e ankthit prej vlerave para-trajtim; ku GAD T1(M=9.60; DS=3.27) dhe pas-trajtim GAD T2 (M=3.70; DS=1.15), $t(10) = 7.69$, $p < .000$ (dy drejtimëshe). Zvoglimi i vlerës mesatare ishte 5.90 me një interval konfidence prej 95 % që rangohet nga 4.16 deri në 7.63. Eta katrore (.90) teknika na tregon se ka një efekt të madh raporti.

Grupi i Relaksimit Progresiv të Muskujve: Ka rezultuar një zvogëlim domethënës në vlerat e ankthit prej vlerave para-trajtim; ku GAD T1(M=8.40; DS=2.50) dhe pas-trajtim GAD T2 (M=5; DS=1.33), $t(10) = 5.20$, $p < .001$ (dy drejtimëshe). Zvoglimi i vlerës mesatare ishte 3.40 me një interval konfidence prej 95 % që rangohet nga 1.92 deri në 4.87. Eta katrore (.75) teknika na tregon se ka një efekt të madh raporti.

Grupi i Kontrollit: Ka rezultuar një zvogëlim domethënës në vlerat e ankthit prej vlerave para-trajtim; ku GAD T1 (M=10.50; DS=3.20) dhe pas-trajtim GAD T2 (M=8.80; DS=2.14), $t(10) = 3.43$, $p < .008$ (dy drejtimëshe). Zvoglimi i vlerës mesatare ishte 1.70 me një interval konfidence prej 95 % që rangohet nga 5.79 deri në 2.82. Eta katrore (.56) teknika na tregon se ka një efekt të madh raporti.

Pyetja kërkimore 2. A janë teknikat e *hipnoterapisë* më efikase se *teknika e relaksimit* në reduktimin e ankthit të përgjithësuar dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës?

Nga rezultatet sasiore del se teknikat e *hipnoterapisë* janë më efikase se *teknika e relaksimit* duke vërtetuar hipotezën H2. Teknikat e *hipnoterapisë klinike* janë me efikase se teknika e *Relaksimit Progresiv* në reduktimin e ankthit të përgjithësuar dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës.

Me qëllim të zbërthimit më të detajuar të rezultateve kemi përdorur ANOVA testin për të parë *dallimet e mundshme në mes të grupeve të krijuara në nivelin e GAD*. Në rastin e nivelit të GAD nuk ka dallim domethënës në mes të grupeve të përcaktuara për t'u futur në trajtim.

Nuk ka dallime statistikisht të rëndësishme në GAD para trajtimit. $F=1.01$, $p=.403$ por ka dallime statistikisht të rëndësishme pas trajtimit $F=23.485$, $p < .01$.

Pyetja kërkimore 3. A është teknika e sugjerimeve *direkte/autoritariane* e *Forcimit të Egos* më efikase se teknika e *sugjerimeve indirekte/tolerante* e *Metaforës* në reduktimin e ankthit të përgjithësuar dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës?

Rezultatet sasiore nxjerrin përfundimin se teknika e sugjerimeve *direkte/autoritariane* e *Forcimit të Egos* më efikase se teknika e *sugjerimeve indirekte/tolerante* e *Metaforës* duke vërtetuar hipotezën H3. Teknika e sugjerimeve *direkte/autoritare* e *Forcimit të Egos* është më efikase se teknika e sugjerimeve *indirekte/tolerante* e *Metaforës* në reduktimin e ankthit të përgjithësuar dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës.

Krahasimet post-hoc me teknikën Games-Howell indikojnë se vlera mesatare për: Grupi i Metaforës (M=5.50; DS=.52) ka dallim domethënës me Grupi i Forcimit të Egos (M=3.70; DS=1.15) dhe Grupi i Kontrollit (M=8.80; DS=2.14) por jo me Grupi i Relaksimit Progresiv (M=5; DS=1.33) (Tabela 12).

Po ashtu krahasimet me teknikën Games-Howell indikojnë se vlera mesatare për: Grupi i Forcimit të Egos (M=3.70; DS=1.15) ka dallim domethënës me Grupi i Metaforës (M=5.50; DS=.52) dhe me Grupi i Relaksimit Progresiv (M=5; DS=1.33) por edhe me Grupi i Kontrollit (M=8.80; DS=2.14) (Tabela 12).

Grupi i Relaksimit Progresiv (M=5; DS=1.33) ka dallim domethënës me Grupi i Forcimit të Egos (M=3.70; DS=1.15) dhe me Grupi i Kontrollit (M=8.80; DS=2.14) (Tabela 12).

Grupi i Kontrollit (M=8.80; DS=2.14) ka dallim domethënës me të tre grupet e tjera që kanë marrë trajtim (Tabela 12).

Ndikimi i trajtimit në nivelin e cilësisë së jetës

sipas T-test i kampionit të çiftëzuar

Pjesa e dytë e pyetjeve kërkimore 1, 2, 3, 4 Sa efikase janë teknikat e *hipnoterapisë klinike* dhe *Relaksimit Progresiv* në përmirësimin e cilësisë së jetës?

Përgjigjja e pjesës së dytë të hipotezës H1. H2. H3: Teknikat e *hipnoterapisë klinike* dhe teknika e *Relaksimit Progresiv* janë efikase në përmirësimin e cilësisë së jetës.

T-test i kampionit të çiftëzuar është përdorur për të vlerësuar ndikimin e trajtimeve të përdorura në cilësinë e disa nga funksioneve jetësore të individit: *punën, kujdesin për shtëpinë dhe marrëdhënien me të tjerët* pas trajtimeve të aplikuara. Ka rezultuar një zvogëlim domethënës në vlerat e vështirësive të para-trajtim.

Në rastin e *punës* para trajtimit T1 (M=1.75; DS=.49) dhe pas-trajtimit T2 (M=1.37; DS=.49), $t(40) = 3.36$, $p < .002$ (dy drejtimëshe). Zvoglimi i vlerës mesatare ishte .375 me një interval konfidence prej 95 % që rangohet nga .149 deri në .600. Eta katrore (.22) teknika na tregon se ka një efekt të madh raporti.

Në rastin e *kujdesit për shtëpinë* para trajtimit T1 (M=1.77; DS=.69) dhe pas-trajtimit T2 (M=1.37; DS=.54), $t(40) = 3.25$, $p < .002$ (dy drejtimëshe). Zvoglimi i vlerës mesatare ishte .400 me një interval konfidence prej 95 % që rangohet nga .151 deri në .648. Teknika Eta katrore (.21) na tregon se ka një efekt të madh raporti.

Në rastin e *marrëdhënies me tjerët* para trajtimit T1 (M=1.75; DS=.74) dhe pas-trajtimit T2 (M=1.30; DS=.51), $t(40) = 3.98$, $p < .000$ (dy-drejtimëshe). Zvoglimi i vlerës mesatare ishte .450 me një interval konfidence prej 95 % që rangohet nga .221 deri në .678. Teknika Eta katrore (.28) na tregon se ka një efekt të madh raporti.

T-test (paired samples) është përdorur për të vlerësuar ndikimin e llojeve të trajtimeve të përdorura në vlerat e cilësisë së disa funksioneve jetësore të individit: *punës*, *kujdesit për shtëpinë* dhe *marrëdhëniet me të tjerët* pas trajtimeve të aplikuar.

Grupi i Metaforës: Ka rezultuar një zvogëlim domethënës në vlerat e vështirësive në *kujdesin ndaj shtëpisë* prej vlerave para-trajtimit; ku para-trajtimi T1 (M=1.90; DS=.73) dhe pas-trajtimit T2 (M=1.30; DS=.43), $t(10) = 2.714$, $p < .024$ (dy-drejtimëshe). Zvoglimi i vlerës mesatare ishte .6 me një interval konfidence prej 95 % që rangohet nga .099 deri në 1.100. Eta katrore (.44) teknika na tregon se ka një efekt të madh raporti. Nuk ka rezultuar një zvogëlim domethënës në vlerat e vështirësive në *punë* dhe në *marrëdhënie me të tjerët* prej vlerave para-trajtimit.

Grupi i Forcimit i Egos: Ka rezultuar një zvogëlim domethënës në vlerat e vështirësive në *punë* prej vlerave para-trajtimit; ku para-trajtimi T1 (M=1.90; DS=.73) dhe pas-trajtimit T2 (M=1.30; DS=.43), $t(10) = 4.583$, $p < .001$ (dy drejtimëshe). Zvoglimi i vlerës mesatare ishte .7 me një interval konfidence prej 95% që rangohet nga .354 deri në 1.045. Eta katrore (.70) teknika na tregon se ka një efekt të madh raporti. Nuk ka rezultuar një zvogëlim domethënës në vlerat e *kujdesin ndaj shtëpisë* dhe në *marrëdhënie me të tjerët* prej vlerave para-trajtimit.

Grupi i Relaksimit Progresiv: Ka rezultuar një zvogëlim domethënës në vlerat e vështirësive në *punë* prej vlerave para-trajtimit; ku para-trajtimi T1 (M=1.80; DS=.63) dhe pas-trajtimit T2 (M=1.20; DS=.42), $t(10) = 2.753$, $p < .022$ (dy drejtimëshe). Zvoglimi i vlerës mesatare ishte .8 me një interval konfidence prej 95 % që rangohet nga .142 deri në 1.457. Eta katrore (.45) teknika na tregon se ka një efekt të madh raporti. Nuk ka rezultuar një zvogëlim domethënës në vlerat e *kujdesin ndaj shtëpisë* dhe në *marrëdhënie me të tjerët* prej vlerave para-trajtimit.

Grupi i kontrollit: Nuk ka rezultuar një zvogëlim domethënës në vlerat e vështirësive në *punë*, në *kujdesin ndaj shtëpisë* dhe në *marrëdhënie me të tjerët* prej vlerave para-trajtimit.

Diskutime

Qëllimi i këtij studimi ishte krahasimi i efikasitetit të teknikave të *hipnoterapisë klinike të Metaforës dhe Forcimit të Egos* në reduktimin e nivelit të ankthit të përgjithësuar dhe cilësisë së jetës, tek studentët. Për të parë ndikimin e tyre në popullatën jo klinike, u krahasua efekti i dy teknikave me teknikën e huazuar nga terapia bihevjoriste e *Relaksimit Progresiv të Muskujve*.

Rezultatet sasiore tregojnë se të tri teknikat e përdorura kanë efekt pozitiv në reduktimin e ankthit të përgjithësuar duke na vërtetuar hipotezën kryesore të punimit H1: Teknikat e *hipnoterapisë klinike* dhe teknika e *Relaksimit Progresiv* janë efikase në reduktimin e ankthit të përgjithësuar dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe i japin përgjigje pyetjes kërkimore 1 (Sa efikase janë teknikat e *hipnoterapisë klinike* dhe *Relaksimit Progresiv* në trajtimin e ankthit të përgjithësuar dhe në cilësinë e jetës?).

Grupi i Kontrollit kishte ulje të nivelit të ankthit edhe pse në nivele tepër të ulëta. Pjesëmarrësit e dinin që do të merrnin pjesë në një studim për uljen e nivelit të ankthit, kështu që efekti Placebo (Lambert & Bergin, 1994) është më se i shpjgueshëm në këtë rast, por nga analizat e mëtejshme statistikore duket qartë që nuk ka pasur efekt në përmirësimin e sjelljeve në dimensionet e jetës: punë, shtëpi dhe marrëdhënie me të tjerët. Çdo terapi ka arritjet dhe mangësitë e veta, të gjitha janë superiore kundrejt grupit të kontrollit (Lambert & Bergin, 1994).

Pjesëmarrësit e të dy grupeve të trajtuar me teknikat e *hipnoterapisë klinike* pothuajse nuk kishin informacion për hipnozën dhe trajtimin me anë të saj, tetë nga dhjetë pjesëmarrës (*Metafora*) dhe nëntë nga dhjetë pjesëmarrës (*Forcimi i Ego*). E vetmja përballje me hipnozën kishte qenë nëpërmjet filmave, librave të lexuar ose videove të hedhura në youtube.

Rezultatet sasiore na tregojnë se teknikat e hipnoterapisë klinike të *Forcimit të Egos* dhe të *Metaforës* kanë pasur më shumë efikasitet në trajtimin e ankthit të përgjithësuar dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës, krahasuar me *Relaksimin Progresiv*, duke vërtetuar hipotezën H2: Teknikat e *hipnoterapisë klinike* janë më efikase se teknika e *Relaksimit Progresiv* në reduktimin e ankthit të përgjithësuar dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe i japin përgjigje pyetjes kërkimore 2 (A janë teknikat e *hipnoterapisë* më efikase se teknika e *relaksimit* në reduktimin e ankthit të përgjithësuar dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës?). Kjo gjetje është në kundërshtim me një studim ku efekti i saj ishte i ngjashëm me atë të ushtrimeve të relaksimit dhe trajnimit imagjinar (Gruzelier, 2002) dhe po ashtu me studimin e Gordin (1981), por është në vijë me studimin e O'Neil, Barnier dhe Mçonkey (1999) ndonëse këtu është fjala për vetë-hipnozën e aplikuar. Është e rëndësishme

të theksohet se krahasimi i relaksimit të teknikave të *hipnoterapisë* me teknikën e *relaksimit progresiv* mund të bëhet vetëm nëse do të përdornim si protokoll të *hipnoterapisë*: induksionin + thellimin + zgjimin por u përdor edhe pjesa e terapisë (metafora/forcimi i egos) e cila ju jep superioritet ndaj teknikës së *relaksimit*. Prej të gjithë të dhënave nga pjesëmarrësit duket se teknika e *Relaksimit Progresiv* ka efekt shumë pozitiv në relaksim të trupit, por nuk përjashtohet edhe relaksimi mendor i cili raportohet vetëm në disa raste.

Nga të dhënat e mbledhura nga pjesëmarrësit, kuptohet se teknika e *Metaforës* dhe teknika e *Relaksimit Progresiv* arrijnë të japin relaksim të trupit. Pra teknika e *Metaforës* e ka relaksin fizik brenda vetes, por ka vështirësi konjitive për t'u perceptuar dhe kjo e ul efikasitetin në trajtim (krahasuar me teknikën e *Forcimit i Egos*) duke u përafëruar me teknikën e *Relaksimit Progresiv* por në disa raste nuk është përjashtuar fakti që është parë edhe si një mënyrë për të dhënë siguri.

Nga studimet ka dalë se *Relaksimi Progresiv* ka potencial në arritjen e relaksit të pacientëve të cilët janë trajnuar me përdorimin e tij (Kerr, 2000). Rausch etj., (2006) në studimet e veta arrin në përfundimin se kjo teknikë ka çuar në ulje të nivelit të ndjeshëm të ankthit somatik, gjë që na jepet qartë nga të dhënat e pacientëve të cilët kanë shprehur dukshëm arritjen e relaksimit fizik të trupit. *Relaksimi Progresiv* i muskujve jep një qetësim total të trupit, nuk kërkon impenjim konjitiv dhe fokusohet vetëm te pjesa fizike. Padyshim që pacientët të cilët kanë nivel ankthi kanë edhe vështirësi në relaksim të trupit, por ky është aspekti i vetëm që trajtohet me këtë teknikë. Ky aspekt del i qartë nga përgjigjet e subjekteve pjesëmarrës të cilët vënë theks pozitiv vetëm në relaksim fizik të trupit.

Teknikat e *Forcimit i Egos* dhe *Relaksimit Progresiv* kanë arsyet e mëposhtme se përse teknika e parë ka arritur të ketë më shumë efikasitet në reduktimin e nivelit të ankthit sesa *Relaksimi Progresiv*: *Forcimi i Egos*, si një prej teknikave të hipnozës e ka relaksin brenda dhe ky arrihet nëpërmjet teknikave të thellimit; *Relaksimi Progresiv* funksionon vetëm në pjesën fizike dhe jo në atë mendore; Të dyja teknikat janë të drejtpërdrejta, por *Forcimi i Egos* është autoritar ndërsa *Relaksimi Progresiv* lejuar/tolerant.

Rezultatet sasiore na tregojnë se teknika e *Forcimit i Egos* ka më shumë efikasitet në trajtim krahasuar me teknikën e *Metaforës* duke na vërtetuar hipotezën H3: Teknika e sugjerimeve *direkte/autoritare* e *Forcimit të Egos* është më efikase se teknika e sugjerimeve *indirekte/tolerante* e *Metaforës* në reduktimin e ankthit të përgjithësuar dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe i japin përgjigje pyetjes kërkimore 3 (Cila nga teknikat e *hipnoterapisë* është më efikase (teknika e sugjerimeve *direkte/autoritare* e *Forcimit të Egos* dhe teknika e *sugjerimeve indirekte/tolerante* e *Metaforës*) në reduktimin e ankthit të përgjithësuar dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës?). Kjo gjetje është e kundërt me studimet si Alman & Carney (1980); Stone & Lundy (1985) dhe Mosher & Matthews (1985) ku

sugjerimet indirekte ishin më efektive por janë në një vijë me gjetjet e studimeve si Van Gorp, Meyer, dhe Dunbar (1985). Padyshim duhet përmendur këtu se është fjala për studime jo të lidhura me ankthin por me gjendje tjera. Vetëm në studimin e Nugent (1989) është gjetur se sugjerimet indirekte janë efikase tek rastet me disa lloje çrregullimesh ankstioze.

Gjatë përdorimit të teknikës së *Forcimit të Egos* fjalët janë direkte, të thjeshta, përshtatshme dhe përfshijnë disa aspekte të jetës së përditshme, kemi përsëritjen e disa fjalëve të cilat e bëjnë "implementimin" në të pavetëdijshmen edhe më të lehtë. Hipnoza në vetvete gjen terren shumë të përshtatshëm kur përdor teknikën e *Forcimit të Egos* sepse arrin në mënyrë të pavetëdijshme të zhvillojë një ego të shëndetshme (Yapko, 2003). Ajo konsiderohet si një teknikë e cila ndikon në rritjen e vetëbesimit, të konfidencës dhe të optimizmit (të gjithë pjesëmarrësit; krijimin e një stabiliteti mendor, emocional dhe fizik i cili do të jetë i dukshëm në reagimet e pacientëve në jetën e përditshme (pjesa më e madhe e pjesëmarrësve); shikohet si një teknikë e cila të ndihmon që të përballosh realitetin dhe problematikat jetësore (më shumë se gjysma e pjesëmarrësve).

Janë vënë re edhe disa pika të dobëta (shumica e pjesëmarrësve) në përdorimin e kësaj teknike në rastin tonë, të cilat konsistojnë në pikëpyetjen se sa afatgjate mund të jetë kjo teknikë. Nëse besimi do të rritet më shumë nga ç'mund të përballojë pacienti, atëherë në jetën e përditshme, ndoshta do të dalë jashtë personalitetit të vet dhe mund të çojë në "pandjeshmëri" ndaj konflikteve të brendshme që mund të ketë pacienti. Për këtë arsye kjo teknikë sugjerohet të shoqërohet edhe me teknika të tjera të hipnoterapisë. Ndryshimi i besimit të vetes i arritur nëpërmjet induktimeve/sugjerimeve të jashtme është parë si pozitiv nga pjesëmarrësit, por në këtë rast duhet të theksojmë kontekstin shqiptar sepse ndryshe do të ndikonte kjo teknikë në një shoqëri tjetër ku individit është formuar dhe edukuar që të jetë i lirë për të vendosur se cila është më e përshtatshme për të.

Atëherë na lind pyetja se çfarë ndikon te shqiptarët që teknika autoritare/e drejtpërdrejtë të ketë efikasitet më të lartë në trajtim, krahasuar me teknikën tolerante/indirekte, duke e theksuar faktin që arrihet nëpërmjet një terapie e cila punon në nivel të pavetëdijshëm? Për këtë përgjigje duhet parë shumë më thellë dhe nuk mund të ndalohej vetëm në pikën që terapisti është figura autoritare dhe gjatë përdorimit të kësaj teknike roli i vet ka qenë më i fuqishëm, apo në faktin se 60% e suksesit në terapi arrihet nga efekti Placebo sipas Rosenthal dhe Frank (Kroger, 2008). Ndikim në këtë pikë ka edhe pjesa e *pavetëdijës kolektive* të cilën e mbartim me vete (Jung, 1954).

Rezultatet e studimit treguan që pas trajtimit teknikat nuk kishin dallime në trajtimin e ankthit të përgjithësuar midis meshkujve dhe femrave. Ky rezultat hedh poshtë hipotezën H4. Sipas së cilës ka dallime në efikasitetin e teknikave mes gjinive në reduktimin e ankthit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës duke i dhënë përgjigje

pyetjes 4. Studimet e mëparshme për dallime gjinore në aftësinë e hipnotizimit dhanë disa të dhëna për të mbështetur besimin, se në përgjithësi, femrat mund të hipnotizohen më lehtësisht se meshkujt (Hilgard, 1965). Weitzenhoffer (2000), përmbledhi rezultatet e tij për këtë temë duke theksuar se dallimi është aq shumë i vogël, vetëm 5%, sa që kjo i ka çuar studiuesit në refuzimin e këtij ndryshimi sepse ky dallim nuk ka rëndësi praktike. Studime të tjera nuk arrijnë të nxjerrin një përfundim në lidhjen mes seksit, moshës, diagnozës dhe cilësive të personalitetit, në lidhje me nivelin e suggestionibilitetit (Meares, 1955). Kjo gjetje është pak a shumë e kuptueshme në faktin se Weitzenhoffer (2000), arrin në përfundimin se nuk ka ndonjë dallim gjinor substancial në efektin e hipnozës.

Një tjetër këndvështrim është edhe fakti që target-grupi ishin studentë të cilët në këtë fazë të jetës janë në euforinë e barazisë gjinore dhe femrat në procesin e emancipimit të tyre dhe në përpjekje për të luftuar për fuqizimin e tyre në ditët e sotme.

Nga studimet e bëra ka rezultuar se çrregullimet e ankthit çojnë edhe në dëmtime të shëndetit dhe cilësisë së jetës. Spitzer, Kroenke & Linzer, (1995) gjetën dëmtime në të gjitha sferat e jetës duke përfshirë funksionimin social, funksionimin sipas rolit ndërsa Mendlowicz & Stein (2000) tregojnë për dobësim të cilësisë së jetës dhe funksionimit social tek pacientët që vuajnë nga ankthi. Këto të dhëna paraqiten edhe në rezultatet e dala nga analiza për të parë se si kanë reaguar pjesëmarrësit pas trajtimit në funksionimin e tyre në marrëdhënie me *shtëpinë, punën dhe të tjerët*. Gjithashtu, Kessler dhe kolegët e tij (1999) kanë gjetur, se njerëzit të cilët kanë nivel të GAD, raportojnë ulje të cilësisë së jetës në punë dhe marrëdhëniet sociale.

Nga rezultatet del që ka reflektim pozitiv në dimensionet e ndryshme të jetës: *të kujdesit ndaj shtëpisë, vështirësisë në punë dhe përballjes me të tjerët*. Teknikat e përdorura në trajtimin e të tre grupeve kanë ulur nivelin e ankthit duke ndikuar pozitivisht në këto tre dimensione duke përfunduar efektin real të teknikave.

Teknika e *Forcimi i Egos* vepron pozitivisht te vështirësitë e përballjes në punë. Rritja e besimit, optimizmi, të parit të jetës në këndvështrim pozitiv që përshkruhet nga pacientët si aspekte të përdorimit të kësaj teknike, e reflektojnë hapur këtë pjesë. Pritshmëria ishte që kjo teknikë të kishte efikasitet edhe në marrëdhënie me të tjerët por kjo ngelet për tu diskutuar në studime të mëtejshme.

Teknika e *Metaforës* ka ndikuar vetëm në kujdesin ndaj shtëpisë por jo tek dy dimensionet e tjera. Kjo teknikë nuk ka brenda trajtimit, komponentin social të përballjes me të tjerët.

Teknika e *Relaksimit Progresiv* ka vepruar pozitivisht vetëm në vështirësitë në punë dhe kjo është e kuptueshme që nëse je i relaksuar do ta pasqyrosh edhe në marrëdhëniet e punës por nuk ka pasur rezultat në marrëdhëniet me të tjerët dhe kujdesin ndaj shtëpisë. E njëjta rrjedhë shpjegimi vlen edhe për efikasitetin e kësaj teknike, sepse marrëdhëniet në punë janë të lidhura edhe në marrëdhëniet me

të tjerët. Nga studimet ka rezultuar se mësimi i teknikave të relaksimit ka çuar në përmirësimin e funksionalitetit njohës, ekuilibrin emocionalë dhe të sjelljes në cilësinë e jetës (Dress, Ayres & Beechley, 2009).

Tek *Grupi i Kontrollit* nuk kemi ndikim në asnjë nga këto dimensione, gjë që pritej të ndodhte me qenë se nuk u ndërmor asnjë hap për të trajtuar ankthin.

Kufizime te studimit

Ky studim ka një sërë kufizimesh të cilat duhen diskutuar. Dihet që pyetësorët kanë kufizimet e veta për sa i përket specifikës së tyre. Përdorimi i testit GAD-7 nuk mjafton për të bërë një vlerësim substancial të ankthit. Po ashtu GAD-7 është një test i pa standardizuar në Shqipëri dhe si i tillë ka mangësi në përdorim dhe në administrim. Administrimi i GAD-7 dhe trajtimi i pjesëmarrësve, i bërë nga i njëjti studiues përbën një tjetër kufizim të këtij punimi, për vetë faktin e mundësisë së subjektivizmit. Nuk ka pasur vlerësues klinik nga një psikiatër ose psikolog klinik për rastet për të njohur gjendjen e tyre reale, por në këtë rast janë përdorur vetëm pjesëmarrësit të cilët përmbushnin kriteret e përcaktuara në bazë të testit.

Në trajtimin me hipnoterapi ne i përshtatim teknikat sipas pacientit dhe nevojave të tij për trajtim prandaj edhe mund të themi se në këtë studim ky është një nga kufizimet themelore. Në hipnoterapi, si në çdo terapi klinike seancat janë *"tailor made"* të cilat u përshtaten nevojave, kushteve dhe qëllimit të përmirësimit të pacientit. Në rastin tonë, qëllimi ishte të shihej efekti i teknikave të veçanta por duke u zgjedhur pjesëmarrësit në mënyrë të rastësishme, mundet që teknika të caktuara të mos jenë efikase për pjesëmarrës të caktuar. Ajo që bëhet në dhomën e terapisë nuk mund të përshtatet plotësisht në një eksperiment.

Referencat

- Alman, B. M. (1983). *Self-Hypnosis: A Complete Manual for Health and Self-Change*. San Diego: International Health Publications.
- American Psychiatric Association (2000). *Diagnostic and Statistical Manual of Mental Disorders*. (4th ed.), Text Rev. Washington-DC.
- American Psychiatric Association. (2013). *Diagnostic and statistical manual of mental disorders* (5th ed.). Washington-DC.
- Bandler, R., & Grinder, J. (1978). *Frogs into Princes: Neurolinguistic Programming*. Moab-UT: Real People Press.
- Bandler, R., & Grinder, J. (1979). *Frogs into princes*. Moab-UT: Real People.
- Bandura, A. (1986). *Social Foundations of Thought and Action: A Social Cognitive Theory*. Englewood Cliffs-NJ: Prentice Hall.
- Bandura, A. (1997). *Self-efficacy*. New York: Freeman and Company.

- Bandura, A. (2001). *Social Cognitive Theory: An Agentic Perspective*. Annu. Rev. Psychol. 2001. 52:1-26 Copyright c 2001 by Annual Reviews.
- Barber, T.X. (1999). *A comprehensive three-dimensional theory of hypnosis*. In: I. Kirsch, E. Cardena, & S. Amigo (eds.), *Clinical hypnosis and self-regulation: Cognitive-behavioral perspectives*. Washington-DC: 21-48.
- Barker, Ph., (1985). *Using Metaphors in Psychotherapy*. New York: Brunner/Mazel.
- Barrett, D. (2010). *Hypnosis and hypnotherapy*. Santa Barbara-CA: Praeger.
- Boeree, G. (2004). *Teoritë e Personalitetit, nga Frojdi deri në ditët tona*. Tiranë: Plejad.
- Bourland, S.L., Stanley, M.A., Snyder, A.G., et al. (2000). Quality of life in older adults with generalized anxiety disorder. *Aging and Mental Health* 2000, 4 (4): 315-323.
- Brann, L.; Owens, J. & Williamson, A. (2012). *The Handbook of Contemporary Clinical Hypnosis: Theory and Practice*. John Wiley & Sons, Ltd, (1st ed.).
- Burrows, G. D., Stanley, R. O. & Bloom, P. B. (2001). *International Handbook of Clinical Hypnosis*. John Wiley & Sons, Ltd.
- Campbell, J. (1949). *The hero with the thousand faces*. Princeton, NJ: Princeton University press.
- Crawford, H. J. & Gruzelier, J. H. (1992). A midstream view of the neuropsychophysiology of hypnosis: Recent research and future directions. In E. Fromm & M. R. Nash (Eds), *Contemporary Hypnosis Research*. New York: Guilford Press: 227-266.
- Diagnostic and Statistical Manual of Mental Disorders*. 3rd ed. American Psychiatric Association, Washington-DC, 1980.
- Diagnostic and Statistical Manual of Mental Disorders*. 3rd ed. American Psychiatric Association, Washington-DC, 1987.
- Durham, M.E. (1990). *Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera për Shqipërinë dhe shqiptarët* Tiranë: 8 Nëntori; origjinali: "Some Tribal Origins, Laws, and Customs of the Balkans" London: AMS Press, 1908.
- Dhima, A. (2013). *Antropologji e komunikimit: Qasje në realitetin shqiptar*. Tiranë: Kumi.
- Erickson, M. H., & Rossi, E. L. (1979). *Hypnotherapy: An Exploratory Casebook*. New York: Irvington.
- Erickson, M. H., Rossi, E. L. & Rossi, S. I. (1976). *Hypnotic Realities: The Induction of Clinical Hypnosis and Forms of Indirect Suggest*. New York: Irvington.
- Ericson, M., Rossi, E., & Rossi, S. (1976). *Hypnotic realities: The induction of clinical hypnosis and forms of indirect suggestion*. New York: Irvington Publishers.
- Erikson, E.H. (1964). *Insight and responsibility*. New York: Norton.
- Evans, F. (1991). *Hypnotisability: Individual differences in dissociation and the flexible control of psychological processes*. In: Lynn, S. J., Rhue, J. W. (eds) *Theories of hypnosis: Current models and perspectives*. New York: Guilford Press, ch. 5, 144.
- Frank, J. D. & Frank, J. B. (1991). *Persuasion and healing: A comparative study of psychotherapy*. Baltimore, John Hopkins University Press.
- Freeman, L.W., (2001). *Research on mind-body effects*. In: Freeman, L.W., Lawlis, G.F. (Eds.), *Complementary & alternative medicine: A research-based approach*. Mosby, London.
- Fromm, E. (1980). *Greatness and limitations of Freud's thought*. New York: New American Library.
- Gauld, A. (1992). *A History of Hypnotism*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Geertz, C. (1973). *The Interpretation of Cultures*. New York: Basic Books.
- Genter, D. & Jeziorski, M. (1993). *The shift from metaphor to analogy in Western science in Metaphor and Thought*, edited by Andrew Ortony (2nd ed.). Cambridge: Cambridge University, 447-448.
- Gill, M.M., & Brenman, M. (1959). *Hypnosis and Related States: Psychoanalytic Studies in Regression*. New York, International Universities Press.
- Gilligan, S.G. (1987). *The therapeutic trances: The cooperation principle in Ericksonian Hypnotherapy*. New York: Bruner/Mazel.
- Green, J.P., Barabasz, A., Barrett, D., & Montgomery, G.H. (2005). Forging ahead: The 2003 APA Division 30 definition of hypnosis. *International Journal of Clinical and Experimental Hypnosis*, 53: 259-264.
- Grinder, J., & Bandler, R. (1981). *TRANCE-formation*. Moab, UT: Real People press.
- Grup autoresh. (2010). *Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe*. Tiranë.
- Hammond, D. C. (1990). *Handbook of hypnotic suggestions and metaphors*. New York: W.W. Norton.
- James, U. (2005). *Clinical Hypnosis Textbook. A guide for practical intervention*. Radcliffe Publishing. Oxford-UK & Seattle-WA.
- Jonas, W.B. & Levin, J.S. (1999). *Essentials of Complementary and Alternative Medicine*. Lippincott: Williams & Wilkins.
- Jung, C.C (1954). *The Collected Works. The Development of Personality*. Volume Seventeen. Routledge & Kegan Paul Ltd.
- Kerr, K. (2000). Relaxation techniques: a critical review. *Critical Reviews in Physical and Rehabilitation Medicine*, 12:51-89.
- Kessler, R., Chiu, W., Demler, O., & Walters, E. (2005). Prevalence, severity, and comorbidity of 12-month DSM-IV disorders in the National Comorbidity Survey Replication. *Archives of General Psychiatry*, 62 (6): 617-27.
- Kessler, R.C., Du Pont, R.L., Berglund, P., et al. (1999). Impairment in pure and comorbid generalized anxiety disorder and major depression a T12 months in two national surveys. *American Journal of Psychiatry*, 156: 1915-1923.
- Kirsch, I. (1991). The social learning theory of hypnosis, in *Theories of Hypnosis: Current Models and Perspectives*. (Ed. by Lynn SJ, Rhue JW). New York, Guilford: 439-465.
- Kopp, R. (1995). *Metaphor Therapy: Using client generated metaphors in psychotherapy*, Brunner, New York.
- Kroenke, K., Spitzer, R.L., Williams, J.B., Monahan, P.O. & Löwe, B. (2007). Anxiety Disorders in Primary Care: Prevalence, Impairment, Comorbidity, and Detection. *Annals Internall Medicine*, 146 (5): 317-25.
- Kroger, W.S. (2008). *Clinical & Experimental Hypnosis: In Medicine, Dentistry, and Psychology*, 2nd Edition, Lippincott: Williams & Wilkins. (2nd ed.).
- Lambert, M. J., & Bergin, A. E. (1994). *The Effectiveness of Psychotherapy*. In A. E. Bergin & S. L. Garfield (Eds.), *Handbook of Psychotherapy and Behavior Change* (4th ed.). New York: Wiley.
- Lankton, C. H., & Lankton, S. R. (1986). Enchantment and intervention in family therapy: A training seminar on Ericksonian approaches. New York: Brunner/Mazel.
- Lichstein, K.L. (1988). *Clinical relaxation strategies*. New York: Wiley.
- Löwe, B., Decker, O., Müller, S., Brähler, E., Schellberg, D., Herzog, W., & Herzberg, P. Y. (2008). Validation and standardization of the Generalized Anxiety Disorder Screener (GAD-7) in the general population. *Medical Care*, 46: 266-274.
- Lynn, S.J. & Kirsch, I. (2006). *Essentials of Clinical Hypnosis: An Evidence-Based Approach*. Washington, DC: American Psychological Association.
- Meissner, W.W. (2009). *Classical Psychoanalysis*. NW Sadock, B. J., Sadock, V. A., & Ruiz, P. Kaplan & Sadock's Comprehensive Textbook of Psychiatry (9th ed.). Lippincott Williams & Wilkins: 2804-2832.

- Ormel, J., Vonkorff, M., Ustun, B., Pini, S., Korten, A. & Oldehinkel, T. (1994). Common Mental Disorders and Disability Across Cultures. *The Journal of the American Medical Association*, 272 (22): 1741-8.
- Ormel, J., Von Korff, M., Ustun, T.B., Pini, S., Korten, A., & Oldehinkel, T. (1994). Common mental disorders and disability across cultures: results from the WHO Collaborative Study on Psychological Problems in General Health Care *The Journal of the American Medical Association*, 272 (22): 1741-1748.
- Oxford English Dictionary*, (1998). Oxford University Press.
- Pango, Y. (2004). *Psikoterapia*. Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Universitar.
- Reber, S. Reber, E. (1995). *Penguin Dictionary of Psychology*. New York: Penguin Books (4th ed.).
- Pintar, J. & Lynn, S.J. (2008). *Hypnosis: A Brief History*. Wiley-BlackWell Press.
- Rankin-Box, D., & Williamson, E.M., (2006). *Complementary medicine: A guide for pharmacists*. Edinburgh: Churchill Livingstone.
- Reber, A. S. & Reber, E. (2001). *The Penguin dictionary of psychology* (3rd edition). London: Penguin.
- Rossi, E. L. (1986). *The Psychobiology of Mind-Body Healing*. New York: W.W. Norton & Company.
- Sorr, A. (1989). *Freud; A very short introduction*. Oxford: Oxford University Press.
- Stein, M.B. & Heimberg, R.C. (2004). Well-being and life satisfaction in generalized anxiety disorder: comparison to major depressive disorder in a community sample. *Journal of Affective Disorders*, 79: 161-166.
- Stevens, A. (2001). *Jung: A Very Short Introduction*. Oxford University Press.
- Tamo, A. (1998). *Psikoterapia 1*. Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Universitar.
- Wolpe, J. (1990). *The practice of behaviour therapy* (4th ed.). New York: Pergamon.
- Yapko, M. D. (2003). *Trancework*, New York and Hove: Brunner-Routledge.
- Yapko, M. (1995). *Essential of hypnosis*. New York: Bruner/Mazel.
- Zeig, J. (1980). *Erickson's use of anecdotes*. Chapter in: J. Zeig (Ed.), *A Teaching Seminar With Milton H. Erickson*, M.D. New York: Brunner/Mazel: 3-28.

Modernizimi dhe Demokracia: Një Vlerësim Kritik ndaj Teorisë së Modernizimit në Studimin e Demokratizimit

Gerti Sqapi

UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS, FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE
DHE TË EDUKIMIT, SHKENCA POLITIKE
E-mail: gerti.sqapi@uet.edu.al

Abstrakt

Dekadat e fundit të shek. XX njohën një progres të konsiderueshëm të transformimeve të regjimeve të ndryshme politike drejt demokracisë. Që prej kësaj kohe, studimi i demokracisë dhe demokratizimit do të përbënte një industri gjithnjë e më shumë në rritje ndër shkollarët dhe studiuesit e ndryshëm të fushës. Dhe ndoshta pyetja më tërheqëse për studiuesit e kësaj fushe ka qenë pikërisht ajo se: Çfarë e bën të mundur shfaqjen dhe qëndrueshmërinë e regjimeve politike demokratike në vende të ndryshme? Teori të ndryshme janë ngritur duke ofruar një gamë të larmishme idesh, përgjithësimesh dhe variablash për faktorët shkakësorë që ndihmojnë për të shpjeguar tranzicionet e suksesshme të regjimit drejt demokracisë. Një nga teoritë kryesore në këtë drejtim ka qenë edhe teoria e modernizimit, me një fushë kërkimi të vetën brenda literaturës së demokratizimit, që nis së pari nën traditën e vendosur nga Seymour Martin Lipset (1959) dhe pasurohet më pas nga kontributi i autorëve të tjerë. Pretendimi kryesor i teorisë së modernizimit, ai sipas të cilit se ekziston një lidhje shkakësore midis zhvillimit socio-ekonomik dhe demokracisë në një vend të caktuar, mund të thuhet se ka qenë një ndër më të studiuarit dhe më të debatuarit në shkencën politike. Diskutimi i argumenteve/kontributeve kryesore teorike brenda teorisë së modernizimit për studimin e demokratizimit, si dhe një vlerësim kritik ndaj këtyre shpjegimeve moderniste nën dritën e evidencës empirike dhe të eksperiencës së demokratizimeve bashkëkohore të vendeve të ndryshme, do të jenë synimi kryesor i këtij artikulli. Kritikën kryesore që i adresohen teorisë së modernizimit këtu kanë

të bëjnë me cilësimin e saj si një qasje ahistorike, teleologjike nga pikëpamja e ndryshimit social që ofron, etnocentrike, si dhe argumentohet se lidhja shkakësore që kjo teori pretendon midis zhvillimit socio-ekonomik dhe demokratizimit të vendeve nuk qëndron.

Fjalë kyç: *Modernizimi, zhvillimi socio-ekonomik, kushte strukturore, tranzicion, demokratizim*

Hyrje

Çfarë e bën të mundur shfaqjen dhe qëndrueshmërinë e regjimeve politike demokratike në vende të ndryshme? Cili është raporti i marrëdhënies midis zhvillimit socio-ekonomik dhe modernizimit të vendeve nga njëra anë, dhe demokracisë nga ana tjetër? Cilat janë kushtet (strukturore) që nevojiten për formësimin dhe qëndrueshmërinë e sistemeve demokratike në vende të ndryshme? Këto janë disa nga pyetjet që shumë studiues të politikës së krahasuar do mundoheshin t'i jepnin përgjigje në analizën dhe shpjegimin e variablit e preferuar të varur: regjimit politik¹ (demokratik). Identifikimi i kushteve të përshtatshme strukturore dhe sociale për shfaqjen e demokracisë, ka qenë një ndër shqetësimet kryesore për autorët brenda qasjes moderniste. Autorë të ndryshëm që kanë kontribuar brenda teorisë së modernizimit kanë theksuar faktorë të ndryshëm strukturore dhe proceset afat-gjata në kohë si kushtet për formësimin dhe qëndrueshmërinë e sistemeve demokratike. Në veçanti, pretendimi kryesor i qasjes modernizuese, ai sipas të cilit se ekziston një lidhje shkakësore midis zhvillimit socio-ekonomik dhe demokracisë në një vend të caktuar, mund të thuhet se ka qenë një ndër më të debatuarit në literaturën e demokratizimit. Diskutimi i argumenteve/kontributeve kryesore teorike që janë zhvilluar ndër autorë të ndryshëm brenda teorisë së modernizimit do të jetë pjesë e seksionit II të këtij punimi. Ndërsa në seksionin III, do të ndërmerret një vlerësim kritik ndaj shpjegimeve moderniste për studimin e proceseve të demokratizimit. Këtu do të argumentohet në lidhje me pamjaftueshmërinë teorike të qasjes së modernizimit për të shpjeguar proceset e demokratizimit, duke e cilësuar atë si një qasje ahistorike, teleologjike nga pikëpamja e ndryshimit social që ofron, së tepërmi etnocentrike, si dhe nën dritën e eksperiencës së demokratizimeve bashkëkohore të vendeve të valës së tretë, kritikohet empirikisht lidhja shkakësore që kjo teori pretendon, ajo midis zhvillimit socio-ekonomik dhe demokratizimit të vendeve.

¹ David Altman & Anibal Perez-Linan (2002), "Assessing the Quality of Democracy: Freedom, Competitiveness and Participation in Eighteen Latin American Countries", fq. 85.

Teoria e Modernizimit

Në fundin e viteve '50 dhe vitet '60, teoria e modernizimit shënonte një prirje dominuese në shkencat politike, në një kohë kur sistemet demokratike ishin më së shumti të vendosura në kuadratin perëndimor të globit dhe kryesisht ndër vendet më të zhvilluara. Tipari thelbësor dallues i qasjes moderniste ishte se ajo e shihte lindjen dhe zhvillimin e sistemeve politike demokratike si produktin e një procesi evolucionar ndryshimi dhe zhvillimi të shoqërive njerëzore. Pra, nën optikën e kësaj qasje, demokratizimi shihej si një derivat i progresit të shoqërive njerëzore që karakterizohej nga një sërë faktorësh të ndryshëm dhe procesesh afatgjata. Theksi këtu vihej tek një sërë kushtesh strukturore dhe shoqërore që ishin të favorshme për formësimin dhe qëndrueshmërinë e sistemeve demokratike. Megjithëse konturet e mendimit modernist datojnë shumë kohë më parë, që nga periudha e Iluminizmit dhe idesë së progresit njerëzor të saj, si dhe tek shkrimet e Max Weber dhe Talcott Parsons me shqetësimin e tyre për t'i ndarë shoqëritë në tradicionale dhe moderne, autori që mund të thuhet se ishte i pari që kodoi qasjen moderniste brenda studimeve të demokratizimit ishte Seymour Martin Lipset me veprën e tij pioniere në këtë fushë "*Some Social Requisites of Democracy: Economic Development and Political Legitimacy*".

Teza e propozuar më së pari nga Lipset, sipas të cilit, ka një marrëdhënie pozitive dhe të favorshme midis zhvillimit socio-ekonomik të një vendi dhe demokracisë, përbën një nga pretendimet kryesore të qasjes moderniste. Kështu, Lipset duke vendosur lidhjen teorike midis këtyre variablave, do të deklaronte se "sa më e madhe mirëqenia e një vendi, aq më të mëdha mundësitë që ai do ta mbështesë demokracinë"². Në këtë mënyrë, theksi që autori vendos në shpjegimin e demokratizimit qëndron në argumentin se sa më të pasur të jenë qytetarët e një vendi, aq më të prirur do jenë ata të përbrendësojnë vlerat dhe normat demokratike, të kundërshtojnë regjimet autoritare që dhunojnë liritë dhe të drejtat e tyre, dhe të mbështesin regjime demokratike në mjediset e tyre. Vetëm në një shoqëri të pasur mund të ekzistojë një situatë, sipas Lipset, në të cilën "masa e popullsisë mund të marri pjesë në mënyrë inteligjente në politikë dhe të zhvillojë vetë-përmbytjen e nevojshme për t'iu shmangur dorëzimit ndaj apeleve të demagogëve të papërgjegjshëm. Një shoqëri e ndarë midis një mase të madhe të varfër dhe një elite të vogël të favorizuar do të rezultonte ose në oligarki... ose në tirani"³.

Kështu, zhvillimi socio-ekonomik sipas Seymour Martin Lipset nënkuptonte një tërësi faktorësh si industrializimi, urbanizimi, pasurimi dhe edukimi, që të gjitha vepronin së bashku në krijimin e kushteve të favorshme për të nxitur

² Seymour Martin Lipset (1959), "*Some Social Requisites of Democracy: Economic Development and Political Legitimacy*", fq. 75.

³ Po aty.

qoftë fillimin e tranzicioneve demokratike në vende me regjime autoritare, qoftë stabilitetin demokratik në ato vende ku demokracia ishte e vendosur. Këtë, autori e shpreh në mënyrë eksplicite kur thotë se “të gjitha aspektet e ndryshme të zhvillimit ekonomik - industrializimi, urbanizimi, pasuria dhe edukimi – janë kaq të ndërlidhura ngushtësisht me njëra-tjetrën sa që të formojnë një faktor kryesor i cili ka lidhjen politike me demokracinë”⁴. Veprimi i këtyre faktorëve së bashku përbën rrugën e modernizimit për ndryshimin social, dhe ku demokratizimi shihet si produkti fundor i këtij procesi ndryshimi. Przeworski dhe Limongi shprehen kështu në lidhje me këtë supozim themelor të qasjes moderniste:

“Modernizimi konsiston në një diferencim gradual dhe specializim të strukturës sociale që kulminon në një ndarje të strukturave politike nga strukturat e tjera dhe e bën demokracinë të mundur. Zinxhiri shkakësor specifik konsiston në sekuenca të industrializimit, urbanizimit, edukimit, komunikimit, mobilizimit, dhe përfshirjes politike, ndërmjet një numri pafund të tjerash: një akumulim progresiv të ndryshimit social që bën gati një shoqëri për të vazhduar në kulminimin e saj, demokratizimin”⁵.

Për këta autorë, modernizimi e manifestonte veten nëpërmjet krijimit të strukturave të përshtatshme që ndryshonin kushtet sociale të një shoqërie, që janë të favorshme për një sistem demokratik. Në këtë mënyrë, autorët që kanë kontribuar brenda qasjes moderniste, e kanë vënë theksin tek proceset e ndryshimit që ndodhin brenda shoqërisë, ato procese evolucionare dhe progresiste që krijojnë kushtet e përshtatshme për kultivimin e vlerave demokratike, mbrojtjen e të drejtave politike të qytetarëve, për krijimin e një sistemi klasor të hapur dhe që në fund çonin në vendosjen e regjimeve demokratike. Demokracia pra, sipas kornizës teorike të qasjes së modernizimit, lulëzon si pasojë e përshtatjes funksionale të saj me shoqëritë industriale të zhvilluara.

Autorë të ndryshëm e kanë lidhur modernizimin dhe proceset e ndryshimit social që e karakterizojnë atë, me lindjen dhe zhvillimin e kapitalizmit. Pra, se një shoqëri moderne, në thelb, është një produkt i kapitalizmit⁶. Nuk është e rastit që ndër autorë të ndryshëm modernistë, pikë fillesë për modernitetin merren pikërisht shoqëritë perëndimore në periudhën e pas Revolucionit Industrial në fund të shek. XVIII dhe përgjatë shek. XIX, kohë në të cilën marrëdhëniet kapitaliste dhe shoqëria e tregut kishin filluar të lulëzonin dhe thelloheshin në këto vende. Sipas Lipset, kapitalizmi ishte zemra e demokracisë sepse ai prodhonte pasuri (të cilën ai, në mënyrë të pa problematizuar, supozonte se do të vërshonte poshtë dhe do të çonte në nivele më të larta të konsumit masiv), çoi në një klasë të mesme të arsimuar dhe prodhoi një numër ndryshimesh kulturore të favorshme për demokracinë, si shekullarizimi i rritur dhe zvogëlimi i identiteteve të dhëna dhe

primordiale⁷. Kështu, sipas autorit në fjalë, ishte zhvillimi kapitalist dhe progresi material që ai prodhonte, ato që krijuan kushtet e përshtatshme për shfaqjen e demokracive. Një mënyrë tjetër se si Lipset bëri lidhjen midis kapitalizmit dhe demokracisë, ishte edhe nëpërmjet zvogëlimit të konfliktit klasor dhe hapjes së sistemit të klasave që bënte të mundur kapitalizmi. Ai do të shprehej se:

“Për shtresën e ulët, zhvillimi ekonomik, i cili nënkupton të ardhura më të larta, siguri ekonomike më të madhe dhe arsimim më të madh, lejon ato në këtë status të zhvillojnë perspektiva më afat-gjata dhe pikëpamje më komplekse dhe gradualiste të politikës. Një besim në gradualizmin reformist shekullar mundet të jetë ideologjia vetëm e një klase të ulët relativisht në mirëqenie. Pasuria dhe arsimimi i rritur gjithashtu i shërbejnë demokracisë duke rritur masën në të cilën shtresa e ulët është e ekspozuar ndaj presioneve të tërthorta, të cilat do të reduktojnë intensitetin e përkushtimit të tyre ndaj ideologjive të caktuara dhe i bën ata më pak receptues në mbështetjen e atyre ekstremiste... Pasuria e rritur nuk është e lidhur vetëm shkakësisht me zhvillimin e demokracisë duke ndryshuar kushtet sociale të punëtorëve, por ajo gjithashtu ndikon rolin politik të klasës së mesme duke ndryshuar formën e strukturës së stratifikimit, duke e zhvendosur atë nga një piramidë të zgjatur me një bazë të gjerë të klasës së ulët, drejt formës së një diamanti me një klasë të mesme të zgjeruar. Një klasë e mesme e madhe luan një rol lehtësues në moderimin e konfliktit përdorues ka mundësi të shpërblejë partitë e moderuara dhe demokratike dhe të penalizojë grupet ekstremiste”⁸.

Një argument të tillë të ngjashëm të ofruar nga Lipset në lidhjen që ekziston midis kapitalizmit, progresit material dhe demokracisë, e kanë ofruar dhe autorë të tjerë. Kështu, Walter Rostow në veprën e tij “*The Stages of Economic Growth: A Non-Communist Manifesto*” do të teorizonte shtegun nga modernizimi ekonomik drejt demokracisë si linear dhe të pashmangshëm⁹. Në këtë vepër, autori identifikon edhe fazat lineare nëpër të cilat kalonin shoqëritë e ndryshme në zhvillimin ekonomik të tyre, faza të cilat në fund çonin në pjekjen e kushteve të nevojshme për demokracinë. Ndërsa autorë si Diamond, Linz dhe Lipset shprehen se, ato regjime që janë “më të avancuara në zhvillimin e tyre kapitalist (madhësia e sektorit të tregut të ekonomisë, autonomia e klasës së tyre sipërmarrëse) janë gjithashtu ato që janë më të ekspozuara ndaj presioneve për demokraci”¹⁰.

⁷ Po aty.

⁸ Seymour Martin Lipset (1959), “*Some Social Requisites of Democracy: Economic Development and Political Legitimacy*”, fq.78.

⁹ Walter W. Rostow (1960), “*The Stages of Economic Growth: A Non-Communist Manifesto*”.

¹⁰ Larry Diamond, Juan Linz, dhe Seymour Martin Lipset, (edt). (1988), “*Democracy in Developing Countries: Africa*”. Cituar në Seymour Martin Lipset (1994), “*The Social Requisites of Democracy Revisited*”, fq. 3.

⁴ Seymour Martin Lipset (1960), “*Political Man. The Social Basis of Politics*”, fq. 41.

⁵ Adam Przeworski & Fernando Limongi (1997), “*Modernization: Theories and Facts*”, fq. 158.

⁶ Jean Grugel (2002), “*Democratization: A Critical Introduction*”, fq. 47.

Një autor tjetër që mund të përmendnim këtu, në ripohimin e tezave moderniste dhe ritheksimin e korrelacionit që ekziston midis zhvillimit ekonomik dhe rritjes së mirëqenies së shoqërive nga njëra anë, dhe demokratizimit të tyre nga ana tjetër, është edhe Samuel P. Huntington. Ndoshta këtu, Huntigtoni ka shkruar edhe më larg se autorë të tjerë modernistë, duke i shtrirë argumentet e qasjes moderniste në rrafsh global, ndër të gjitha vendet dhe rajonet e botës. Ndër faqet e veprës së tij *“Vala e Tretë: Demokratizimi në Fund të Shekullit të Njëzetë”*, autori e konsideron zhvillimin ekonomik të vendeve si një ndër faktorët kryesorë që përcaktoi suksesin e demokratizimeve të valës së tretë. Huntington e shpreh këtë kur vëren se “në një masë të madhe, vala e demokratizimeve që filloi në vitin 1974 ishte produkt i rritjes ekonomike të dy dekadave të mëparshme¹¹. Sipas tij, gjatë një periudhe afatgjatë, zhvillimin ekonomik i vendeve krijoi kushtet për regjimet e tyre demokratike. Autori ofron edhe lidhjet shkakësore që ekzistojnë midis zhvillimit ekonomik dhe demokratizimit kur ofron hipotezat se, së pari, niveli i mirëqenies ekonomike brenda një shoqërie forcon vlerat dhe qëndrimet civike tek qytetarët e saj; së dyti, zhvillimi ekonomik rrit nivelin e arsimit në shoqëri; së treti, zhvillimi ekonomik krijon burime më të mëdha në dispozicion të shpërndarjes së të mirave materiale mes grupeve shoqërore çka lehtëson marrëveshjen dhe kompromisin; së katërti, zhvillimi ekonomik nxit hapjen e shoqërive në tregtinë e jashtme, me prirjet ndërkombëtare dhe idetë demokratike; dhe së fundi, por jo për nga rëndësia, zhvillimi ekonomik nxit zgjerimin e klasës së mesme çka është një faktor kyç dhe forcë e rëndësishme për demokracinë¹². Të gjitha këto, ishin variabla të rëndësishme shpjegues dhe një rikonfirmim i tezave moderniste në versionin global të tyre, çka për Samuel Huntigton ishin kyçe për fillimin e tranzicioneve demokratike dhe për suksesin e tyre gjatë valës së tretë së demokratizimit.

Një Vlerësim Kritik Ndaj Teorisë së Modernizimit

Pretendimi kryesor i teorisë së modernizimit, ai sipas të cilit se ekziston një lidhje shkakësore midis zhvillimit socio-ekonomik dhe demokracisë në një vend të caktuar, mund të thuhet se ka qenë një ndër më të debatuarit dhe të kontestuarit në literaturën e demokratizimit. Po të kontestuarra kanë qenë, edhe përpjekjet që janë bërë brenda kësaj qasjeje për ta teorizuar suksesin e regjimeve demokratike nën rrugën (e fazave) të modernizimit dhe zhvillimit kapitalist të vendeve, ashtu siç kishte ndodhur me shoqëritë e vendeve perëndimore gjatë shek. XVII - XIX. Në këtë seksion, do të argumentohet në lidhje me pamjaftueshmërinë teorike të qasjes së modernizimit për të shpjeguar proceset bashkëkohore të demokratizimit

në vende të ndryshme, si dhe do të ndërmerret një kritikë empirike lidhur me pretendimin e kësaj qasjeje, për ekzistencën e lidhjes shkakësore që qëndron midis zhvillimit socio-ekonomik dhe demokratizimit të vendeve.

Teoria e modernizimit është ahistorike në atë që ajo presupozon se, të gjitha shoqëritë mund të replikojnë një tranzicion i cili ka ndodhur në një moment të veçantë në hapësirë dhe kohë¹³. Qasja e modernizimit është ahistorike, këtu, në atë se ajo injoron së tepërmi trashëgimitë historike dhe mënyrat (rrugët) e ndryshme të zhvillimit të vendeve të veçanta. Këto trashëgimi dhe eksperiencia të ndryshme të zhvillimit të vendeve janë të rëndësishme të merren në konsideratë, pasi ato kanë pasojat e tyre të rëndësishme dhe përcaktojnë edhe trajektoret e ndryshme të transformimeve që këto vende mund të marrin. Për më tepër, mund të thuhet se vetë modelet e zhvillimit të vendeve ndryshojnë shumë midis tyre, dhe mund të kenë fare pak ose aspak ngjashmëri. Kështu p.sh., kritikët e modernizimit kanë sugjeruar se zhvillimi i vonë (ai gjatë shek. XX) ka çuar në fakt në një version malinj të modernitetit të shënuar më tepër nga kapitalizmi autoritar se sa nga demokracia¹⁴. Injorimi i elementëve të veçantë, apo mosnjohja e vështirësive të ndryshme që vendet hasin në zhvillimet e tyre, pra në terma ahistorike, shpesh e zhvlerëson apo e bën të pafuqishme teorinë e modernizimit përballë trajektoreve të ndryshme politike që vendet marrin.

Prej këtu vijmë edhe tek një kritikë tjetër që i bëhet teorisë së modernizimit dhe që lidhet shpesh edhe me presupozimin e nënkuptuar implicit të saj, ai sipas të cilit ekziston një model i vetëm i modernitetit (ose rruga e modernizimit) nëpër të cilin vendet kalojnë. Sipas këtij modeli të ndryshimit social, teoria e modernizimit supozon se shoqëritë kalojnë në zhvillimin e tyre nga shoqëri para-moderne dhe tradicionale, në shoqëri moderne kapitaliste dhe të zhvilluara, dhe ku demokratizimi shihet si produkti fundor logjik i këtij procesi ndryshimi. Këtu kritika ka të bëjë me idenë teologjike të ndryshimit social që kjo teori mbart në vetvete, ku kapitalizmi dhe shoqëria e tregut që ky sistem prodhon, shihen si burim i pashmangshëm për demokracinë. Ashtu si edhe Beetham ka sugjeruar, “ideja se tregu është pashmangshmërisht mbështetës për demokracinë, siç modernizimi presupozon, është e pambështetshme”¹⁵. Një shoqëri tregu mund të jetë mbështetëse për demokracinë po aq sa edhe mund të mos ndikojë fare në llojin e regjimit të një vendi, ashtu siç rastet e Malajzisë, Singaporit, por edhe i Kinës në ditët e sotme na tregojnë.

Në fund, një kritikë tjetër që ka të bëjë me teorinë e modernizimit lidhet me edhe me karakterin etnocentrik të saj. Kështu, për shkak se modernizimi injoron proceset e zhvillimeve të veçanta të botës së tretë dhe është nxjerrë duke u bazuar së

¹³ Jean Grugel (2002), *“Democratization: A Critical Introduction”*, fq. 49.

¹⁴ Cituar në Jean Grugel (2002), *“Democratization: A Critical Introduction”*, fq. 49.

¹⁵ D. Betham (1997), *“Market Forces and Democratic Polity”*. Cituar në Jean Grugel (2002), *“Democratization: A Critical Introduction”*, fq. 49.

¹¹ Samuel P. Huntigton (1991), *“Vala e Tretë: Demokratizimi në Fund të Shekullit të Njëzetë”*, fq. 81.

¹² Po aty, fq. 85-86.

tepërmi mbi eksperiencën e botës (shoqërive të industrializuara) perëndimore si një rregull për të gjithë planetin, teoria e modernizimit është në thelb etnocentrike¹⁶. Sipas kësaj qasje, eksperiencia e vendeve që janë në rrugën të zhvillimit të tyre nga shoqëri tradicionale dhe të prapambetura në shoqëri të zhvilluara, është në thelb e ngjashme me eksperiencat që vendet perëndimore patën kaluar më parë. Kjo do të thotë se konceptet teorike, ashtu si edhe modelet e modernizimit të zhvilluara për ndryshimin social në kontekste të ndryshme kohore dhe hapësinore mund të aplikohen për eksperiencat aktuale pa shumë ndryshime¹⁷. Premisa bazike këtu mbetet po ajo se “shoqëria e tregut demokratike” është e “aplikueshme universalisht”¹⁸.

Nëse teza kryesore e teorisë së modernizimit se ekziston një korrelacion shkakësor midis zhvillimit socio-ekonomik të një vendi dhe vendosjes së demokracisë do të ishte e vërtetë, atëherë ne do të prisnim fillimin e tranzicioneve demokratike në të gjitha ato vende me regjime autoritare që kanë arritur nivele të larta zhvillimi në mjediset e tyre. Sipas kësaj teorie, sekuenca e ngjarjeve që do të prisnim është ai, nga vende autoritare të varfëra që zhvillohen dhe bëhen demokratike kur ato arrijnë nivele të caktuara zhvillimi, një “prag”¹⁹. Pra, kur kemi një nivel të caktuar zhvillimi ekonomik ku modernizimi do ta manifestonte veten në kushte më të mira për shoqërinë në të gjitha elementët e tij - industrializim, pasuri, edukim etj. – atëherë do të ishin dhe gjasat më të mëdha për përmbyshjen e regjimeve autoritare dhe nisjen e tranzicioneve demokratike. Pra, ne mund të prisnim që regjimet demokratike të shfaqeshin në mënyrë të rregullt me nivelet e zhvillimit ekonomik të vendeve, ndërsa e kundërta mund të pritej për vendet e pazhvilluara dhe me një nivel të vogël të ardhurash për frymë. Kështu, p.sh. Samuel P. Huntington pretendonte se gjatë valës së tretë, nga viti 1976 deri në 1990, vendet në zonën me të ardhura të mesme kishin më shumë gjasa të ndërmerrnin një tranzicion drejt demokracisë. Ai shprehej se “sapo vendet zhvillohen ekonomikisht dhe lëvizin në këtë zonë, ato hyjnë në perspektivën e demokratizimit” sipas Huntingtonit²⁰. Gjithsesi, të dhënat tregojnë se pretendimet e teorisë së modernizimit janë teorikisht të cekëta, dhe nga pikëpamja empirike shpesh janë të pavlefshme.

Studime të fundit empirike që janë ndërmarrë për të testuar marrëdhënien midis zhvillimit ekonomik dhe demokracisë, tregojnë nuk ekziston ndonjë lidhje e rëndësishme shkakësore midis tyre. Kështu p.sh., Adam Przeworski, Fernando

Limongi dhe autorë të tjerë në studimet e tyre kanë treguar se demokracitë (nisja e tranzicioneve demokratike, ajo që kemi dalluar konceptualisht si faza e dytë në përkufizimin e procesit të demokratizimit më lart këtu, Kapitulli 1.3) mund të shfaqen në cilindo nivel zhvillimi, ashtu sikundër edhe diktaturat mund të mbijetojnë apo të përmbysen për arsye të ndryshme që nuk kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik apo modernizimin e vendeve. Në këtë mënyrë, Przeworski dhe Limongi janë shprehur duke treguar se:

“Në të vërtetë, diktaturat mbijetuan për vite në vende që ishin të pasura. Cilido qoftë pragu në të cilin zhvillimi (ekonomik) supozohet se gërmon varrin për regjimet autoritare, është e qartë se shumë diktatura ia dolën të mbijetonin në shëndet të mirë. Edhe duke lënë mënjane ato vende që i marrin më shumë se gjysmat e të ardhurave të tyre nga nafta, diktaturat lulëzuan dhe mbijetuan në Singapor, Taiwan...Spanjë, Argjentinë dhe Meksikë për shumë vite pasi këto vende i kishin arritur të ardhurat e tyre me mbi 5000 dollarë për frymë...”²¹.

Po kështu, raste të tjera empirikë në ditët e sotme që tregojnë se tezat e modernizimit janë të pavlefshme dhe se demokracia jo domosdoshmërisht është e lidhur me zhvillimin socio-ekonomik, janë edhe India dhe Bostana. Këto dy vende, në klasifikimet e ndryshme të regjimeve politike, renditen si vende me regjime demokratike madje që kanë qenë edhe të qëndrueshme, edhe pse janë vende që janë të varfëra dhe në pjesën më të madhe të tyre të pazhvillura. Pjesa më e madhe e popullsisë së këtyre vendeve jeton me të ardhura relativisht të ulëta, me një nivel arsimimi të ulët, por kjo nuk e ka penguar demokracinë të mbijetojë në mjediset e tyre. Demokratizimi, pra, mund të fillojë dhe të mbijetojë edhe në shoqëri të pazhvilluara ekonomikisht. Në anën tjetër qëndrojnë dy raste të kundërta, Singapori dhe Malajzia, dy vende të pasura dhe që janë pasuruar në një periudhë afatgjatë, por që ende sot regjimet e tyre nuk klasifikohen si demokraci. Ndër këto vende, por edhe të tjerë që mund të përmenden, Singapori ndoshta përbën rastin ilustrues më kontrastues për t’u përmendur këtu. Kjo për faktin se, ndryshe nga ato vende rentiere që të ardhurat e tyre i nxjerrin duke u bazuar kryesisht tek burimet natyrore që ato zotërojnë dhe ku pasuria përgjithësisht përqendrohet në duart e pak individëve (pra, një proces zhvillimi që nuk përfshin modernizimin e tyre siç presupozon qasja moderniste), Singapori nga ana e tij është një vend që është i zhvilluar në një kohë të gjatë, ka njohur ritme rritjeje ekonomike të larta prej gati pesë dekadash, dhe është një shoqëri me të ardhura të larta. Pra, për Singaporin mund të thuhet se është një vend i modernizuar. Megjithatë, regjimi politik i tij ende në ditët e sotme nuk klasifikohet si demokraci, por si një regjim hibrid ku kombinohen si tipare të demokracisë dhe të autokracisë. E nëse parashikimet e

¹⁶ Jean Grugel (2002), *“Democratization: A Critical Introduction”*, fq. 49.

¹⁷ Paul Blokker (2005), *“Post-Communist Modernization, Transition Studies and Diversity in Europe”*, fq. 4.

¹⁸ Cituar në Paul Blokker (2005), *“Post-Communist Modernization, Transition Studies and Diversity in Europe”*, fq. 4.

¹⁹ Adam Przeworski & Fernando Limongi (1997), *“Modernization: Theories and Facts”*, fq. 158.

²⁰ Samuel P. Huntington (1991), *“Vala e Tretë: Demokratizimi në Fund të Shekullit të Njëzetë”*, fq. 79-82. Vendet që hyjnë në zonën me të ardhura të mesme sipas Huntingtonit, ishin ato vende me një PBB për frymë midis 1000 dhe 3000 dollarë në vit. Për autorë të tjerë, kufiri për ato vende që hyjnë në zonën e vendeve me të ardhura të mesme, është ai i atyre me PBB për frymë midis 4000-6000 dollarë në vit.

²¹ Adam Przeworski & Fernando Limongi (1997), *“Modernization: Theories and Facts”*, fq. 160.

teorisë së modernizimit (që bazohen pikërisht tek korrelacioni që ekziston midis zhvillimi ekonomik dhe demokratizimit) për vendosjen e demokracisë në Singapor, Malajzi apo edhe në Kinën e sotme, nuk kanë munguar ndër autorë të ndryshëm²², parashikimet e tyre kanë rezultuar të pasakta. Ashtu siç edhe Przeworski dhe Limongi e kanë vendosur, “nëse teoria e modernizimit do të kishte ndonjë fuqi parashikuese, duhet të ketë ndonjë nivel të ardhurash në të cilën dikush mund të jetë relativisht i sigurtë se një vend do ta përmbysë diktaturën”²³. E megjithatë në praktikë, siç shembuj të ndryshëm empirikë kanë treguar, demokratizimi i vendeve nuk është i lidhur me nivelin e zhvillimi të ekonomik të tyre, cilido qoftë ai. Kështu, lidhja shkakësore midis zhvillimit socio-ekonomik dhe demokratizimit të vendeve nuk qëndron, po ashtu sikundër janë treguar të jenë të pavlefshme edhe pretendime të tjera të teorisë së modernizimit, si p.sh. ato se tregu dhe kapitalizmi janë pashmangshmërisht mbështetës demokracinë.

Konkluzion

Tipari thelbësor dallues i qasjes së modernizimit është përpjekja e saj për të teorizuar faktin se demokracitë shfaqen si pasojë (derivat) i zhvillimit dhe progresit të shoqërive të ndryshme. Brenda kësaj qasje, autorë të ndryshëm janë përpjekur të theksojnë faktorë të ndryshëm apo komponentët e veçantë të zhvillimit socio-ekonomik (dhe kapitalizmit) të shoqërive, që do krijojnë kushtet e favorshme për demokracinë në mjediset e tyre. Një kritikë kryesore që iu adresuar kësaj qasjeje këtu, kishte të bënte me dimensionin ahistorik dhe një dimension shpesh të nënkuptuar teleologjik që e karakterizojnë atë. Një nga presupozimet implicite kryesore të teorisë së modernizimit është ai sipas të cilit se të gjitha shoqëritë (edhe demokratizimet e tyre) mund të replikojnë një tranzicion i cili ka ndodhur më parë në një moment të veçantë në hapësirë dhe kohë (në botën perëndimore). Qasja e modernizimit injoron së tepërmi trashëgimitë historike dhe mënyrat (rrugët) e ndryshme të zhvillimit të vendeve të veçanta, duke mos njohur kështu edhe vështirësitë apo pasojat e tyre, të cilat janë të rëndësishme për t’u kuptuar pasi kushtëzojnë edhe trajektoret e ndryshme të transformimeve politike të vendeve. Një kritikë këtu u ndërmor edhe ndaj karakterit etnocentrik të qasjes modernizuese, e cila e nënkupton eksperiencën e zhvillimit (rrugën e modernitetit) të shoqërive të prapambetura apo demokracive të reja, si të ngjashme me eksperiencën e zhvillimit që kanë kaluar më parë vendet perëndimore, dhe ku në fund produkti do të jetë po

i njëjtë: “një shoqëri tregu demokratike” e aplikueshme universalisht. Në fund, një kritikë në këtë punim ndaj teorisë së modernizimit u ndërmor edhe në rrafshin empirik, me një sërë shembujsh të regjimeve politike të cilat nuk i përmbushin pritshmëritë / parashikimet e tezave moderniste, madje në mjaft raste edhe i hedhin poshtë ato si të pavlefshme.

Bibliografia

- Altman, David & Perez-Linan, Anibal (2002), *Assessing the Quality of Democracy: Freedom, Competitiveness and Participation in Eighteen Latin American Countries*. Democratization, Vol. 9, No. 2, fq. 85-100.
- Blokker, Paul (2005), *Post-Communist Modernization, Transition Studies and Diversity in Europe*. Stockholm: World Congress of the International Institute of Sociology. E aksesueshme në http://www.swedishcollegium.se/IIS2005/total_webb/tot_html/papers/postcommunist_modernization.pdf [parë për herë të fundit me 7 Dhjetor 2015].
- Grugel, Jean (2002), *Democratization: A Critical Introduction*, London: Palgrave.
- Huntington, Samuel P. (1991), *Vala e Tretë: Demokratizimi në Fund të Shekullit të Njëzetë*, Tiranë: Instituti i Studimeve Ndërkombëtare (2011 botimi në shqip).
- Inglehart, Ronald & Welzel, Christian (1997), *Modernization, Cultural Change and Democracy: The Human Development Sequence*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Lipset, Seymour Martin (1959), *Some Social Requisites of Democracy: Economic Development and Political Legitimacy*. American Political Science Review, Vol. 53, No. 1, fq. 69-105.
- Lipset, Seymour Martin (1960), *Political Man. The Social Bases of Politics*. New York: Doubleday.
- Lipset, Seymour Martin (1994), *The Social Requisites of Democracy Revisited: 1993 Presidential Address*. American Sociological Review, Vol. 59, No. 1, fq. 1-22.
- Przeworski, Adam & Limongi, Fernando Limongi (1997), *Modernization: Theories and Facts*. World Politics, Vol. 49, No. 2, fq. 155-183.
- Rostow, Walter (1960), *The Stages of Economic Growth: A Non-Communist Manifesto*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Shin, Doh Chull (1994), *On the Third Wave of Democratization: A Synthesis and Evaluation of Recent Theory and Research*. World Politics, Vol. 47, No. 1, fq. 135-170.
- Wucherpfennig, Julian & Deustch, Franziska (2009), *Modernization and Democracy: Theories and Evidence Revisited*. Living Reviews on Democracy, Vol. 1. E aksesueshme në http://www.cis.ethz.ch/content/dam/ethz/special-interest/gess/cis/cis-dam/CIS_DAM_2015/WorkingPapers/Living_Reviews_Democracy/Wucherpfennig%20Deutsch.pdf [parë për herë të fundit me 7 Dhjetor 2015].

²² Shih psh. në Samuel P. Huntington (1991), *Vala e Tretë: Demokratizimi në Fund të Shekullit të Njëzetë*, fq. 339; Ronald Inglehart & Christian Welzel (1997), *Modernization, Cultural Change and Democracy: The Human Development Sequence*, fq. 161, 190-191; dhe Adam Przeworski & Fernando Limongi (1997), *Modernization: Theories and Facts*, fq. 158-163.

²³ Adam Przeworski & Fernando Limongi (1997), *Modernization: Theories and Facts*, fq. 163.

Roli i muslimanëve në ndërtimin e ndërgjegjes kombëtare shqiptare

(Fundshekulli XIX-Fillimshekulli XX)

Dokt. Lulzim Hoxha

Abstrakt

Në këtë punim do të përpiqem të vërtetoj hipotezën se ndërgjegjia kombëtare shqiptare ishte një konstrukt i farkëtuar nga elitat toske të administratës Osmane, të cilët në fundshekullin XIX dhe fillim shekullin e XX ishin tepër aktiv për të promovuar idetë dhe interesat e tyre si në aktivitetin politik ashtu edhe në fushën e kulturës. Në këtë kuptim, është e pamundur të flitet për ndërgjegjen kombëtare shqiptare pa pasur parasysh rolin që kanë pasur politikanët shqiptar në Perandorinë Osmane në promovimin e nacionalizmit shqiptar. Pyetjet kërkimore në këtë punim do të jenë: Cili ishte roli i elitave toske në administratën osmane në përhapjen e sensit të përkatësisë tek shqiptarët? Si dhe: çfarë impakti pati ligjërimi orientalist në një shoqëri me shumicë myslimane që për më shumë se katër shekuj ishte pjesë e një perandorie myslimane si Osmanët? Pyetje të tilla do të analizohen duke u bazuar në qasjen konstruktiviste dhe konkretisht mbi gjenealogjinë e ligjërimit orientalist në Shqipëri. Në këtë punim do të përdoren metodat cilësore duke u fokusuar kryesisht në analizën e ligjërimit të politikanëve shqiptar të Perandorisë Osmane, të cilët pas pavarësisë u kthyen në simbole të nacionalizmit shqiptar.

Hyrje

Vitet e fundit, në vazhdim të debatit rreth çështjes së identitetit, pjesa dërrmuese e qasjeve janë prirur të provojnë përkatësinë perëndimore të identitetit të shqiptarëve. Duke e trajtuar identitetin si një koncept të pandryshueshëm në kohë dhe hapësirë, këto qasje kryesisht kanë përshkruar të përbashkëtën brenda identitetit dhe jo diferencën, ndërkohë që sipas qasjes konstruktiviste që do të përdoret në këtë

punim, identiteti krijohet nëpërmjet një konstrukti, çka nënkupton një diferencë fillestare mes vetes dhe tjetrit. Në këtë punim do të përdoren teoritë bashkëkohore të nacionalizmit dhe identitetit me autorë të tillë si Hobsbaum, Gellner, Clayer, të cilët e konceptojnë kombin dhe ndërgjegjen kombëtare si një konstrukt të modernitetit. Nëpërmjet kësaj qasjeje do të përpiqem të vërtetoj hipotezën se ndërgjegjia kombëtare shqiptare ishte një konstrukt i farkëtuar nga elitat toske të administratës Osmane, të cilët në fundshekullin XIX dhe fillim shekullin e XX ishin tepër aktiv për të promovuar idetë dhe interesat e tyre si në aktivitetin politik ashtu edhe në fushën e kulturës. Në këtë kuptim, është e pamundur të flitet për ndërgjegjen kombëtare shqiptare pa pasur parasysh rolin që kanë pasur politikanët shqiptar në Perandorinë Osmane në promovimin e nacionalizmit shqiptar. Pyetjet kërkimore në këtë punim do të jenë: Cili ishte roli i elitave toske në administratën osmane në përhapjen e sensit të përkatësisë tek shqiptarët? Si dhe: çfarë impakti pati ligjërimi orientalist në një shoqëri me shumicë myslimane që për më shumë se katër shekuj ishte pjesë e një perandorie myslimane si Osmanët? Pyetje të tilla do të analizohen duke u bazuar në qasjen konstruktiviste dhe konkretisht mbi gjenealogjinë e ligjërimit orientalist në Shqipëri. Në këtë punim do të përdoren metodat cilësore duke u fokusuar kryesisht në analizën e ligjërimit të politikanëve shqiptar të perandorisë Osmane, të cilët pas pavarësisë u kthyen në simbole të nacionalizmit shqiptar. Nëpërmjet këtij punimi do të evidentohet roli i intelektualëve të Rilindjes në fabrikimin dhe përfytyrimin e idesë së kombit dhe ndërgjegjes kombëtare, gjithashtu edhe tiparet e veçanta të modernitetit shqiptar në kontekstin e periudhës së Tanzimatit.

Ligjërimi Orientalist i Nacionalizmit Shqiptar

Duke bërë pjesë për pothuajse 500 vjet në Perandorinë Osmane dhe qysh prej të paktën 300 vjet me një popullsi mbizotëruese myslimane nuk mund të ndodhte që Shqipëria, më shumë akoma se të gjitha vendet ballkanike, mos t'i nënshtrohej ndikimit kulturor turko-oriental që u shtri jo vetëm tek gjuha dhe kultura material, por edhe duke mbujtur krijimtarinë letrare të shqiptarëve dhe bëri që të lindë një letërsi e rregullt shqipe (Bartl Peter: 2006, f.160). Për të dëshmuar ndikimin e gjuhës turke tek shqiptarët, historiani Peter Bartl duke cituar gjuhëtarin Gustav Meyer shkruan se “nga 5140 fjalë kryesore, rreth 1180 ishin me prejardhje turke” (Ibid). Ky aspekt nuk vihet re vetëm tek pjesa myslimane e shqiptarëve, por edhe tek pjesa katolike ndonëse në një nivel më të kufizuar, vihet re një ndikim i rëndësishëm i orientalizmeve gjuhësore. Kështu për shembull Lok Limthi duke hulumtuar mbi veprën më të njohur të Gjergj Fishtës “Lahuta e Malcis” rezultoi se në këtë libër janë përdorur 364 turqizma (Limthi:1961, Shtejzat 5, 86-92). Për të treguar ndikimin

e osmanishtes edhe në Shqipërinë pas pavarësisë, Eqrem Bej Vlora pohon se “Të gjitha veprimet nëpër zyrat e kadastrës deri në vitin 1920 janë kryer po në gjuhën osmane” (Vlora E, Dosja A-VII-5, 55). Një tregues që dëshmon se osmanishtja ka mbetur një gjuhë komunikimi mes intelektualëve shqiptarë deri në fillim të viteve 40’ janë disa letra të shkruara osmanisht që intelektualë shqiptar i kanë dërguar Eqrem Bej Vlorës (Egro: 2007, 58). Revistat katolike të urdhrit Françeskan “Hylli i Dritës” dhe “Leka” kishin prirje të vinin theksin vetëm tek aspektet negative të shtetit osman duke evidentuar përplasjen që Krishtërimi katolik dhe Islami patën në tokat shqiptare (Po aty, 71).

Përplasje mes katolikëve dhe myslimanëve në periudhën pas pavarësisë u paraqit si përplasje midis atyre që kërkonin të shkonin drejt “Europës” dhe atyre që preferonin të qëndronin në orientin statik e të prapambetur. Një prej intelektualëve më të njohur të nacionalizmit shqiptar gjatë periudhës midis dy luftërave ishte Branko Merxhani. Në lidhje me dallimin e Perëndimit nga Lindja, ai shpjegonte se “Zhvillimi i perëndimit dhe dallimi i tij nga lindja filloi me urbanizimin në Europë, sepse rritja e dendësisë së popullatës së qyteteve çoi në rritjen e specializimit të ndarjes së punës. Me kohë, Perëndimi e kapërceu mesjetën dhe hyri në epokën moderne, kurse Lindja mbeti në këtë etapë historike deri vonë” (Merxhani B: 2003, 149-151). Më pas ai shton se “Jemi të shtrënguar me dashje e pa dashje të ecim për në oksident” (Po aty, 237). Ashtu sikurse kronikanët perëndimorë dhe autorët e krishterë u referoheshin Osmanëve si “turq” meqenëse identiteti etnik - sikurse është thënë më sipër - në Europë kishte prioritet, edhe tek katolikët shqiptarë pas pavarësisë përdorej fjala “turk” për të nënkuptuar prapambetjen dhe pushtimin e dhunshëm Osman. Perceptimi i Perandorisë Osmane si “turq” synonte shmangien e lidhjeve me formacionin multi-etnik, pjesë e të cilëve ishin edhe vetë katolikët shqiptarë. Shpeshherë historiografia shqiptare e pas pavarësisë prirët ta shohë periudhën e Perandorisë Osmane duke u nisur nga konteksti i sotëm dhe duke mos i kushtuar rëndësi faktit se kemi të bëjmë me një Perandori e cila për nga organizimi shoqëror, identiteti lokal, pushteti qendror dhe modeli ekonomik nuk kanë fare lidhje me shtetet-kombe si Turqia apo Shqipëria. Po ta shohim ngjarjen për kontekstin e periudhës historike në fjalë do vërehej se “Ngaqë nocioni ‘kombësi’ nuk ekzistonte në konceptin shtetëror Osman, u arrit që shteti Osman të qëndronte mbi komunitetet e ndara të princave feudale” (Egro: 2007, 136). Mungesa e homogjenitetit kulturor, politik dhe gjuhësor në Shqipëri deri në fillimet e shekullit të njëzetë lidhet me mungesën e modernitetit në periudhën e Perandorisë Osmane duke i qëndruar strikte linjës së “Mënyrës Aziatike të Prodhimit” e cila me sa duket ishte një koncept që mbështetej në periudhën e Komunizmit sikurse na tregon libri i Petrika Thëngjillit “Renta feudale dhe evoluimi i saj në viset shqiptare në shekujt XVII-XVIII”. Madje historian Sami Pulaha shkon edhe më tej kur shkruan se “Një faktor i parë politik, që ndikoi në përhapjen e fesë Islame ishte

kolonizimi, duke vendosur familje të tëra në zona të ndryshme të Shqipërisë” (Pulaha S: 1978, f.50). Me sa duket, ashtu sikurse tradita historike përpara vitit 1945, shkëputja nga e kaluara Osmane do të vendosej në qendër të studimeve komuniste, por ndryshe nga studimet e para Luftës së parë Botërore që kishin si synim ta afronin shtetin shqiptar drejt perëndimit, në rastin e sistemit komunist synohej që e shkuara Osmane të paraqitej si faktor stanjacioni i vendit. Një pjesë të mirë të stereotipeve mbi orientin, të krijuara në periudhën romantiko-nacionale dhe atë komuniste i kritikon Isa Blumi në librin e tij “Reinstating the Ottomans” i cili na jep një perspektivë krejt të ndryshme në lidhje me periudhën e sundimit Osman në Shqipëri, veçanërisht në shekujt XIX- XX. Ai argumenton se (Blumi:2011, f. 9) ndryshe nga sa mendohet në historiografinë shqiptare pas pavarësisë, “Ismail Bej Vlora nuk do të ulej i vetëm në Ballkonin e një historie moderne të shqiptarëve. Ai do ta ndante unitetin e së shkuarës së Ballkanit perëndimor me shumë të tjerë, me të cilët bashkë ndanin të shkuarën e tyre Otomane.” Autori flet për një histori alternative të modernitetit shqiptar, çka pasqyron vështirësitë që paraqiten në përkufizimin e modernitetit si dhe shumësitë e llojeve të ndryshme të tij. Historiografia e pas pavarësisë na ka prezantuar me figurën e Ismail Qemalit si një ndër figurat qendrore të “kombit shqiptar”, ndërkohë që Ismail Qemali si politikan është evidentuar në administratën Otomane, ashtu sikurse pjesa dërrmuese e figurave të politikës shqiptare në fillimin e shekullit të njëzetë. Përkundër analizës klasike që i bëhet periudhës së Perandorisë osmane, në të cilën simplifikohet ndjeshëm mënyra e organizimit dhe thyerjet e shumta që kanë ndodhur në më shumë se katër shekuj histori, në fakt Perandoria Osmane ka qenë një shoqëri tepër komplekse, të karakterizuar nga ndryshime të vazhdueshme politikash shtetërore dhe njësisht territoriale. Tek “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhet? “Sami Frashëri duke qëndruar në të njëjtën linjë shkruan se “Nën sundimin turk shqiptarët morën një pozitë të parapëlqyer, shumë prej tyre patën poste të larta në ushtri dhe në administratën perandorake. “Ndryshe nga tezat e periudhës romantiko-nacionaliste ku prirjet orientaliste kundrejt shtetit Otoman janë të qarta, Samiu thekson se gjatë shekujve, arnautët dhe osmanët shkonin mirë me njëri-tjetrin. Sepse ato që donin arnautët: pasurinë, respektin, armët, kuajt, prenë si dhe lirinë e tyre të domosdoshme, ato i gjenin tek turqit; dhe ato që kërkonin turqit; trimërinë, besnikërinë, përbuzjen e vdekjes i gjenin tek shqiptarët” (Frashëri: 1962, f.12). Po kështu, Eqrem Bej Vlora thekson se “Asnjë shqiptar, me përjashtim të disa kokave të ndezura, që nuk njohin, janë pa përvojë për gjendjen e vërtetë në vend, nuk ëndërron për një Shqipëri të pavarur. (Eqrem Bej Vlora tek “Myslimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare, 2006). Ndryshe nga versionin nacional-romantik ku thuhet se revoltat e viteve 1905-1907 të shqiptarëve të Perandorisë ishin revolta për pavarësi kombëtare, Pater Bartl shkruan se “Kryengritjet e viteve 1905-1907 ishin revolta lokale me synime lokale – ruajtja e

privilegjeve, protesta kundër futjes së taksave e detyrimeve të tjera dhe kundër arbitraritetit të nëpunësve turq” (Po aty, f.86). Në kryengritjet e vitit 1908 duke iu referuar një fotografie të kohës ku paraqiten disa kryengritës të veshur në mënyrë të ndryshme nga njeri-tjetri, me kostume kombëtare të vendeve të ndryshme, del në konkluzionin se “këta njerëz nuk po festonin rënien e sulltanit me synim për të ngritur kauzën e kombit shqiptar. Në të vërtetë, në verë të vitit 1908 ishte themelimi i një regjimi tëri Otoman dhe ishte pikërisht kjo ngjarje që i bëri këta njerëz të mbledhjen së bashku. Me fjalë të tjera: reformimi i Perandorisë për këta burra ishte diçka thelbësore” (Blumi: 2011, f.13). Po të bazohemi në argumentin nacional-romantik, do të mund të thonim se revoltat lokale në periudhën e Perandorisë Osmane kishin aspirata kombëtare dhe ishin këto revolta që sollën lindjen e kombit shqiptar. Nëse e shohim nga konteksti i sotëm modern, ky lloj argument mund të bëjë kuptim, por nëse kthehemi në retrospektivë në kontekstin e vendit ku kanë ndodhur këto ngjarje, kryengritjet e Mirditës dhe ato të jugut të Shqipërisë vështirë se mund të themi se kishin mbujtur të njëjtën ndërgjegje kombëtare brenda një komuniteti aq heterogjen. Nëse do të prireshim që ta shohim periudhën e Perandorisë osmane në optikën e periudhës pas pavarësisë do dilnim në përfundimin se meqenëse një pjesë e mirë e administratës Otomane përbëhej nga shqiptarë Toskë, ndërsa kryengritjet e vitit 1908 kryesisht ishin ngjarje që ndodhën në pjesën Gegë, atëherë shqiptarët po luftonin me njëri-tjetrin. Por nëse do i referoheshim kontekstit të kohës, duke qenë se kemi të bëjmë me një Perandori të organizuar me një strukturë krejt të ndryshme nga shtet-kombi modern, automatikisht etiketimi i tyre në terma kombëtar nuk do na ndihmonte të shpjegojmë asgjë. Për sa i përket periudhës së shekujve XVIII-XIX e cila konsiderohet si epoka ku i ka fillesat moderniteti dhe forcimi i ndikimit shtetëror në gjithë territorin e vendit, diçka e ngjashme mund të gjejmë edhe në rastin e Perandorisë Osmane në kohën e reformave të Tanzimatit (1839-1876). Gjatë kësaj kohe, Shteti Otoman synonte zgjerimin e autoritetit shtetëror në gjithë territorin e vendit, midis të tjerash edhe në zonën e Gegnisë. Si rrjedhojë e kësaj, do të ishin burokratët Toskë që promovuan rritjen e autoritetit shtetëror në zonat Gegë, çka do të sillte implementimin e disa politikave të cilat në kontekstin e sotëm do të konsideroheshin si raciste (Blumi: 2011, f.37). Shumica e elitës Toskë që qeveriste Perandorinë mendonin se komunitetet malësore të veriut nuk ishin veçse njerëz të egër që duhet të civilizoheshin (Blumi, po aty, f.17). Në kohën e Tanzimatit, komunitetet lokale të veriut të qeverisura deri asokohe nga Bajraktarët, do të sakrifkoheshin për një shtet më të centralizuar. Prezumimet e periudhës modern sipas të cilës turqit ishin uzurpues të një shoqërie të krishterë para-ekzistuese dhe i shtypi retorikat nacionaliste të këtij komuniteti, nuk janë veçse argument esencialiste të një komuniteti kombëtar primordial. Kombi primordial nuk është veçse sajësë e nacional-romantizmit të fillimit të shekullit të njëzetë, dhe më pas u

amplifikua më tej nga regjimi Nacional-komunist i Enver Hoxhës. Ky argument duket se përjashton ekzistencën e momenteve alternative të modernitetit gjatë periudhës kur shqiptarët ishin pjesë e shtetit Otoman. Në këtë drejtim, një ndër figurat më interesante të kombëtarizuara dhe të orientizuara ishte padyshim figura e Ali Pashës, guvernatorit të Sanxhakut të Janinës, i cili njihet rëndom si një ndër personalitetet që luftoi Sulltanin për hir të pavarësisë së shqiptarëve. Në vitin 1787 qeveria Otomane e emëroi Ali Pashën guvernator të sanxhakut të Janinës. Gjatë kësaj kohe ai shtypi kryengritje të shumta lokale si ajo e Mahmut Pashë Bushtatit në Shkodër apo kryengritje të tjera të “banditëve” lokal. Gjatë kësaj periudhe shteti Otoman qeverisej nga një bashkëpunim midis qeverisjes qendrore dhe ajanëve lokalë të cilët ishin përgjegjës për rajone të caktuara. Isa Blumi shkruan se gjatë luftës së Perandorisë me fuqitë e mëdha, Ali Pasha ishte një ndër personat më të pushtetshëm që luftonin në krah të sulltanit. Megjithatë, gjatë kohës së rritjes së influencës britanike, ruse dhe franceze ai u përpoq ta fuqizonte pushtetin e tij duke përkrahur herë Perandorinë herë fuqitë e mëdha. Ajo çka është karakteristike e kësaj periudhe është se Ali Pasha synonte të krijonte një shtet të madh brenda shtetit Otoman dhe ai nuk militonte për separatizëm politik, por në të vërtetë synonte të zinte një pozicion sa më komod në administratën Otomane ende të paprekur nga reformat centralizuese të Tanzimatit (Blumi: 2011, f.69). Nëse i shohim nga perspektiva e sotme do të thonim se ai kishte një identitet të fortë kombëtar (Shqiptar i jugut/Tosk) apo fetar (Bektashi). Mirëpo pyetja që vlen të ngrihet është: a ishte veprimtaria e Ali Pashës e motivuar nga nacionalizmi Tosk apo ai Bektashi? Nga ana tjetër, parë nga perspektiva e sotme do të ishte i pakuptimtë kontributi i Toskëve të Shqipërisë në luftën për pavarësi të shtetit grek (Xoxi: 1991, 134). Në këtë kuptim, separatizmi grek lëvroi tek shqiptarët një përzierje të ligjëtimeve nacionaliste dhe orientaliste të fokusuar kryesisht tek anti-islamizmi dhe përqaftimi i besimit fetar të Krishterë.

Një modernitet provizor

Në kohën e reformave të Tanzimatit, periudhë të cilën isa Blumi e konsideron si një “Modernitet provizor” (Blumi, 2011, 72), ndër tiparet më të rëndësishme për t’u evidentuar ishte transferimi i pushtetit nga Sulltani tek burokracia e Perandorisë, të njohur si Porta e Lartë. Kjo mundësoi një ndryshim të rëndësishëm në hierarkinë e perandorisë, ku pjesa kryesore e pushtetit do të ishte në duart e elitës së re burokratike, tipar i cili sipas Hobsbawm përbën një ndër elementet më të rëndësishme të shtetit modern (Hobsbawm: 2012, f.48). Po kështu, gjatë kësaj periudhe mund të identifikojmë edhe të tjera elemente të modernitetit si: forcimin e autoritetit qendror dhe kontrollin e shtetit në gjithë territorin si dhe

rënien e pushtetit të atyre që në botën perëndimore do quheshin “feudalët lokal”, ekuivalentët e të cilëve në perandorinë Osmane ishin *ajanët*.

Ngritja në këmbë e një rrjeti arsimor modern, si edhe rritja dhe centralizimi i administratës kishin qenë objektivat madhore të autoriteteve osmane që prej kohës së Tanzimatit. Shtirja e rrjetit shkollor dhe e burokracisë, po ashtu edhe zhvillimi i rrjetit të telegrafit, rrjetit rrugor, rrjetit hekurudhor, ekipeve të regjistrimeve ose rrjeti i informatorëve kishin ndihmuar në shtimin e kontaktit midis shtetit dhe shoqërisë (Clayer: 2009, 310). Por ky modernitet provizor nuk qëndronte i izoluar por ai ishte vazhdimisht në ndërveprim me vendet e tjera perëndimore. “Në kohën e Tanzimatit, rrjeti i ri që imitonte sistemin perëndimor, mendohej si një sistem arsimor për të gjithë subjektet e perandorisë” (Georgon Francois: 1995). Nathalie Clayer shpjegon se periudha e Tanzimatit e cila u karakterizua nga disa elemente të modernitetit Europian në fakt kishte si funksion rezistencën ndaj influencës së perëndimit në shtetin Osman. Me fjalë të tjera, reformat e Tanzimatit pavarësisht se mbartnin aspekte të modernitetit Europian, u implementuan si kundërvënie nda këtij të fundit duke manifestuar disa aspekte që nuk mund t’i gjejmë në modernitetin perëndimor. Kësisoj duket se teoria e moderniteteve të shumëfishta i përgjigjet deri diku zhvillimeve të kësaj periudhe, por ama ajo nuk është në gjendje të na thotë arsyen pse moderniteti ndryshon në bazë të kontekstit ku ai vendoset. Siç ka treguar Benjamin Fortna, rrjeti shkollor dhe masivizimi i arsimit në fakt “ndihmonin për t’iu kundërpërgjigjur ‘kërcënimit’ të misionarëve të Krishterë (siç ishte për shembull ndikimi i misionarëve Françeskanë në very të Shqipërisë), propagandës së vendeve fqinje si dhe aktiviteteve të ‘minoriteteve’. Kurset u ndryshuan dhe theksi u vu mbi disiplinën në shoqëri, besnikërinë ndaj Sulltanit, dhe mbi vlerën dhe parimet fetare” (Fortna Benjamin: 2002). Dërgimi i predikuesve, ndërtimi i xhamive dhe fondacioneve shkollore shkonin të gjitha në të njëjtin hap. Këto veprime synonin forcimin e patriotizmit Osman dhe të bindjeve fetare (islamike) (Clayer: 2009, 312). Nga këto të dhëna del se gjatë kësaj kohe Perandoria Osmane po përpiqej të instalonte një lloj homogjenizimi në të gjithë territorin e vendi, gjë që do të kulmonte me lindjen e një kombi Osman ku të gjithë do të flisnin një gjuhë të përbashkët dhe të gjithë qytetarët do të qeveriseshin nga administrata e re Osmane. Carter Finley ka përshkruar mekanizmat dhe rrjedhojat kryesore të këtij plani në rrafshin shoqëror: Kalimi nga shërbimi i skribëve që funksiononte mbi një model esnafor dhe patriarkal në një administratë, e cila teorikisht ishte e organizuar sipas një sistemi racional dhe e mbështetur në ligje të shkruara; rritja e konsiderueshme e kësaj administrate gjatë procesit të centralizimit, për shkak të forcimit të rrjetit administrative në të gjitha shkallët e tij; ndarja e funksioneve; një shumëllojshmëri e profileve dhe e horizonteve kulturore të funksionarëve (Carter Findley tek Clayer: 2009, po aty). Këto strategji politike pasqyrojnë njëkohësisht reduktimin e pushtetit lokal të *ajanëve* dhe forcimin e

centralizimit të një qeverisjeje moderne. Sikurse kam shkruar më sipër, për të kuptuar modernitetin nuk është e mjaftueshme që të hulumtojmë një kontekst politik dhe shoqëror të caktuar duke e interpretuar konceptin e modernitetit si një fenomen që merr formë në një “ishull” të izoluar. Në fakt kur flasim për mënyrën se si moderniteti merr formë në një shoqëri të caktuar, duhet të kemi parasysh edhe ndërveprimin e kësaj shoqërie me vendet e tjera fqinje. Thënë ndryshe: koncepti i modernitetit në këtë punim është interpretuar sipas qasjes së ndërveprimit simbolik, përmes së cilës reformat dhe zhvillimet politike dhe shoqërore të kësaj periudhe duhet t’i shohim si kundërvënie apo si rezistencë kundrejt forcave të jashtme që perceptohen si “kërcënues” të status-kuosë ose formacioneve politike të periudhës para-moderne. Duke iu referuar politikave identitare që shpalosen me rritjen e ndërveprimit të kulturave të ndryshme dhe raporteve të forcave që janë gjithnjë në ndryshim e sipër, do të kemi një pamje më të qartë mbi format e ndryshme që merr moderniteti në kontekste të ndryshme ku ai vendoset. Në këtë drejtim, zhvillimet e Perandorisë më të madhe orientale të kësaj periudhe na bëjnë të kuptojmë se strategjia politike e administratës Osmane gjatë kësaj kohe po perëndimorizohej, por nga ana tjetër mënyra se si këto strategji politike implementoheshin në shoqëri kishte një formë krejt të ndryshme nga perëndimi. Është e vërtetë se konflikti i Ali Pashës me Sulltanin të kujton konfliktet e borgjezisë me aristokracitë Europiane që kulmuan me revolucionet borgjeze të shekulli të tetëmbëdhjetë, megjithatë ndryshe nga borgjezia e trashëguar europiane që me kalimin e kohës u kthye në balancues të pushtetit të mbretit, *ajanët* si Ali Pasha apo Mehmet Aliu dhe pushteti që ato morën nuk binte në kundërshti me pushtetin e Sulltanit, përkundrazi ata ishin përgjegjës për ruajtjen e legjitimitetit të tij në lokalitetet ku qeverisnin. Ardhja e këtij moderniteti provizor argumentohet sipas Isa Blumit me dy ngjarje kryesore: Së pari për shkak të dështimit në implementimin e politikave shtetërore nga ana e patriarkëve lokal, jo për shkak të rezistencave me sfond nacionalist të këtyre të fundit, por për arsye sepse ata ishin fokusuar më së tepërmi në rritjen e avantazheve dhe të pushtetit të tyre politik në rajonet ku ishin vendosur. Ndërsa faktori i dytë ishin luftërat e Perandorisë me fuqitë e mëdha, sidomos lufta me Rusinë e cila përfundoi me humbjen e Krimesë e cila deri në atë kohë kishte qenë nën administrimin e Perandorisë. Gjatë këtyre luftërave u shfaqën limitet ushtarake të shtetit Osman, gjë që solli në rritjen e influencës perëndimore në territoret e Perandorisë. Ishte pikërisht rritja e influencës perëndimore që u shoqërua me kultivimin e ndërgjegjes kombëtare tek minoritetet e Krishtera të Perandorisë. Influenca e huaj ndikoi në forcimin e dallimeve burokratike midis të Krishterëve dhe Myslimanëve. Me fjalë të tjera: Nga njëra anë politikat e Perandorisë synonin centralizimin e shtetit, fshirjen e diferencave sektare dhe forcimin e ligjit, kurse nga ana tjetër vendet Europiane po shfrytëzonin influencën e tyre duke i promovuar më tej diferencat ekzistuese. Ligjërimi

nëpërmjet të cilit fuqitë perëndimore synonin politizimin e diferencave ekzistuese ishte ai i zbulimit të “rrënjëve natyrore” të komuniteteve fetare në emër të të cilave duhet të luftonin për shpëputjen nga një Perandori etnikisht dhe kulturalisht heterogjene (Blumi: 2011, 103). Kësisoj shtetet Europiane në politikën e jashtme u shpallën si mbrojtës të grupeve të Krishtera brenda Perandorisë të cilat duhet ta harronin të shkuarën e tyre disa-shekullore në këtë shoqëri multi-fetare. Në lidhje me këtë çështje, studiuesi Ussama Makdisi do të shkruante se “Të kushtëzuara nga rrethanat e kohës, elitat lokale do të hynin në aleancë me fuqitë Europiane duke artikuluar një ligjërim progresi dhe civilizimi” (Makdisi: 2000, f. 92). Ky lloj ligjërimi mbi ‘civilizimin dhe progresin’ është në koherencë me orientalizmin, si farkëtimin e një ndërgjegjeje false mbi Tjetritin e pa civilizuar e të prapambetur. Ishte pikërisht ky lloj ligjërimi që në fazat e mëtejshme u “ngjyros” me nuancat nacionaliste në periudhën e Rilindjes kombëtare. Nga ana tjetër, ishin prirjet separatiste të kohës të mishëruara në figurën e botës së civilizuar të Krishterë që do të sillnin centralizimin e shtetit Osman në kohë e reformave të Tanzimatit si rezistencë kundrejt ligjëritimit nationalist dhe orientalist të minoriteteve. Është e rëndësishme që në mbyllje të kësaj pjese të theksohet se figura të rëndësishme të nacionalizmit shqiptar si Bushatllinjtë e Shkodrës, Ali Pasha, Skënderbeu apo Mehmet Aliu ashtu sikurse figura të nacionalizmit serb të tilla si Obrenovici, në kontekstin e tyre nuk synonin zgjerimin e vendit të tyre përtej rajoneve ku ata qeverisnin. Isa Blumi na kujton se “atdheu” i Skënderbeut nuk shtrihej deri në Tivar apo në Prevezë, teksa Ali Pasha bashkëpunoi me elitat e Peloponezit në sulmin e tij kundër Gegëve të veriut të Shqipërisë në përputhje me politikën e Sulltanit (Blumi: 2011, 106). Ndryshe nga pikëpamjet klasike sipas të cilës ishte ndërgjegjja kombëtare shqiptare që solli si rezultat luftën e vazhdueshme për hapjen e shkollave shqipe, mund të thuhet se në të vërtetë hapja e këtyre shkollave ishte në vazhdimësi të rritjes së influencës së fuqive Europiane në Perandorinë Osmane. Në këtë drejtim, mund të shohim se si dialektika mes rritjes së centralizimit të aparatit shtetëror gjatë periudhës së Tanzimatit dhe rezistencës së brendshme të intelektualëve në rajone të ndryshme të Perandorisë solli si rezultat një elitë të shkolluar nëpër shkollat e Stambollit dhe të Janinës, që do t’i bënte rezistencë arsimimit masiv që po promovonte administrata e re Osmane.

Konkluzione

Në këtë punim jam përpjekur të analizoj mënyrën dhe format e ndryshme të etiketimit të “Tjetrit” në kontekstin e një periudhe në transformim e sipër siç ishte fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit të XX që kulmoi me krijimin e shtetit modern shqiptar. Në këtë drejtim, kam përshkruar mënyrën se si iluminizmi dhe

moderniteti perëndimor kanë pasur një ndikim tepër të rëndësishme edhe në një perandori orientale si perandoria osmane. Reformat e Tanzimatit dhe revolucioni xhonturk janë versionet orientale të modernitetit evropian që e ka origjinën që nga koha e revolucionit francez. Edhe vetë ligjërimi orientalist i elitave toske mbart në vete elemente tipike të orientalizmit evropian të periudhës së modernitetit. Nisur nga këto elemente si dhe nga të dhënat empirike që kam mbledhur, mund të konkluzohet se identiteti shqiptar nuk duhet përkufizuar detyrimisht si perëndimor apo oriental, por duhet trajtuar në varësi të kontekstit dhe hapësirës ku merr formë ky identitet. Kësisoj në kontekstin e perandorisë osmane, në lëvizjen për pavarësi shqiptarët morën elemente kulturore myslimane duke përfutur nga rrethanat e kohës për t’i përdorur këto të fundit në avantazhin e tyre. Ndërkohë që në periudhën pas pavarësisë, shqiptarët nisën ta etiketojnë veten si perëndimorë vetëm si pasojë e arratisjes së tyre nga orienti, ku bënë pjesë për thujtë pesë shekuj.

Bibliografia

- Bartl P, Myslimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare (1878-1912), Dituria, Tiranë 2006.
- Blumi I, Reinstating the Ottomans, Palgrave Mac Millan, New York 2006.
- Clayer N, Në fillimet e nacionalizmit shqiptar: Lindja e një kombi me shumicë myslimane në Europë, Tiranë: Përpjekja, 2009.
- Fortna B, Imperial classroom. Islam, the state and education in the late Ottoman Empire, Oxford University Press: 2002.
- Frashëri S, Shqipëria çka qenë, çështje e ç’do të bëhet? Mendime për shpëtim të mëmëdheut nga rreziqet që e kanë rrethuar, Tiranë 1962.
- Georgon F, Des Ottomans aux Turcs. Naissance d’une nation, Isis, Stamboll: 1995.
- Hobsbaum E, Kombet dhe nacionalizmi që nga 1780: program, miti, realiteti; Toena, Tiranë 2012.
- Limthi L, Fjalët turkisht ose t’ardhuna në anën e turkishtes të përdorura në “Lahuta e Malcis”, Shtejzat 5, Tiranë: 1961.
- Makdisi F, The Culture of Sectarianism: Community, History and Violence in Nineteenth-Century Ottoman Lebanon, University of California Press 2000.
- Merxhani B, Vepra, Plejad, Tiranë, 2003.
- Pulaha S, Qëndresa e popullit shqiptar kundër sundimit Osman nga shek. XVI deri në fillim të shek. XVIII, dokumente Osmane, Tiranë, 1978.
- Vlora E, Bisedime mbi Historinë Bujqësore të Shqipërisë, Arkivi i Institutit të Historisë, Dosja A-VII-5, 55.

ESE

Ndikimet e filozofisë antike greke dhe filozofëve bashkëkohës me të, në veprën e Gregorit të Nisës

Dokt. Arjan Curi

LEKTOR I FILOZOFISË DHE SOCIOLOGJISË SË FESË NË UET

Abstrakti

Dy dashuritë e mia të mëdhaja filozofia dhe teologjia më intrigonin herë pas here me faktin se herë e donin njëra tjetrën, herë e luftonin egërsisht dhe herë e ndihmonin njëra tjetrën, aty ku nuk ia dilnin të vetmet që të arsyetonin tezat apo doktrinat e tyre duke pasur një bashkëjetesë shëkullore shumë të çuditshme ashtu si një vallëzim mistik mes dashurisë dhe urrejtjes. Sapo krishtërimi përmes figurës së Palit u ngrit në një sistem mirëfilli teologjik, pikërisht në atë çast u përdor si strukturë dhe si metodë filozofia e vjetër greke. Kështu hyjmë në një epokë gjigande të mendimit filozofik, në periudhën e patristikës, që nga shekulli i dytë dhe deri në atë të trembëdhjetë, ku krishtërimi nuk mund të konsiderohet më si thjesht një besim vetëm shpirtëror, por gjithashtu ai duhet përfshirë në një korpus të vërtetë, të përbërë nga teologjia metafizike, dogmatike dhe filozofike dhe nga ana tjetër me një ndërthurje të plotë me filozofinë klasike dhe antike.

Në përgjithësi në ambientet akademike shqipfolëse të filozofisë, nën drejtimin dhe fushën e studimit të asaj që zakonisht quhet filozofia mesjetare studiohen figura të ndritshme të patristikës latine me kulminacion Agustinin e Hipos dhe Thoma Akuinin. Si pasojë e kësaj janë më pak të njohur teologë dhe filozofë të mëdhenj të lindjes apo të patristikës helene, njohja sferike e të cilëve do ta bënte më të plotë panoramën e përpjekjeve të iluministëve kristianë të të gjithë botës romake, si asaj perëndimore, por jo më pak edhe asaj lindore. Nëse në Perëndim kemi triumf të filozofisë, në lindje kemi të kundërtën asaj, filozofia vihet në shërbim të predikimit teologjik dhe aty ku bie ndesh me të, mohohet pa asnjë mëdyshje dhe madje luftohet sistematikisht çdo element i saj pagan që konsiderohej si armiqësor ndaj doktrinë së re kristiane. Gjatë studimeve të mia filozofike, më ka tërhequr veçanërisht figura e Gregorit të Nisës si dhe faktit që ai në dallim nga etërit e tjerë kishtarë lindorë nuk ishte kaq agresiv ndaj filozofisë dhe

e përdori atë me shumë elegancë për të predikuar krishtërimin ndër shtresat e pasura, aristokrate dhe të kulturuara të botës helene, duke e bërë krishtërimin një fe elitare që tërhiqte vëmendjen e të urtëve të kohës. Për këtë arsye ai konsiderohet nga studiuesit si filozofi kristian, sepse u përpoq të pajtonte edhe të papajtueshmet elementë të filozofisë greke dhe teologjisë kristiane. Elementë të filozofisë dhe teologjisë së Gregorit të Nisës, do të përpiqemi t'i sjellim në këtë artikull.

Fjalë kyç: Filozofi bizantine, patristikë, teologji, platonizëm, krishtërim

Metodologjia e studimit shkencor

Natyra e këtij studimi ka diktuar që të mos ndiqet një teknikë e vetme kërkimore, përkatësisht vetëm një qasje, sepse, po të veprohej ashtu, do të dilte një shqyrtim shumë i njëtrajtshëm dhe skematik. Kuadri metodologjik nënkupton rrugët, mënyrat dhe atë se si do të veprohet për të menaxhuar në tërësi këtë studim, të cilin e ka diktuar vetë teza e parashtruar. Po ashtu, edhe për ta qartësuar se si ka ecur realizimi dhe rezultatet e arritura. Kryesisht është ndjekur analiza e diskursit filozofik si metodologji e veçantë, e përdorur në rast të studimeve të ngjashme.

a) Duke qenë se shumica e çështjeve teologjike të ndikuara prej rrymave filozofike, që shqyrtohen këtu nuk janë të njohura sa duhet te ne, domethënë prej filozofëve dhe shkencëtarëve shqipfolës, për të paraqitur në formë ravijëzuese teoritë racionaliste në teologji, duhet ndjekur **qasja përshekruese**. Funkcioni i saj është për të parashtruar qartë dhe shkurtimisht aspektet kryesore të teorive që studiohen, ashtu që të krijohet një pasqyrë e këndvështrimeve të ndryshme sipas teologëve dhe filozofëve, bashkëkohës të Gregorit të Nisës, por edhe dallimet në vija të trasha, që të lehtësohet të kuptuarit e pikëpamjeve për problemet e ngritur prej tyre lidhur me doktrinën kristiane.

b) **Qasja historike**, sado e shprehur aty-këtu dhe pa mëtuar historicizëm, do të jetë krejt e nevojshme me qëllim që të kuptohet konteksti kohor. Sado që për mendimin filozofik pak çon peshë aspekti i kohës së shfaqjes së tij, ajo ndihmon për të ndjerë nxitjen dhe evoluimin e këtij mendimi.

c) Lidhur me çështjet kryesore teologjike dhe filozofike që burojnë prej pikëpamjeve të etërve lindorë dhe kuptimit të pikave të takimit të tyre, është menduar për t'u ndjekur edhe **qasja ballafaquese**. Duke i paraqitur pikëpamjet teorike të filozofëve për një çështje konkrete qartësohen më mirë qëndrimet e tyre, gjë që i bën më të dukshme kontributet, por edhe dallimet, pajtimet e mospajtimet, si dhe kundërshtitë.

d) E për ta thelluar qartësinë e pikëpamjeve teologjike dhe filozofike të botës ku punoi dhe jetoi Gregori i Nisës, respektivisht të pretendimeve të tyre, do të nevojitet edhe *qasja kritike*. Kjo, në njërin anë si kritikë e brendshme mistike dhe metafizike e filozofëve, e në anën tjetër edhe si kritikë nga jashtë, përkatësisht nga filozofët paganë që me kritikën e tyre ndriçojnë misionin e pamundur e të pretenduar nga teologët kristianë, për të vënë tërësisht dhe pa kushte filozofinë në shërbim të teologjisë.

e) Këtë studim e karakterizon aspekti i shtjellimit teorik, e kjo domethënë se duhet bërë *sintexa* ashtu që, pas zbërthimit të pikëpamjeve të filozofëve dhe etërve teologjikë të krishtërimit oriental, të shprehen rezultatet. Kjo qasje karakterizon sidomos pjesën e fundit, që rilidh arritjet e gjithë studimit, aty ku do të shprehen qëndrimet në mbështetje të tezës së parashtruar.

Studimi ka një karakter kualitativ, pra të thelluar dhe shkon në mënyrë të natyrshme te përzgjedhja e veprave klasike dhe më përfaqësuese të autorit të marrë në studim, me qëllim që të ekstrahojmë përfundime, bazuar në mendimin e tij, mbi nocionet që parashtrohen në studimin tonë. Kjo është edhe natyra e kërkimit dhe vëzhgimit filozofik, që nuk bazohet në kërkime kuantitative apo opinione të fokus grupeve, por interesohet në studimin e mendimit njerëzor në një epokë dhe traditë filozofike të caktuar. Studimi i Gregorit të Nisës, na çon në hulumtimin e asaj disipline shkencore, që sot do të njihet me termin Filozofia Bizantine.

Në këtë mënyrë ne nuk i shmangemi dot natyrës tërësore të studimit tonë, pra përpjekjes për t'i studiuar burimet në mënyrë shteruese dhe të përgjithshme, duke përzgjedhur kështu si kampionin ku do të bazojmë studimin tonë, veprën e Gregor Nisienit, e parë në mënyrë kritike dhe të thelluar. Kjo do të thotë që çdo vepër e Gregorit u studiua në plotësi dhe jo në aspekte të veçantë, në mënyrë që të kemi një ikonë të plotësuar të mendimit të tij mbi të cilën do të kryejmë analizën tonë sistematike, në mënyrë që studimi të mos na çojë në përfundime të gabuara.

Burimet parësore, dytësore dhe mënyra e referimit të tyre

Veprat e etërve, kryesisht të Shën Gregorit të Nisës, janë konsultuar në botimin e tyre të përmbledhur në serinë e famshme voluminoze, *Patrologia Graeca*, bot. J.P.Migne, Paris 1857 -1912. Sa herë që i kemi referuar thëniet e etërve në greqishten e tyre origjinale, vëllimin, faqen dhe paragrafin e kemi vendosur në referencat përkatëse, kjo kur bëhet fjalë për referencat burimore, pra kur i kemi drejtuar direkt tekstit të Gregor Nisienit në greqishten origjinale. Në këto raste, kemi vendosur shkurtimet me iniciale PG dhe volumen dhe kapitullin përkatës, pasi

referimi sipas APA, nuk është shumë praktik, sepse kemi të bëjmë me të dhëna që përfshijnë volume, paragrafe dhe vargje, sikurse edhe kemi vendosur tekstin e përkthyer krahas origjinalit. Kurse, në rastin kur u kemi referuar burimeve dytësore, pra komentatorëve dhe ekspertëve më të njohur të veprës së Gregor Nisienit, kemi referuar sipas sistemit APA, në fund të faqes dhe jo në tekst, për të ruajtur një mënyrë uniforme të paraqitjes së citimeve.

Përmbledhja më sistematike e veprës gjigande të Gregor Nisienit gjendet më egzakhtësisht e koleksionuar në botimin klasik të *Patrologiae Graecae* (P.G.) në vëllimet XLIV-XLVI. Një botim të plotë kritik të veprës së tij, nuk e gjejmë të publikuar ende, në ndryshim me vepra të etërve të tjerë. Por botime kritike të pjesëshme të veprës së tij, përmendim: FRONTO DUCÆUS (Paris, 1615). Cf. VINCENZI, *In Gregorii Nysseni et Origenis scripta et doctrinam nova recensio*, etc. (Rome, 1864-69); BAUER, *Die Trostreden des Gregorios von Nyssa in ihrem Verhältniss zur antiken Rhetorik* (Marburg, 1892); BOUËDRON, *Doctrines philosophiques de Saint Grégoire de Nysse* (Nantes, 1861); KOCH, *Das mystische Schauen beim hl. Gr. v. Nyssa in Theol. Quartalschrift* (1898), LXXX, 397-420; DIEKAMP, *Die Gotteslehre des hl. Gregor von Nyssa: ein Beitrag zur Dogmengesch. der patristischen Zeit* (Münster, 1897); ËEISS, *Die Erziehungslehre der Kappadozier* (Freiburg, 1903); HILT, *St. Gregorii episcopi Nysseni doctrina de angelis exposita* (Freiburg, 1860); KRAMPF, *Der Urzustand des Menschen nach der Lehre des hl. Gregor von Nyssa, eine dogmatisch-patristische Studie* (Eürzburg, 1889); REICHE, *Die kunstlerischen Elemente in der Ëelt und Lebens-Anschauung des Gregor von Nyssa* (Jena, 1897).

Burimet filozofike dhe teologjike ne veprën e Gregor Nisienit

Shën Gregori i Nisës kishte fatin të ishte pinjoll i një familjeje aristokrate të Kapadokisë dhe të jetonte në shekullin e IV, që konsiderohet si periudha e artë e lulëzimit të teologjisë lindore, që më pas do të përqafuhej nga Kisha Ortodokse e Lindjes dhe që do të përbënte themelin e doktrinës së saj teologjike. Ai mori arsimin më të mirë për kohën dhe ishte një njohës i mirë i të gjitha rrymave filozofike të lashtësisë helene, por edhe të rigjenerimit të tyre dhe rilindjes së filozofisë neoplatonike që ishte në kulmin e saj në kohën që ai ishte ende student. Për të kuptuar diakronicitetin që karakterizon përplasjen në mendimin të doktrinave filozofike dhe teologjike, mjafton të shohim që edhe në ditët e sotme, sërish filozofët që kanë një orientim pro-kristian, pyeten se si mundet që të vendosin paqe mes këtyre dy sistemeve të mendimit. Një përgjigje interesante e jep filozofi Emanuel Levinas, i cili mendon se nuk ka pse të ketë një pajtim mes filozofisë dhe teologjisë, pasi nuk ka patur kurrë një thyerje të tyre.¹

¹ Levinas, E. (2011, 7).

Kështu që edhe si për etërit e tjerë kapadokianë, ashtu si edhe për vëllain e tij biologjik, të famshmin në Patristikën lindore, Shën Vasilin e Madh, shkrimet dhe traktatet e lashta filozofike, por edhe tradita retorike dhe të shkencave të tjera të njohura, përbëjnë burimet kryesore të njohurive të tij filozofike, njohuri të cilat do të ndihen edhe në ndikimin e tyre të pashmangshëm në veprën e tij teologjike të mëvonshme. Në atë periudhë nuk kishim një ndarje të mirëfilltë të disiplinave shkencore siç kemi sot, por njerëzit e pasur, paguanin mësues të famshëm të epokës së tyre dhe ishin të interesuar të arsimoheshin në sa më shumë fusha, sepse edhe njohuritë kishin një karakter të përgjithshëm formues.²

Problemi që del këtu është nëse te Gregori bashkëekzistojnë në mënyrë harmonike dijet teologjike dhe filozofike, nëse ato përplasen me njëra - tjetrën, nëse e përjashtojnë apo e plotësojnë njëra - tjetrën. Këtu ndajmë mendimin me shumicën e studiuesve të veprës së Gregorit se ndikimet filozofike janë të ndjeshme, por nuk duken me shikim të parë, pasi ai ishte kryesisht një dashurues i artit të oratorisë. Kjo duket nga gjuha e gjallë, ndjenja e lirisë nga format e ngushta dhe stilistika e pasur, me të cilën ai shkruan veprat e tij dhe se ai rrallë herë i referohet shkollave të veçanta filozofike të epokës së tij, duke i dhënë kështu një përparësi të dukshme në mendimin e tij, zbulesës hyjnore. Kështu kemi arritur te burimi i tij i dytë, që janë Shkrimet e Shenjta, kryesisht Letrat e Apostull Pavlit dhe Ungjilli i Joan Teologut, vargje prej të cilave do të dominojnë në veprën e tij. Megjithatë ndihet një erë e lehtë, gati – gati një puhizë e fshehur platonizmi që karakterizon mendimin e tij.

Është i njohur fakti se Gregori, peshkopi i Nisës kishte një dashuri të madhe për teologjinë, por megjithatë krahasuar me etërit e tjerë kapadokianë ai njihet më shumë si një filozof, sesa si një teolog, edhe pse njihet si një tipar i përbashkët i etërve kapadokianë, arsimimi i tyre i thellë filozofik. Tek ai, në ndryshim nga kolegët e periudhës së tij, vihet re një distancim nga teologjia dhe një afrim me filozofinë, sepse ai shihte tek filozofia te vetmin mjet, me të cilin mund t'i afroheshe kuptimit dhe soditjes së të vërtetës hyjnore. Nëse teologjia e krishterë nuk shpjegohej nëpërmjet sistemeve filozofike, atëherë sipas Gregorit, ka rrezik që ajo të duket e varfër tek njerëzit, e cekët, e pakuptueshme e paorganizuar dhe ndonjëherë edhe si një përrallë apo mit³.

Edhe pse e sheh filozofinë si një kuruese të teologjisë së tij, Gregori nuk e merr asnjëherë atë si themel, por si një filtër përshtatjeje për lexuesit e tij. Për shembull në rastin e rimishërimit të shpirtit, doktrinë që është tërësisht e hedhur poshtë nga krishtërimi, ai nuk heziton ta refuzojë me forcë këtë mësimdhënie në një prej veprave

të tij⁴. Për Gregorin, fillimi dhe mbarimi i së vërtetës është zbulesa hyjnore, nëse doktrinat e ndryshme filozofike përputhen me të, ato mund të përdoren si argumente plotësuese për të mbështetur dogmën e krishterë, në të kundërt mësimet e filozofëve të ndryshëm që bien ndesh me dogmën, hidhen poshtë pa më të voglin hezitim. Kjo lidhet edhe me bindjen e tij, se filozofia mund ta udhëheqë njeriun drejt virtytit, por krahasuar me zbulesën që lartazi, me doktrinën që e ka burimin te Logosi, te Fjala dhe Biri i Perëndisë, filozofia merr një karakterizim prej tij si “e paplotë”.

Në një rast, Gregori merr përsipër të shpjegojë se si funksionon e mira dhe e keqja në botë duke marrë si shembull ngjarjen që ndodhi në kopshtin e Edenit. Në komentin e tij, vihet re një shmangie nga tradita e atëhershme e interpretimit të shkrimeve dhe një ndikim të fuqishëm te filozofisë së Plotinit, i cili e shikonte të keqen tek materia. Duke marrë shkas nga kjo mësimdhënie, Gregori arrin në mënyrë të shkëlqyeshme të mbështesë nevojën e ngjalljes prej së vdekurish, si edhe ribërjen e gjërave të reja, ritransformimin e gjithë botës⁵.

Te Vepra e Gregorit nuk kemi të bëjmë me një sintezë të elementeve të Helenizmit dhe të Kristianizmit, por kemi të bëjmë me një shndërrim të gjuhës dhe tendencave filozofike të epokës së tij, të cilat përmbledhin si një kryevepër arkitektonike të gjithë historinë e filozofisë, në kërkim të historisë së krijimit të njeriut, të universit dhe të prejardhjes së jetës, kërkim i cili merr përgjigje nga Krishti⁶. Për ta ilustruar më mirë fenomenin e takimit të helenizmit me kristianizmin dhe të mënyrës se si ata bashkëvepruan, mjafton të përmendim komentin e filozofit të famshëm, Bertrand Russell: “Sa më shumë që krishtërimi helenizohej, (d.m.th. bashkëvepronte me filozofinë e lashtë greke) aq më shumë teologjizohej (d.m.th. hynte në fazën e sistemimit teorik të doktrinës së tij)”⁷.

Është i habitshëm fakti se me çfarë mjeshtërie dhe shkathtësi oratorike, i përdor Gregori sistemet e ndryshme filozofike në shërbim të të vërtetave teologjike. Ai krijon një luftë ideologjike mes tyre, kur merr disa ide si aleate të tij për të goditur ide të tjera, të huaja për dogmën kristiane, siç është rasti i refuzimit të materializmit, që e ka origjinën tek mendimi stoikëve dhe epikurianëve. Në këtë përpjekje aleati i tij i madh do të jetë Platonizmi, që siç kemi thënë më lart do të përshkruajë si një fije e pashkëputshme lidhjeje të gjithë veprën e tij⁸.

⁴ Περί ψυχής και Αναστάσεως ο Λόγος, PG 46, 108B : «Και η διδάσκαλος, Οι μὲν ἔξω, φησί, της καθ' ἡμᾶς φιλοσοφίας ἐν διαφοροῖς ὑπολήψεσιν, ἄλλος ἄλλως μέρει τινὶ τοῦ κατὰ τὴν ἀνάστασιν ἐφήψαντο δόγματος». (Fjalë mbi shpirtin dhe Ngjalljen, “Ata që gjenden jashtë filozofisë sonë kanë koncepte të ndryshme, e mendojnë ndryshe ngjalljen, jo në përputhje me dogmën tonë”.)

⁵ Περί κατασκευῆς ἀνθρώπου, Κεφάλαιο Κ', PG 44, 200 C : «... το ὄντως αγαθόν ἀπλὸν καὶ μονοειδὲς ἐστὶ τῇ φύσει, πάσης διπλῆς καὶ τῆς πρὸς τὸ ἐναντίον συζυγίας ἀλλότριον.» (Mbi krijimin e njeriut, Kapitulli 20: “ e mira ontologjike është e thjeshtë dhe monoidike = e njëllojshme në natyrë, çdo dualizëm dhe matje e kundërt është e huaj për besimin tonë.”)

⁶ Ματσούκας, Ν. (1994, 110-111).

⁷ Russell, B. (1946, 527).

⁸ Peroli, E. (1993, 134-135).

² Janullatos, A. (2004, 35).

³ Εξήγησις ακριβής εις τα άσματα των ασμάτων, PG 44, 761 B – C: «Οἱς εἰ μῆτις δια φιλοσοφίας ἐνθεωρήσετε τὴν ἀλήθειαν...». (“Mos e sodisni të vërtetën, veçse nëpërmjet filozofisë”). Varg i shkëputur nga një prej veprave të tij me titull: “Shpjegim i saktë i Kantikut të Kantikëve”.

Ky fakt do t'i preokupojë më së shumti studiuesit bashkëkohorë të veprës së Gregorit. Për shembull, J. P. Cavarnos do të avancojë akoma më shumë duke thënë se aq i madh është ndikimi platonik tek vepra e Gregorit, saqë gjithë përfytyrimi i tij mbi natyrën e shpirtave është i bazuar mbi platonizmin, por ne mendojmë se ndryshimet në koncept janë të ndjeshme, edhe pse ndikimet nuk shmangen. Edhe pse me ndikime platonike, doktrina gregoriane mbi esencën dhe prejardhjen e shpirtave është tërësisht kristiane.

Një ide interesante jep studiuesi i veprës së Gregorit, Skuteri, i cili e karakterizon peshkopin kapadokian si një "i krishterë platonik". Platonizmi është çelësi për të kuptuar veprën e Gregorit dhe jo përgjigja apo konkluzioni mbi doktrinën e tij⁹. Edhe pse në raste të veçanta përdoret platonizmi për të shpjeguar probleme kuptimore, e parë në tërësi fryma e teologjisë biblike mbizotëron mbi çdo ndikim tjetër filozofik, i cili vihet në shërbim të qëllimit final.

Debat se sa i ndikuar nga Platoni është Gregori vazhdon të jetë edhe sot i gjallë mes studiuesve të veprës së tij. Shpesh herë ky debat merr edhe përmasat e një polemike shkencore, atëherë kur opinionet dhe tezat e studiuesve kundërshtojnë njëra – tjetrën në mënyrë diametrike dhe duket se arritja e një konkluzioni të pranuar gjerësisht është gati e pamundur. Megjithatë personalisht i mësojmë faktit dhe mendimit se Gregori është më përpara kristian dhe pastaj platonian. Të qenurit i ndikuar prej platonizmit dhe preferenca e tij për filozofinë e Platonit nuk e bëjnë më pak të krishterë dhe Atë të Kishës sesa bashkëkohësit e tjerë të tij.

Pasi kemi pranuar ndikimin platonik të Gregori nuk na ngelet gjë tjetër veçse të marrim në analizë disa elementë konkretë të këtij ndikimi që më pas do të bëhen edhe pjesë e didaskalisë së krishterë. Le të marrim, për shembull, mësimdhënien e Gregorit të Nisës për ndarjen në tre pjesë të shpirtit njerëzor, ide e cila e ka origjinën te platonizmi dhe që më vonë u bë gjerësisht e pranuar edhe në krishtërim. Kjo ide do t'i shërbente Gregorit për të shpjeguar strukturën e dyfishtë (jo dualizëm) të njeriut, atë që më vonë në dogmatikën apo teologjinë sistematike ortodokse do të quhet me termin "psiko – somatik", pra që njeriu zotëron natyrën e tij të plotë atëherë kur ka në posedim, edhe trupin edhe shpirtin¹⁰.

Një tjetër ide që do ta gjejmë nëse studiojmë veprat e Gregorit është edhe koncepti mbi realitetin i ndarë në botën mendore (të ideve) dhe atë shqisore (të shqisave), ide që Gregori e ka huazuar nga veprat e Platonit. Bota e ideve i paraprin si një dimension paralel botës materiale, e cila përbëhet nga katër elementë bazikë. Këto elementë shndërrohen duke i zënë vendin njëri – tjetrit dhe duke formuar kështu materien, e cila edhe pse në ndryshim të vazhdueshëm nuk pakësohet dhe nuk humbet. Kështu elementët mund të humbasin cilësinë e tyre, por jo ekzistencën e tyre. Këtu vihet re një ndryshim esencial nga botëkuptimi që gjendet në fizikën aristoteliane apo atë stoike. Ky shndërrim i vazhdueshëm i elementëve,

i parë dhe i pranuar prej Gregorit nën dritën e ndikimit platonik, si edhe dallimi i qartë mes botës së ideve dhe asaj materiale, përbën sipas U. Bianchi, edhe kodin për të kuptuar tezat e Gregorit mbi lindjen dhe dekompozimin e trupave njerëzorë, si edhe mendimin e tij mbi virgjërinë si një virtyt thelbësor të krishtërimit.¹¹

Kështu meqë njeriu mbas vdekjes së tij do të jetojë si engjëjt në qiell, nuk do të ketë më nevojë të instiktit të tij seksual. Nëse me anë të virtytit të virgjërisë kjo gjendje paraprihet që në tokë, atëherë ajo paraqitet si një virtyt i veçantë që iu përket vetëm engjëjve dhe botës qiellore. Por edhe ndarja e botës së ideve nga shqisat e ndihmojnë Gregorin të shpjegojë sesi njeriu mundet që duke mos përdorur shqisat e trupit, sepse për to është e pamundur, por me anë të sensorëve të shpirtit të ketë kontakt me "renë hyjnore" me realitetin hyjnor dhe të sodisë Perëndinë, kjo vetëm në sajë të kultivimit të virtyteve dhe të dëshirës dhe lejes së Hyjnisë. Në këtë rast Gregori përdor vetëm fjalorin e Platonit, por jo idetë e tij, sepse Platoni nuk kishte arritur të formulonte idenë e soditjes së Krijuesit, brenda apo jashtë botës shqisore.

Në veprat e tij vihen re edhe shembuj të tjerë të ndikimeve nga idetë platonike, që gjenden në veprat klasike të Platonit. Për shembull, miti i kuajve dhe krahëve të shpirtit vijnë nga "Fedro". Ndërsa nga "Republika" kemi ndikimet e përngjasimeve apo përdorja e krahasimeve të pasioneve të ulëta njerëzore me figura të frikshme bishash. Nga e njëjta vepër e Platonit vjen edhe miti i famshëm i shpellës, mit me të cilin Gregori paralelizon shpellën e Betlehemit, e cila tashmë i jep mundësinë njerëzimit të shikojë jo vetëm si hije të panjohurën.

Por ndër veprat e Platonit që kanë ushtruar më shumë ndikim tek Gregori i Nisës, mund të përmendet edhe "Fedoni"¹². Përshkrimi që ky i fundit bën sesi shpirti mund të ketë "Theoria" apo parjen dhe kungimin me realitetin e lartë hyjnor, mbas ndarjes së tij nga trupi, e bën Gregorin enuziast në mbështetjen e idesë së tij mbi mundësinë e shpirtit për të kuptuar realitetin hyjnor, por në ndryshim nga Platoni, Gregori mendon se kjo gjë është e mundur edhe përpara vdekjes, nëse shpirti zhytet në lutje dhe meditim, krahas kultivimit të virtyteve dhe asketizmit¹³.

Sipas studiuesit të njohur të patrologjisë helene, I. Evstratiu, përdorimi e unitetit aritmetik të esencës, jo vetëm për natyrën hyjnore, por edhe për atë njerëzore është padyshim element i ndikimit platonik. Gjithashtu edhe teoria e tij për rehabilitimin e krijesës të çon në të njëjtin përfundim¹⁴. Në lidhje me mësimdhënien e Gregorit për pastrimin e shpirtit shohim teza interesante që kanë lidhje me teologjinë mistike të peshkopit të Nisës. B. Stavridhi mbështet mendimin se: "Për sa i përket filozofisë së tij, Gregori ndjek shkollën platonike dhe neoplatonike, prej të cilave vihen re edhe tendencat për misticizëm në teologjinë e tij". Për sa i përket mendimit të tij për katarsisin e shpirtave, mendohet se tezat e tij mund të kenë edhe ndikim

¹¹ Bianchi, U. (1978, 97-98)

¹² Ακούλας, Α.Μ. (1888, 27)

¹³ Dennis, T.J. (1978, 597)

¹⁴ Ευστρατίου, Ι. (1971, 463-464).

direkt nga Plotini, i cili mbështeste idenë se shpirti pastrohet nëpërmjet jetës morale shpirtërore e cila e ngre atë në nivele më të larta. Ideja e arritjes së gjendjes 'ekstazë' të shpirtit lidhet direkt me misticizmin e Plotinit¹⁵.

Gjatë leximit të veprës së Gregorit vihet re edhe një tendence e mohimit të materies, gjë që të sjell në mend ngjashmëri të tij me Plotinin. Për P. Courcelle, nuk është e vlefshme të pyetet se sa plotinist ka qenë Gregori, sepse ai sheh një dallim të ndjeshëm mes të dyve dhe përgjigjet negativisht ndaj kësaj pyetjeje, por ai shpreh një dyshim, nëse tezat e Gregorit mbi vlerën dhe të keqen që rrjedh prej materies rridhnin realisht nga Plotini, apo nga Porfiri?

Kërkuesi, Apostolopulos sjell një ide tjetër interesante. Sipas tij në shekullin e katërt ekzistonte një përplasje e fuqishme midis dy rrymave, krishtëritit dhe platonizmit. Aq i madh ishte ky konflikt sa që kishte krijuar një pështjellim tek episkopët e krishterë, studiues të filozofisë, siç ishte rasti edhe i Shën Gregorit të Nisës, i cili në veprën e tij, nuk bën gjë tjetër veçse lëviz ndërmjet platonizmit dhe kristianizmit, si një përpjekje për pajtimin e këtyre dy mendimeve. Apostolopulos sheh një ndryshim për sa i përket stilistikës së veprës së Gregorit. Në rastet, thotë ai, kur Gregori përdor shfaqjet biblike dhe komentet rreth tyre, ai i drejtohet një lexuesi më të thjeshtë siç ishte tërësia e besimtarëve të krishterë, ndërsa në rastet kur ai përdor shembuj dhe ilustrime platonike, ai i drejtohet një publiku me kultivim më të lartë dhe arsimin filozofik më të thellë¹⁶. Sipas të njëjtit studiues aq i madh ishte përplasja e këtyre dy rrymave të mendimit, të platonizmit dhe kristianizmit në kohën e Gregorit, sa që kjo gjë ndihet shumë sidomos në veprën e tij "Mbi shpirtin dhe ngjalljen".

Tek Gregori gjejmë një përdorim të kujdesshëm të zgjuarsisë dhe arritjeve të Platonit. Studiuesit kanë parë jo vetëm huazim të ideve platonike, por edhe të një glosari, apo fjalori neoplatonik, çka do t'i shërbente Gregorit për të shpjeguar në mënyrë me elegante, të kultivuar dhe të lartë, të vërtetat e besimit të krishterë¹⁷. Ai është eklektik, apo përzgjedhës në elementët që i duhen dhe që i shërbejnë qëllimit të veprës së tij dhe refuzues në ato elementë që bien ndesh me doktrinën e krishterë. Fakt klasik është ai i refuzimit me forcë të ndarjes më tresh të strukturës së njeriut të "trikotomisë" platonike të njeriut, element që ne e gjejmë të adoptuar, në ndryshim nga Gregori tek etër të tjerë.

Në të njëjtën mënyrë do të shohim tek Gregori edhe ndikimet e Plotinit. Idetë e tij mbi principin madhor, domosdoshmërinë e distancimit të trupit nga materia, kultivimi etiko – moral që njeriu të ngjitet nga zona e shqisave tek ajo e mendjes, koncepti se materia identifikohet me të mosqenurit, janë disa nga elementet që përbëjnë sistemin filozofik të Plotinit, elementë të cilat Gregori i përdor me mjeshtëri në shpalosjen e doktrinës së tij të krishterë.

¹⁵ Σταυρίδης, Β.Θ. (1957, 574).

¹⁶ Αποστολόπουλος, Χ. (1991, 327).

¹⁷ Περί των νηπίων προ ώρας αφαρμαζομένων, Προς Ιέριον, PG 46, 164 D: «και ο σοφός εν τοις έξω Πλάτων πολλάς εκ προσώπου αναβεβιωκότος περί των εκείθεν δικαστηρίων φιλοσοφήσας..»

Le të shikojmë në vijim, ndikimet e një tjetër filozofi të lashtësisë greke në veprën e Gregorit dhe pikërisht atë të Aristotelit, ndikimi i të cilit nuk kishte si të mungonte, ashtu siç ndodh në përgjithësi në literaturën patristike lindore të shekullit IV.¹⁸ Së pari vihet re një huazim i termave, të elementeve të logjikës dhe etikës aristoteliane, madje nuk mund të përjashtojmë ndonjë ndikim edhe në antropologji. Megjithatë mendimi i Gregorit për filozofinë aristoteliane është në përgjithësi negativ.¹⁹

Duket se edhe Filon me origjinë hebreje ishte jo pak i njohur për Gregorin, që edhe pse dukej se nuk pranohej gjerësisht prej tij²⁰, sërish huazon elementë të mendimit të tij siç është rasti i krijimit të dyfishtë të njeriut prej Perëndisë. Këtë ide ndajnë studiuesit T. J. Dennis dhe I. D. Mucula kur pohojnë elementë me prejardhje nga Filon²¹. "Nëse kjo ide, sipas Filon-it ishte shprehja e tipit ideal të njeriut të krijuar sipas ikonës së Perëndisë, sipas Gregorit nga ana tjetër ishte pro-ikonizimi apo paraimazhi i hyjnizimit të njerëzimit nëpërmjet mishërimit të Logosit, Fjalës. Kjo tezë e Gregorit mund ta ketë pikënisjen tek Filon, por zhvillohet në mënyrë origjinale prej tij, duke u shkëputur më vonë nga mendimi i filozofit hebreje.

Në vijimësi të studimit të veprës së Gregorit vëmë re edhe një ndikim tjetër të një lloji të ri, kësaj rradhe jo aq në ide, sesa në formë edhe në përmbajtje. Bëhet fjalë për mendimtarin, filozofin dhe shkrimtarin e madh, Origjenin, i cili bëhet gjithmonë e më i dukshëm sa më shumë që lexon veprën e Gregorit. Duket se peshkopi i Nisës ka një simpati të veçantë për Origjenin, pasi ai i referohet shumë frymës oratorike dhe mënyrës së shkrimit, ashtu siç vetë Origjeni ka bërë në veprat e tij. Këtë gjë Gregori ose e bën me qëllim, për të treguar preferencën e tij për shkrimtarin dhe oratorin e madh, ose e bën sepse duke qenë një nxënës i zellshëm i retorikës, ka dashur t'i jetë besnik traditës së kohës, ose e bën nga simpatia e tij personale, por kjo nuk do të thotë se Gregori fliste tërësisht si Origjeni. Ai është eklektik, tepër kritik dhe i kujdesshëm në përdorimin e elementëve origjenianë, pikërisht sepse Kisha zyrtare e kishte parë me dyshim veprën e Origjenit dhe Gregori nuk nxiton të adoptojë elementë të papranuar gjerësisht nga Kisha. Në lidhje me Origjenin, ndikimi i tij nuk vihet re shumë në rrafshin glosologjiko –

¹⁸ Κατά Ευνομίου, Λόγος IB' , PG 45, 905 D – 908 A : «Ο φιλοπόνως την Αριστοτελικήν των όντων διαίρεσιν επιθυλλών τω ημετέρω λόγω , εξείργασται γένη, και είδη, και διαφοράς δογμάτων προεχειρίσατο». (Kundër Eunomit, Fjala XII: "Ai që synon të ndjekë filozofinë aristoteliane të qenieve, shkakton një ndarje në formë dhe përmbajtje dhe shpall ndryshim në përputhje me dogmat tona").

¹⁹ Κατά Ευνομίου, Λόγος Z' , PG 45, 741 A – B : «Ταύτα της Αριστοτελικής τεχνολογίας τα κατορθώματα . Δια τούτο ελεεινοί μεν ημείς κατά τον σον λόγον, οι της σοφίας ταύτης αμύητοι. (Kundër Eunomit, Fjala VII: "Këto janë pasojat e teknologjisë aristoteliane. Prandaj janë të mjerë sipas mendimit tonë ata që nuk zhyten në këtë lloj urtësie).

²⁰ Κατά Ευνομίου, Λόγος Z' , PG 45, 748C : «Εστι δε όπου και ο Εβραίος Φίλων τα ίσα πάσχει, εκ των ιδίων πόνων συντρανίζων αυτώ τα λεξείδια». (Kundër Eunomit, Fjala VII: "Diku edhe Hebreu Filon pëson të njëjtat gjëra nga dhimbjet e tij duke mos qenë i qartë me fjalët e tij").

²¹ Dennis, T.J. (1979, 538-539).

stilistik, por në atë konceptual, pra huazim të përdorimit të nocioneve dhe termave që përdoren gjerësisht në veprën e Origjenit.

Aq i gjallë është ndikimi i Origjenit tek Gregori sa studiuesit mendojnë se metafizika e Gregorit nuk është neoplatonike, por vishet me elementë të fuqishëm origjenianë. Disa të tjerë si H. Crouzel dhe B. Salmona e shikojnë ndikimin e Origjenit tek eskatologjia e Gregorit, brenda përpjekjes së tij të ndërfutjes së elementëve neoplatonikë brenda didaskalisë kristiane²².

Ka edhe një grup studiuesish, që mendojnë se Gregori ka adoptuar edhe teza të dënuara prej Kishës të Origjenit, siç është edhe pohimi i paraekzistencës së shpirtave, gjë që e mbështet edhe platonizmi, por kjo nuk gjen mbështetje të gjerë ndër studiuesit e veprës së Gregorit dhe ne nuk mund të besojmë se peshkopi i Nisës, të kishte një njohje kaq të cekët të besimit të krishterë saqë mund të pranojë pohime krejt të huaja për traditën e Kishës lindore. Por Mihail Pselo²³ këmbëngul në mendimin e tij se Gregori kishte rrëshqitur në origjenizëm, duke dhënë shembuj të vargjeve të shkëputura nga vepra e tij, gjë që nuk përbën argument të fortë bindës dhe që rrëzohet nga pjesë të tjera të veprës së Gregorit²⁴.

I gjithë rreziku i keqinterpretimit ndodh për shkak se nuk zbatohet parimi i leximit dhe studimit në kontekst dhe si një e tërë e veprës së Gregorit, por i shkëputjes së vargjeve të ndryshme, gjë që përbën naivitete dhe argumenta të paraqitura sipas kësaj metodologjie, duhet të konsiderohen të vakëta, të cekëta, të pabaza dhe si të tilla të papranueshme. Më shumë se një herë, vetë Gregori në veprat e tij e ka dënuar mësimin origjenik mbi paraekzistencën e shpirtave, si një mësim të vjetër të filozofisë greke dhe që nuk përbën gjë tjetër veçse një mit dhe një mësim të gabuar²⁵.

Por ka edhe të tjerë që natyrisht kanë ndikuar në veprën e etërve kapadokianë, ashtu siç është e pashmangshme për çdo autor që në veprën e tij të mos ndikohet nga personalitetet që kanë karakterizuar epokën kur ka jetuar, si edhe përshtypjet që janë krijuar në bazë edhe të preferencës personale apo atraksionit dhe afeksionit që natyrshëm krijohet gjatë formimit dhe procesit të studimit. Në bashkësinë e etërve kapadokianë vihet re edhe ndikimi i Metodit të Olimp. Tezat e Gregorit në lidhje me kohën fizike dhe atë historike, mbarimin e kohërave, eskatologjinë e

tij, fundin e gjërave materiale, mbarimin e ekzistencës së universit, duket se lidhen me ndikimet e Metodit. Gjithashtu me Metodin duket se lidhen edhe idetë e mbrojtjes së trupit, pa prekur jetën shpirtërore, gjë që nuk e gjejmë te Origjeni. Por kjo s'do të thotë që Gregori nuk respekton filozofinë, ngaqë nuk pranon pjesë të ndryshme të saj, që bien në kundërshtim me besimin e krishterë.

Konkluzione

Shohim pra që në veprën e Gregorit ndikimet janë të shumta, të ndryshme janë sistemet filozofike që i japin atij ngacmimet e duhura, por edhe dijetarët e kohës së tij nuk mbeten prapa. Gregori do ta quante filozofinë në një prej veprave të tij si: ““της των ψυχών ιατρικής, δι’ης παντός πάθους του της ψυχής απομένου την θεραπείαν μανθάνομεν»”²⁶, por që nëse do të krahasonim raportin e këtyre ndikimeve me atë të Shkrimit të Shenjtë, atëherë do të shikonim sesi ndikimet filozofike janë si degët që i japin hijeshi trungut, që s’është gjë tjetër veçse interpretimi i besimit kristian, i ndërthurur edhe me traditën filozofike të kohës.

Pra, në këtë pjesë të hyrjes ne pamë se si Gregori ishte një njohës i shkëlqyer i traditës filozofike, por edhe i traditës kishtare, që përbënin së bashku me Shkrimet e Shenjta, burimet kryesore të veprës së tij. I shtyrë nga tendenca e epokës së tij, nga nevoja për të vënë në jetë nevojën kishtare të predikimit të besimit edhe për njerëzit e kultivuar dhe me dije, ai u përpoq të vinte sistemet filozofike të njohura deri në atë periudhë në shërbim të metodologjisë dhe strategjisë që kishin përdorur edhe etërit përpara tij, si për të pasuruar jo në përmbajtje, por nga ana teorike, traditën e sistemit dhe të paraqitjes së të vërtetave teologjike.

Edhe pse prej shumë studiuesve të veprës së tij ai u quajt si “filozofi kristian” sërish, ai mbetet një nga teologët më të shkëlqyer të Kishës Lindore, por edhe të Krishtërit në përgjithësi, duke u parë si teologu që u përpoq të përgatiste udhëtimin e Kishës, përgjatë historisë, drejt fundit të kohërave, drejt eskatologjisë, temë e cila ishte një nga më të dashurat për të, sepse përbënte qëllimin final të çdo të krishteri dhe marrjen e shpërblimit për përpjekjet e tij, në fund të kohës historike dhe fizike, në fillimin e dimensionit të ri, i cili nuk do të kishte më mbarim.

Por krahas ndikimeve filozofike, në veprën e Gregorit, nëse thellohem i dhe e lexojmë atë si një unitet të vetëm, ashtu siç është edhe në traditën lindore të interpretimit dhe jo në mënyrë të ndarë dhe të shkëputur do të vëmë re dy burime kryesore të ndikimit të traditës teologjike. Së pari është i njohur fakti se Gregori i përkiste shkollës teologjike të Aleksandrisë dhe traditës së saj interpretative të shkrimeve dhe së dyti Gregori i Nisës është në unison me frymën e vëllait dhe të mentorit të tij, të Shën Vasilit të Madh dhe të mënyrës vasiliane të parjes dhe

²⁶ Περί Παρθενίας Κεφ. ΚΓ’ , PG 46, 408 B (Traktati mbi virgjërinë: “filozofia është mjekësia e shpirtit, nëpërmjet të cilës mësojmë terapinë për ta shëruar atë”).

²² Τατάκης, Β. (1960, 238-239).

²³ Μιχαήλ Ψελλός, Διδασκαλία παντοδαπῆ, PG 122, 713 – 716 : «Πότε ἡ ψυχὴ τῷ κυομένῳ ἐννοῦται σώματι; Ὁ μὲν τὴν Θεολογίαν μέγας Ἰρηγόριος ἀσαφῆς ἐπὶ τοῦτο το μέρος, καὶ οὐκ ἀν ραδίως αὐτὸν εὖροις ταῦτῃ ἢ ἐκείνῃ προσκείμενον τῶν δόξων».

²⁴ Περί ψυχῆς καὶ Ἀναστάσεως ὁ Λόγος, PG 46, 116 D: «Εἰ γὰρ οὔτε ἄνθρωποι, οὔτε φυτὰ , οὔτε βοσκήματα, μὴ ψυχῆς ἄνωθεν ἐπὶ ταῦτα ἐμπεσοῦσης..» (Mbi shpirtin dhe ngjalljen: “Sepse as njerëz, as bimë, as kullota nuk mund të ekzistojnë, as shpirta që vijnë nga larg dhe bien mbi to”).

²⁵ Περί κατασκευῆς ἀνθρώπου, Κεφάλαιο ΚΗ’ , PG 44, 252 A: «Οἱ τῷ προτέρῳ παριστάμενοι λόγῳ καὶ πρεσβύτεραν τῆς ἐν σαρκὶ ζωῆς τὴν πολιτείαν τῶν ψυχῶν δογματίζοντες, οὐ μοι δοκοῦσι..» (Mbi krijimin e njeriut, Kapitulli 28: “Ata që shfaqin arsyet e vjetra të jetës në mish dhe të qytetit të shpirtave nuk dogmatizojnë saktë”). Këtu dënohet qartë doktrina e paraekzistencës së shpirtave.

ndarjes së pikëpamjeve mbi çështjet e ndryshme teologjike.

Dhe së fundi, siç është e natyrshme, në veprën e Gregorit, ndikim të madh ka edhe vepra e vëllait të tij, atit të ndritshëm të krishtërimit lindor, por edhe atij universal, Shën Vasilit të Madh. Është gjerësisht e njohur dashuria dhe respekti që Shën Gregori i Nisës, ushqen për vëllain e tij, Vasilin dhe ndikimi i këtij të fundit është i madh si shpirtërisht, ashtu edhe filozofikisht dhe teologjikisht. Si ilustrim mund të merret qëndrimi i përbashkët që kanë të dy vëllezërit mbi të keqen dhe nëse ajo ka ose jo ekzistencë reale. Edhe pse mos ekzistenca e të keqes, përbënte një qëndrim gjerësisht të pranuar nga filozofia e shekullit IV, sërish vihet re një agoni e Gregorit për të mbajtur qëndrim në unison me Vasilin e Madh, veprën dhe idetë e të cilit ai i njeh shumë mirë.

Vetëm duke kuptuar konceptet platonike dhe neoplatonike mbi botën e ideve dhe botën e përtëjme mund të arrijmë të kristalizojmë një opinion të plotë mbi përpjekjen titanike të Gregorit për të pajtuar këto dy rryma mendimi në veprën e tij, pra që lexuesit e tij të kuptonin se platonizmi nuk ishte thjesht një rrymë filozofike, por një fe dhe besim i rilindur në neoplatonizëm dhe i përsosur në kristianizëm. Edhe pse duket sikur te Gregori kemi të bëjmë me një person i cili përpigjet t'i vendosë neoplatonizmit një maskë kristianizmi, sërish ne jemi të mendimit se Gregori, nuk heziton asnjëherë, nëse bëhet fjalë për mospajtim dogmatik të këtyre ideologjive, të mbështesë doktrinën e krishterë. Asnjë ide platonike nuk lejohet nga Gregori të dëmtojë dogmën kristiane. Këtu i mëshojmë mendimit se çdo ide e Gregorit mbështetet fort dhe kryesisht te Shkrimi i Shenjtë, tek i cili ai gjen burimin kryesor të të vërtetave që ai shpall në traktatet e tij. Këtë ide ka edhe edhe A. Meredith që thekson leximin në mënyrë universale të veprave të Gregorit dhe jo në mënyrë të shkëputur²⁷.

Bibliografia

(Burimet dytesore)

- Bianchi, U. (1978). *Presupposti platonici e dualistici nell' antropologia di Gregorio di Nissa*. Roma.
- Cavarnos, C. (1989). *The Hellenic Christian Philosophical tradition*. Massachusetts: Institute for Byzantine and Modern Greek Studies.
- Gilson, E. (1955). *History of Christian Philosophy in the Middle Ages*. New York.
- Janullatos, A. (2004). *Globalizmi dhe Ortodoksia*. Tiranë: K.O.A.SH.
- Levinas, E. (2011). *Etika dhe pafundësia*. Tiranë: Papiurs.
- Λογοθέτη, Κ. (1930). *Η φιλοσοφία των Πατέρων και του μέσου αιώνας, μέρος α'*. Αθήνα.
- Ματσούκα, Ι. (1971). *Υπάρχει χριστιανική φιλοσοφία*; Αθήνα: Επετηρίδα.
- Meredith, A. (1988). *Phaedo Christianus*. *Journal of Theological Studies*, 39, 258-273.
- Pelikan, J. (1993). *Christianity and Classical Culture*. New Haven: Yale University Press.

²⁷ Meredith, A. (1988, 258-260).

Peroli, E. (1993). *Platonismo e l'antropologia filosofica di Gregorio di Nyssa*. Milano: Vita e Pensiero.

Rusell, B. (1946). *A history of Western Philosophy*. London: George Allen & Unwin Ltd.

Σκουτέρης, Κ. (1984). *Malum privatio est*. Ο Άγιος Γρηγόριος Νύσσης και ο Ψευδο-Διονύσιος δια την ύπαρξιν του κακού. *ΕΕΘΣΠΑ*, 26, 78-112.

Τατάκη, Β. (1960). *Η συμβολή της Καππαδοκίας στη Χριστιανική σκέψη*. Αθήνα.

Ζηζιούλα Ι. (1977). *Από το προσωπεύον εις το πρόσωπο*. Η συμβολή της πατερικής θεολογίας εις την έννοιαν του προσώπου. Θεσσαλονίκη: Χαριστήρια.

POLICY PAPER

Adaptim arkitektonik pranë zonës “Harry Fultz”

Otjela Lubonja

Abstrakt

Ky dokument është pjesë e Projektit kërkimor, të aplikuar nga Dr. Otjela Lubonja. Qëllimi i Projektit është të nxjerrë në pah një zonë e cila ka nevojë për riadaptim, për ta bërë sa më të gjallë dhe me nevoja plotësuese. Në këtë studim trajtohen disa çështje teoriko-praktike që kanë të bëjnë zonën në tërësi si objekt studimi i marrë në shqyrtim. Nëpërmjet analizës që kryejmë për të parë anët pozitive, negative që na ofron kjo situatë aktuale dhe si mund të arrijmë në përmirësimin e saj. Përmes një analize të thelluar të indikatorëve të ndryshëm, studimi synon të analizojë, interpretojë nëse ka shanse reale për një ndryshim efektiv, nëse po, cilat do të ishin disa nga mekanizmat e mundshëm për një ndryshim të tillë. Impakti i “gjetjeve” mund të shërbejë si bazë metodologjike për shpjegimin e pse-së së gjendjes aktuale. Në studim dalin në pah arsyet kryesore që kanë ndikuar pse kjo zonë nuk ka pasur gjallëri, rivitalizim. Falë shfrytëzimit të literaturës, të situatës aktuale, gjetjeve të planeve të ndryshme në këtë zonë, të hartave që mundet të më ndihmonin, në studim identifikohen problemet, vështirësitë që kjo zonë ka hasur dhe ndryshimi i saj që mund të arrihet për ta përmirësuar këtë situatë. Projekti, në fazën aktuale, u mbështet nga të dhënat dytësore si; harta plotësuese e zonës, planimetritë aktuale, për fazën e dytë, studimi të shtrihet më gjerë duke bërë politika publike e paraqitur si projekt për realizimin e tij, në institucione publike si Minibashki, Bashkia e Tiranës. Nëpërmjet këtij Projekti, UET-i tërheq vëmendjen e opinionit shkencor në vend dhe më gjerë për mundësitë që krijohen për studime të thelluara në fushën e shkencave të Arkitekturës.

Hyrje e punimit

Ajo çfarë ne shohim sot, ku hasim probleme dhe situata nga më të ndryshmet, debate, diskutime, një ndër temat me theks aktual mbetet “Adaptimi i zonave të ndryshme në Shqipëri”, të cilat kanë shumë nevojë për të ndërhyrë në to.

Pikat e referencës së kësaj problematike lidhen me aspekte praktike, zbatuese. Vendi ynë, qyteti i Tiranës dhe shumë qytete të tjera sot po marrin një hov të madh zhvillimi, por pyetja që lind natyrshëm është se si po ndodh ky hov? Kush duhet të ndërgjegjësohet që mos hasim probleme dhe vështirësi në zona të ndryshme?

Zona që është marrë në studim për ta trajtuar me projekt adaptimi janë disa pallate të cilat i përkasin njërit prej blloqeve të banimit përballë shkollës “Harry Fultz”.

Shpresoj që ky projekt të hapë rrugën për një gjykim realist mbi zonat të cilat kanë nevojë të riadaptohen në Shqipëri në një të ardhme të afërt.

Çështja dhe problematika kryesore

Gjymtyrët e Projektit kanë të bëjnë me adaptimin arkitektonik të zonës së marrë në studim tek blloku i ndërtesave pranë “Harry Fultz”. Objektivat e Projektit janë:

1. Të parashtrojë një analizë aktuale të zonës së marrë në studim.
2. Të përcaktojë karakterin e kësaj zone.
3. Të nxjerrë në pah problematikat e zonës.
4. Të nxjerrë në pah problemet që hasin banorët.
5. Ndërhyrjet që mund të pësojë kjo zonë.

Konceptet dhe metodologjia e punimit

Për përmbushjen e qëllimit të këtij Projekti është paraparë zbatimi i disa principeve metodologjike si më poshtë:

Së pari, analiza e dokumentacionit ekzistues si: harta, planimetri ekzistuese të zonës, kanë karakterin e një metodologjie empirike, duke zbatuar një vëzhgim të drejtpërdrejtë.

Pyetje kërkimore

Ndërhyrjet që mendohen të realizohen në këtë zonë arrijnë ta rivalizojnë atë, ta gjallërojnë më tepër dhe t’i plotësojnë nevojat bazë?

Nën pyetje të projektit kërkimor


1. Nga ndërhyrjet që do të bëhen a mundet t’i shmangim zhurmat për banorët?
2. A ka probleme ekzistuese zona për parkim dhe si mundet ta zgjidhim atë?

3. A nevojitet të ndërhyjmë për hapësirat e gjelbërta?
4. Duhet të vëmë akses vertikal, pra ashensor? Kanë nevojë objektet?
5. Ka nevojë kjo zonë për shtim në sipërfaqe të brendshme të apartamenteve?
6. Si mund të shmanget prezenca e lagështisë?
7. Po për sistemin elektrik a ka nevojë kjo zonë për ndërhyrje?

Analizë

Historiku i zonës

Zona që është marrë në studim për ta trajtuar me projekt adaptimi janë disa pallate të cilat i përkasin njërit prej blloqeve të banimit përballë shkollës “HARRY FULTZ”.



Me ngjyrë të verdhë është paraqitur qendra e Tiranës dhe tregon lidhjen me zonën që kam marrë në studim. Grupi i banimit është paraqitur me ngjyrë të zezë.

Përbëhet nga dy pallate 5-kateshë të cilët i përkasin tipologjisë të tipit kullë dhe dy pallate të tipologjisë me seksion. Këto janë pallate aktualisht me 5-kate, ku katet e para aktualisht përdoren për shërbime tregtare individuale, ndërsa katër katet e sipërme shfrytëzohen për banim. Rrjeti rrugor i zonës është i tillë që konturon hapësirën e brendshme ndërmjet pallateve, por ka mungesë në vendet për parkim.

Grupi i banimit, ndodhet në rrugën “UNAZA”, 1.3 km në veri-lindje të sheshit “Skënderbej”. Zona përreth është një zonë me përdorim kryesisht rezidencial me blloqe pallatesh 4 dhe 5-kateshe dhe zonë me hapësira konviktesh dhe shkollash.

Për sa i takon tipologjisë dhe periudhës kohore të këtyre banesave, bëhet fjalë për banesën e planifikuar të viteve 50-90.

Përcaktimi i karakterit

- Funkzioni kryesor banim, i përzierë edhe me funksione të tjera shërbime të vogla tregtare.
- Zona përbëhet kryesisht nga objekte banimi të lartësive të ulëta e përziera me pallate banimi të para dhe pas viteve ‘90.
- Vlen për t’u përmendur, mos koordinimi kompozicional i objekteve të ulëta (ekzistuese) me objektet e larta (pallate banimi të reja).
- Peizazhi/ pamjet rrugore përcaktohen nga fasadat e apartamenteve të banimit 4-5 katëshe të cilat përgjithësisht ndjekin vija ndërtimi paralel me rrugët.
- Rrugë të brendshme të ngushta dhe përshkueshmëri të ulët brenda blloqeve.

Imazhe të zonës aktuale



Banasa me seksione



Banese e tipit kullë


Këto banesa për sa i përkasin karakterit dallohen për minimalizëm dhe në shumicën e rasteve monotone dhe me ngjyra të zbehta. Nga pikëpamja urbanistike këto blloqe banimi organizohen në mënyra që të konturojnë jo vetëm rrugët kryesore, por dhe të formojnë hapësira të përdorshme. Rezultatet e presioneve për ndërtimet pas viteve ‘90 vërehen me zhvillime informale të ulëta dhe në zhvillime të kontrolluar që janë të tipit (mbushje) ose i përkasin rastit ku qyteti zhvillohet mbi atë ekzistues.

Tendenca për zhvillimin e këtyre zonave është drejt ndërtimeve të larta, me funksione mix, por që respektojnë rrjetin rrugor themelues atje ku ai është themeluar. Ndërtimet e reja në zonë e kanë rritur ndjeshëm dendësinë dhe frekuentimin e

kësaj zone, duke e shndërruar atë në një zonë të rëndësishme banimi dhe tregtar.

Komunikimi me rrugë është i mirë. Hyrja në zonë bëhet nëpërmjet rrugëve dytësore, të cilat të çojnë në hapësirën e brendshme ndërmjet pallateve që aktualisht është e zënë me ndërtime të rastësishme që pas viteve '90.

Shohim planin e katit përdhe të banesës me seksione:



Burimi: Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit
(KARTË TEKNIKE E MARRË NGA ARSHIVA)



Pamje e planit të katit përdhe, banesa tip kulle
Burimi: Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit
(KARTË TEKNIKE E MARRË NGA ARSHIVA)



Burimi: Foto nga autori


Vëmë re që sipërfaqet e brendshme janë minimaliste. Kemi një mungesë të ashensorit, të dhomës së ditës etj. Banesat janë kryesisht me pesë kate me konstrukcion me tullë të plotë në një tarracë të hidroizoluar. Trashësia e mureve të jashtme është 38 cm dhe e atyre të brendshme është 25 cm dhe 12 cm.

Fasada e pallatit është e pa suvatuar, dritaret janë pjesërisht me kasë druri dhe pjesërisht me profile duralumini dhe disa prej tyre janë të pajisura me grila duralumini.

Gjithashtu vëmë re dhe shtesa sporadike në vende të ndryshme të objektit.

Në pallatet e tipit kullë hyhet nga ana jugore e pallatit, ndërsa në ato me seksione hyrja bëhet në anën lindore dhe perëndimore. Kafazi i shkallëve është i hapur, ai është i suvatuar dhe i lyer, shkallët janë me basamakë granili të derdhur, sheshpushimet janë të shtruara me pllaka. Ndryshimi dhe ventilimi i shkallëve realizohet në mënyrë natyrale.

Fasadat ekzistuese



Burimi: Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit
(KARTË TEKNIKE E MARRË NGA ARSHIVA)

Evidentimi i problematikave të zonës

- Zhurma në bllokun e banimit për shkak të afërsisë me rrugën.
- Mungesë e vendeve të parkimit, për banorët.
- Mungesë e hapësirës së gjelbëruar, e cila shpesh është zënë me ndërtesa të reja, pas viteve '90, të ndërtuara pa studim dhe në forma e lartësi të ndryshme.
- Shtesa në kate dhe në ato vëllimore të cilat prishin imazhin e fasadës.
- Mungesa e ashensorit.

Problemet që hasin banorët

- Prezenca e lagështisë në muret e apartamenteve për shkak të amortizimit të strukturës.
- Sistemi elektrik problematik për shkak të ndërhyrjeve të reja.
- Ulje e normës ditore të furnizimit me ujë të pijshëm për shkak të rritjes së

- dendësisë së popullsisë për njësi sipërfaqeje.
- Probleme me tubacionet e kanalizimeve, që në mjaft raste ka sjellë ndotje të lartë të ambientit dhe rrezik për shëndetin e banorëve.
- Nivel i lartë i zhurmave për shkak të mungesës së izolimit akustik të mureve të jashtme të ndërtesave.
- Ambiente të brendshme të banimit me sipërfaqe shumë të vogla, të pamjaftueshme për kërkesat dhe standardet e sotme të jetesës.

Ndërhyrjet në zonë

Duke parë dëmtimet e shumta të bllokut të banimit kam menduar këto ndërhyrje:

- Do të prishen të gjitha shtesat që janë bërë me kalimin e kohës dhe që prishin identitetin e zonës.
- Do të bëhen shtesa në kate dhe në pjesë të ndryshme të fasadës duke përdorur element të ri konstruktiv.
- Do të rregullohet problemi i parkimit, duke ndërhyrë në pjesët nëntokësore.
- Do të shtohet gjelbërimi në zonë i cili pothuajse mungon.
- Do të përmirësohet sistemi elektrik dhe ai i ngrohjes.
- Do të bëhet ndërhyrje në materialet e fasadës.


Pasi analizuam një gjendje ekzistuese të zonës që kam zgjedhur, shohim ndërhyrjet që kam menduar për t'u realizuar.

Genplani i propozuar për zonën e zgjedhur



Vëmë re që kemi ambiente rekreative, gjelbërimi është shtuar. Parkimi është konceptuar që të realizohet nëntokësor, në pjesën anësore të kopshtit në të majtë.

Plani i parkimit



Hapësira në dispozicion është menduar për 42 makina.

Plani i katit përdhe të banesës me seksione




Në raport me gjendjen ekzistuese është bërë një përmirësim i ambienteve tregtare si në sipërfaqe po ashtu dhe në ngritje si kuotë. Duke vënë disa këmbë shkallë përpara hyrjes, pasi hyrja ishte direkt në kuotën 0.00. Shohim dhe një shtim të ashensorëve, pasi mungonin.

Plani i katit tip (banesa me seksione)



Kemi shtim të sipërfaqeve në çdo kat të objektit. Apartamentet janë 1+1 dhe 2+1. Gjithashtu kemi dhe një ambient ndejtje i cili tek gjendja ekzistuese mungonte. Janë shtuar kollona ere që ndihmojnë për përforcimin e gjithë objektit. Nga jugu janë orientuar kryesisht zona e ditës, por pa përjashtuar dhe një pjesë të zonës së natës.

Plani i katit përdhe të banesës tip kulle



Siç vëmë re dhe këtu tek banesa tip kullë kemi shtuar sipërfaqet, ashensorin dhe zyrat të cilat janë ambiente tregtare në gjendjen ekzistuese. Është ngritur kuota me disa këmbë shkallë.

kati përdhe, sipërfaqe ekzistuese = $140 \text{ m}^2 \times 5 \text{ kate} + \text{ballkone } 8 \text{ m}^2$
= 732 m^2 gjithsej

kati përdhe sipërfaqe ekzistuese = 140 m^2

kati përdhe sipërfaqe e shtuar = 32 m^2

total sipërfaqe ekzistues = 732 m^2

total sipërfaqe bashkë me shtesën 5 kate ndërtim = 904 m^2



Plani i katit të parë



Apartamentet janë 2+1 me sipërfaqe 85 m^2 dhe 1+1 me sipërfaqe 65 m^2 . Gjithashtu kemi dhe një ambient ndejtje i cili tek gjendja ekzistuese mungonte.

kati përdhe sipërfaqe ekzistuese
= $140 \text{ m}^2 \times 5 \text{ kate} + \text{ballkone } 8 \text{ m}^2 = 732 \text{ m}^2$ gjithsej

kati i parë sipërfaqe ekzistuese = 148 m^2

kati i parë sipërfaqe e shtuar = 35 m^2

kati parë sipërfaqe gjithsej = $35 \text{ m}^2 + 148 \text{ m}^2 = 183 \text{ m}^2$

total sip. ekzistuese = 732 m^2

total sip. bashkë me shtesën 5 kate ndërtim = 904 m^2



Prerjet e reja të objektit



Në këtë prerje është bërë dhe një analizë ambientale për sa i përket ngrohjes në ambientet e brendshme në banesë sipas orareve të ndryshme dhe stinëve të ndryshme si në dimër dhe në dhjetor dhe gjithashtu dhe në verë e qershor.

Fasadat e reja të objekteve në zonën e përzgjedhur



Materialet e reja të përdorura në fasade janë pllakë qeramike, xham i vazhduar, konstruksion i ri shtesë metalike për pjesën e llozhave, gjelbërim i integruar në fasadë. Në disa pjesë të fasadës kemi dhe material suva, por grafiato.

Imazhet e reja të propozuara për zonën



Përfundime dhe rekomandime

Në këtë Projekt u përqendruam në problematikën që haste zona e marrë në studim.

Së pari, analizuam gjendjen ekzistuese të zonës.

Së dyti, meqenëse evidentuam problemet e kësaj zone pranë shkollës “Harry Fultz”, u propozua një projekt i ri adaptimi.

Së treti, përcaktuam ndërhyrjet në këtë zonë, pra aty ka vërtet nevojë për t’a bërë një zonë sa më me gjallëri.

Duke parë dëmtimet e shumta të bllokut të banimit ndërhyrjet do të ishin këto:

- Prishja e të gjithë shtesave që janë bërë me kalimin e kohës dhe që prishin identitetin e zonës.
- Shtesa në kate dhe në pjesë të ndryshme të fasadës duke përdorur element të ri konstruktiv.
- Rregullimi i parkimit, duke ndërhyrë në pjesët nëntokësore.
- Shtimi i sipërfaqeve të gjelbërta.
- Përmirësimi i sistemit elektrik dhe atij të ngrohjes.
- Ndërhyrje në materialet e fasadës.

Ndihmesa për universitetin

Nëpërmjet këtij projekti, UET-i tërheq vëmendjen e opinionit shkencor në vend dhe më gjerë për mundësitë që krijohen për studime të thelluara në fushën e shkencave të arkitekturës.

Së dyti, nëpërmjet projekteve të tilla konkrete, UET-i synon të evidentojë vullnetin dhe mundësitë (infra)strukture që ka krijuar për pedagogët në drejtim të

nxitjes së veprimtarisë së tyre shkencore, në përputhje me filozofinë e funksionimit si institucion i besueshëm didaktiko-shkencor i arsimit të lartë në Shqipëri.

Së treti, UET-i jep mesazhin se tashmë ka krijuar mundësi të prekshme për rifreskim të njohurive nga ana e pedagogëve të tij në fushat përkatëse.

Së katërti, UET-i dëshmon me ndërmarrjen e projekteve të kësaj natyre se si mund të përdoren indikatorët e performancës së punës kërkimore-shkencore për zgjedhje më të mira konceptuale, të domosdoshme për shkencat shoqërore ose shkencore në harmoni me përvojën dhe praktikën e universiteteve të huaja.

Bibliografia

1. Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit (Kartë teknike e marrë nga arshiva në vitin 2009).
2. Crawford L. (2016). Transgender Architectonics The Shape of change in Modernist Space
3. User Modeling, Adaption, and Personalization (2013) 21th International Conference, UMAP 2013, Rome, Italy, June 10-14, 2013. Proceedings (Lecture Notes in Computer Science).

Të rinjtë, rrjetet sociale dhe shoqëria e networkut

Elisabeta Bajrami

Abstrakt

Ky punim vjen si një përpyetje për të kuptuar se përse rrjetet sociale përdoren masivisht sot nga të rinjtë dhe cilat janë efektet negative e pozitive të këtij përdorimi në masë. Cilat janë rrjetet sociale më popullore e më të parapëlqyer prej tyre dhe sa kohë mesatarisht shpenzojnë ata në rrjete. Qëllimi i studimit është që të masë jo vetëm se sa të përdorura janë rrjetet sociale por gjithashtu të zbulojë arsyet që i kanë bërë ato masivisht të përdorura e të masë efektet që sjell përdorimi i tepërt i tyre në jetën e një të riu student. Në këtë studim pra fokusi do të jenë të rinjtë studentë dhe synimi është të studiohet sjellja e tyre si përdorues e të kuptohet nëse ata i përdorin më së shumti rrjetet sociale për komunikim virtual, informim, argëtim apo qëllime tjera, të tilla si promovimi i kauzave të caktuara sociale, promovimin e iniciativave të ndryshme lidhur me studimet dhe fushat e interesit etj. Metoda e përdorur për të analizuar raportin e të rinjve me përdorimin e teknologjive të komunikimit duke veçuar këtu rrjetet sociale më të përdorura, (Facebook, Instagram, Twitter, Youtube, Hi5), është një përzierje mes metodës cilësore dhe asaj sasiore. Të dhënat empirike të studimitu siguruannëpërmjet anketimit. U anketuan 200 të rinj të grupmoshave nga 18 – mbi 22 vjeç. Të dhëna të tjera të cilat e plotësuan për nga modeli teorik këtë punim, u siguruan nga shqyrtimi i Literaturave të orientuara. Shtysa për të ndërmarrë një studim të kësaj natyre vjen pasi që kur flasim për masivizim të përdorimit të rrjeteve sociale dhe si ky masivizim ndikon negativisht në jetën e të rinjve kemi të bëjmë me një dukuri e cila ka përfshirë gjithë globin e ku të rinjtë shqiptar nuk mund të konsiderohen periferik. Përkundrazi, ajo çka rezultoi nga ky studim është se pikërisht në shoqëri si e jona, përdorimi masiv e pa kontroll i rrjeteve sociale ka tendencën të sjellë më tepër pasojë negative sesa pozitive.

Fjalë kyç: teknologji; komunikim; rrjete sociale; facebook

Hyrje

Jetojmë në një kohëkur teknologjia ka prekur dhe po e orienton dita-ditës komunikimin dhe marrëdhëniet shoqërore në një drejtim tëri, në një erë të re zhvillimi ku janë rimodeluar e po ndryshojnë me shpejtësi raportet tona të komunikimit dhe ndërveprimit si qenie sociale. Zhvillimi i shpejtë i teknologjive të komunikimit sigurisht që ja ka lehtësuar individit interaksionin në shoqëri por njëkohësisht ka prodhuar edhe një efekt boomerang; atë të izolimit dhe reduktimit të komunikimit verbal duke e zëvendësuar këtë të fundit përherë e më tepër me komunikimin virtual. Interneti është kthyer në kryefjalën e përditshmërisë së shumë njerëzve e ku nëpërmjet rrjeteve sociale është tanimë mjeti më i përdorur për të komunikuar, për tu informuar, për tu argëtuar, për të promovuar aktivitete të natyrave të ndryshme, për të qarkulluar lajmin, për të promovuar një biznes si dhe për të ndarë ngjarje të ndryshme nga jetët e tyre personale e profesionale etj. Njëketo kushte të reja të zhvillimit shoqëror si dhe të qënurit nën ndikimin e vazhdueshëm të teknologjisë është e rëndësishme të kuptohet se deri në çfarë pike përdorimi masiv i teknologjive të komunikimit përbën risi e në cilën pikë fillojnë të preken jetët dhe sjelljet tona individuale e kolektive? Në një kohë kur individ gjendet i ‘bombarduar’ nga të rejat e papritura të cilat ia lehtësojnë jetesën atij, por në një prizëm tjetër mund edhe t’ja vështirësojnë, lind natyrshëm pyetja; a mund ta përdorim ne internetin pa rënë në kurthet e anëve të tij negative?

Që prej lindjes së tij në vitet 60’, për internetin ka pasur disa lloje përkufizimesh. Në këtë punim ne do ti përmbahemi atij të sjellë nga studiuesi Joseph Dominicki cili e përkufizon internetin si një rrjet global i rrjeteve të kompjuterit (Dominicki, J.R. 2010:424). Përdorimi i internetit ka pësuar ndryshime të mëdha prej kohës së lindjes së tij e deri në ditët tona. Fillimisht ai përdorej me një sasi të vogël paketash programesh, kryesisht ato për të shkruar tekste, operacione financiare e lojëra. Por me kalimin e kohës u shfaqën programe të reja të komunikimit të cilat lehtësuan zhvillimin e rrjeteve lokale (LAN) të cilat bashkonin disa kompjutera në një rrjet. Zhvillimi tjetër më i rëndësishëm në vazhdim të revolucionit të kompjuterit do të ishte zhvendosja e tij nga zyra ne shtëpi ku tashmë përdoruesit lexojnë lajmet më të fundit, kontrollojnë email-in, menaxhojnë të ardhurat e tyre dhe shkruajnë tekste (Dominicki, J.R. 2010:421). Veçanësisht më e madhe e web-it të sotëm janë patjetër rrjetet sociale, përdorimi masiv i të cilave nuk njihet gjeografi dhe kufizim. Ato kanë tërhequr e kanë bërë për vete përdorues anëmbanë globit. Prej shoqërive të varfëra e deri në ato që sot për sot sundojnë botën me superzhvillimin e teknologjisë.

Termi rrjete sociale është përdorur fillimisht në vitin 2004, vit në të cilin u krijua edhe faqja e parë sociale me emrin Facebook. Një faqe e cila deri në gjysmën

e vitit 2016 numëron mbi 1.71 bilion përdorues në të gjithë botën¹. Lindja e rrjeteve dha një dimension të ri të ashtuquajturit ‘socializim virtual’. Një ngjarje kjo që u shoqërua me një hov të menjëhershëm të komunikimit virtual nëpërmjet përdorimit të teknologjisë duke çuar dita-ditës në atë që njihet sot si dixhitalizimi i komunikimit. Se sa të rëndësishme janë rrjetet sociale si një medium i tërë mjafton të shihen sesa shumë mesazhe përcillen aty çdo ditë, mesazhe të cilat do të humbisnin nëse nuk do të ishte rrjeti si medium. Pra, po të mos ishte mediumi nuk do të ekzistonte fare mesazhi, apo siç thoshte Marshall McLuhan që në vitin 1964 “: *“mediumi është vetë mesazhi”*” (McLuhan, M. 1999:11). Thelbi i një teorie të tillë konsiston në atë se vetë rrjetet sociale si mediumi përmes të cilit realizohet përmbajtja e një mesazhi luan rolin qëndror në mënyrën se si perceptohet ky mesazh. Pra impakti i secilit lloj mediumi është i tillë që prodhon efekte sociale dhe psikologjike tek audienca e tij duke e orientuar atë në një mënyrë të caktuar të menduarit e të ndërtuarit të raporteve sociale, mënyra të cilat nuk varen nga lloji i përmbajtjes që përcillet. Ky impakt ose këto efekte përbëjnë vetë mesazhin e mediumit. (Greenfield, P.M. 1984:3).

Komuniteti online në rrjete sociale është i larmishëm për sa i takon përdoruesve por të dhënat empirike të studimeve të ndryshme tregojnë se të rinjtë janë kategoria që i dominon ato. Edhe vetë Facebook, rrjeti social më popullor, në fillim u krijua dhe funksionoi si një rrjet vetëm për studentët dhe administruesit e tij fillestarë lejonin anëtarësimin vetëm të studentëve të universitetit të tyre (Noor Al-Deen, H.S dhe Hendricks, J.A. 2012:3). Për shkak të gjithë kompleksitetit të zhvillimit të tyre psiko-emocional, të rinjtë janë grupi më vital i shoqërisë dhësi rrjedhojë edhe grupi më i prirur për të eksploruar e provuar gjëra të reja. Kështu ka ndodhur edhe me teknologjinë e me rrjetet sociale. Përdoruesit më të shpeshtë i përkasin gjeneratës së re. Rrjetet sociale janë pjesë e rutinës së tyre të përditshme dhe përdorimi është aq i gjerë sa që flitet deri për një varësi kronike të një pjese të konsiderueshme. Madje, sot njihet edhe e ashtuquajtura sindromë e varësisë ndaj teknologjisë ose çrregullimi i varësisë nga interneti i njohur si ‘*Internet addiction disorder*’². Studimet e fundit, veçanërisht ato në fushën e komunikimit flasin për një stad të ri të zhvillimit shoqëror e kësaj gjeneratë e re dhe masivizimi i përdorimit të rrjetit nga ana e të rinjve është veçse reflektim i këtij stadi të zhvillimit shoqëror. Kemi hyrëpra në një fazë të re zhvillimi, në atë që studiuesit bashkëkohorë quajnë shoqëria e networkut apo shoqëria e rrjetit. Në këtë morfologji të re të shoqërisë, individ është kudo i lidhur me teknologjinë. Ai i përdor rrjetet, mendon e funksionon duke ju referuar atyre dhe e vendos veten në një kontekst të ri ku vija ndarëse mes realitetit dhe virtualitetit është vështirësisht e dallueshme.

¹ www.statista.com/statistics/264810/number-of-monthly-active-facebook-users-worldwide/

² https://en.wikipedia.org/wiki/Internet_addiction_disorder

Metodologjia

Për nga aspekti metodologjik ky studim u konceptua dhe realizua duke ndërthurur metodën sasioreme atë cilësore, për disa përparësi të veçanta lidhur me tematikën e këtij studimi i cilinga njëra anëka si synim të masë sa të masivizuara janë rrjetet sociale, sa përdoren ato nga të rinjtëpor nga ana tjetër edhe të kuptojëse si ndikojnë këto rrjete në jetën e të rinjve duke interpretuar konkretisht pohimet e tyre. Metoda e përzgjedhur konsistoi në mbledhjen dhe analizën e të dhënave empirike nëpërmjet anketimit i cili kishte për qëllim përshkrimin e tendencave apo shpjegimin e marrëdhënies që qëndron mes variablave: masivizimi i përdorimit të rrjeteve sociale ndikon negativisht në jetën e të rinjve (studentë).

Qëllimi dhe objektivat

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të kuptuarit e lidhjeve që ekzistojnë mes kohës së harxhuar masivisht në rrjete sociale dhe ndikimi që ky përdorim masiv ka tek të rinjtë. Të analizohen efektet negative e të shihet sesa ndikojnë negativisht rrjetet sociale në jetën e të riut student. Për realizimin e tij objektivat ishin:

- Të kuptohet sa i njohin dhe i përdorin rrjetet sociale të rinjtë dhe cili është raporti i tyre me teknologjinë.
- Të identifikohen cilat janë rrjetet sociale më të përdorura prej tyre.
- Të vlerësohet sa kohë mesatarisht shpenzon në rrjete sociale një i ri student.
- Të evidentohen dhe analizohen efektet që vijnë prej përdorimit masiv të rrjeteve sociale.

Karakteristikat e subjekteve dhe kampionimi: si subjekte të këtij studimi u zgjedhën të rinj studentë të moshave prej 18 – mbi 22 vjeç. Është zgjedhur ky target grup për të verifikuar edhe hipotezën e studimit: përdorimi masiv i rrjeteve sociale ndikon negativisht në jetën e të rinjve studentë. Kampionimi ishte i qëllimshëm pasi që një kampionim i tillë na lejoi ta zgjidhnimatë me një qëllim paraprak, duke u mbështetur në gjykimin mbi karakteristikat tipike të subjekteve apo popullsisë shenjë. Ata ishin të rinj, studentë, kryesisht njohës e përdorues të rrjeteve sociale, ishin mbi 18 vjeç etj. Për ta lehtësuar procesin e aplikimit të pyetësorit u përdorën auditorët e universitetit të Tiranës, ku dominuan studentët e shkencave sociale. Pjesa më e madhe e të intervistuarve (86.5%) ishin të gjinisë femërore dhe 13.5% të gjinisë tjetër. Të intervistuarit u siguruan paraprakisht mbi konfidencialitetin dhe qëllimin e përdorimit të të dhënave.

Instrumenti: të dhënat e përdorura për realizimin e studimit janë të dhëna të përfituara nga aplikimi i 200 pyetësorëve. Ky instrument ishte mjaft i përshtatshëm për sigurimin e informacionit parësor të punimit. Ai u përdor për shkak të përparësive që ka në mbledhjen e të dhënave të shumta duke qënë se edhe numri i target grupit ishte relativisht i madh. Pyetësori në këtë studim ishte në pjesën e parë i standardizuar dhe me pyetje të strukturuara ku j'u kërkua subjekteve që të zgjidhnin ndërmjet një numri të caktuar alternativash e në pjesën e fundit me pyetje të hapura. Pyetësori u nda në katër sesione. Sesioni i parë ju përmbajt të dhënave kryesisht demografike mbi gjininë, moshën, gjëndjen shoqërore dhe atëekonomike (kjo e fundit për të kuptuar mundësinë ekonomike për akses në teknologji e rrjete). Për këtë sesion u përdorën normalisht pyetjet dikotomike. Në sesionin e dytë u përqëndruan pyetjet e lidhura me informacionin e përgjithshëm mbi rrjetet. Në sesionin e tretë u përqëndruan pyetjet mbi efektet e përdorimit të rrjeteve sociale dhe perceptimi i subjekteve kryesisht në lidhje me efektetnegative.

Rrjetet sociale si katalizator i komunikimit virtual (global)

Zhvillimi i teknologjisë informative dhe i mjeteve të komunikimit është pjesë e pandashme e proceseve aktuale të globalizimit të shoqërive, madje është një nga aspektet më të spikatur nëqoftëse i referohemi proceseve difuzive kulturore si rezultat i globalizmit. Në vetëm disa sekonda njerëz nga vende të ndryshme të botës mund të lidhen ndërmjet tyre, të komunikojnë e shkëmbejnë pjesë nga identiteti i tyre kulturor. Lirisht mund të pohohet se jetojmënë kohën e komunikimit të përshpejtuar. Ndikimet e këtij zhvillimi tëkomunikimit masiv po vërehen edhe tek shoqëria jonë, ku përdorimi masiv i teknologjisë ka përfshirë të gjitha shtresat dhe grupmoshat. Në kuadër të rrjeteve sociale, teknologjia më e përdorur është aktualisht telefoni celular, mjet pa të cilin përdoruesit masiv nuk mundet të qëndrojnë asnjë minutë larg. Për shkak të gjithë aplikacioneve që ai ofron dhe lehtësinë për akses në rrjete është bërë domosdoshmëri e të rinjve. Ai është kthyer në gjymtyrin e padukshëm por të domosdoshëm për të funksionuar në një ditë të zakonshme individi.

Një herë e një kohë, rrjeti ishte veçse një mjet publikimi, thajse mediatik në të cilin publikues të ndryshëm profesionistë, apo edhe amatorë shkarkonin faqe të ndryshme nëpër server. Tanimë rrjeti nuk është më thjesht një medium publikimesh. Rrjete të tilla si Facebook, Twitter, Instagram etj, kanë marrë një përdorim të gjerë në shumicën e vendeve të botës. Ato janë një shprehje e qartë e dukurive globaliste, të cilat i afrojnë njerëzit me mjetet e tyre që në thelb janë produkt i zhvillimit të vrullshëm të teknologjive sot në botë. Rrjetet sociale tanimë janë të larmishme për nga lloji e masive për nga përdorimi. Rrjetet sociale si shprehje e dukurive globaliste janë të spikatura dhe tejmasë tërheqëse për tu studiuar. Ato lehtësojnë

komunikimin e njerëzve në të gjithë botën me një shpejtësi të jashtëzakonshme (Dominick, J.R. 2010:441)

Zhvillimet e fundit të teknologjisë, përfshirë shtypin, telefoninë dhe internetin kanë zvogëluar barrierat fizike të komunikimit dhe kanë lejuar njerëzit të komunikojnë në shkallë globale. Përdorimi i internetit në përgjithësi dhe i rrjeteve sociale nëveçanti ka sjellë edhe mjaft efekte të tjera pozitive. Interneti konsiderohet një dritare informacioni lehtësisht e aksesueshme dhe e dobishme për nga shpejtësia e gjetjes e përpunimit të informacionit.

Të rinjtë studentë dhe raporti me rrjetet sociale

Jetojmë në epokën e dixhitalizimit të informacionit dhe ku tashmë në pothuajse të gjithë nivelet e edukimit, teknologjia është një mjet gjerësisht i përdorur dhe instrument i pandashëm i procesit të edukimit. Një sistem i tillë tentohet të implementohet edhe në Shqipëri. Megjithatë të rinjtë shqiptarë duket se janë të prirur ti keqpërdorin internetin dhe rrjetet në një kohë kur shumica i përdor ato për argëtim ose për atë që njihet në gjuhën e ëeb-it si “chat&cheat”. Një nga problematikat e para që i referohet pikërisht këtij raporti të ngushtë që kanë të rinjtë studentë me rrjetet sociale është pikërisht neglizhenca dhe lënia pas dore e leximit. Nëse më parë studentëve për realizimin e detyrave ju duhej të kalonin orë të tëra në biblioteka për gjetjen e informacioneve, tanimë ndodh ndryshe. Një pjesë e të madhe e të rinjve kalojnë shumë pak orë në biblioteka pasi që përdorin masivisht internetin dhe faqe të ndryshme ku kanë të disponueshme shumë informacione të cilat mund ti përdorin për realizimin e detyrave akademike, duke mos ju drejtuar kësaj si më parë bibliotekave. Nuk mund të thuhet me siguri që ky është një fenomen vetëm shqiptar. Për shumë studentë nëse informacioni nuk gjendet online, ai nuk ekziston, ndërkohë që specialistët e informacionit kanë arritur në përfundimin se vetëm 15% e informacionit të përgjithshëm gjendet në internet (Dominick, J.R. 2010:442). Shtoji kësaj faktin që informacioni duke u marrë në mënyrë mekanike e shpesh herë të pjesshme, bën që tekshumë studentë në shumë raste të mungojnë qasja analitike ndaj çështjeve të studimit dhe jo vetëm. Me siguri që duhet ti rikthehemi librave jo vetëm si burim origjinal informacioni por dhe për kënaqësinë e veçantë që të ofron leximi jo dixhital.

Faktorët relevantë që ndikojnë në masivizim

Ka disa faktorë të cilët i shtyjnë të rinjtë ti përdorin së tepërmi rrjetet sociale. Por disa prej tyre janë më relevantë. Para së gjithash janë faktorët psiko-socialë. Të rinjtë e sotëm të cilët përherë e më tepër janë të prirur drejt individualizimit,

gjejnë hapësirë në rrjete sociale për të shprehur qëndrime apo për tu përfshirë në forume të ndryshme debati për shumë orë gjatë një dite të zakonshme. Ata e kanë më të lehtë të shprehin vetveten nëpërmjet rrjeteve sociale sesa me individë tjerë nga jeta e tyre reale. Së dyti, papuësia e madhe tek të rinjtë konsiderohet një faktor domethënës. Numri i papunësisë tek të rinjtë është përherë e më i lartë e si rezultat angazhimet e tyre janë përherë e më të zbehta. Sipas të dhënave të Institutit kombëtar të Statistikave, nga viti 2007 e deri në vitin 2015 numri i të papunëve për grupmoshën 15-29 vjeç (ku përfshihet edhe target grupi i studimit tonë) ka ardhur vazhdimisht në rritje. Në vitin 2015 shkalla e papunësisë rezultoi të ishte 33.2%³. Faktorë të tjerë do të ishin patjetër edhe vetëneglizhenca apo mungesa e interesit kundrejt aktiviteteve të cilat do të duhej të konsideroheshin si parësore, të tilla si leximi, aktivitetet vullnetare, aktivitete të tjera sociale, si dhe një “paafësi” për kontrollimin e kohës së humbur në internet e rrjete sociale. Këto dhe faktorë të tjerë socio-ekonomik e psikologjik, dinamika e të cilëve është në ndryshim të vazhdueshëm mund të renditen si ndër faktorët të cilët sot kanë krijuar një lloj varësi nga ana e të rinjve kundrejt rrjeteve sociale. Në mos varësi, një lloj dashurie që shkon deri në patologji.

Kufiri mes jetës reale dhe asaj virtuale

Synimi për të analizuar kufirin mes jetës reale dhe asaj virtuale në kontekst të këtij punimi është ngushtësisht i lidhur me të kuptuarit e sasisë dhe cilësisë së komunikimit verbal dhe atij joverbal nga ana e të rinjve. Komunikimi joverbal përfshin të gjitha modelet e sjelljeve që nuk janë fjalë. (Guerrero, L.K., Floyd, K., 2006:4). Ka edhe autorët të tjerë si J.Burgoon, D. Buller dhe W. Woodall të cilët sjellin një përkufizim tjetër duke e përcaktuar komunikimin si një proces dinamik të pandërprerë nëpërmjet të cilit dhënësit dhe marrësit shkëmbejnë mesazhe dhe në komunikimin joverbal mesazhe janë ato që njerëzit i këmbëjnë pa fjalë në vetvete (J.Burgoon, D. Buller., W. Woodall., 1996:13 sipas Guerrero, L.K., Floyd, K., 2006:4). Virtualiteti është veçanërisht i përhapur tek ata individë të cilët janë të prirur të manipulojnë me identitetin e tyre dhe e shohin teknologjinë si mjet për ta realizuar atë (Hartley, J. (2007:232).

Sigurisht që komunikimi joverbal siç është komunikimi nëpër rrjete sociale nuk është i njëjtë me atë verbal dhe si i tillë ai ka mangësitë e veta. Para së gjithash, nëpërmjet komunikimit joverbal nuk mund të realizohet marrja e feedbackut të menjëhershëm, nuk mund të analizohen tiparet e interlokutorit ose bashkëbiseduesit. Nuk mund të kuptohen tonalitetet e zërit, shmanget totalisht kontakti sy më sy, reflektimi i gjëndjes emocionale etj. Të gjitha këto elemente

³ <http://www.instat.gov.al/al/themes/tregu-i-pun%C3%ABs.aspx?tab=tabs-5>

të cilat janë të pranishme në komunikimin verbal dhe që mungojë plotësisht në komunikimin në rrjete sociale. Komunikimi joverbal është informacion ose emocion që shprehet pa fjalë dhe pa ndikimin e gjuhës. Në krahasim me atë verbal, komunikimi pa fjalë është më pak i kontrollueshëm por edhe më potent sepse mbart shumë emocione dhe ndjenja të cilat shpesh është e pamundur të shprehim me fjalë, madje është vështirë ti kuptojmë ato edhe tek vetja (Dragoti, E. 2004:62). Fytyra dhe sytë tanë shpesh herë pasqyrojnë ndjenjat toba, frikën, gëzimin, të vërtetën dhe gënjeshtren. Një mesazh ose një informacion, për ta transmetuar zakonisht përdorim tre elemente, ku përfshihen fjalët, zëri dhe lëvizjet. Lëvizjet përbëjnë 55% të transmetimit të mesazhit në kuadrin e komunikimit, fjalët 7% dhe 38% tjetër jepet nga përdorimi i zërit. Nuk mund të thuhet me siguri se cila formë komunikimi është më e mirë pasi që për disa individë është më i lehtë komunikimi joverbal pasi që evitohet përballja fizike dhe kontakti sy më sy, elemente të cilat tek disa individë krijojnë barriera psikologjike por që nga ana tjetër mungesa e këtyre elementëve tek shumica e bashkëbiseduesve e pengojnë komunikimin ose e bëjnë atë të çalë. Fakt është që komunikimi joverbal në rrjete është bërë përherë e më tërheqës për përdoruesit e rinj për shkak të komoditeteve të tilla si anonimiteti, mungesa e kontaktit sy më sy, dëshira për të shfaqur veten virtuale etj.

Risitë dhe plus-et që kanë gjeneruar rrjetet sociale

Pavarësisht qasjes kritike për të analizuar efektet negative që manifestojnë shumë të rinj, përdorues të rregullt të rrjeteve, nuk mundet të biem në gracka nihiliste e të bëjmë pohime kategorike. Entuziastët e teknologjisë sot flasin sesi rrjetet sociale kanë prodhuar shumë efekte pozitive. Para së gjithash, interneti ka gjeneruar një sasi të madhe informacioni e cila është e gatshme për tu përdorur nga studentët. (Dominick, J.R. 2010:442). Përdorimi i rrjeteve sociale ka zvogëluar barrierat fizike të komunikimit dhe ka krijuar lehtësira të jashtëzakonshme në mënyrë që njerëzit të komunikojnë në shkallë globale me njerëz nga jeta e tyre reale apo virtuale. Teknologjia j'u ka mundësuar lehtësira komunikimi të mahnitshme e të jashtëzakonshme. Ato përbëjnë padyshim një rrugë të re komunikimi, mënyrën më të shpejtë e më komode për tu përdorur. Por përveç përdorimit të tyre si mjet komunikimi, rrjetet sociale gjithashtu krijojnë një mundësi të shkëlqyer për marrjen e informacionit e përdorimin e këtij informacionin në mënyra të ndryshme.

Duke qënë se rrjetet sociale tanimë janë media më vete, ato sigurisht që ofrojnë në mënyrë të shpejtë qarkullimin e informacionit duke ju dhënë mundësi përdoruesve të jenë në dijeni online të të rejave të ndryshme. Përdoruesit e larmishëm të rrjeteve kanë mundësinë që ta marrin informacionin shumë shpejt pavarësisht vendndodhjes së tyre gjeografike pasi që rrjetet sociale janë masivisht

të përdorura në të gjithë botën. Me opsionet e reja që ofrojnë rrjetet sociale tanimë është e mundur që në shumicën prej tyre, përdoruesit të ndajnë komente, shkrime, mesazhe zanore e vizive.

Ndër të tjera, rrjetet sociale janë një mundësi e shkëlqyer për tu përfshirë në diskutime online e për të marrë informacione mjaft të dobishme nga fusha të ndryshme, të ofruara nga specialist të ndryshëm. Pra, ideja se rrjetet sociale ndikojnë negativisht në menaxhimin e kohës së përdoruesve, nuk mundet të jetë një tezë e cila mohon në mënyrë kategorike të gjithë efektet pozitive që rrjetet sociale kanë sjellë e për revolucionin e madh në fushën e komunikimit.

Jo masivizimit të përdorimit të rrjeteve. Minus-et e mëdha

Ka padyshim disa anë të errëta të cilat vijnë si rezultat i përdorimit të rrjeteve sociale në mënyrë të pakontrolluar e jo të dobishme. Sjellja e përdoruesve të rrjeteve sociale ngërthen në vetvete disa problematika të cilat kurrsesi nuk kërkojnë të zbehin gjithë efektet pozitive që ky revolucion teknologjik komunikimi ka sjellë. Edhe të rinjtë shqiptar, përballen me problematika të ngjashme me të cilat përballen edhe shumë të rinj të vendeve tjera. Këtu do të mund të listojmë vetëm ato problematika të cilat kanë rezultuar konkretisht nga studimi, në mënyrë që ta kontekstualizojmë sa më shumë qasjen tonë.

Që prej kohës së themelimit të rrjeteve sociale janë evidentuar botërisht disa efekte anësore të njohura botërisht dhe që mesa duket edhe tek të rinjtë e intervistuar evidentohen qartazi. Këto efekte apo pasoja vërehen në aspektin social, psikologjik e madje edhe atë fizik. Përdoruesit e rëndomtë të rrjeteve sociale konsiderohen si 'vrasës tipik'. Ata vrasin gjënë më të shtrenjtë që posedon një i ri, kohën, duke i përdorur rrjetet sociale më së tepërmi për argëtim, chat (biseda online në kuptimin e varësisë së komunikimit virtual). Në ditët tona vërehet se të rinjtë kanë interes përherë e më të ulët për lexim dhe studim, duke humbur shumë kohë në rrjete sociale e duke mos arritur të vendosin ekuilibra mes të dyjave.

Rrjetet sociale ushtrojnë një lloj presioni social mbi individin duke e detyruar atë të ketë përgjithësisht një sjellje ashtu siç e kërkojnë rrjetet duke e çuar atë në jo pak raste në dyzim të personalitetit. Shumica e përdoruesve vetë pohojnë se në rrjete sociale ndërtojnë një profil jo rrallë herë është i ndryshëm nga ai i jetës reale. Ky dyzim, në momentin që i ballafaqon me jetën reale i orienton përdoruesit drejt nervozizmit, agresivitetit e deri në sjellje devijante. Shumë prej tyre janë të prirur të reklamojnë e ekspozojnë gjëra personale për shkak se ashtu bën shumica. Të rinjtë humbasin kohë në rrjete duke u ekspozuar, duke komentuar e duke komunikuar me njëri-tjetrin e duke e çuar virtualitetin në kufij të pakontrollueshëm. Vetë rrjetet sociale duket se diktojnë disa sjellje që janë të ngjashme për shumicën e

përdoruesve. Ato të kërkojnë të jesh njëkohësisht i/e bukur, i/e zgjuar, interesant/e etj. Ato ndikojnë në sjelljen e përdoruesve duke kërkuar që jo rrallë herë ai/ajo të ndryshojë personalitetin e tij. Në rrjete individit nis të ndërtojë një profil e personalitet i cili e çon atë deri në narcizizëm. Sipas Marshall McLuhan, mënyra më e mirë për ta shpjeguar influencën e madhe të medias tek individit, mund të bëhet nëpërmjet mitit të narcizit i cili duke e parë reflektimin e tij në ujë u dashurua me të. Narcizi nuk u dashurua me veten e tij reale por me veten si zgjatim i asaj që pasqyron media. Pra me veten e krijuar. (McLuhan. M sipas Mulder, A. 2004:67)

Gjithmonë duke ju referuar efekteve negative në aspektin social, vërehet gjithashtu një dobësim i motivit social të individit, duke e larguar atë nga aktivitetet e lira e duke vënë vazhdimisht në rrezik edhe identitetin e tij. Një tjetër problem ose efekt negativ lidhur me masivizimin e përdorimit të rrjeteve sociale lidhet direkt edhe me prirjen e individit për tu izoluar nga familja, shoqëria, grupet e interesit etj. Tanimë, është bërë normale që të rinjtë të komunikojnë pa kufi nëpërmjet rrjeteve sociale e të shmangin takimet reale me miqtë dhe të afërmit. Duket sikur ka një lloj kalimi nga “kafe në bare” tek “kafe në rrjete”. Kjo lloj dukurie shoqërohet edhe me një ngjarje tjetër, atë të rimodelimit të gjuhës së shkruar në rrjete. Mesazhet e komunikimit joverbal përcjellin mesazhe të cilat lejojnë një gamë të gjerë mënyrash të të kuptuarit nga të tjerët në krahasim me komunikimin verbal (Dervishi, Z. 2008:257). Kjo prirje dhe nevojë e re për të komunikuar masivisht në rrjete sociale dobëson lidhjet reale me të afërmit duke krijuar një lloj vakumi shoqëror e duke e thelluar edhe më tej procesin e individualizimit të njeriut. Rrjetet sociale po i bëjnë njerëzit asocial pasi që shoqëria po bëhet gjithmonë e më e lidhur në rrjet e gjithmonë e më e largët jashtë rrjetit.

Tejmase të rëndësishme janë efektet e llojit psikologjik e sigurisht efekti më i rëndësishëm është ai i lidhur me varësinë ndaj përdorimit të rrjeteve sociale. Të rinjtë janë kategoria më e “pangopur” në shpenzimin e kohës në internet. Kjo sigurisht që ndërlidhet edhe me pasoja të tjera në jetën e individit. Një i ri i cili shpenzon shumë kohë në internet e rrjete sociale është i prirur të ketë pak ose aspak interes për aktivitete të tjera rinore. Një individ i varur është i prirur të jetë vazhdimisht i pranishëm në rrjete jo vetëm duke rifreskuar profilin e tij virtual por edhe duke vëzhguar të tjerët e duke kërkuar hapësira të pafundme komunikimi, interes për njohje virtuale, lojëra, ndarje videosh etj. Një individ i varur shpesh është i lodhur. Kjo lodhje shpesh shoqërohet me stres e ky i fundit jo rrallë herë çon në lindjen e çrregullimeve. Një individ i varur nga rrjetet sociale është i prirur që çdo gjë tijën ta lidhë me këto rrjete. Edhe kur takon njerëz në jetën e tij reale ai sërish flet e i referohet realitetit virtual. Të rinjtë të cilët i përdorin së tepërmi rrjetet sociale në të shumtën e rasteve përcjellin shumë ngjarje nga jeta e tyre shpirtërore e gjëndja emocionale. Komunikimi joverbal është shumë më i përshtatshëm për të shprehur qëndrimet dhe ndjenjat në krahasim me idetë (Dervishi, Z. 2008:265).

Rrjetet sociale ndikojnë psikologjikisht mbi përdoruesin për shkak se ato shumë herë shkaktojnë ndrydhje dhe zvogëlim të aftësive njohëse dhe potencialit të tij për të shfaqur realisht personalitetin e tij.

Përveç efekteve në aspektin social e psikologjik të individit, Organizata botërore e shëndetit (OBSH) ka radhitur edhe disa pasoja në aspektin e zhvillimit fizik, të lidhura me efektin që kanë valët elektromagnetike mbi disa sëmundje, efekte të lidhura me shikimin e individit, dobësimin e aftësisë perceptivë, dhimbje të shtyllës kurrizore, lodhje e dhimbje të qafës, duarve etj. Përdorimi i internetit në përgjithësi është radhitur si ndër faktorët kryesor në Obezitet (OBSH, 2001).

Gjetjet e studimit dhe diskutimi

Analiza në këtë studim ravijëzohet në disa drejtime kryesore:

- Cilat janë rrjetet sociale që njohin e përdorin më së shumti të rinjtë
- Sa kohëharxhojnë mesatarisht në ditën rrjete sociale
- Cili është perceptimi i përgjithshëm që kanë për to
- Sa të vetëdijësuar janë mbi efektet negative si rezultat i përdorimit të rrjeteve sociale në masë.

Në sesionin e parë qëllimi ishte të kuptohej sa të njohura i kanë një sërë rrjetesh sociale të rinjtë dhe ju dha mundësia të zgjidhnin një ose më shumë alternativa si dhe të zgjidhnin se cilin rrjet përdornin më së tepërmi. Rezultatet e sesionit të parë të pyetjeve treguan që rrjeti social Facebook është rrjeti që njohin e përdorin pothuajse të gjithë, ku 95% prej tyre e kanë zgjedhur si rrjetin e parë që njohin. Pas Facebook, renditja vazhdon me Youtube e Instagram. Por mjaft domethënës ishte rezultati prej 17.5% ku subjektet konfirmuan se praktikisht i njohin gjithë rrjetet sociale edhe pse përdorin disa prej tyre bazuar në preferenca personale. Kjo veçse konfirmon edhe njëherë që ashtu si të rinjtë e shumë vendeve të botës edhe të rinjtë tanë njohin e janë përdorues masiv të rrjetit më popullor në botë, Facebook. Ky i fundit për shkak të numrit të lartë të pjesëmarrësve dhe opsioneve që ofron i bën individët të tërhiqen prej tij e ta përdorin së tepërmi duke ndarë aty statuse, komente, foto e shumë ngjarje të tjera lidhur me jetën e tyre personale, familjare e më pak atë profesionale. Edhe pse vitin e fundit është vërejtur një rënie e aktivitetit në Facebook dhe rrjeti që po bëhet përherë e më popullor e që njihet shifra në rritje është Instagram. Megjithatë Facebook për të rinjtë studentë vazhdon të jetë rrjeti më popullor (Noor Al-Deen, H.S dhe Hendricks, J.A. 2012:3). Deri në gjysmën e vitit 2016 ai numëronte 1.71 bilion përdorues. Në këtë shifër u

konsideruan përdorues ata të cilët kanë përdorur Facebook minimalisht njëherë në harkun e një muaji⁴.

Referuar kohës që një i ri harxhon në ditë në rrjete sociale u pa se shumica i përdorin ato çdo ditë, madje për më shumë se 1 orë (40%). Dy orë e më shumë i përdorin rreth 25% e të intervistuarve, ndërsa rreth 1 orë në ditë 10%. Vetëm 2.5% e subjekteve pohuan se hynë rrallë në rrjete sociale, disa herë në javë. Megjithatë, rrjetet mbeten pjesë e pandashme e të rinjve dhe jo vetëm. Ashtu siç pohon Dominick, J.R në studimin e tij duke mos kategorizuar vetëm të rinjtë: *“çdo ditë miliona njerëz hynë në sajtet e rrjeteve sociale, kontrollojnë lajmet. Blejnë, lexojnë lajmet, këmbëjnë video, shkarkojnë muzikë dhe madje mund të jetojnë edhe jetën e dytë”* (Dominick, J.R 2010:421). Pra, të rinjtë janë tanimë aq të përfshirë nga interneti e rrjetet sociale saqë ata janë vazhdimisht të pranishëm aty e në këtë mënyrë anashkalojnë shumë aktivitete tjera të cilat duhej të mbushnin kohën e tyre. Të tilla si leximi, pjesëmarrja në aktivitete rinore e kulturore, puna vullnetare etj. Ata, njëkohësisht janë më pak të prirur që të izoloohen e të kenë gjithnjë e më pak kontakte me miqtë e të afërmit. *“Një sondazh zbuloi se rreth 65% e të intervistuarve shpenzon më shumë kohë me kompjuterin sesa me bashkëshortin apo ndonjë person tjetër”* (Dominick, J.R 2010:420). Në këtë kontekst edhe rrjeti social më me ndikim në botë, Facebook, është bërë pothuajse rutinë dhe pjesë e përditshmërisë së tyre. Rezultati ynë konfirmohet edhe nga një tjetër studim. Të bërë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sipas të cilit u pa se të rinjtë studentë e përdorin Facebook mbi 30 minuta në ditë si pjesë të përditshmërisë së tyre (Pempek, Yermelayeva, & Calvert, 2009:227, sipas (Noor Al-Deen, H.S dhe Hendricks, J.A. 2012:3).

Perceptimi që të rinjtë kanë për rëndësinë e rrjeteve sociale dhe kontakteve në rrjete

Përsa i përket vetë perceptimit që të rinjtë kanë mbi rrjetet sociale rezultoi që pjesa më e madhe ka një mendim tejet pozitiv për to duke i cilësuar ato si shumëfunktionale, si mjet që lehtëson komunikimin e tyre me njerëzit, si mënyrë informimi të shpejtë apo argëtimi saherë që ju jepet mundësia. Duhet pranuar që interneti dhe rrjetet sociale në përgjithësi janë mjaft të preferueshme për marrjen e shpejtë të informacionit. *“Në aspekt pozitiv interneti ka gjeneruat një sasi shumë të madhe informacioni e cila është e gatshme për tu përdorur nga studentët”* (Dominick, J.R 2010:442). Mirëpo kjo përpjekje për t’ju referuar internetit si burim i parë informacioni shkencor është e gabuar pasi që jo çdo lloj informacioni i dobishëm mund të gjendet në internet. Rreth 44.5% i konsideron ato shumë të mira për të ruajtur lidhjet e komunikuar me miqtë e të afërmit. Rreth 10.5% i shohin si një mjet i shpejtë për tu informuar e qënë në kontakt me të rejtat e fundit. 25% i

konsiderojnë si një mënyrë e mirë argëtimi. Mjaft interesant është rezultati prej 11.5% të cilët mendojnë se rrjetet sociale janë të rëndësishme për të ndjekur njerëz të famshëm të cilët i frymëzojnë. Vetëm 3.5% e tyre mendojnë që rrjetet sociale nuk kanë ndonjë rëndësi të veçantë për ta.

Përsa i përket marrëdhënies që përdoruesit krijojnë me kontaktet e tyre në rrjete u pa se shumica e të intervistuarve ju japin përparësi kontakteve nëpërmjet internetit, individët me të cilët ndajnë debate online, mesazhe, video etj, i konsiderojnë si pjesë mjaft e rëndësishme e jetës së tyre të përditshme dhe ruajnë marrëdhënie të komunikimit të vazhdueshëm. Rreth 59% mendojnë se kontaktet dhe komunikimet në rrjete janë mjaftueshëm të rëndësishme. Një pjesë e tyre (rreth 29%) madje i konsiderojnë miqësitë virtuale shumë të rëndësishme e 6.5% madje i konsiderojnë të domosdoshme. Pak domethënëse i konsiderojnë vetëm 3.5% e 2% aspak të rëndësishme. Një nga problematikat e komunikimit virtual është edhe fakti që shumë të rinj krijojnë kontakte me njerëz të panjohur ose njerëz të fushave të ndryshme të cilët i admirojnë dhe kjo shpesh shoqërohet me një lloj presioni tek individ i cili fillon të mendojë se jeta e tij nuk është aq e bukur dhe interesante sa ajo e shumë miqve virtualë. Individ i cili gjendet nën presionin e rrjeteve sociale përjeton ndjenja ankthi e izolimi të vazhdueshëm.

Efektet e përdorimit masiv të rrjeteve sociale

Pjesë e dytë e rëndësishme në analizën tonë i referohet pikërisht efekteve që vijnë si rezultat i përdorimit masiv të rrjeteve sociale. Efekti i parë negativ i referohet pikërisht mungesës së efikasitetit në menaxhimin e kohës nga ana e të rinjve të cilët i përdorin së tepërmi rrjetet sociale dhe janë tepër të apasionuar pas tyre. Ata kryesisht janë të rinj të cilët shpenzojnë shumëkohë duke naviguar gjatë nëpër rrjete sociale. *“Të rinjtë në përgjithësi janë të prirur që të humbasin kohë pas botës virtuale, madje ajo mund të shndërrohet në të vetmen gjë të preferueshme për ta nëse nuk do të ekzistonin kufizimet apo parandalimet nga familja, institucionet shkollore e shoqëria”* (Rreth 45% mendojnë se koha që ata shpenzojnë në rrjete nuk ju ndikon në kohën e studimit. Ndërkohë që 30% mendojnë që në fakt koha që harzhojnë në rrjete sociale është kohë e humbur edhe pse nuk arrijnë ta shmangin dot. Rreth 15% shfaqen skeptikë për pyetjen dhe 10% nuk e kanë menduar ndonjëherë që koha që shpenzojnë në internet ju ndikon në kohën e leximit. Megjithatë, për të kuptuar më mirë përgjigjet e këtij sesi u përdor një pyetje tjetër e cila heton më mirë duke kërkuar informacion mbi mënyrën sesi e menaxhojnë dhe shpenzojnë kohën të rinjtë. Rreth 36% mendojnë se arrijnë të ekuilibrojnë gjithmonë kohën në rrjete sociale me aktivitetet e tjera. Madje 31.5% shprehen se e menaxhojnë shumë mirë atë. Ndërkohë që 18.5% shprehen se e kanë të vështirë të vendosin me eikasitet. Vetëm 13.5% u përgjigjën që e kanë tepër të vështirë të ekuilibrohen.

⁴ <https://www.statista.com/statistics/264810/number-of-monthly-active-facebook-users-worldwide/>

Për të kuptuar raportin e të rinjve me rrjetet sociale ju kërkua që të përgjigjen mbi aktivitetet të cilat ata i konsiderojnë të rëndësishme. Pohimet ishin të larmishme. Një pjesë e madhe pohuan se studimet janë parësore për ta. Më pas shumë u përgjigjen që koha në internet është një mënyrë shumë e mirë për tu argëtuar e shpenzuar kohën e lirë. Disa parapëlqejnë të shpenzojnë kohë në kafe me miqtë. Disa parapëlqejnë të merren me vullnetarizëm e një pjesë e vogël me aktivitete sportive. Ishin vetëm 8 të rinj në 200 të intervistuar të cilët pohuan se kanë pasion leximin, çka vërteton që dobësimi i motivit për të lexuar është në rritje.

Përsa i përket efekteve negative në kuptimin e dëmtimeve fiziologjike e psikologjike, u pa se një pjesë e subjekteve kanë ndjerë shpesh lodhje gjatë përdorimit të internetit e rrjeteve sociale për një kohë relativisht të gjatë. Shumica pohuan se kanë ndjerë kryesisht lodhje te syve, kjo shpjegohet edhe me faktin se shumica e të rinjve tanimë i aksesojnë rrjetet sociale kryesisht nëpërmjet telefonave celularë. Ashtu siç pohon edhe autori, Tofler Alvin në librin e tij “*Tronditjet e së ardhmes*” ku thotë se: “*zhvillimi i shpejtë i teknologjisë shpie në një mori shqetësimesh fizike e mentale*”. Por, dëmtimet fiziologjike ndoshta nuk janë më të shpeshta se ato të llojit psikologjik. Një pjesë e përdoruesve përfshihen nga ndjenja të përziera të tilla si euforia, ankthi, emocioni etj gjatë kohës së përdorimit të rrjeteve. Të rinjtë të cilët janë tepër aktivë në rrjete, sillen e veprojnë në një mënyrë apo në një tjetër e cila shumë shpesh nuk shpreh mendimet e ndjenjat e tyre të vërteta.

Përfundime

Të rinjtë që ishin pjesë e këtij studimi ishin përdorues të rregullt të rrjeteve sociale prej ku rrjeti social më popullor rezultoi të ishte Facebook. Shpenzimi i kohës duke naviguar në internet dhe në rrjete sociale përgjithësisht është pjesë e pandashme e rutinës së tyre të përditshme. Nga ky studim u pa që të rinjtë janë të prirur ti përdorin rrjetet sociale masivisht për të kontaktuar me miqtë e tyre realë por edhe për të krijuar kontakte të shumta virtuale. Pjesa më e madhe i përdorin si një mjet argëtimi, komunikimi, ndjekja e njerëzve të famshëm apo njerëz të shquar të fushave të interesit. Shumica e të intervistuarve përdor rrallë rrjetet sociale për promovimin e ndonjë kauze sociale apo kulturore, edhe pse një pjesë e vogël pohuan se marrin pjesë në aktivitete të ndryshme të natyrës sociale prej ku informacionin për këto aktivitete e sigurojnë nëpërmjet rrjeteve sociale.

Në përgjithësi të rinjtë kanë një konsideratë të lartë për rrjetet sociale dhe i vlerësojnë ato si një risi e jashtëzakonshme e teknologjisë së komunikimit, si një mjet me të cilin argëtohen e krijojnë njohje të reja. Tanimë që rrjetet sociale mund të navigohen lehtësisht nëpërmjet telefonave celularë, të rinjtë kanë mundësinë që të jenë gjatë gjithë kohës të informuar mbi atë se çfarë ndodh me miqtë e tyre virtualë.

Një pjesë i ndjekin në mënyrë aktive edhe portalet informative online duke mos pasur nevojë të shfletojnë shtypin e shkruar apo të ndjekin me interes mediat vizive.

Qartësisht, koha që shpenzojnë të rinjtë në rrjete sociale si Facebook apo Instagram, Youtube, faqe të ndryshme chati online etj, ndikon në reduktimin e interesit të tyre për aktivitete të rëndësishme siç është për shembull leximi. Ata nuk arrijnë të vendosin dot një raport efikas mes kohës që shpenzojnë në rrjete dhe kohës së leximit. Dita ditës është duke u zbehur kultura e leximit, një zbehje tek e cila ndikojnë sigurisht edhe aktorë të tjerë që e rrethojnë individin. Të tillë si familja, shkolla, grupi shoqëror etj. Me këtë pohim nuk kërkohet të përgjithësohet problemi e të konsiderohet koha e humbur në rrjete sociale si një faktor determinant në mungesën e suksesit të një të riu apo në performancën e tij të dobët akademike. Por është fakt që rrjetet sociale ndikojnë në motivin për mësim, ku sot shihet një interes nën mesatar për lexim dhe mësim duke humbur shumë orë gjatë ditës në rrjete sociale e duke mos arritur të menaxhojnë kohën. Kjo sigurisht që sjell edhe një pasojë tjetër, atë të reduktimit të produktivitetit të të rinjve. Edhe në kuadër të marrjes së informacioneve për realizimin e detyrave të ndryshme ata ju drejtohen pikë së pari internetit dhe jo bibliotekave, pa marrë parasysh që shumica e informacionit në rrjete është i paçertifikuar. Të rinjtë që ishin pjesë e këtij studimi ju përgjigjen negativisht mundësisë së pësimi dëmtime fiziologjike, psikologjike e sociale si rezultat i përdorimit të rrjeteve sociale në mënyrë të pakontrolluar. Madje një pjesë e tyre pohojnë se gjatë përdorimit të rrjeteve ndihen më euforikë, më të kënaqur dhe më komunikues.

Nuk ka antidot i cili mundet ti ndalë sot për sot rrjetet sociale për nga aspekti i masivizimit të tyre. Një hap i parë drejt zgjidhjes së problemit, konkretisht reduktimit të kohës së humbur në rrjete sociale është që vetë të rinjtë të informohen e ndërgjegjësohen mbi këto efekte negative. Një hap i dytë do të ishte një llojdetoksikimi dixhital term i përdorur së fundmi nga studiuesit e komunikimit, i cili nënkupton një distancim gradual apo edhe të menjëhershëm nga teknologjia përgjithësisht e sigurisht nga rrjetet sociale të cilat e mbajnë në mënyrë të pashmangshme individin të lidhur me teknologjinë.

Dy fjalë mbi të ardhmen: Pritet që intelijenca artificiale të rritet në të ardhmen e njeriu mund të bëhet aq i varur saqëmund të jetë ai i cili të vihet në shërbim të teknologjisë e jo më teknologjia në shërbim të tij. Ky robotizimi i frikshëm por edhe i mahnitshëm pritët të prekë edhe më shumë jetët tona. Edhe vetë shkrimi i këtij punimi është bërë ndërkohë që shpesh në njërin nga dritaret e monitorit të kompjuterit lexohet Facebook, çka rikonfirmon edhe njëherë nevojën tonë ende të pashpjegueshëm për të qenë të lidhur në rrjet e për të ndarë e komentuar virtualisht çdo gjë që prekim e na prek. Jetojmë në shekullin e kibernetikës apo në epokën e internetit, ku sa më shumë robotizojmë atë që na rrethon duket sikur humbasim shpirtin.

Bibliografia

- Dervishi, Z. (2005). *Lente të Ndërveprimit Simbolik*. Tiranë:Emal.
- Dominicik, J.R. (2010). *Dinamika e Komunikimit Masiv: Media në periudhën digjitale*. Tiranë:Uet-Press.
- Dragoti, E. (2004). *Psikologjia Sociale*. Tiranë: Toena.
- Greenfield, P.M. (2014). *Mind and Media. The effects of Television, Video Games and Computers*. revised edition, New York: Psychology Press.
- Guerrero, L.K and Floyd, K. (2006). *Nonverbal Communication in Close Relationships*. New Jersey: LEA Publishers.
- Hartley, J. (2007). *Communications, cultural and Media Studies*. London and New York: Routledge.
- McLuhan, M. (1999). *Understanding Media, The extensions of man*. London: The Mit Press.
- Mulder, A. (2004). *Understanding Media Theory: Language, Image, Sound, Behavior*. Rotterdam: V2_publishing
- Noor Al-Deen, H.S and Hendricks, J.A. (2012). *Social Media: Usage and Impact*. London: Lexington Books.
- Tofler, A. (1990). *Future Shock*. New York: Bantam books.
- Web bibliografia
- www.statista.com/statistics/264810/number-of-monthly-active-facebook-users-worldwide/
- <http://www.instat.gov.al/al/themes/tregu-i-pun%C3%ABs.aspx?tab=tabs-5>
- https://en.wikipedia.org/wiki/Internet_addiction_disorder

RECENCË

Identiteti i Partive Politike në Shqipëri gjatë periudhës 1990–2013. Roland Lami & Aleksandër Kocani. Shtëpia botuese: Lambert Academic Publishing

Anjeza Xhafferraj

Rënia e dallimeve ideologjike ndërmjet partive politike u artikulua që në mes të viteve 1960-të, kur Otto Kircheimer identifikoi një tipologji të re partiake, atë 'catch-all' apo thënë shqip 'kap gjithkënd'. Në ndryshim nga partia e masave që e siguronte suksesin prej aftësisë për të rritur gjithmonë e më tepër përkushtimin e një elektorati që 'natyrshëm' do të votonte për të për shkak të identifikimit ideologjik të përbashkët, partia 'kap gjithkënd' i drejtohej gjithkujt pavarësisht përkatësisë shoqërore. Ajo sfidoi nocionin e partisë si përfaqësuese e sektorëve të mirë-përcaktuar të shoqërisë. Partia 'kap gjithkënd' lindi në një periudhë ku kufijtë socialë tradicionalë kishin filluar të binin duke çuar në rënie të identiteteve kolektive të qarta dhe ku kishim një rritje të rëndësisë së shtetit të mirëqenies sociale gjë që lehtësonte elaborimin e programeve që nuk ishin as përçarëse dhe as partizane, por që pretendonin se i shërbenin interesave të të gjithëve, ose pothuaj të gjithëve. Së fundmi, vitet 1950-1960-të karakterizohen nga zhvillimi i mass medias gjë që ndryshoi komunikimin e drejtuesve të partisë me elektoratin sepse u dha mundësinë t'i drejtoheshin në të njëjtën kohë të gjithë elektoratit, i cili tashmë përbëhej nga votues që silleshin më tepër si konsumatorë se sa si pjesëmarrës aktivë. Në vazhdim të dobësimit të lidhjeve të partisë me shoqërinë vazhdoi edhe Angelo Panebianco (1982) me partinë elektoral-profesionale ku rëndësi më të madhe kishin profesionistët sesa anëtarësia e thjeshtë dhe së fundmi Katz dhe Mair (1995) të cilët observuan lidhjen e partisë me shtetin dhe dobësimin e lidhjeve partizane.

Megjithatë rënia e sistemit komunist dhe krijimi i gjithë hapësirës post-komuniste, krijoi një hapësirë të madhe boshe përse i përket literaturës që merr

në shqyrtim shoqëritë në tranzicion ku bën pjesë edhe Shqipëria. Ashtu sikundër edhe vendet e tjera post-komuniste, edhe Shqipëria hasi vështirësi për të patur një demokraci perëndimore për shkak të së shkuarës komuniste, e cila e pengonte avancimin drejt demokracisë dhe si rezultat kemi krijimin e një demokracie hibride që shfaq elemente të së shkuarës komuniste dhe të demokracisë perëndimore.

Ky është edhe sfondi ku zhvillohet analiza e librit Identiteti i Partive Politike në Shqipëri gjatë periudhës 1990-2013 me autorë Roland Lami dhe Aleksandër Kocani. Sipas autorëve, si faktorë të pengimit të krijimit të një demokracie të konsoliduar në Shqipëri mund përmenden trashëgimia e të njëjtave burime njerezore të sistemit komunist, padituria e elitave të sistemit të shkuar të cilat nuk e njihnin sistemin e ri, gjë që u kthye në një sfidë për ta, grupet sociale të homogjenizuara për shkak se sistemi komunist i kish rrafshuar të gjitha dallimet shoqërore gjë që sillte pengesa për të patur diversitetet ideologjik. Pikërisht këta faktorë të 'rinj' të ndryshëm nga faktorët që çuan në transformin e partive politike në perëndim, bëjnë që edhe në vendet post-komuniste dhe konkretisht në Shqipëri të shfaqet një model i ri partie, dhe mbi të gjitha një paqartësi ideologjike në lidhje me programet partiake si nga ana e partive ashtu edhe nga ana elektoratit.

Autorët ngrenë pyetjen: A kanë partitë politike shqiptare ideologji apo janë parti pragmatike? Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje u morën në shqyrtim dy partitë kryesore të spektrit politik shqiptar: Partia Socialiste dhe Partia Demokratike. Autorët kanë përdorur metodën e analizës së ligjërimit kritik me anë të së cilës janë analizuar programet e partive që prej vitit 1990-të. Po kështu autorët kanë kryer edhe matje në elektoratin e Tiranës për të parë nëse ky elektorat identifikohet me të majtën apo të djathtën.

Ajo ç'ka nxjerr në pah studimi është se edhe e majta edhe e djathta kanë elementë edhe të majtë edhe të djathtë si në programe ashtu edhe në sjellje politike kur janë në pushtet. Po cilat janë shpjegimet për këtë gjë? Sipas autorëve pesë janë faktorët që kanë ndikuar këtu: 1- Trashëgimia komuniste; 2- Mos-strukturimi i grupeve sociale në zonat urbane dhe rurale; 3- Kultura politike dhe elita politike; 4- Strukturat ndërkombëtare që imponojnë axhendën dhe së fundmi 5- Media.

Në lidhje me faktorin e trashëgimisë komuniste, autorët komentojnë se me rënien e sistemit komunist, vendi u përball me sfidën e vendosjes së kontrollit demokratik mbi hapësirën publike dhe ri-dimensionimin e shtetit. Megjithatë, në Shqipëri, ndoshta edhe më shumë se sa në vendet e tjera post-komuniste kjo ishte e vështirë sepse megjithëse u bënë përpjekje për të vendosur institucione dhe rregulla sipas modelit Perëndimor, vendit i mungonte kultura politike andaj edhe mund të thuhet se patëm një model demokracie sui generis. Për shumë vite vendi ishte indoktrinuar nga një pseudo-ideologji marksiste-leniniste dhe drejtohej nga një parti e vetme, nga partia totalitare. Për rreth një shekull, Shqipëri kish qenë e izoluar prej botës dhe nuk i njihte parimet demokratike dhe kjo së bashku me

mungesën e tranzicionit demokratik e bënë të vështirë suksesin e demokracisë. Për më tepër trashëgimia komuniste e pat dëmtuar vendin edhe në aspektin ekonomik, shëndetësor, bujqësor duke e çuar vendin në një kolaps të plotë nga i cili ishte e vështirë të dilej. Po kështu vendi u përball edhe me një vakuum ligjor gjë që solli një seri problematikash që mbetën të tilla jo vetëm në vitet e para të tranzicionit por edhe më tej.

Në lidhje me faktorin e dytë, pra mos-strukturimin e grupeve sociale në zonat urbane dhe rurale mund të thuhet se dinamika e lëvizjes migratore krijon një dinamikë identitësh të grupeve sociale dhe kjo i vendos në dilemë partitë politike që e lënë ofertën politike në disa nevoja bazë duke rritur kështu ngjashmëritë mes së majtës dhe të djathtës përsa i përket programit politik. Në zonat peri-urbane flitet për infrastrukturë, legalizim, kanalizim, urbanizim, shërbime sociale. Në zonat rurale flitet për relievin e tokës, teknologjinë, lëvizjet migratore, relievin e thyer, hidrovolet, subvencionimet, kanalizimet, infrastrukturën, tregjet e përbashkëta, cmimet, heqjen e TVSH për fara, naftën. Dhe së fundmi në zonat urbane flitet për mungesën e investitorëve të huaj dhe në një kohë kur biznesi familjar nuk ngrihet në nivelin e grupeve të interesit dhe nuk kemi sindikata, atëherë kërkesat mbeten të njëjta. Kjo strukturë e bën ligjërimin politik të majtë dhe të djathtës të përgjithshëm dhe jo ideologjik sepse synon të perfaqësojë shumicën e elektoratit që do ta sjellë apo do e mbajë në pushtet. Edhe shoqëria civile ka problematikën e mbijetesës, të financimit, qarkullimit të elitave. Ajo i gjen fondet nga donatorët e huaj, politikat e të cilëve nuk lidhen me kontekstin shqiptar dhe për pasojë i pershtasin programet në perputhje me donatorët, duke mos përfaqësuar kështu interesat e grupeve sociale në Shqipëri. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për sindikatat të cilat nuk janë të orientuara rreth interesit të punëtorëve por janë të rreshtuar në krahë politikë. Pram und të thuhet se në Shqipëri nuk ka struktura që të strukturojnë ligjërimin e partitë politike, andaj edhe ligjërimi nuk është më ideologjik.

Faktori i tretë i identifikuar prej autorëve është kultura e munguar politike dhe elitat politike. Sipas autorëve është e vërtetë që sistemi politik ndryshoi por dija mbeti e njëjtë sepse mungonin burimet njerezore për ta ushqyer atë. Në Shqipëri nuk ka ende një konsensus për dijen politike andaj edhe një fenomen që u vu re në Shqipëri është shfaqja e elitave teknike të cilat u rreshtuan krah njëres parti apo tjetres. Po kështu edhe shoqëria civile u integrua apo absorbua në partitë politike duke humbur kështu rolin e saj si artikulesë të interesave të shoqërisë. Elitat politike mbetet gjithsesi më të fuqishme se teknikienët dhe shoqëria civile duke sfumuar kështu zërin e tyre brenda rradhëve të partisë politike.

Faktori i katërt ka të bëjë me strukturat ndërkombëtare që imponojnë axhendën. Fillimisht PD detyrohet të ndërmarrë reforma neo-liberale nën rekomandimin e Bankës Botërore dhe FMN-së dhe më pas përgjithësisht si e majta ashtu edhe e djathta kanë qenë të detyruara t'ia nënshtrojnë reformat

organizatave ndërkombëtare dhe vitet e fundit veçanërisht Bashkimit Evropian. Debati nuk organizohet sipas linjave ideologjike e majtë- e djathtë por kush do e cojë Shqipërinë më shpejt në BE dhe kush i zbaton më mirë udhëzimet e dhëna. Ndodh pra ajo që Paul Taggart thotë se duke gjurmuar BE-në mund të gjurmojmë edhe konturet e sistemit partiak të një vendi. Pikërisht kjo gjë e bën debatin teknik dhe jo ideologjik. Tashmë studjuesit e ndikimit të BE-së mbi partitë politike janë dakortësuar se BE nuk ka shkaktuar ndonjë ndarje të re në sistemin partiak, por përkundrazi përgjithësisht është pika e takimit ndërmjet partive politike. E njëjta gjë ka ndodhur edhe në Shqipëri dhe kjo e sipas autorëve Lami dhe Kocani e ka kthyer debatin në teknik dhe jo ideologjik.

Faktori i fundit që ka ndikuar në mungesën e ideologjisë si strukturuese të debatit politik është media. Natyra e fushatave elektorale në Shqipëri nuk është gjë tjetër veçse produkt i kompanive të marketingut që i dizenjojnë ato. Pushteti që ka marrë media ka ardhur si rezultat i rënies së strukturave të partive politike si institucione të përfaqësimit, karrierës dhe hartimit të politikave, si edhe rritjes dhe fuqizimit të rolit dhe influencës politike të mediave dhe bizneseve që i sponsorizojnë ato. Sipas autorëve media në Shqipëri ka shumë formë dhe pak substancë. Rrjetet sociale kanë shumë personalizim dhe pak përfaqësim grupi sepse ndalen kryesisht tek elementet estetik dhe intim dhe jo tek interesat e grupit. Andaj edhe elementet e intimes/privates kanë qenë aq shpesh prezente në fushatat elektorale. E megjithatë drejtuesit e partive politike shqiptare e kanë kuptuar rëndësinë e Telematikës dhe duket sikur i japin të njëjën rëndësi si anëtarësisë në terren ashtu edhe followers në rrjet.

Si përfundim mund të thuhet se libri konfirmon se ka një krizë përfaqësimi në Shqipëri dhe se partitë politike janë të distancuara prej qytetarëve. Kjo gjë ka ndodhur se asnjë prej partive politike nuk ja ka dalë të ndërtojë një elektorat identiteti. Në këtë kontekst, libri është jo vetëm një hartë që na drejton drejt paqartësive ideologjike të elektoratit dhe partive politike, por na shpjegon edhe faktorët që kanë çuar në këtë paqartësi. Materiali i shumtë teorik dhe empirik e bën librin shumë të vlefshëm. Andaj ky studim nuk është një punim të cilit mund t'i referohet vetëm studjuesi i shkencave politike, por edhe një pikë reference për partitë politike shqiptare që do të duan të reformohen.

RECENCË

Mbi librin “Vështrim i parë mbi Teorinë e Komunikimit” dhe dy pikëvështrime të lidhura me Shqipërinë

———— **Prof. Asoc. Dr. Bashkim Gjergji** ————

———— **Prof. Asoc. Dr. Belina Budini** ————

“Vështrim i parë mbi teorinë e komunikimit” është një tekst bazë që përdoret nga universitetet në shumë vende të botës, duke filluar nga ShBA. Autori i saj, Em Griffin, është bërë kështu një emisar i teorive të komunikimit të studentët përmes këtij libri që ka nëntë ribotime deri tani. Si bashkautorë të botimit në shqip të këtij teksti, kemi punuar me të në shumë nivele. Personalisht, si lektore e komunikimit në UET, i jam referuar këtij teksti prej vitesh, ndërsa punonim për ta sjellë në shqip. Pas shumë etapash përkthimi, përshtatje, redaktimi, përzgjedhje të elementeve për botimin në shqip, vështrimi mbi teorinë e komunikimit vjen më në fund i plotë. Angazhimi në të gjitha rolet e mësipërme ishte sipërmarrje e vështirë dhe e pamundur për t'u realizuar, pa mbështetjen e departamentit të Komunikimit dhe Marrëdhënieve Publike në Universitetin Europian të Tiranës.

Termat redaksionalë të botimit dhe kapitujt kontekstualizues për aspekte të komunikimit të lidhura me Shqipërinë, janë produkt i një përkushtimi të përbashkët në cilësinë e bashkautorëve për botimin shqip të këtij libri.

Megjithëse publikimi në shqip i “Teorive të komunikimit”, si teksti i parë i plotë në këtë fushë për përdorim studentor, është në radhë të parë lajm i mirë për vetë studentët, publikimi i tij është njëherësh çlirues edhe për pedagogët, pasi krijon bazën e të kuptuarit të ndërsjellët me studentët, duke nxitur thellimin dhe avancimin e vazhdueshëm dhe të dyanshëm në studime të komunikimit. Ndërsa grupi i autorëve, për botimin në anglisht, i shpjegojnë vetë gjithë detajet përmbajtësore dhe organizuese të “Vështrimit” në parathënien për instruktorët, në këtë hyrje të shkurtër shpjeguese për botimin në shqip, po ndalemi më tepër në

aspektet përzgjedhëse që kanë të bëjnë me botimin shqip si edhe kapitujt 38 dhe 39 që kanë autorësinë tonë të drejtpërdrejtë.

Për botimin shqip është përzgjedhur edicioni i nëntë i tekstit “A first look at communication theory”, duke referuar në pak raste, shembuj dhe studime, që autorët i kanë paraqitur në botimet e mëparshme, një pjesë e të cilëve gjenden të vendosur edhe në rrjet në anglisht. Konkretisht, kapitulli 18, që paraqet Teorinë e strukturimit të përshtatshmërisë nga Marshall Scott Poole, është ruajtur nga botimi i 8-të i librit, pasi një pjesë e mirë e këtij kapitulli i referohet teorisë së strukturimit të Anthony Giddens-it, një autor ky i njohur për studentët shqiptarë falë një teksti universitar të tij për sociologjinë. Po kështu, disa nga shembujt ose ilustrimet me anë të filmave ose shfaqjeve mediatike janë lënë të pandryshuara duke qenë se gëzojnë më tepër njohje dhe rezonojnë më tepër për studentët dhe për lexuesit në Shqipëri.

Gjuha e përdorur në këtë tekst është mjaft e përshtatshme për studentët me synimin që përmbajtja e tij të përcillet me sa më shumë qartësi. Ky parim është ruajtur edhe në përkthimin dhe redaktimin e tekstit në shqip, duke e përshtatur terminologjinë e tij sa më afër shqipes, edhe pse kjo nuk ka qenë gjithnjë e lehtë.

Pikëveshtrim i teorive, i lidhur me Shqipërinë

Konkretisht, kapitulli 38 me titull “Paraqitje të Shqipërisë në mediat e huaja” synon të hedhë një vështrim mbi komunikimin dhe teoritë e mediave me anë të një rasti të aplikuar studimor, që lidhet me vendin tonë. Në fakt, përmbajtja e çdo kapitulli në këtë libër ka në qendër ose si pikënisje një rast studimor, që ashtu siç pohojnë Griffin dhe të tjerët, shërben për të përcjellë reflektimet teorike mbi komunikimin te studentët, duke ndjekur parimin pedagogjik të shpjegimit të asaj që studentët s’e dinë ende me anë të ideve dhe pamjeve të njohura më parë prej tyre.

Ashtu si disa prej këtyre kapitujve, edhe kapitulli në fjalë, që ka autorësinë time (Belina Budini), është i lidhur ngushtë me një projekt kërkimor të zgjeruar. Njëlloj si në rastet e mësipërme, kur teoria buron prej një projekti kërkimor, edhe në këtë kapitull kërkimi është përshkruar në detaje dhe bazuar në vëzhgimet sistematike të ndërmarra. Një version më i plotë i projektit kërkimor për sa i përket mënyrës si paraqitet Shqipëria nga mediat e huaja është vetë libri “Tri kohë të Shqipërisë në Time”, botim i UET Press, 2014.

Në fakt, baza teorike e këtij libri dhe projektit kërkimor që referohet në kapitullin 38, është mbështetur gjerësisht në teoritë e komunikimit dhe të mediave. Qasjet teorike të përzgjedhura u publikuan bashkë me librin, me synimin për të mbështetur dhe për të shpjeguar modelin aplikativ të mënyrës si paraqitet dhe ndërtohet tema e Shqipërisë në mediat ndërkombëtare (për një pamje më të plotë

të teorive të përdorura, shikoni librin). Mirëpo, për qëllimet e studentëve, korniza e tij teorike u bë një lloj leximi bazë, duke e përdorur më tej si mbështetje teorike edhe në punët e tyre të diplomës.

Ndërkaq modeli aplikativ i librit “Tri kohë të Shqipërisë në Time” fiton kështu një lloj lirie për të ekzistuar më vete, duke qenë se “Teoritë e komunikimit” ia sigurojnë bazën fillestare të njohjes dhe kuptueshmërisë për studentët. Kjo është arsyeja pse në këtë kapitull, si bashkautore në “Teoritë e komunikimit”, njëlloj si profesor Gjergji, kam zgjedhur të ndalem më gjatë te rasti i aplikuar në kontekstin e studimeve shqiptare sesa tek teoritë në vetvete. Ky kapitull përbën pra në thelb një sintezë të librit studimor “Tri kohë të Shqipërisë në Time”, përshtatur për studentët e komunikimit. Është monitoruar nga afër revista amerikane *Time*, duke analizuar të gjitha artikujt dhe publikimet e saj për Shqipërinë që nga viti i saj i parë i themelimit si revistë (1923) dhe deri sot (viti përmbyllës i studimit është viti 2013). Me anë të kërkimeve sasiore dhe cilësore, janë prodhuar të dhëna nga tekstet e artikujve, shpeshësia e publikimeve, ilustrimet, konfigurimi i revistës, autorësia, burimet e informimit, tiparet organizative dhe profesionale, plotësuar me intervista marrë prej drejtuesve historikë të revistës *Time* dhe atyre aktualë. Këto të dhëna janë analizuar mandej, duke u mbështetur në analizën e këtyre përmbajtjeve, të teksteve, si edhe të organizatës pikërisht në teoritë e komunikimit, një pjesë e të cilave referohen edhe në këtë libër që keni në duar.

Belina Budini

Pak fjalë për veprën e Em Griffin

Em Griffin, që është autori i parë i këtij libri, e ka përqendruar kamerën e vet të vëzhgimit mbi teoritë që qarkullojnë aktualisht lidhur me komunikimin dhe, në çdo “ndalesë” të tij para derës së autorëve të tyre, ia ka arritur të interpretojë në shumë plane veçoritë e trajtimeve nga ana e kolegëve të tij (thujse të gjithë ata janë të angazhuar në jetën akademike), dhe ta shoqërojë studimin e tij të gjerë me shembuj konkretë, me analiza e krahasime, duke prekur njëkohësisht tematika të shumta brenda sferës së vet të studimit.

Ndaj mendoj se vlen të theksoj se ky tekst, që u vjen sot në dorë pedagogëve dhe studentëve tanë, do të gjejë një përdorim të gjerë, pasi në fokusin e tij janë gazetarët, mediat, marrëdhëniet mes individëve, ato mes individit e grupit a komunitetit ku ai bën pjesë; gjuha, mënyra e përdorimit të saj dhe problemet që dalin në rrugë e sipër; çështjet gjinore dhe “profilet” e komunikimit mes partnerëve (dialektet gjinore), organizatat dhe raportet komunikuese mes anëtarëve, hapësira

si aspekt kulturor, studimet kulturore dhe Stuart Hall, teoria e gjykimit social ose ajo e përcaktimit të axhendës, e pakësimit të pasigurisë, dialektika e marrëdhënieve dhe shumë e shumë të tjera.

Për ta përmbledhur me pak fjalë, nuk ka drejtim a disiplinë brenda fushës së shkencave të komunikimit që të mos ceket nga një studim i tillë shumë planësh, shpjegimet sqaruese rreth të cilit dhe argumentimi i strukturës tematike për çdo kapitull e merr përsipër vetë Griffin në faqet e para të librit. I shkruar me gjuhë të qartë dhe me shembuj konkretë, me një këndvështrim multidisiplinar, libri i tij plotëson bibliotekën ende të mangët në shqip për procesin e ndërlikuar e me shumë kënde të komunikimit dhe jep një model trajtimi të tij në kushte e në rrethana të caktuara. Për përdorimin e tij në auditor punën na e ka lehtësuar kolegja Budini, përkthimi mjeshër i së cilës na kujton se kur një angazhim i tillë ndërmerret nga njerëz të fushës dhe me talent, roli i përkthyesit vjen natyrshëm në nivelin e bashkautorësisë.

Kaq për librin, të cilin lexuesit (besojmë jo vetëm studentë e profesionistë të medias), do të kenë mundësi ta përdorin si një konsultim permanent për çdo detyrë a nismë në biznes, politikë, arsim, art, sport, ushtri; shkurt në çdo lëmë të veprimtarisë shoqërore ku komunikimi shihet, vlerësohet si një element i fuqishëm në aspektin e organizimit, të bashkëpunimit, të zgjidhjeve, përzgjedhjeve dhe aplikimit të politikave të reja drejtuese.

Ne dhe të tjerët

Kapitulli 39, i shkruar nga unë (Bashkim Gjergji), hedh një vështrim më të përgjithshëm mbi procesin e komunikimit në shoqërinë shqiptare. Që në krye kam nxituar të sqaroj se ideja e përfshirjes së tij në një botim të këtij lloji, me trajtime e sinteza, që autori Em Griffin i mbështet në lëndën bazë - studimet e shumta, të kahershme e aktuale, të një grupi të madh studiuesish, një pjesë prej të cilëve me reputacion ndërkombëtar, është ajo e përshkrimit të procesit të komunikimit ndërkulturor të shoqërisë shqiptare me botën dhe brenda vetvetes. Frymëzimi për të dhe optika brenda së cilës shihen dukuritë komunikuese me stampë shqiptare burojnë nga libri i Griffin, ato marrin shkas nga vështrimi i tij i thellë e i gjerë, nga përshkrimet ngacmuese e ndonjëherë me humor, nga ngacmimi i tij për të parë në thellësi të natyrës njerëzore dhe për të “gjykuar” fjalën, gjestin, marrëdhënien!

Duke i dhënë kapitullit në fjalë një prerje historike, e gjej me vend të theksoj se, *së pari*, kapitulli përqendrohet në dukuritë që shfaqen nga viti 1945 e vjen deri në ditët e sotme. Arsyeja e kësaj përzgjedhjeje ka qenë se e gjithë periudha e deri në kohën e sotme prezanton dinamika të shpejta zhvillimesh, ngjarjesh që kanë lënë gjurmë në tiparet psikologjiko-kulturore të shoqërisë dhe kanë përcaktuar format

e komunikimit. Aleancat e kohës komuniste dhe ajo çka i shoqëronte ato në planin kulturor si dhe izolimi i tejskajshëm plazmuan tipare dhe gjuhë komunikimi që në kapitull cilësohen e herë analizohen drejtpërdrejt duke iu referuar ideve e pikëpamjeve të autorëve të ndryshëm, e herë jepen në shtratin kronologjik për të krijuar një imazh linear për një gjeneratë të re, që nuk ka njohje personale, ndërkohë që informacione të pakta e sporadike i siguron në familje apo përmes ndonjë produkti mediatik si temat e së shkuarës ose filmat e kohës.

Së dyti, duke realizuar një lloj etnografie të komunikimit shqiptar, u pa e nevojshme që me përpjekje modeste të hidhej dritë mbi sfondin e ngjarjeve, të analizoheshin situatat që kanë përcaktuar dimensionet e komunikimit në shoqëri. Por gjithçka tjetër është menduar t’u lihet në dorë vetë studentëve. Duke lexuar me kujdes të gjithë kapitujt, ata do ta kenë më të lehtë të ballafaqojnë faktet shqiptare me teoritë e përfshira në tekst, të thellohen e të bëjnë analizat e tyre si dhe të mund të adoptojnë koncepte e instrumente analitike për të bërë krahasimet e natyrshme me çka ndodh sot në peizazhin mediatik e atë shoqëror në Shqipëri dhe më gjerë.

Një vend në këtë kapitull zënë edhe shqiptarët jashtë kufijve, kontaktet me të cilët vendosen e zgjerohen masivisht vetëm më rënien e komunizmit në të dyja anët e kufirit. Çështja e komunikimit mes vetë shqiptarëve është parë si një proces me faza të kushtëzuara nga politikat e ndjekura dhe si një fenomen interesant po të mbahet parasysh si izolimi i plotë i vendit tonë, ashtu edhe mungesa e njohjes, e kontakteve dhe e ndikimeve të ndërsjella mes dy palëve. Konceptimi i strukturës ë kapitullit sipas linjës së mësipërme dhe me qëllimin që përshkrova më sipër më ka detyruar të lë jashtë komunikimin me minoritetet, që jetojnë në zona të ndryshme të Shqipërisë, ose me popujt fqinj; po kështu edhe komunikimin gjinor ose mes besimtarëve, por kjo nuk besoj aspak se do pengojë auditorin ta përqendrojë me raste vëmendjen dhe diskutimin e vet edhe mbi këto drejtime.

Bashkim Gjergji

Lindja e politikës vetëshprehëse përmes teknologjive të reja

James Stanyer

Përktheu për POLIS: Alfred Lela

Abstrakt

Ky artikull mbi format e reja të komunikimit politik është shkëputur nga libri “Komunikimi politik modern” me autor James Stanyer, i cili është sjellë në shqip nga gazetari dhe anëtari i Departamenti të Komunikimit në UET, Alfred Lela. Ndërsa libri nuk ka dalë ende në gjuhën shqipe, trajtimi i Stanyer përbën një kontribut të rëndësishëm për temën e këtij numri të revistës, edhe pse nga një perspektivë e Britanisë së Madhe dhe Amerikës, si vendet ku praktikatat komunikative janë edhe më të shpejta e të zhvilluara. Në një kohë kur mënyrat e shprehjes së qëndrimit politik të publikut po ndryshojnë edhe në Shqipëri, të dhënat dhe analizat e Stanyer i flasin edhe realiteteve të reja në vendin tonë. Kështu, ndërsa publiku mund të shprehë pikëpamjet e tij mbi çështjet politike përmes një morie protestash dhe forumesh mediatike dhe, gjithashtu, përmes teknologjive të reja, për më tepër, publiku tani i përket një një mjedisi politik ku aktorë të ndryshëm e nxisin vazhdimisht për të shprehur pikëpamjet, qofshin këto në opozitë me veprimtarinë e qeverisë apo korporatave transnacionale, mbështetje për normat mjedisore apo ankesa për një kompani dhe për shërbimet e pushtetit vendor.

Hyrje

Publiku në Shtetet e Bashkuara dhe në Britaninë e Madhe, jo vetëm merr informacion dhe formon opinione por, gjithashtu, i shpreh pikëpamjet e veta mbi çështjet politike në një sërë mënyrash. Tradicionalisht, është menduar se opinioni publik futet në sistemin e komunikimit politik përmes një numri kanalesh të caktuara: repertorit të protestave si grevat, mitingjet dhe

demonstratat; kutive së votimit, medias, faqeve të letrave nga populli nëpër gazeta dhe sondazheve (Coleman, 2002b; Davis dhe Curtice, 2000; Hart, 2001; Inglehart, 1997b; McNair e të tjerë, 2003; Manin, 1997; Norris, 2002b; Pattie e të tjerë, 2003a, 2003b, 2004; Verba, e të tjerë, 1995; Wahl-Jorgensen, 2001). Këto kanale të ndryshme shiheshin si linja të qëndrueshme, përmes të cilave publiku mund të shprehte pikëpamjet e tij mbi çështjet politike. Megjithatë, për shumicën e publikut shprehja e opinioneve politike kufizohet kryesisht tek të votuarit në zgjedhje të ndryshme (Dalton e të tjerë). Por, ky realitet po ndryshon me shpejtësi.

Mënyra e shprehjes së qëndrimit politik të publikut po ndryshon. Ai nuk kufizohet më te ngjarje të caktuara si zgjedhjet dhe as nuk kërkon domosdoshmërisht praninë e të tjerëve. Publiku mund të shprehë pikëpamjet e tij mbi çështjet politike përmes një morie protestash dhe forumesh mediatike dhe, gjithashtu, përmes teknologjive të reja (Bucy dhe Gregson, 2001; Davis, R., 2005; Ferguson dhe Howell, 2004; Hill dhe Hughes, 1998). Për më tepër, publiku tani i përket një një mjedisi politik ku aktorë të ndryshëm e nxisin vazhdimisht për të shprehur pikëpamjet, qofshin këto në opozitë me veprimtarinë e qeverisë apo korporatave transnacionale, mbështetje për normat mjedisore apo ankesa për një kompani dhe për shërbimet e pushtetit vendor. Ndërsa numri i problemeve që kërkojnë vëmendjen e publikut rritet, mbajtja e qëndrimeve nuk kufizohet më te çështjet kombëtare dhe politika e zakonshme.

Kjo rritje e mundësive për format verbale të shprehjes nëpërmjet medias dhe për format joverbale të veprimeve simbolike përkthehet me një mbingopje nga publiku të sistemit të komunikimit politik si asnjëherë më parë (Blumler dhe Gurevitch, 2000). Të dyja vendet po përballen me shfaqjen e asaj që disa e kanë quajtur “kultura e vetëshprehjes” (Coleman, 2004) dhe të tjerë një mjedis “i ri” opinioni (Bennet, 2003 a) apo “demokraci të avokatisë” (Dalton e të tjerë, 2003). Me fjalë të tjera, një kulturë ku shprehja e mendimeve politike nxitet, mundësohet dhe lehtësohet vazhdimisht nga një mori individësh e organizatash, si dhe përmes formave të reja të teknologjisë së komunikimit.

Ky artikull hulumton shfaqjen e kësaj kulture të vetëshprehjes politike. Skicon rrugët, nëpërmjet të cilave publiku kërkon të shprehë pikëpamjet e tij. Shqyrton, gjithashtu, shtimin e mundësive të shprehjes së qëndrimeve, si dhe përpjekjet për mobilizimin e opinionit nga organizata të ndryshme. I bazuar në të dhëna nga burime të ndryshme kapitulli vëren shtimin e llojeve të caktuara të shprehjes së qëndrimit dhe se pjesë të caktuara të shoqërive amerikane dhe britanike janë më të prirura sesa të tjerat për të përfutur nga mundësitë e mbajtjes së qëndrimeve publike. Në mbyllje të kapitullit arrihet në përfundimin se edhe pse ky mjedis ofron mundësi të reja është shumë larg prej imazhit të agorës që i kanë veshur disa.

Repertorët politikë: të rinj e të vjetër

Qytetarët nuk kanë nevojë të presin për zgjedhje ose referendum dhe as të pyeten nga anketuesit për të shprehur opinionet e tyre. Ata mund t'i komunikojnë pikëpamjet e tyre mbi veprimtarinë e qeverisë dhe në një mori çështjesh të tjera, nëpërmjet rrugëve më pak të zakonshme dhe më të drejtpërdrejta. Ka forma tradicionale si grevat, zaptimet, demonstratat, votimi dhe dhënia e fondeve, të cilat të gjitha bashkë kanë një histori të gjatë dhe mbeten mënyra të rëndësishme të shprehjes së qëndrimit. Gjithashtu, ka forma të reja të protestës që janë bërë pjesë aksiomatike e shprehjes së qëndrimit politik përgjatë 40 vjetëve të fundit. Publiku mund ta thotë fjalën e tij nëpërmjet shumë veprimeve: bojkotimit të një prodhimi ose bashkimit me një “*boycott*” të mallrave etike* (*ethical goods*); firmosja e një peticioni; pjesëmarrja në një letër-zinxhir*; veshja e një *t-shirt*-i, parulle, kapeleje, manshete ku shkruhet një mesazh; shpërndarja e fletushkave, mbledhja e fondeve, dhurimi i parave përmes një *apeli telefonik* ose përmes një donacioni të tipit koncerte *rock 'n roll*-i. Kjo, sigurisht nuk është një listë gjithëpërfshirëse: forma të reja të protestës; hibride, internetike janë shfaqur vitet e fundit dhe publiku mundet, ta zëmë, t'i bashkohet një *e-mail*-i-zinxhir ose të firmosë një *e-petition*.

Votimi protestues dhe ai në zgjedhjet plotësuese (mesmandat)

Publiku përdor repertorë të vjetër në mënyra të reja: zgjedhjet shërbejnë për të regjistruar një protestë kundër politikave të qeverisë në fuqi ose për të shprehur antipati kundër partive kryesore politike. Ky votim-protestë shfaqet në zgjedhjet e përgjithshme, megjithëse është një tipar themelor i zgjedhjeve plotësuese (*mesmandat*), “zgjedhjeve të rendit të dytë” (*Rallings* dhe *Thrasher*, 2000; *Southwell* dhe *Everest*, 1998). Publiku, shpesh i përdor zgjedhjet e rendit të dytë ose zgjedhjet *mesmandat* për të dërguar një mesazh mosmiratimi të përgjithshëm, një mesazh pakënaqësie ose zemërimi rreth çështjeve të ndryshme. Këto zgjedhje mund të shihen si referendum informale mbi politikën dhe veprimtarinë e qeverisë.

Megjithëse pjesëmarrja në zgjedhjet e rendit të dytë dhe ato plotësuese (*mesmandat*) është e ulët, përfituesit e votave-protestë janë kundërshtarët kryesorë të qeverisë ose, ndonjëherë, partitë që garojnë në mbështetje të një çështjeje të vetme. Në Amerikë, në vitin 1994, shqetësimi rreth politikave të presidentit *Clinton* çoi në një reagim të fortë kundër demokratëve në zgjedhjet plotësuese (*Davies*, 1999). Në vitin 2006, trazimi rreth Irakut solli refuzimin e Partisë Republikane në zgjedhjet plotësuese. Në Britani, për shembull, Liberaldemokratët marrin vazhdimisht votat-protestë në zgjedhjet e pushtetit vendor ose zgjedhjet speciale.

Ndonjëherë përfituesit e votave-protestë janë kandidatët që garojnë me një kauzë të caktuar ose ata që protestojnë kundër *establishment*-it, me fjalë të tjera, kandidatët që përfaqësojnë shqetësimet e publikut: për shembull frika e mbylljes së një shkolle apo spitali mund të çojë në mbështetjen e një kandidati që e kundërshton këtë. Në Britani, shqetësimet rreth emigracionit dhe azilkërkuesve bënë që një pjesë e elektoratit të votonte për parti nacionaliste të ekstremit të djathtë. Këto shqetësime nuk janë vetëm lokale, por mund të jenë kombëtare dhe ndërkombëtare. Një shqetësim rreth procesit në vazhdim të integritit europian dhe Kushtetutës së Bashkimit Europian çoi në një rritje të ndjeshme të atyre që votuan për Partinë Independente në Britani në zgjedhjet për Parlamentin Europian të vitit 2004 - ata përfituan 16 për qind të votës.

Teknologjia e komunikimit të ri dhe media e hapur ndaj publikut

Shfaqja e medias së hapur ndaj publikut dhe teknologjive të komunikimit të ri i lejon publikut shprehjen e mëtejshme të opinionëve mbi një mori problemesh. Këto u shtohen formave të zakonshme si telefoni fiks, televizioni publik apo teknologjive të reja si telefonat celularë, televizioni dixhital dhe interneti. Mësymja e televizionit dixhital interaktiv u ka lejuar shikuesve të “luajnë” me programet përmes telekomandës. Megjithëse “regjistrimi” është më i kufizuar, krahasuar me teknologjitë e tjera, shikuesit “dixhitalë” mund t'i regjistrojnë opinionet e tyre drejtpërdrejt dhe me lehtësi; gjithashtu, mesazhet *sms* i kanë mundësuar publikut komunikimin e pikëpamjeve, pavarësisht vendndodhjes. Ndikimi i internetit ka qenë i madh dhe është pranuar si tillë. Siç vëren *Casrells*-i (2004), interneti në përgjithësi e ka rritur aftësinë e publikut për t'u mobilizuar rreth një çështjeje. Prania e *e-mail*-it, për shembull, e ka shtuar lehtësinë, me të cilën publiku mund të shprehet rreth problemeve: megjithëse publiku mundet të shkruajë letra dhe e bën këtë, *e-mail*-i garanton një mënyrë pothuajse të menjëhershme, me të cilën mesazhet mund t'i dërgohen qeverisë, përfaqësuesve të zgjedhur dhe medias (*Margolis* dhe *Resnick*, 2000). Interneti ka krijuar mundësi të mëtejshme për vetëshprehje përmes *chat-rooms* dhe grupeve *Usenet*, të cilat janë shtuar me tepri: gruper *Usenet*, për shembull, i ofrojnë publikut mundësinë e postimit të pikëpamjeve të tyre, por edhe komentet mbi to (*R. Davis*, 2005; *Hill* dhe *Hughes*, 1998). Larmia e programeve *software*, të lehta për t'u përdorur, ka çuar në shumimin e hyrjeve në rrjet (*web-logging*) dhe të blogjeve. Në vitin 1999, sipas një përlllogaritjeje ekzistonin më pak se 50 blogje (*Drezner* dhe *Farrell*, 2004); nga viti 2004, sipas një tjetër përlllogaritjeje kishte më shumë se 2.5 milion të tilla (*Technocrati*, 2004; cituar nga *Ferguson* dhe *Howell*, 2004). Të tjera përlllogaritje të kohëve të fundit e kanë “shtyrë” numrin edhe më lart, në 10 milion e sipër, megjithëse është e vështirë për të patur shifrën e përgjithshme (*Henning*, 2004). Blogjet janë simotrat internetike të ditarëve ku

postimeve të rregullta të bëra nga “i zoti” i faqes u shtohen shpesh edhe videoklipe dhe fotografi. Shumë prej tyre kanë një element që u lejon vizitorëve të reagojnë ndaj mesazheve (*Ferguson* dhe *Howell*, 2004). Uebfaqet si *YouTube* dhe *Bebo-Tv* janë bërë, gjithashtu, forume popullore për publikun, i cili poston në to video personale. Sipas përlllogaritjeve vetëm në Britani faqe të tilla numëronin rreth 3.6 milion përdorues gjatë vitit 2006 (*Harris*, 2006). Kjo nuk do të thotë se përmbajtja e blogjeve apo buletinëve të *Usenetit* është gjithnjë politike, por se ato ofrojnë raste për mesazhe politike, mundësi që më së shpeshti përdoren (*Cornfield* e të tjerë, 2005).

Format e shprehjes së qëndrimeve

Është e qartë se ekziston një numër i madh i mundësive të vetëshprehjes politike; sidoqoftë, rritja i përket një mënyre të caktuar të të shprehurit. Bëhet fjalë për ato që mund të emërtohen si forma të shprehjes “individualiste” dhe jo “kolektive”. Format individualiste të shprehjes së qëndrimeve, në ndryshim nga ato kolektive, nuk kërkojnë praninë e njëkohshme të të tjerëve. Format individualiste mbështeten në “hyrje” të grumbulluara për të pasur ndikim – numrat e firmosësve të një peticioni, për shembull, rriten me kalimin e kohës. Sidoqoftë, më shumë se kaq, përhapja iu përket formave të të shprehurit “jotradicionale” individualiste. Format jotradicionale ndryshojnë nga tradicionalet në disa drejtime. Së pari, ato janë më të shpejta; format jo-tradicionale janë kryesisht të atypëratyshme, sidomos ato që ndihmohen nga teknologjia e informacionit. Së dyti, ato marrin pak përkushtim; kryesisht nuk kërkojnë veprimtari kohëngrënëse, rezerva të shpenzuara apo anëtarësim në një organizatë. Së treti, ato janë më të volitshme: publiku nuk ka nevojë të presë votimet dhe që dikush të organizojë demonstrata apo anketime për të shprehur mendimin e tij. Nuk ka nevojë për të udhëtuar fizikisht; ata mund të shprehen në kohën e vendin e zgjedhur prej tyre dhe jo sipas zgjedhjes së dikujt tjetër.

TABELA 7.1 Format e shprehjes së qëndrimit nga publiku

	Tradicional	Jotradicional
Kolektiv	Demonstratat Grevat Zaptimet	Protestat në rrugë/festivalet Grumbullimet
Individualist	Votimi Shpërndarja e fletushkave Letrat Donacione monetare Usenets, chatrooms, t-shirt/shirita krahu ose kyqesh, e-mail, sms, telefonata	Firmosja e një peticioni Bojkoti “Buycott”-i Email letra-zinxhir, blogimi, vlogimi,

Burimi: Autori

Siç tregojnë ana e djathtë e tabelës 7.1, shtimi i mundësive të shprehjes gjatë 30 vjetëve të fundit u përket formave jo-tradicionale individualiste. Publiku ka më shumë mundësi që, shpejt e volitshëm, ta përcjellë mesazhin e tij të kundërshtimit apo mbështetjes ndaj një kauze me pak ose aspak angazhim. Sigurisht, format jotradicionale individualiste përdoren bashkë me ato kolektive e tradicionale: individët mund të zgjedhin t’i shprehin pikëpamjet e tyre mbi një çështje përmes blogjeve, telefonatave dhe *sms*-ve për emisionet radiofonike apo duke iu bashkuar një proteste a greve, duke votuar por, po aq lehtë, mund t’i dërgojnë një mesazh një programi radiofonik për një tjetër problem.

“Na thuaj ç’mendon?!”: nxitja e shprehjes së qëndrimit

Rritja e mundësive është shoqëruar me nxitjen e gjithanshme të publikut për të shprehur vetveten. *Manin*-i vëren se gjatë shumicës së shekullit XX, qëndrimet e publikut u kanalizuan kryesisht përmes mediave partiake ose të njëanshme. Ai argumenton se, gjatë erës së demokracisë së dominuar nga partitë, qytetarët nuk kishin zë përveç atij të partisë dhe organizatave motra të saj (1997). Në të dyja vendet sot ka një varg organizatash dhe individësh që ftojnë publikun për t’u shprehur. Publiku nxitet, pothuajse vazhdimisht, nga disa aktorë dhe organizata për të shfaqur pikëpamjet rreth një game të gjerë çështjesh. Nuk ndodh më që publiku t’i shprehë pikëpamjet e tij vetëm për ngjarje themelore dhe të mbetet në heshtje pjesën tjetër të kohës; qytetarët mund t’i shprehin opinionet e tyre rreth padrejtësive politike, urisë në botën në zhvillim, si edhe mjedisit, jetëstilit, kulturës dhe një vargu shqetësimesh të tjera materiale e postmateriale. Aktorët individualë dhe organizatat kanë kuptuar, gjithashtu, se inkurajimi i publikut duhet ndjekur nga përpjekjet për ta bërë shprehjen e opinionëve të shpejtë e volitës. Për shembull, që nga vitet ‘60, *issue entrepreneurs** kanë përdorur jo vetëm repertorë tradicionalë, por edhe repertorë individualë për të regjistruar opinionet.

Issue entrepreneurs, numri i të cilëve është rritur përgjatë 40 vjetëve të fundit, kanë qenë veçanërisht të suksesshëm në paraqitjen e një morie çështjesh para publikut. Këto lëvizje të reja shoqërore – grupe fetare, grupe kauzash dhe VIP-ash – jo vetëm që luajnë një rol në ndërgjegjësimin e publikut por, gjithashtu, gjë me shumë rëndësi, kërkojnë të lehtësojnë reagimet përmes mjeteve tradicionale ose jo. Ata krijojnë rregullisht mundësi të shprehjes publike, duke e mobilizuar opinionin përmes apelimeve të vazhdueshme (shih *Bennet*, 2003 a).

Reagime të tilla mund të kenë nxitës të ndryshëm: në të dyja vendet. Veprimtaritë e qeverive lokale dhe qendrore, taksat e reja apo rritja e tyre kanë vepruar si katalizatorë për zbrazjen e ndjenjave (shih kapitullin 5). Politikën dhe veprimtaria e qeverisë amerikane, si dhe politikën e institucioneve botërore si

Organizata Botërore e Shëndetësisë, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe G8-a kanë qenë një tjetër nxitës (Bennet, 2003 b). Grupet antiglobaliste kanë planifikuar, reklamuar dhe kordinuar demonstrata të njëkohshme në kryeqytete të ndryshme botërore (Castells, 2004). Paralelisht me të ashtuquajturën “Betejë në Seattle”, në nëntor të vitit 1999 pati protesta në 82 qytete të tjera (Licbach dhe Almeida, cituar nga Bennet, 2003b). Në vitin 2003, ndërhyrja në Irak shërbeu si mekanizëm i pashoq mobilizimi. Në Britani demonstratat kundër ndërhyrjes ishin projektuar për të dërguar një mesazh kundërshtimi, sa për George W. Bush-in, aq edhe për Tony Blair-in. Në vitin 2005 pati protesta me rastin e samitit të G8-ës, zemra e të cilave qe koncerti “Live 8”. *Issue entrepreneurs*, nën kostume të ndryshme, i mëshojnë një kauze qoftë kjo lokale, kombëtare apo globale dhe, gjithashtu, llojit të aksionit dhe qëllimit të tij.

Rritja e formave të shprehjes individualiste jotradicionale

Rrafshi ku *issue entrepreneurs-at* kanë mëshuar më fort ka qenë inkurajimi i reagimeve përmes mjeteve individualiste jotradicionale. Nëse publiku nuk është i gatshëm të marrë pjesë në një demonstratë mund të jetë gati të firmosë një petition, të veshë një *t-shirt* apo një shirit ose të angazhohet në ndonjë formë tjetër të shprehuri. Disa shembuj të kohëve të fundit janë veçanërisht ilustrues: ylli i popit Bono bashkë me një mori korporatash, lançoi prodhimet “Red” për të ndihmuar luftën ndaj varfërisë në Afrikë. Linja e produkteve “Red” përfshinte që nga celularët deri tek teshat dhe aksesoret, simbolikisht të gjitha në ngjyrë të kuqe. Grupi i kauzave “Liberty” u bashkua me stilisten Vivienne Westwood dhe prodhuan *t-shirts* për të theksuar gjendjen e vështirë të atyre që mbaheshin në burg pa një akuzë nga qeveritë amerikane e britanike në “Luftën kundër Terrorit”. Secila prej bluzave mbulohej nga fjalët “Unë nuk jam terrorist”. Në vitin 2005, në vazhdë të një ideje të shoqatës së bamirësisë së çiklistit amerikan Lance Armstrong, grupe të panumërta lobingu dhe bamirësie lançuan manshetat e tyre me ngjyrë të stampuara me një slogan.

Në shumë raste grupet e avokatisë kanë përdorur internetin për të dhënë versione online të mënyrave të të shprehurit *off-line*. Uebfaqet si *thepetitionsite.com*, *ipetitions.com* apo *pledgebank* u japin “rrëmuesve” akses dhe informacion rreth peticioneve dhe apelimeve për aksion mbi një numër çështjesh në vende të ndryshme, jo vetëm në Britani dhe në Amerikë. Ashtu si në rastin e një peticioni *off-line*, publikut i jepet një përmbledhje e çështjes dhe inkurajohet për të dhënë emrin dhe adresën e *e-mail-it*. Në ndryshim nga një petition *off-line*, kjo formë është e menjëherëshme dhe lejon shprehjen e mendimit aty për aty; nuk ke nevojë të shpresosh te fati i mirë i takimit me një aktivist në rrugë (Gurak dhe Logie, 2003; Johnson, 2005). Nëpër faqe të tilla mund të gjenden peticione mbi çështje lokale, kombëtare apo

globale dhe të firmosen menjëherë; siç vërejnë Gurak-u dhe Logie: “protestat *online* janë me kilometra përpara protestave tradicionale, përsa u takon shpejtësisë dhe numrave. Përpjekjet për të organizuar një protestë internetike maten kryesisht me orë dhe ditë, ndërkohë që protestat tradicionale nuk janë më të shpejta se posta” (2003). Kësisoj, interneti shpesh përdoret në të njëjtën kohë me bojkotin e konsumatorëve, demonstratat apo forma të tjera të aksionit të drejtpërdrejtë.

Issue entrepreneurs janë mobilizues informale të rëndësishëm të opinionit publik, por jo të vetmit. Institucionet publike dhe përfaqësuesit e zgjedhur, gjithashtu, kanë bërë hapa drejt inkurajimit dhe lehtësimit të reagimeve të publikut. Ndërkohë që shprehja me anë të referendumeve është dokumentuar gjerësisht (shih Dalton e të tjerë, 2003), përdorimi i shpeshtë i mjeteve individualiste jotradicionale nuk ka qenë i tillë. Në të dyja vendet, qeveritë lokale dhe sidomos ato kombëtare, kanë qenë disa nga aktorët kryesorë që kanë inkurajuar publikun për t’u shprehur si pjesë e të shfaqurit të vëmendshëm ndaj këtij reagimi. Në Britani, në nivelin e qeverisë lokale, një numër në rritje këshillash, u kërkojnë njerëzve opinionin e tyre mbi një mori çështjesh përmes fokus-grupeve, anketimeve, paneleve dhe jurive qytetare (Pratchett, 1999). Në të dyja vendet, që nga vitet ’80, ka patur një varg nismash, të cilat kanë synuar mundësimin e reagimit të publikut mbi një sërë çështjesh. Qeveritë e të dyja vendeve besojnë, gjithashtu, se interneti do të mundësojë riprojektimin e marrëdhënieve mes qeverisë dhe qytetarëve (Chadwick, 2006) dhe të dyja qeveritë kanë uebsajtet e tyre: *FirstGov* në Amerikë dhe *DirectGov* në Britani. Ato u lejojnë qytetarëve të kontaktojnë ministrat dhe nëpunësit civilë në departamente të ndryshme qeveritare përmes *e-mail-it*. Të dyja qeveritë kanë filluar, gjithashtu, të përdorin internetin për ta bërë më gjithëpërfshirës procesin e këshillimit publik, duke lejuar ministrat dhe nëpunësit të marrin mendimet e publikut. Kjo bëhet me synimin që të gjitha konsultimet publike të qeverisë qendrore të jenë të arritshme përmes internetit (Chadwick, 2006). Një skemë e ngjashme e inkurajimit të të rinjve për të shprehur pikëpamjet para komisioneve hetimore parlamentare u lançua në vitin 2006 në Britani nga Komiteti i Çështjeve të Brendshme dhe Shoqëria *Hansard* - një organizatë jopartiake e pavarur. Uebfaqet i ngritur posaçërisht për projektin “Thirrjet e Qytetarëve” u jepte të rinjve një numër telefoni duke u kërkuar pikëpamjet e tyre me anë të *sms*-ve mbi një radhë çështjesh, të cilat po konsideroheshin nga Komisioni.

Korrespondenca apo takimi me një përfaqësues të zgjedhur kanë qenë gjithmonë kanalet kryesore, përmes të cilave njerëzit mund të komunikonin pikëpamjet e tyre mbi një çështje. Përfaqësuesit e zgjedhur, në të dyja vendet, tani inkurajojnë edhe komunikimin me anë të *e-mail-it* dhe pothuajse të gjitha uebsajtet e tyre listojnë mënyrat e të kontaktuarit. Madje, disa inkurajojnë *sms*-të dhe kanë “tabela mesazhesh” ku zgjedhësit mund të lënë idetë e tyre (Ferguson dhe Howell, 2004; Johnson, 2004). Të dy, Presidenti dhe Kryeministri, i inkurajojnë kontaktet. Në

Amerikë, Shtëpia e Bardhë i kërkon publikut “të zgjedhë në një menu opsionesh, si kërkimi i ndihmës, ftesa për të marrë pjesë në një takim ose të shprehë miratim a mosmiratim rreth një pozicioni të Shtëpisë së Bardhë” (Davis dhe Owen, 1998). Në Britani, përveç elementëve të zakonshëm, uebsajti i *Downing Street* i jep publikut mundësinë për të projektuar dhe firmosur një *e-petition*.

Mediat *mainstream* i inkurajojnë, gjithashtu, shikuesit/lexuesit t’i bëjnë të njohura pikëpamjet e tyre: Ka patur një rritje të madhe të numrit të emisioneve, ku angazhohet publiku duke nxitur opinionet e një audience që nuk është e pranishme. Emisionet politike radiofonike janë ndoshta “lehtësuesit” më të njohur: ato “shtynë” dëgjuesit të telefonojnë dhe “të bëjnë me dije se ç’mendojnë”. *Sms*-të dhe *e-mail*-et janë bërë, gjithashtu, aspekte përcaktuese të *talk media*-s (Herbst, 1996; Ruddock, 2006). Këto programe përfaqësojnë një mundësi pak a shumë të re për publikun në parashtrimin e çështjeve. Siç vërejnë McNair-i e të tjerë “në Britani, para vitit 1948, askush nuk merrte pjesë në debatin politik të moderuar” (2003). Programet radifonike “merr në telefon” nuk ishin pjesë e dukshme e radios komerciale deri nga vitet ‘70 (Davis dhe Owen, 1998; McNair e të tjerë, 2003). Në Amerikë, nga vitet ‘80, u shfaqën *Christian Radio*, *NRA Radio* dhe shumë drejtues programesh të tjera politike, si *Rush Limbaugh* and *G. Gordon Liddy* (shih kapitullin 5).

Në Britani, megjithëse pati disa programe që përdornin formatin e pyetjes së dëgjuesve, ato ishin disa milje larg pjesëmarrjes së audiencës që u përhap vite më vonë. Metoda “merr në telefon” u fut në përdorim, kryesisht, përmes radiove lokale komerciale. Ky format më vonë u përhap edhe te media kombëtare (McNair e të tjerë, 2003). Pjesëmarrja e publikut në programet politike filloi në fundvitet ‘70, kur BBC-ja hapi *Question time*, të parin emision me “pjesëmarrjen” e publikut, i cili vazhdon edhe sot (McNair e të tjerë, 2003). Tani ka një varg emisionesh të tilla, të cilat janë bërë element kryesor i pasqyrimin të politikës veçanërisht gjatë fushatave zgjedhore. Një numër i madh i emisioneve politike kanë uebsajtet e tyre apo faqe në një uebsajt, ku mund të postohen pikëpamjet. Ato, gjithashtu, reklamojnë numrat e telefonit dhe adresat e *e-mail*-it gjatë transmetimit. Shumica e këtij “prodhimi” politik i nxit dëgjuesit dhe shikuesit të telefonojnë, t’i dërgojnë me *sms* e *e-mail* pikëpamjet e tyre apo të përdorin elementët interaktivë në televizorët e tyre dixhitalë, nëse kanë një të tillë. Një shembull i njohur në të dyja vendet ishte një ekuivalent politik i programit të suksesshëm *Pop Idol*, ku shikuesit e *American Candidate* në SHBA dhe *Vote for me* në Britani kishin mundësinë të votonin për një varg politikanësh të ardhshëm dhe për politikën e tyre.

Nxjtja e komenteve të audiencës është bërë një kusht paraprak i buletineve të lajmeve. Buletinet e lajmeve të rrjeteve televizive, jo vetëm rrjetet populiste të lajmeve apo programet e çështjeve të ditës, i bombardojnë shikuesit me kërkesa për komunikimin e pikëpamjeve të tyre; rrjetet serioze bëjnë të njëjtën gjë. Opinionistët e gazetave (*columnists*) japin adresat e *e-mail*-it, që lexuesit të mund

të reagojnë (shih Gunter, 2003) dhe tabloidët ofrojnë numrat e telefonit, që lexuesit të mund të japin mendime për çështje të ndryshme; në fakt, anketimet telefonike janë një element i zakonshëm i këtyre forumeve (shih kapitullin 5). Në Amerikë, një studim i uebsajteve të televizioneve informative zbuloi se 10 për qind e tyre ofronin forume diskutimi dhe 35 për qind ofronin forma *feedback*-u në faqe (*Chan-Olmsted* dhe *Park*, 2000). Pothuajse të gjitha gazetët kryesore amerikane u ofrojnë lexuesve mundësinë për t’iu përgjigjur editorialeve *online*.

Përvojat e këqija të njerëzve si pacientë, udhëtarë dhe konsumatorë, shpesh, veprojnë si forca të fuqishme mobilizuese për shprehjen e ankesave dhe, si rezultat, gjatë 40 vjetëve të fundit janë shfaqur organizatat *watchdog*, me qëllim ndihmën dhe adresimin e ankesave që mund të çojnë në përmirësimin e tyre apo të shërbimeve të tjera. Në Britani, Këshilli i Udhëtarëve të Hekurudhave dhe Posta janë dy nga disa institucione, veçanërisht të afta, në kanalizimin e ankesave rreth rrjetit të hekurudhave dhe shërbimit postar respektivisht-dy nga shërbimet publike me ankesa më të shumta.

Përmbledhtazi, publiku përmbytet nga kërkesat e një morie aktorësh për regjistrimin e mbështetjes apo kundërshtimit, kënaqësisë apo pakënaqësisë, për një varg çështjesh apo përvojash. Këta aktorë dhe organizata kanë kërkuar, veç të tjerash, financimin e kostos së shprehjes së qëndrimit të publikut nëpërmjet mjeteve individualiste jotradicionale.

Publiku komunikues?

Ndërsa publiku ka më shumë mundësi dhe nxitje për t’i regjistruar opinionet, a është duke i shfrytëzuar këto mundësi?

Ndërkohë që publiku përdor disa forma të caktuara individualiste të të shprehurit, nuk ka të dhëna, në rrafsh kombëtar, rreth shtrirjes me të cilën publiku i përdor teknologjitë e reja të këtij repertori për të komunikuar pikëpamjet e tij, kështu që faktet e përdorura këtu janë nxjerrë nga burime të ndryshme. Një sondazh i angazhimit politik *online* në Britani, zbuloi se rreth 17 për qind – që do të thotë rreth një e pesta e gjithë përdoruesve të internetit – thanë se kishin marrë pjesë në secilën prej formave të dhëna si “të vizituarit e një uebsajti, firmosja e një peticioni, dërgimi i një kartoline elektronike apo pjesëmarrja në një *chat room* apo tabelë diskutimesh” (Ward e të tjerë, 2003). Numri i njerëzve që futen në diskutime politike dhe grupe *chat*-i gjatë fushatave elektorale në Amerikë është rritur nga 2 milion në vitin 1996, në 6 milion në vitin 2004 (Pew Internet, 2005 a). Në vitin 2004, një 7-përqindësh tjetër dërgoi *e-mail*-e duke nxitur të tjerët për të votuar për një kandidat të caktuar (Pew Internet, 2005a).

Studimet dëshmojnë se interneti po përdoret nga publiku për të kontaktuar median e lajmeve. Në 1996-n, në Britani, *Times Online* mori rreth 100 *e-mail*-e

në ditë; nga 1999-a, e njëjta gazetë merrte 6 herë më shumë (Gunter, 2003). Përgjigjet ndaj kërkesave për koment nga emisionet televizive shkojnë në mijëra, në mos qindra-mijëra. Shpesh, përgjigjja është vetëm regjistrimi i një opinionit pro apo kundër një çështjeje. Në Britani, për shembull, në 2005-n, 100 mijë njerëz i dërguan sms *Radio Five Live* për të votuar mbi pyetjen, nëse shtypi kishte të drejtë të publikonte karikaturat e profetit Muhamed (Shaw, 2006).

Teknologjitë e reja të komunikimit po përdoren, gjithashtu, nga publiku për të kontaktuar qeverinë dhe përfaqësuesit e zgjedhur: në vitin 2001, 11 për qind e publikut britanik përdori komoditetet e qeverisë *online*; në vitin 2003, ky numër u rrit në 18 për qind (Taylor Nelson Sofres 2003, cituar nga Dunleavy e të tjerë, 2003). Në vitin 2000, Sekretari i Brendshëm i asaj kohe, Jack Straw, mori 70 000 *e-mail*-e, ku nxitej për të ekstraduar gjeneralin Pinochet, i cili gjendej në arrest shtëpiak në Britani (Duffy, 2000). Ndërsa ata që u ankuan rreth shërbimit postar me anë të letrave u dyfishuan gjatë periudhës 2000-‘04, ata që u ankuan me anë të *e-mail*-it apo telefonit ishin pak më shumë se katërfish (Postwatch Annual Report, 2004). Në Amerikë, në vitin 2003, sipas një sondazhi të Pew Center, nga 54 për qind e njerëzve që kontaktuan qeverinë, 42 për qind përdorën teknologji të vjetër si telefoni, 47 për qind përdorën internetin dhe 22 për qind përdorën të dyja teknologjitë: të reja e të vjetra. Shumica e kontaktuesve nëpërmjet shërbimeve online, 19 për qind, përdorën internetin për të regjistruar opinionet e tyre mbi çështjet dhe politikat (Pew Internet, 2004). Në Amerikë, numri i *e-mail*-eve të marra nga Kongresi u rrit dramatisht nga 51 milion në vitin 1999, në 128 milion në vitin 2002 (Johnson, 2004). Edhe në Britani, numri i atyre që u nisnin *e-mail* deputetëve të tyre u shtua. Numri i *e-mail*-eve dërguar Shtëpisë së Bardhë dhe Downing Street ka pësuar, gjithashtu, rritje: në 1993-shin, Shtëpia e Bardhë merrte 800 *e-mail*-e në ditë, numër që u rrit domethënshëm, duke shkuar në mijëra (Davis dhe Owen, 1998).

Megjithëse numri i atyre që kërkojnë të shprehen përmes mjeteve kolektive tradicionale është rritur vetëm pak, ka patur një shtim të atyre që duan t’i artikulojnë mendimet e tyre përmes mjeteve të ndryshme individualiste jotradicionale. Sidoqoftë, ky sigurisht nuk është një brez aktivistësh; të dhënat tregojnë se ka më shumë gjasa që shumica e publikut të vetëshprehet përmes pak veprimtarive gjatë një viti. Vetëm një pakicë mund të konsiderohet si rregullisht e përfshirë në veprimtari të shumta.

Ndërkohë që është shënuar rritje e shprehjes së publikut nëpërmjet mjeteve “më të reja” individualiste dhe “*low cost*”, kërkimet kanë zbuluar se një pjesë e opinionit është më e gatshme se të tjerat për shfrytëzimin e mundësive. Vullneti për të shprehur idetë politike duket se është i lidhur ngushtë me një varg faktorësh socio-ekonomikë si të ardhurat dhe arsimimi. Shprehja e bindjeve politike është, në fakt, e shtresëzuar siç vërejnë Schlozman e të tjerë (2004) dhe Pattie e të tjerë (2003b). Në Amerikë, kur “vjen puna tek protesta, më të arsimuarit dhe më të kamurit kanë

më shumë gjasa të bëhen pjesëmarrës” sesa të varfërit (Schlozman e të tjerë, 2004). Ata që fitojnë më shumë se 75 mijë dollarë kanë më shumë gjasa të përfshihen në aktivitete politike, sesa ata që fitojnë më pak se 15 mijë. Në Britani, Pattie e të tjerë, tregojnë se ata me më shumë gjasa për t’i bërë publike idetë e tyre përmes aksionit politik ishin profesionistët e punësuar që fitonin më shumë se 30 mijë paund në vit dhe ata të cilët janë shkolluar të paktën deri në moshën 19-vjeçare. Ata me më pak gjasa ishin të varfërit dhe shumë të varfërit, të cilët fitonin nën 10 mijë paund dhe, ata me më pak vite arsimim (2003 a). Ky kuadër u pohua edhe nga një sondazh i MORI-t, sipas të cilit, nga ata që merrnin pjesë në pesë apo gjashtë aksione politike (më aktivët), 80 për qind i përkisnin kategorive A, B dhe C1 krahasuar me 19 për qind nga C2, D dhe E (Worcester, 2002).

Këto gjetje përshtaten me përfundimet e të dhënave të sondazhet krahasuese. Norris-i vëren se në 15 demokraci industriale të përparuara, 40 për qind të atyre me nivel të lartë arsimor ishin përfshirë në të paktën një protestë, krahasuar me vetëm 24 për qind të atyre me nivele të ulëta shkollimi. Një hendek i ngjashëm ekziston edhe mes profesioneve: ndërsa 43 për qind të atyre që mbajnë poste menaxheriale-profesionale dhe 43 për qind të “punëtorëve me laps” ishin përfshirë në të paktën një protestë, vetëm 26 për qind e punëtorëve të krahut kishin bërë të njëjtën gjë (2002b).

Të dhënat e kufizuara tregojnë se të njëjtat grupe që përfshihen me anë formash të ndryshme, kanë më shumë gjasa për të kërkuar shprehjen e ideve të tyre mbi çështjet politike përmes medias. Në studimin e tyre cilësor, McNair-i me të tjerë vërejnë se të intervistuarit nga klasa punëtore ndjeheshin të përjashtuar nga emisionet me pjesëmarrës më të “ngritur”. Shumë nga fokus-grupet e tyre e shihnin “hyrjen dhe pjesëmarrjen në debate politike si kohë e lirë e “atyre” dhe jo “neve”- duke i konsideruar “ata” klasën e mesme të arsimuar dhe “ne” njerëzit e zakonshëm” (2003). Këto gjetje u përsëdytën pjesërisht nga Davis-i dhe Curtice-i, studimi i të cilëve mbi pjesëmarrjen në *talk show*-n radiofonik, *Election Call*, tregoi se telefonuesit e suksesshëm u përkisnin kryesisht mjedisëve menaxheriale-profesionale; 35 për qind e telefonuesve, krahasuar me 10 për qind punëtorë krahu dhe 8 për qind të papunë.

Relativisht të pasurit dhe të mirëarsimuarit kanë, gjithashtu, më shumë gjasa për t’i shprehur pikëpamjet e tyre mbi çështje politike para përfaqësuesve të zgjedhur. Në Amerikë, ata që fitojnë mbi 75 mijë dollarë, janë më të prirur për të kontaktuar qeverinë se ata që fitojnë nën 30 mijë dollarë (Pew Internet, 2004). Më të arsimuarit janë, gjithashtu, më të prirë të jenë aktivë në kontaktimin e qeverisë se më pak të arsimuarit (Bimber, 1999). Në Britani, 10 për qind e kategorive sociale A, B dhe C1 “mbajnë mend se ia kanë paraqitur idetë e tyre një deputeti” në 2-3 vitet e fundit, krahasuar me 3 për qind të kategorive C2, D dhe E (Electoral Commission, 2004 c).

Vëzhgimi i atyre që përdorin internetin për qëllime politike nga *Ward*-i e të tjerë, tregoi se pjesëmarrja është dominuar nga të arsimuarit e klasës së mesme të lartë: “Ndërsa klasat profesionale përbëjnë 18 për qind të totalit të të anketuarve, ata ishin pothuajse një e treta e pjesëmarrësve nga interneti. Punëtorët e krahut dhe gjysmë të kualifikuarit përbënin 32 për qind të të anketuarve, por vetëm 16 për qind e tyre “vinin” nga interneti”. Veç kësaj, “17 për qind e më të arsimuarve përbënin dy të pestat e pjesëmarrësve internetikë”.

Në Amerikë, *Pew Center* pasi anketoj ata që dërgonin rregullisht *e-mail*-e politike (62 për qind) apo që përfshiheshin rregullisht në diskutimet politike *online* (59 për qind), gjeti se 67 për qind ishin me diploma universitare ose kishin kryer pak vite universitet, ndërsa 67 për qind fitonin më shumë se 30 mijë dollarë (*Davis* dhe *Owen*, 1998). *Bimber*-i zbuloi se më të shkolluarit ishin më të prirë për të kontaktuar qeverinë përmes *e-mail*-it, krahasuar me më pak të arsimuarit (1999).

Të dhënat tregojnë se elitat qytetare të mirëarsimuara, relativisht të kamura dhe politikisht të motivuara janë të gatshme për të përqafuar format më të reja të pjesëmarrjes dhe aksionit politik. Në Britani, *Pattie* e të tjerë, vërejnë se “shprehja e bindjeve politike përqendrohet tek individët me burimet më të mëdha, qofshin këto të ardhurash apo aftësish” (2003). Një argument i ngjashëm mund të jetë përshkrues edhe për Amerikën (shih *Schlozman* e të tjerë, 2004).

Përfundime

Ky artikull është përpjekur të japë natyrën në ndryshim të shprehjes së qëndrimit të publikut. Tradicionalisht, ushtrimi i bindjeve politike ka qenë i kufizuar te ngjarje të caktuara, ka kërkuar përkushtim dhe nuk ka qenë, medoemos, i volitshëm në disa raste, duke kërkuar bashkëpraninë e të tjerëve. Gjatë 40 viteve të fundit dhe veçanërisht që nga mesi i viteve ‘90, shprehja e qëndrimit të publikut ka qenë e çliruar nga këto shtrëngesa teksa “strukturat e mundësive” të shprehjes janë zgjeruar (shih *Scott* dhe *Street*, 2001). Individët përmes opsioneve të rrjetit (*web*) ose *sms*-ve mund të përgjigjen menjëherë kur pyeten. Përparimet teknologjike, gjithashtu, mundësojnë një prani *online*, të cilën mund ta kenë dhe ta ruajnë lehtësisht me pak dijeni mbi teknologjinë (*Ferguson* dhe *Howell*, 2004). Publiku nuk ka nevojë të sakrifikojë ndonjë pjesë të kohës së lirë apo punës për të shprehur idetë. Nuk ka nevojë të pritët që mundësitë të organizohen nga aktorë të caktuar. Për shembull, votimi mund të jetë një veprimtari “*low cost*”, por koha e zgjedhjeve apo referendumi, zakonisht, nuk përcaktohet nga publiku.

Lobuesit, drejtuesit e emisioneve, VIP-at, qeveria dhe partitë politike vazhdimisht e nxisin shprehjen e qëndrimeve dhe i lehtësojnë ato përmes formave

dhe medimeve të reja. Shpejt e volitshëm dhe me kosto të ulët personale këta aktorë organizojnë mundësi për publikimin e ideve mbi një mori çështjesh: përgjigje ndaj një pyetjeje të ngritur nga një buletin lajmesh, nga një gazetë apo një drejtues emisioni, nga një firmë në një peticion; veshja e një *t-shirt*-i me slogan, zëvendësimi i disa mallrave të bojkotuar me të tjera, një *e-mail* me ankesa dhe shqetësime apo blerja e një CD-je. Në fakt, të dhënat e kufizuara tregojnë se publiku u përgjigjet të gjitha thirrjeve të mësipërme përmes një morie mjetesh individualiste jotradicionale.

Mund të thuhet se këta faktorë përbëjnë një kulturë politike të re të vetëshprehjes, dikur e karakterizuar nga një mori zërash që flisnin përballë njëri-tjetrit, duke promovuar dhe iu përgjigjur një pafundësie axhendash: kundër ndalimit të gjuetisë me qen; për të drejta të zgjeruara për baballarët e divorcuar; në favor të të drejtave të kafshëve; në kundërshtim të luftës në Irak; në mbështetje të dënimeve më të ashpra për kriminelët nën moshë; kundër kërkimeve *stem cell*; kundër vendosjes së një *billboard*-i të një kompanie celulare afër një shkolle fillore; dhe kështu pafund. Shumica e atyre që shprehin një opinion mbi këto e të tjera çështje e bëjnë këtë disa herë në vit dhe përmes metodash individualiste jotradicionale, shpesh si reagim i drejtpërdrejtë ndaj thirrjeve.

Kjo nuk do të thotë se nuk ka shpërthime kolektive, shprehje të zemërimit, pakënaqësi apo zmbrapsje, siç nuk do të thotë se nuk ka hapësira për rrahje mendimesh në arenën publike -në fakt, shtimi i blogjeve dhe grupeve *Usenet* dëshmon se kjo është e mundur (*Davis*, 2005). Kjo e jona, megjithatë, nuk mund të quhet një kulturë ku aktivizimi politik është më i madh. Kërkimet tregojnë se mjetet kolektive të shprehjes së qëndrimit nuk përdoren më shumë sot se në brezat e mëparshëm dhe që të përfshirët në debate janë shpesh një grup i vogël individësh me opinione të forta dhe mendjengjashëm (*Coleman*, 2002b; *Davis* dhe *Owen*, 1998; *Hill* dhe *Hughes*, 1998; *Margolis* dhe *Resnick*, 2000).

Kjo kulturë e vetëshprehjes është e tillë që publiku – të paktën më të arsimuarit dhe relativisht të kamurit – mundet dhe lëviz rrefshëm nga çështjet lokale tek ato kombëtare dhe globale, duke shprehur kundërshtim apo mbështetje me një varg mënyrash, tek dhe si e shohin të përshtatshme pa pasur nevojë të lëvizin jashtë lokalitetit të tyre apo të jenë anëtarë të një organizate. Një akt, të cilin brezat e mëparshëm do ta kishin pasur të vështirë, në mos të pamundur.

Fjalorth

***buycott**- e kundërta e bojkotit; një fushatë aktive e blerjes së produkteve ose shërbimeve të një kompanie apo një vendi të caktuar.

***chain letter**- përbëhet nga një mesazh që përpiket të bindë marrësin të bëjë disa kopje të kësaj letre dhe, më pas, t’ua kalojë ato sa më shumë njerëzve që të jetë e mundur.

***issue entrepreneur-** dikush që nuk kërkon bizneset më të “nxehta”, por zhvillon një strategji që i bën bizneset “të nxehta”. Ata krijojnë një “çështje” të rëndësishme për biznesin e tyre dhe më pas llojnë qeverinë apo çdo institucion tjetër, duke kërkuar ndihmë për rritjen e biznesit të tyre.

***ethical goods-** janë produkte që konsumatorët i konsiderojnë si të prodhuara në bazë të një standardi etik: që do të thotë duke i shkaktuar pak ose aspak dëm mjedisit, kafshëve.

ABSTRACTS

Euphemisms in the Albanian public discourse and their relationship with the truth

Gilman Bakalli

In this essay we will discuss about how euphemisms are used to describe the reality. Knowing that euphemisms appear in different lingual structures, it is important to differentiate some of the main categories where they are used. Firstly we will analyze some of the main functions of euphemisms and after we will discuss on some lingual types, their role in the semantic change, their comparison with the discursive acts and at the end analyzing their relationship with the truth and falsity.

“The Author Rebirth” through self-tailoring, the case of Edi Rama _____

_____ *Belina Budini* _____

Edi Rama has accepted publicly in the Guardian, in 2003 that he is a pop-star among leaders and a leader among pop-stars. He has styled himself as such not only during the years he led the Ministry of Culture or the Municipality of Tirana, but also now as a prime minister, a time when he has enriched his pop-star performance and PR. In a previous work, published in 2009, titled “Edi Rama, the pop (ulist) pop-star” I have analyzed his communicative strategies, while in this article I will discuss about his symbolic performance through photos, selfies, social networks posts etc. By using the semiotic analysis of Roland Barthes and his new paradigm proposed by Raoul Eshelman (2008), I will try to prove that through symbolic performances, the case of Edi Rama illustrates “the rebirth of the author” in the Albanian political communication. Given the multitude of these appearances, it is important to analyze the spread of show politics in our country as well. Rama has decided to bring a new political model whose application are and will be notable in media and public discourse as well.

Use of Facebook during the electoral campaign _____

_____ *Roland Lami* _____

Today social networks offer a new infrastructure for public media and public policies. Thanks to them are being created promises about a more direct democracy due to the immediate electronic voting, popular referendums, exit-polls etc. The last elections in Albania showed a growing tendency of using the internet but in difference with other countries and politicians, the candidates here used it more as a window where they could expose their daily activities instead of interacting with the public, who is more used than using the information. Communication happens vertically and not horizontally, same as they used the traditional media, a tendency that was evident during the electoral race of 2015 in Tirana, between Erion Veliaj and Halim Kosova.

Textual analysis of the first article of Sali Berisha, published in “Bashkimi” journal, September 1990

Alfred Lela

This paper tries to analyze the “languages” of one of the most important speeches held by Sali Berisha, in “Bashkimi” newspaper, in 1990. The analysis will be divided in two main parts; 1- old language- referring to the language used by the leadership during communism and that is similar with the concept of newspeak, elaborated by Orwell, or “ the totalitarian Albania, elaborated by Ardian Vehbiu; 2- “new language” – or the western language that brought to use new words such as pluralism, democracy, human rights, private property etc.; 3- “ technical or scientific language”, words that have to do with the profession of the speaker, in this case, medicine and last but not least 4- “ the ideological/ political language, terms referring to the left or the right wing. The aim of the paper is to create a dictionary of words and after a quantitative analysis to define which language is more important than others in the discourse of Dr. Sali Berisha.

Femininity in the Albanian tabloids

Irena Myzeqari & Teuta Zyberli

This paper aims to bring together gender as a variable and Discourse Analysis as a method in analyzing Fashion magazines in Albania and seeing the ways they portray women image and femininity in their pages. Critical studies on media have always said that gender is an important research angle and for Janice Radway “the analysis of texts shows aspects that confirm patriarchy... and that affirm women inferiority in the society (Maigret 2010: pp. 176). Judith Butler, influenced by the concepts of Michel Foucault, reveals a more radical approach on identity saying that “ saying is doing”, the social reality is primary a game of labeling and that gender is performative in the sense that individuals are what they do, not what they are” (Butler 1990: pp. 18). Said this, this paper aims to understand how is gender created in these pages, in terms of what is said is done or has to be done by women.

The efficacy of hypnotherapeutic techniques and relaxation in reducing anxiety: a quantitative study _____

_____ *Klodiana Rafti & Fleura Shkëmbi* _____

Hypnotism has faced many challenges in the history of psychology and medicine. Nevertheless, today hypnotherapy is included in standard psychological, medical or dental treatments. Anxiety disorders are present in almost all cultures and they reduce the quality of life. One prevalent disorder is generalized anxiety. Anxiety among college students is quite common. This study aimed at gaining knowledge on the effects of using hypnotherapy clinical techniques in reducing generalized anxiety and improving the quality of life. As part of the methodology, the study applied half-experimental methods, which included three therapeutic techniques: metaphor, ego strengthening and progressive relaxation with the purpose of reducing generalized anxiety in a case study on students of 20-30 years old. The sample consisted of 214 randomly selected students; The generalized anxiety questionnaire GAD-7 ($\alpha = .843$) was used as evaluation instrument. It resulted in low level of GAD ($n = 81$; 38 %), and a moderate level of GAD ($n = 34$; 16 %). In the second phase of the study 20 women and 20 men were selected from the sample above. These were divided into four groups (3 groups received the treatment: metaphor, ego strengthening and progressive relaxation) and the fourth group was used for control. The quantitative findings show that hypnotherapy techniques are more efficient than relaxation techniques, and it also appears that the technique of directly suggestions/authoritarian ego strengthening is more efficient than the technique indirect suggestions/metaphor tolerant in reducing generalized anxiety and improve the quality of life. Moreover, the results suggest that clinical hypnotherapy techniques and progressive relaxation techniques are effective in improving the quality of life. Due to cultural specificities, further studies are necessary to elaborate further the effectiveness of these techniques in our environment.

Key words: *hypnotherapy, techniques, generalized anxiety, quality of life*

Modernism and democracy: a critical approach to the theory of modernism _____

_____ *Gerti Sqapi* _____

The last decades of the XX century have known a considerable progress of changes towards democracy. That is why the study of democracy and democratization would built a school of thought embraced by many scholars of different disciplines, trying to answer one the main question of this process: what the factors that make possible the appearance and stability of democratic regimes in different countries? Different theories offer numerous tools to prove scientific evidences but one of the most prominent theories is the theory of modernism, based on the tradition of research imposed by Martin Lipset (1959). Its main claim is that it exists a correlative relationship between the social-economic development and democracy. This article tries to evaluate this thesis, discussing about main contribution done to this theory, dealing especially with critics addressed to it such as being a-historical, teleological from the point of social change it proposes.

Key words: *modernism, socio-economic development, structural conditions, transition, democratization*

The role of Muslims in building the Albanian national identity _____

_____ *Lulzim Hoxha* _____

This paper tries to prove the idea that the Albanian national conscience was a construct prepared by the Toske elites of the Ottoman administration, who at the end of the 19th century and beginning of 20th century were active in promoting ideas and interest in the political and cultural activities during those years. Said this, it is impossible to talk about national conscience without having in mind the role that Albanian politicians of the Ottoman Empire have played in promoting Albanian Nationalism. What was the role of the Toske elites in the Ottoman Empire and what did they do to develop the sense of identification among Albanians? What kind of impact did have the orientalist discourse in a society with a majority of Muslims that were part of the empire for more than 400 years? Based on a constructionist approach we will try to answer these questions, focusing more in the discourses of Albanian politicians who after independence became symbols of Albanian Nationalism.

Key words: *energy security, European context, diversifying energy sources, energy dependence*

Influences of the Greek and contemporary philosophy in the works of Gregory of Nice _____

_____ *Arjan Curri* _____

My two biggest loves, philosophy and theology have always intrigued by their shared affection and their never ending war in a mystical dance of love and hate. Since the moment that Christianity through the image of Pol, shifted to a more theological system, the old Greek philosophy became a method and a structure. This is the moment when we enter a new phase of the philosophical thought, that of patristica, that lasted from the second century till the 13th one and where Christianity was not only seen as a spiritual belief but was also part of a bigger structure compound by the metaphysical, dogmatic and philosophical theology mingled with classic and antique philosophy. Main figures of this period are Augustine, Hipos and Thomas Ac quines and many others are left apart, but whose contributions would complete the information we share in this field. If in the West we have a triumph of philosophy, in the East we find its contrary and philosophy serves to the theological sermons and if it contradicts them it is denied and considered an enemy. During my philosophical studies, I have been extremely impressed by the figure of Gregory of Nice and the fact that in comparison with other priests did not consider philosophy as an enemy, using it as a way to talk about Christianity in the elites, created the idea that it was itself a religion of the higher strata. That is why he is considered to be the Christian philosopher because he tried to bring together elements of Greek philosophy and Christian theology.

Key words: *Byzantine philosophy, patristic, theology, Platonism, Christianity*

Architectural plan for the “HARRY FULTZ” Area _____

_____ *Otjela Lubonja* _____

This policy paper is part of a scientific project, applied by Dr. Otjela Lubonja, whose aim is to propose a new project for an area in Tirana. This research deals with different theoretical and practical aspects of this area and through a detailed analysis we can propose creative ways how to improve its quality. This study aims to analyze, interpret and discover if there are any real chances for an effective change and if yes who are the possible mechanisms what would make this change possible. In the study are further clarified the reasons why this area has not been revived and thanks to previous works, different urban plans created for this area we could offer creative solutions for the improvement of its conditions. The project is just a part of a bigger research project that plans to be further expanded in other areas and by making concrete proposals interested stakeholders, while the university opens the discussion for further studies in the field of Architecture and Urban development

Youth, social networks and network society _____

_____ *Elisabeta Bajrami* _____

This paper is an attempt to understand why social networks are massively used by young people today and what are the negative and positive effects of it? What are the most popular social networks and how much time do they spend using them? The purpose of the study is to measure not only how social networks are used but also to reveal the reasons why they have become massively used and to measure the effects that this excessive use has in the life of a young student. The focus of this study are young students and the aim is to discover the reason why they use them such as: virtual communication, information, entertainment or other purposes like promoting certain social causes, promoting various initiatives related to studies and areas of interest etc. Based on a mixture of qualitative and the quantitative methods, this study analyzes how much time youth spend using these social networks especially (Facebook, Instagram, Twitter, YouTube, and Hi5). Empirical data were obtained through a questionnaire and the target group was compound of 200 young people from the age of 18 - over 22 years. The increasing use of new media is of special interest because we have to understand how much young people live are affected by them. The results show that in societies like ours, due to lack of control, social networks tends to bring more negative than positive consequences.

Key words: *technology; communication; social networks; Facebook*

BOOK REVIEW

The identity of Albanian political parties during 1990–2013. Roland Lami & Aleksandër Kocani. Lambert Academic Publishing _____

_____ *Anjeza Xhaferraj* _____

The lack of ideological difference among political parties was evident since the middle of 1960, when Otto Kircheimer identified “the catch –all” party as a new typology. In difference with the party of masses that gained success thanks to the capability to increase the devotion of an electorate that would “naturally” vote for her, this new type of party sends messages for everybody beyond their social class and status, challenging the notion of the party as a representative of the social hierarchy

BOOK REVIEW

On “A first Look on communication theories” and two approaches related to Albania _____

_____ *Bashkim Gjergji & Belina Budini* _____

“A first look to communication” is one of the most important textbooks in different universities in the USA and Em Griffin, as his author, has become a guru of theories of communication. As a lecturer of communication at EUT, I could say that this book has been quite useful to me even in those years when we were trying to bring it in Albanian. This is a great news for the students, as it is the first complete text in this field of study, but also for the lecturers, because it creates a strong basis for further research in studying communication. In this short essay we are going to give some details and aspects about the chapter 38 and 39 that were written by us. We have translated in Albanian the 9th edition of this book and in some cases we have brought examples, cases and studies from previous editions. For example the 18th chapter that talks about the Adaptation theory elaborated by Marshall Scott Poole, is taken from the 8th edition of the book. Same stands true for some movies and illustrations that the audience in Albania is familiar too. The language of the textbook is easy yet satisfying, a principle that has been kept during its translation and editing process in our language.

The birth of self-expressing politics through new technologies _____

_____ *James Stanyer* _____

This article is focused on the new forms of political communication, extracted from book written by James Stanyer and brought in Albanian by Alfred Lela, journalist and lecturer at the department of Communication, at EUT. While the book has not been published yet, the work of Stanyer is an important contribution for the journal's main topic because it brings new information on political communication in Great Britain and the USA. In times of great changes, the data and the analysis of Stanyer find relevance in our reality as well. Nowadays the audiences have the chance to express their ideas through protests and forum but also through new media tools, something that increases their chances to influence decision making and politics.

